



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 25 DHE 26 JANAR 2018

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 25. I 26. JANUARA 2018. GODINE

JANAR - JANUAR
2018

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtjen me armë nga z. Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike,
5. Shqyrtimi i propozim-Rezolutës për miratimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm - Agjenda 2030 për Kosovën,
6. Shqyrtimi i parë i Projekt-Kodit të Drejtësisë për të Mitur,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin 05/L-080,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azil,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për standardizim,
13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016,
14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016,
15. Shqyrtimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës, 2017-2026,
16. Zgjedhja e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
17. Zgjedhja e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit,
18. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare,
19. Propozimi për emërimin e tre (3) anëtarëve në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Interpelacija premijera Ramush Haradinaj, na zahtev parlamentarne grupe LDK, za informisanje Skupštine u vezi pucanja oružjem od strane g. Dardan Gashi, zamenik ministra i ministar Dijaspore i strateške investicije,
5. Razmatranje predlog - Rezolucije za usvajanje objekta za održiv razvoj - Agenda 2030 za Kosovo,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakonika o pravima maloletnika,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o unutrašnjoj kontroli javnih finansija,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javne funkcije,
9. Prvo razmatranje zakona o tretiranju bespravne gradnje,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-034 o Kosovskoj Agenciji za privatizaciju, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-115 i Zakonom br. 05/L-080,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona o azilu,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o standardizaciji,
13. Razmatranje godišnje izveštaja Regulativnog autoriteta za elektronske i poštanske komunikacije za 2016,
14. Razmatranje godišnjeg izveštaja Agencije za statistiku Kosova za 2016,
15. Razmatranje Strategije za energiju Republike Kosova za 2017-2026,
16. Izbor jednog (1) kandidata za ne izvršnog člana Odbora Centralne banke Republike Kosova,
17. Izbor 5 (pet) zamenika narodnog advokata,
18. Predlog parlamentarnih grupa o zameni članova u parlamentarnim komisijama,
19. Predlog o imenovanju tri (3) članova u Komisiji za prava, interese zajednica i povratak.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Fillojmë me seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar 30 minuta, në emër të grupit parlamentar diskutimi zgjat 5 minuta, gjersa për deputetin 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Po e shoh se Xhevahire Izmaqi nuk qenka këtu. Bekë Berisha, në emër të grupit. Urdhëro!

BEKË BERISHA: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Unë sot kam një kërkesë urgjente për banorët e Dukagjinit, të cilët janë duke bërë natën në të ftohtë pa rrymë, për shkak të kushteve atmosferike të ditëve të shkuara.

Unë si deputet kërkoj direkt nga kryeministri të marrë menjëherë masa dhe të formojë një komision për vlerësimin e dëmeve të erës së fundit në Istog dhe Pejë. Aty era shkaktoi dëme në prona private në rrjetin e energjisë elektrike dhe në bujqësi.

Kërkoj direkt nga kryeministri që komisionit të jetë nga Qeveria, sepse organet komunale të këtyre dy vendeve, edhe atëherë kur Qeveria bën ndonjë ndihmesë të vogël, aty formohet një komision turpi dhe ato ndihma nuk preken të gjithë të dëmtuarit, bëhet hile dhe ka keqpërdorime të vazhdueshme.

Banorët e kësaj ane janë punëtorë, bujq. Ju ftoj që ta zgjatni dorën e shtetit, kjo është kërkesë e tyre.

Gjithashtu mungesa e energjisë elektrike në këto ditë të ftohta e bën të vështirë jetën e qytetarëve.

Zyra e Rregullatorit për Energji të japë llogari për tolerimin që i është bërë KEDS-it për mungesë të furnizimit me energji elektrike.

Është e papranueshme që energjia që prodhohet të vend të eksportohet jashtë, përderisa qytetarët janë në terr.

Përfitimit të kompanive private në kurriz të qytetarëve duhet t'i vijë fundi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Driton Selmanaj e ka fjalën, po i kombinoj edhe sipas partive, në emër të grupit parlamentar.

DRITON SELMANAJ: Po flas në emër të grupit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vend se Kuvendi i Kosovës të diskutojë për problemet reale që kanë qytetarët e Kosovës, siç është gjendja në arsim, shëndetësi, mirëqenie e punësim, ne jemi të detyruar të reagojmë fuqishëm ndaj skandaleve të përjavshme që po na vinë nga Qeveria apo nga disa deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Në vazhden e këtyre skandaleve para disa ditësh 11 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë ndërmarrë një nismë legislative për amnistimin apo faljen e deputetëve që kanë kryer veprë penale në sallën e Kuvendit të Kosovës gjatë periudhës 25 gusht 2015 deri më 10 maj 2017.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të jepet lirim i plotë nga ndjekja penale apo nga ekzekutimi i dënimit të gjithë deputetëve kryes të veprave penale të përcaktuar me Kodin Penal të Kosovës, si mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pautorizuar të armëve, përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm, pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës nismën e tillë e vlerëson si të dëmshme, të pakuptimtë dhe në kundërshtim të plotë me përpjekjet tona për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e pavarësisë së pushteteve. Ne vlerësojmë se përmes kësaj nisme deputetë të Kuvendit të Kosovës provojnë të nxisin dhe të legjitimojnë përdorimin e mjeteve parapolitike në ambientet e Kuvendit të Kosovës për realizimin e qëllimeve politike. Mesazhi që kjo nismë dërgon te njerëzit që jetojnë në Kosovë, është se kushdo dhe kurdo mund të kryejë çfarëdo veprë penale dhe një ditë vjen një kastë politike e papërgjegjshme dhe i falë të gjitha ato.

Kjo nismë, bashkë me nismën tjetër për Dhomat e Specializuara, po dëshmon se subjektet politike që janë pjesë e koalicionit qeverisës dhe, për fat të keq në këtë nismë të fundit figurojnë edhe disa deputetë nga opozita, në këtë rast nga Lëvizja “Vetëvendosje”, po tregon se disa deputetë nga Qeveria dhe deputetë të tjerë i kanë shpallur luftë sistemit të drejtësisë në vend.

Në njërën anë, ata nuk ofrojnë bashkëpunim me Gjykatën Speciale, në anën tjetër ndërmarrin nisma për amnisti apo mosbashkëpunim me institucionet e drejtësisë vendore.

Deputetë nga shumica parlamentare kanë vendosur që nismat e tyre legislative të mos jenë të natyrave që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njerëzve që jetojnë në Kosovë, por të jenë vetëm të natyrës që lidhet me fatin e disa deputetëve ose disa pushtetarëve në vend.

Për dallim nga ju, të nderuar deputetë, LDK-ja ka ndërmarrë tri nisma legislative: Projektligjin për të ardhurat personale, Projektligjin për TVSH-në dhe Projektligjin për të ardhurat e korporatave, ligje të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në lehtësi për bujqit, zejtarët dhe shtresa të tjera në vendin tonë.

Po ta kishit përkushtimin, ashtu siç e keni narracionin që të bëjmë këtë shtet funksional dhe të konsoliduar, do të ishit pikërisht ju ata që do të bëni thirrje që institucionet e drejtësisë dhe vendosja e drejtësisë në këtë vend të fillonte pikërisht nga ju dhe ndaj jush. Por jo. Ju keni zgjedhur rrugën e kundërt, atë të luftimit të drejtësisë, pengimit të prokurorëve që t'i kryejnë obligimet, që ky Kuvend ua ka dhënë nëpërmjet Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon nga deputetët që e kanë nënshkruar këtë nismë që të tërhiqen nga ajo dhe t'i lejojnë institucionet e drejtësisë që të bëjnë punën e tyre. Nga ana tjetër, të përkushtohemi të gjithë së bashku që pamjet dhe sjelljet të tilla të përdorimit të gazit lotsjellës në Kuvend dhe mjeteve të tjera të ndaluara t'i takojnë historisë si një episod i turpshëm i parlamentarizmit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Dëshiroj ta shfrytëzohet këtë kohë që në emrin tim të shtroj disa kërkesa ose një kërkesë të disa qytetarëve që kanë origjinë nga Lugina e Preshevës, Bujanoci dhe Medvegja.

Është shtruar disa herë në këtë Parlament çështja e problemeve që kanë ata qytetarë në dokumente ose nxjerrjen e dokumentacionit ose kryerjen e obligimeve që ka shteti dhe që kanë ata në administrimin e plotë të pronës dhe jetës normale të tyre në Kosovë.

Siç e dimë, viteve të fundit disa mijëra persona shqiptar nga këto treva jetojnë në Kosovë, disa prej tyre tashmë kanë shtetësinë e Kosovës, disa të tjerë bëjnë punën e andej edhe këndeje, ndërsa disa prej tyre kanë vështirësi të plotë në marrjen e shtetësisë dhe në obligimet në këtë vend.

Unë e di që Ligjin për shtetësi e kemi bërë ne vetë këtu, e kemi trajtuar këtë problem disa herë. Dëshiroj ta shtroj tash, edhe pse është përsëritur disa herë, por mendoj që duhet të merret më seriozisht, nuk jemi në ndonjë fushatë zgjedhore.

Unë personalisht kam kërkesën e disa dhjetëra qytetarëve që jetojnë në Gjilan, po të tillë ka që jetojnë në Fushë-Kosovë dhe gjithandej në Kosovë.

Mendoj që duhet Qeveria, Ministria e Brendshme, të trajtojë edhe një herë këtë ligj, t'u bëhet e mundur, është fjala diku për nja 1 000 - 1 500 ose mund të shkojë deri në 2000 numri i personave që kanë probleme specifike, që kanë të bëjnë me qëndrimin në Kosovë. Janë familje të përziera, disa kanë, disa nuk kanë shtetësi. Është momenti i fundit që t'u dalim ndihmë këtyre personave.

Nuk bëhet fjalë për keqpërdorime ose nuk bëhet fjalë për kërkesa që kanë të bëjnë për shtetësi, se mund ta marrë një pasaportë që mund të bëjë vizë ose diçka tjetër, po thjesht për shkaqe humanitare.

Është momenti i fundit, mendoj që edhe presidenti, meqenëse kohët e fundit ka pasur një kërkesë nga Shqipëria që të bëjë zgjidhje për shtetësinë e kosovarëve. Mendoj që duhet të bëjmë ne një zgjidhje për qytetarët e Luginës së Preshevës, Bujanocit dhe të Medvegjës që jetojnë këtu, në mënyrë që ata të mund të jetojnë sa më mirë, sa më lehtë, disa prej tyre kanë probleme serioze me pushtetin atje prej ngjarjeve të fundit.

Unë u bëj thirrje edhe një herë Ministrisë së Brendshme, Qeverisë së Kosovës, presidentit të vendit që të ulen, të shikojnë se si mund të bëhet sa më shpejt, e sidomos për një numër të qytetarëve që kanë kërkesa specifike. Po them edhe një herë, diku mund të jenë një numër, sa kam informacione unë prej Ministrisë së Brendshme 1 500 deri në 2 000 persona, me të cilët duhet t'i zgjidhin problemet ose ne duhet t'u ndihmojmë të zgjidhin problemet administrative të qëndrimit të tyre rezident në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albin Kurti e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar, besoj.

ALBIN KURTI: Qytetarë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit,
Kabinet i Qeverisë,

Kjo Qeveri nuk e di se çka do të bëjë as 20 javët e ardhshme, mirëpo hyn në obligime shtetërore për 20 vjetët në vijim. Kontrata me "Contour Global" e vë Republikën e Kosovës, shtetin dhe interesin tonë publik, në shërbim të një ndërmarrje të huaj private. Nuk do të punojë "Contour Global" për Kosovën dhe qytetarët e saj, por ne do të punojmë për "Contour Global", sepse asaj, me paratë e qytetarëve ia marrim përsipër borxhin që ia shlyejmë dhe përfitimim që ia garantojmë.

Kontrata me "Bechtel-Enka" që na i fshiu gati 2 miliardë euro, kurrë s'u bë publike, pra ishte hajni pa transparencë. Kontrata me "Contour Global" duket se do të na i fshijë trefishin e "Bechtel-Enka"-s, por, kësaj radhe, si një hajni me transparencë, meqenëse u publikua kontrata.

Por, edhe këtu kemi transparencë jo të plotë, sepse disa anekseve nuk u dihet përmbajtja dhe ka transparencë veçse në rezultat, ama jo edhe në proces.

Prodhuesit vendës në Kosovë e dinë se shpesh nuk arrijnë të hyjnë në treg për shkak të pragut të lartë, mirëpo “Contour Global” i garantohet shitja e energjisë nga Qeveria përmes një ndërmarrje të posaçme publike që do të themelohet. Sipas kontratës, “Contour Global” do t’i paguhen të gjitha kostot, këstet e kredisë, kamata e tyre, fitimi, e madje edhe tatimi.

Jo vetëm çmimi i energjisë do të rritet, por falja e territorit të ndërtimit, zhvendosja e banorëve, shfrytëzimi dhe furnizimi me linjit, burimet e ujit që nevojiten, mospërshtatja me sistemin aktual, blloqet aktuale punojmë me 300 MW, teksa e reja parashihet 500 MW, norma tejet e lartë e kthimit të brendshëm prej 18,5% e deri te blerja pa limit e energjisë së prodhuar, madje me çmimin 20% më të lartë se 80 euro për MWh për çdo MWh të prodhuar më shumë, na tregojnë për një projekt rrënues, i cili merr gjithçka nga Kosova dhe jep si rezultat të fundit energji elektrike, të cilën Kosova e ka prodhuar dhe e prodhon që prej viteve ’60-a.

“Contour Global” do të marrë para nga kuleta e qytetarëve edhe si konsumatorë të energjisë, edhe si tatimpagues për buxhet.

Kur neve na duhet të paguajmë kaq shumë, ky nuk është kurrfarë investimi i huaj në Kosovë, por më parë, investim i Kosovës në një fond investiv të huaj, e për atë fond investiv të huaj.

Qeveria e Kosovës nuk ka një vizion zhvillimor nacional, ku ndërtimi i termocentraleve të reja do të ishte përbrenda atij plani ekonomik zhvillimor.

Kapacitetet e reja prej 500 MW janë plani i “Contour Global” për fitimin e saj, por jo plani i Qeverisë së Kosovës për zhvillimin e vendit. Nuk ekziston kurrfarë ndërlidhjeje mes kapaciteteve të reja energjetike dhe rritjes së industrisë në Kosovë.

Tetë fish më shumë energji elektrike në Kosovë shpenzon amvisëria se sa industria. 500 MW-ët e rinj nuk janë për ta ndryshuar këtë raport.

Askush nga zyrtarët e Kosovës të përfshirë në këtë aferë nuk mund të shpjegojë racionalisht përse Kosova nuk bën ta ndërtojë me pronësi publike investimin më fitimprurës që kemi në dorë dhe sipas kushteve e kërkesave të ekonomisë së saj, por duhet ta bëjë këtë nëpërmjet një fondi privat, të përzgjedhur pa e ditur shumëkush nga kush.

Jemi në një situatë të vështirë në sektorin e energjisë në Kosovë. KOST-i pengohet nga Serbia për anëtarësimin në ETSOE dhe si pasojë, interkonjeksioni me Shqipërinë është i bllokuar. Privatizimi i KEDS-it ishte krejt abuziv, e fort i dëmshëm. Projekti i rindërtimit të termocentralit

“Kosova A” nga “Billfinger”-i u pat shpërfillur. Tash, kontrata me “Contour Global” është fitim për ata, “Globalin”, e humnerë për neve lokalën.

Deputetët e Kuvendit duhet të japin ndihmën e tyre, duke mos e votuar, kurdo që marrëveshja vjen në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Islam Pacolli nuk është. Zonja time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Një numër i madh i qytetarëve të Republikës së Kosovës, të diplomuar në të gjitha nivelet e arsimit të lartë nëpër institucionet arsimore të Republikës së Shqipërisë, po ballafaqohen tash e një kohë shumë të gjatë me problemin e mosnjohjes së diplomave nga institucionet kompetente të Republikës së Kosovës.

Si rrjedhojë shumica nga ata kanë humbur vendet e punës, nuk kanë pasur mundësi të avancimit në profesion, nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë në konkurse të ndryshme punësimi dhe avancimi dhe vazhdojnë të sorollaten poshtë e përpjetë me përpjekjet e tyre që problemin, që në fund është administrativ, ta zgjidhin në favorin e tyre.

Pse veprohet kështu në Kosovë? Kjo duhet të ketë një përgjigje të duhur, në Shqipëri nuk veprohet kështu. MASHT-i njih diplomat e fituara në të gjitha institucionet e arsimit në Kosovë, nuk lejohet diskriminim, së paku jo në këtë fushë.

Shumë herë kemi dëgjuar në mediat elektronike dhe të shkruara prononcimet e ministres së Arsimit të Shqipërisë dhe ish-ministrit Bajrami se nuk do të ketë asnjë problem lidhur me nostrifikimin, njohjen dhe barasvlerën e diplomave të fituara në Shqipëri.

Madje, procedura edhe do të thjeshtësohet, duke potencuar se ato do të njihen brenda 24-48 orëve.

Ish-ministri Bajrami ishte deklaruar publikisht në Tiranë dhe në Prishtinë se çështja e njohjes së diplomave është vetëm çështje kohe, duke premtuar publikisht se kjo çështje do të zgjidhet pa procedura të koklavitura administrative dhe brenda një kohe të shkurtër. Madje ka nënshkruar marrëveshjen ndërqeveritare dhe ndërministrorë me Qeverinë e Shqipërisë, gjegjësisht me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri. Premtimi publik është kontratë që duhet realizuar.

Janë krijuar grupe punuese, janë bërë takime mes komisioneve qeveritare, por çështja nuk po gjen zgjidhjen.

Ju kërkojmë që të ndikoni sa më shpejt, duke mos zvarritur më tutje Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë çështjen e njohjes së diplomave të fituara në universitetet shqiptare, të ndikoni në këtë zgjidhje, sepse është bërë pothuajse një dekadë që nuk po shihet asnjë rezultat. Kjo nuk është çështje lëmoshe dhe as falje të diçkaje, është obligim shtetëror i ndërsjellë. Madje nuk kemi arsye t'i bëjmë bllokada dhe censura shtetit tonë amë, e sidomos kur bëhet fjalë për diploma.

Ne kërkojmë dhe besojmë në ndikime dhe veprimin tuaj në zgjidhjen urgjente të problemit të stërzgatur dhe të pakuptimit.

Andaj, apeloj te ministri i Arsimit që seriozisht të merret me këtë çështje, në mënyrë që gjithë atyre që kanë diplomuar në Republikën e Shqipërisë t'u njihen diplomat, në mënyrë që të kenë të drejtë punësimi dhe të avancimit në sektorin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Albulena Balaj-Halimaj, të bëhet gati Xhevahire Izma.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Të nderuar qytetarë,

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Dhe ju kolegë deputetë,

Unë desha të ngre një çështje, e cila ka kaluar qe disa muaj, por që këtu në Kuvend nuk është diskutuar dhe mua tani m'u dha rasti, ka të bëjë me Universitetin e Prishtinës.

Kisha Ortodokse në kampusin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" është simbol i dhunës, i cili ushtronte pushtet absolut në mënyrë brutale.

Kombi shqiptar dhe qytetarët e Kosovës janë ndër popujt që shquhen për tolerancë fetare. Por, duke pasur parasysh se jemi një shtet laik, nuk mund t'i shkelim ligjet për të cilët dëshmorët e këtij vendi kanë derdhur gjak.

Ky objekt kulti ka uzurpuar pronën e Universitetit të Prishtinës dhe nuk ka asnjë të drejtë juridike që të qëndrojë i tillë në pronën e universitetit.

Në padinë që është nisur nga vetë Universiteti i Prishtinës, tashmë gjykata ka dhënë verdiktin e saj, i cili është i papranueshëm dhe për të cilin duhet të kërkohet llogari nga përgjegjësit e universitetit.

Në padinë që është nisur, si pasojë e mungesës së përfaqësuesve të Universitetit të Prishtinës në gjyq për pronësinë e tokës në kampusin e UP-së, është sjellë një vendim i dëmshëm për pronën e universitetit dhe shtrohet pyetje pse kanë munguar përfaqësuesit e universitetit?

Si pasojë e mungesës së përfaqësuesve të universitetit në seancën gjyqësore Gjykata e Apelit ka marrë vendim që të hedhë poshtë si të pabazuar ankesën e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” kundër vendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Në vendimin e Gjykatës së Apelit të marrë më datë 27.9.2017 thuhet se vendimi i Gjykatës Themelore në vitin 2015 kishte qenë i bazuar, meqenëse pala paditëse, përkatësisht UP-ja, nuk ishte paraqitur në seancën kryesore lidhur me këtë kontest. Sipas Gjykatës, arsytimi i UP-së për mospjesëmarrje në seancë të vitit 2015 kishte qenë fakti se ka pasur protesta të shumta para kishës së lartpërmendur. Pyetja a duhet të japë llogari dikush për përgjegjësinë ndaj pjesëmarrjes në një seancë gjyqësore të rëndësishme së veçantë, ku si pasojë kemi humbur rreth katër hektarë tokë të Universitetit të Prishtinës.

Pretendimet ankimore të palës paditëse më 17.11.2015 dhe më 18.11.2015 para ndërtesës së Rektoratit ka pasur protesta prej disa dhjetëra punëtorëve, kjo gjykatë i konsideroi si të pabazuara, sepse kjo nuk ishte pengesë që ata të mos marrin pjesë në seancë.

Prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore Gjykata e Apelit i konsideroi të pabazuara dhe të paqëndrueshme, nga se nuk kanë bazë për prova konkrete, thuhet në vendim.

Edhe në sqarimin që ka kërkuar ministri i Arsimit, zoti Shyqiri Bytyqi, nga Rektorati i Universitetit, është arsyetuar se në atë kohë nuk kanë qenë të njëjtit në detyrë, por e hedh fajin në menaxhmentin e kaluar, gjë edhe ky arsyetim nuk e mbulon dëmin e madh që i është shkaktuar Universitetit të Prishtinës.

Nga informacionet që na afron ministri Bytyqi, ai ka insistuar që kjo çështje të vazhdojë me një padi të re, për të cilën ka angazhuar edhe Zyrën ligjore të MASHT-it për të ndihmuar në procese dhe njëkohësisht ka kërkuar raporte të detajuara nga menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës.

Por neglizhenca nga ana e Universitetit të Prishtinës për një çështje kaq të rëndësishme nuk e shfajëson dhe as nuk heq përgjegjësinë e përfaqësuesve të universitetit për llogaridhënie lidhur me këtë çështje.

Studentët e Universitetit të Prishtinës duhet të kalojnë çdo ditë pranë këtij objekti për të ndjekur studimet e tyre, të kujtojnë se çfarë ka bërë një sistem i kohës së Milosheviqit për vite të tëra, derisa UP-ja i neglizhon procedurat ligjore, e ndihmon regjimin e asaj kohe, duke e mbajtur objektin e kultit që kishte për synim vetëm të tregonte pushtet, uzurpim dhe spastrim etnik.

Si përfaqësuese e popullit kërkoj përgjegjësi nga përfaqësuesit e Universitetit të Prishtinës për një vendim të tillë nga ana e gjykatës dhe persona përgjegjës të tjerë kompetentë, të marrin masa ose hapa konkretë në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Xhevahire, fjala për ju. Ndërkohë të bëhet gati Naser Rugova.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit për fjalën, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fjala ime kisha pasur dëshirë t'i adresohet edhe fizikisht ministrit, meqenëse nuk është këtu, po shpresoj që diku e përcjell, po ashtu edhe kryeministrit.

Kolegë të nderuar,

Të respektuar qytetarë,

Marr shkas të diskutoj mbi një temë, e cila u bë një shqetësim i shtuar ditëve të fundit për qindra familje tona, prindër dhe studentë, rreth deklaratave të ministrit të nderuar të Arsimit se në shpejtësi do të dalë me një vendim për mbylljen e universiteteve publike, shtatë të tilla aktualisht, duke pritur një vlerësim të një komisioni të formuar, po ashtu në një kohë rekorde që lë vend për të besuar në një vlerësim kualitativ, në kohën kur i gëzohemi faktit që kemi mundësi të flasim për përpjekjet në cilësi në procesin edukativo-arsimor.

Nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike, i nderuar ministër, jeni deklaruar që keni formuar një komision vlerësues, e për këta emra që mësuam se janë në këtë komision, ne na vijnë informacione si deputetë se të gjithë këta kanë qenë persona që kanë përfituar duke qenë ose rektorë themelues, ose prorektorë, ose edhe anëtarë të këshillave drejtues të këtyre universiteteve, të cilat ju jeni deklaruar se do t'i mbyllni, sipas raportit që është duke u përgatitur nga këta ekspertë.

Sa janë kredibilë këta emra ekspertësh, a kanë konflikt interesi këta ekspertë përfitues nga postet që kanë mbajtur në pozitat udhëheqëse të këtyre universiteteve në themelim dhe ku nuk kanë mundur të rizgjidhen të rregullt si rektorë apo në një pozitë tjetër, tash duhet të jenë të besueshëm dhe sa duhet të jenë të besueshëm në këtë hartim të këtij raporti, që si duket, mund të parashikojmë se si do të vijë.

Edhe një çështje, ne morëm po ashtu informacion se edhe ju vetë nuk ishit takuar ende ndonjëherë me asnjërin nga rektorët aktualë, mirëpo në faqen zyrtare kemi parë vetëm një takim nga një përfaqësues i një universiteti privat.

Komisioni, qysh është tani, është edhe në shpërputhje me Ligjin për arsimin e lartë dhe Udhëzimin administrativ në fuqi, sepse është Agjencia e Kosovës për Akreditim ajo që vlerëson cilësinë dhe qëndrueshmërinë e programeve që lejohen në institucionet e arsimit të lartë, për të cilat sigurisht janë angazhuar edhe ekspertë ndërkombëtarë.

Mandej Bordi i cilësisë së AKA-s merr vendim për këto programe, ku në kuadër të këtij bordi ka edhe tre ekspertë ndërkombëtarë, shkarkimi i të cilit u bë në kohë rekorde, po ashtu në justifikim për jodëgjueshmëri dhe jobashkëpunim, ndërsa realiteti është që ju nuk i kishit ftuar asnjëherë, pra, për asnjë bashkëpunim a takim.

Cilësinë dhe qëndrueshmërinë e programeve e monitorojnë, e bën hapjen dhe mbylljen e tyre vetëm Agjencia për Akreditim, me qindra ekspertë ndërkombëtarë, e jo një grup ekspertësh i krijuar ad hoc, i cili do të sjellë vendimin për mbylljen e pesë universiteteve, dhjetëra programeve dhe hedhjen në ajër të miliona investimeve nga paraja e popullit. Për shembull, vetëm në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë janë investuar mbi 20 milionë euro në infrastrukturë. Në periudhën kur morëm vendim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kërkoj falje, deputete! Jo, se thonë po e lë të grupit të vet parlamentar, e pasi duam ta respektojmë Rregulloren, Xhevahire kërkoj falje, por për tre minuta u thanë ato që u thanë.

Naser, fjala është për ju, ora është dy e gjysmë, e kemi filluar në orën dy, edhe gjashtë vetë i kemi, i fundit je, zoti Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dola në këtë foltore të ngre një çështje shumë të rëndësishme, autoritetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe autoriteti ynë si deputetë të këtij Kuvendi, si të zgjedhur të popullit. Nga vizitat që po i kemi dhe ftesat që i kemi nga mekanizmat, institucionet e caktuara ndërkombëtare, asociacionet apo edhe pjesëmarrja jonë në tubime të caktuara, është një terror i vërtetë i procedimit lidhur me vizat.

Paramendojeni kur një trajtim i tillë bëhet për neve si të zgjedhur të popullit, me çka ballafaqohet qytetari i Kosovës. Andaj, zoti kryetar, kërkoj nga ju dhe Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të arrihet një marrëveshje me ambasadat relevante këtu. Kush ka probleme me ligjin dhe probleme të tjera, është çështje tjetër, mirëpo thjesht imazhi, profili dhe identiteti i shtetit tonë, po edhe i institucionit më të lartë, që është Kuvendi i Republikës së Kosovës, po nëpërkëmbet dhe ne si të zgjedhur të popullit dhe si institucione, pa marrë parasysh pozitë-opozitë, duhet ta ngremë këtë çështje si të zgjedhur të popullit.

Nën dy, nga takimet që po kemi në shtetet e caktuara, por edhe me institucione ndërkombëtare të caktuara kërkoj nga kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ministri i Punëve të Jashtme të bisedojnë me ata ambasadorë dhe përfaqësues diplomatikë që nuk lënë gur pa hedhur ndaj shtetit të Kosovës, ndaj institucioneve, pa marrë parasysh se kush qeveris me Kosovën. Ata

na përfaqësojnë të gjithë neve, e përfaqësojnë profilin, identitetin dhe imazhin e këtij shteti. Kemi dëshmi dhe jemi dëshmitarë të paradokseve dhe skandaleve të tilla diplomatike. Dhe, nën tre, një çështje shumë humane: studentët që po i përfundojnë studimet të nivelit Bachelor në Kosovë kanë probleme serioze që ta përfundojnë një periudhë të caktuar praktikën. Kërkoj nga Qeveria, nga ministritë e linjës, por edhe nga kuvendet komunale, po edhe nga të gjithë kolegët deputetë që ta marrim një nismë ligjore, që të gjithë studentëve që i përfundojnë studimet Bachelor t'ua mundësojmë me ligj që ta mbarojnë praktikën në kohë të nevojshme, në institucionet publike të Republikës së Kosovës, pse jo edhe në ato publiko-private dhe të ndikojmë që edhe në sektorin privat të ndodhë kjo. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45 paragrafi 1 së Rregullores së Kuvendit koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Në këtë seancë janë parashtruar 44 pyetje parlamentare. Në fillim fillojmë me pyetjet e bartura nga seancat e mëparshme.

Deputeti Frashër Krasniqi, pyetje për ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri. Deputetja Arbëria Nagavci, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ARBËRIE NAGAVCI: Ministri as kësaj radhe nuk qenka këtu, mirëpo meqenëse pyetja adreson një çështje të rëndësishme, unë do ta bëj atë. Bëhet fjalë për vendimin e ministrit për shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, të datës 25 shtator 2017, dhe ushtruesit të detyrës së drejtorit të kësaj agjencie.

Në lidhje me shkarkimin e Bordit të agjencisë, unë i kisha bërë një pyetje parlamentare edhe kryeministrit Haradinaj, por përgjigja e tij ishte krejtësisht sipërfaqësore dhe pa asnjë argumentim në lidhje me shkeljet e supozuara, me veprimet që do të ndërmerren në raport me ato shkelje dhe me njoftimin e publikut dhe Parlamentit për gjetjet eventuale rreth performansës së anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë apo veprimet në lidhje me parregullsitë serioze, siç kanë thënë ata, në akreditim në arsimin e lartë.

Pyetja parlamentare për ministrin e Arsimit, për të cilën shpresoj se do të marr përgjigje, pasi që është edhe obligim ligjor i tij, është në lidhje me veprimet që ata i kanë ndërmarrë për të evidentuar shkeljet e supozuara, konkretisht a kanë propozuar krijimin e ndonjë komisioni profesional për të hetuar këto raste dhe çfarë kanë ndërmarrë në raport me vendimet e paligjshme, për të cilat ata thonë se kanë identifikuar apo të dëmshme që i kanë supozuar. Po ashtu, pyetja ka të bëjë me veprimet që ata i kanë marrë në raport me njoftimin e organeve

kompetente për shkeljet e bëra nga ish-anëtarët, kur dihet se disa prej atyre vazhdojnë të mbajnë akoma pozita të larta shtetërore.

Dhe, në fund, ministri duhet të na njoftojë se kur ka planifikuar të raportojë në këtë Kuvend në lidhje me vendimin për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, pasi që ky është obligim sipas Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës, konkretisht neni 7, pika 5, ku decidivisht parashihet se nëse më shumë se 1/3 e anëtarëve të Bordit zëvendësohen për çfarëdo arsye...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Ministri nuk është këtu! Deputetja Besa Baftiu, në qoftë se dëshironi ta bëni pyetjen për ministrin Uran Ismajli, i cili është në udhëtim, dëshiron ta bëni? Urdhëro, fjala është për ju!

BESA BAFTIU: Po, po e bëj pyetjen, meqenëse kjo pyetje është parashtruar më 21 nëntor të vitit të kaluar, kanë kaluar dy muaj e më tepër. Edhe pse ministri Uran Ismajlin e pashë që ishte në seancën paraprahe, për të cilën nuk ka qenë ndoshta i obliguar, e tani do të duhej të ishte këtu.

Kjo pyetje ndonëse, thashë, është parashtruar para dy muajve, është aktuale dhe sot e kësaj dite, sepse ka të bëjë me mungesë të barnave, e siç e dimë ne si Kuvend, me rishikim të buxhetit, falë ndërhyrjes së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kontingjenti prej 11 milionë eurove faktikisht është destinuar për barna esenciale dhe për trajtim jashtë vendit. Mirëpo, çka ka ndodhur në praktikë, në realitet edhe sot e kësaj dite ndonëse kemi buxhetin më të madh për shëndetësi, ndonëse është rritur buxheti për barna, sot në spitalet e Republikës së Kosovës, në Qendrat e mjekësisë familjare mungojnë barnat më esenciale. Paramendojeni nuk ka edhe një vitaminë të vetme që është në protokoll që t'u jepet fëmijëve të porsalindur tash e tre muaj.

Prandaj, unë besoj se ministri e ka parë pyetjen, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje, jo përgjigje këtu në Kuvend, mirëpo do të duhej të jepte përgjigje duke përmirësuar furnizimin me barna esenciale nëpër spitalet e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Drita Millaku, pyetje për ministrin Kujtim Gashi.

DRITA MILLAKU: Përshëndetje për të gjithë!

Pyetja ime i drejtohet ministrit të Kulturës, zotit Kujtim Gashi. Zoti ministër, a jeni në dijeni që me rastin e fillimit të punimeve të impiantit të ujërave të zeza në fshatin Vlashnje, artefaktet dhe zbulimet arkeologjike janë dëmtuar.

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Instituti Arkeologjik i Kosovës është njoftuar për fillimin e ndërtimit të impiantit nga ana e përfituesve të këtij projekti, në këtë rast nga regjioni jugor në mesin e vitit 2016 dhe me këtë rast zyrtarët e Institutit Arkeologjik të Kosovës kanë dalë në terren për të analizuar gjendjen.

Në bazë të raporteve të marra nga ana e Institutit Arkeologjik të Kosovës, i cili është kompetent për gjurmime arkeologjike, sipas legjislacionit në fuqi, pra Ligjit për trashëgiminë kulturore, “Hidroregjioni Jugor”, si implementues i realizimit të këtij projekti ka prezantuar projektin për ndërtimin e impiantit dhe i njëjti është pajisur me pëlqim nga ana e institucioneve kompetente. Gjithashtu, para fillimit të punimeve të IAK-ut, nëpërmjet bashkëpunëtorëve profesionalë ka bërë kontrollin e zonës dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për gjurmime arkeologjike me karakter shpëtimi, që do të thotë, nuk janë shkatërruar gjurmët arkeologjike të këtij lokaliteti. Deri më tani, në bazë të njoftimeve që kemi, është gjurmuar e gjithë sipërfaqja ku do të ndërtohet impianti dhe gjurmimet kanë vazhduar edhe në sipërfaqet, të cilat do të mbetet hapësirë e gjelbër dhe nga ana e arkeologëve është konstatuar se impianti përfshin zonën periferike të vendbanimit arkeologjik të Vlashnjës ose një pjesë e Poslishtit.

Në referencë të raporteve periodike që ka pranuar MKRS-ja, Instituti Arkeologjik i Kosovës vazhdon ta monitorojë procesin e ndërtimit të impiantit çdo ditë pune dhe kjo mbikëqyrje do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Projekti është realizuar falë memorandumit, përkrahjes financiare të “Hidroregjionit”, njëherësh është rasti i parë që aplikuesi për pëlqim zbaton ligjin në përpikëri, mbulon të gjitha shpenzimet financiare. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe unë si ministër do të mbetemi të përkushtuar që përmes institucioneve vartëse, të cilat janë përgjegjëse sipas ligjit që do të bëjnë përcjelljen e punëve, do të kemi përkushtim dhe vëmendje të shtuar në përcjelljen e realizimit të këtij projekti, si dhe të gjitha projekteve të tjera të kësaj natyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Ka pyetje shtesë? Urdhëro, zonja deputete!

DRITA MILLAKU: Zoti ministër, të gjitha ato që i the ne i kemi ditur, por e rëndësishmja është që trashëgimia kulturore është e dëmtuar, për këtë kemi edhe fakte prej banorëve, të cilët jetojnë atje. Nuk është fakt ruajtja, është bërë në formë rrethoje, nuk ruhet ashtu, ato detyrimisht po shkatërrohen nga shiu dhe të reshurat që po bien çdo ditë. Mirëpo, dëmtimi i trashëgimisë kulturore, zoti ministër, e dimë që është vepër penale. Pyetja jonë është kush do ta pasojë këtë vepër penale, pasojë e kujt do të jetë kjo vepër penale? E dimë që këto punime kanë filluar në mandatin ju që keni qeverisur në Komunën e Prizrenit.

KRYETARI: Ministri e ka prapë fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Besoj që isha i qartë edhe në përgjigje, e nderuar deputete. Ju keni bërë pyetje për cilat eksponate, për të cilën nuk e kam të qartë edhe shumë pyetjen. Nëse po flasim për një vendbanim arkeologjik, e thashë dhe po e përsëris, Instituti Arkeologjik si kompetent për të monitoruar këtë proces është 24 orë nën mbikëqyrje të këtij projekti dhe po ashtu, të gjitha ato që janë gjetur aty janë sjellë te vendi përkatës, pra nuk kemi asnjë dëmtim të asnjë të gjeture në këtë vendbanim. Kështu që mos u shqetëso, se gjithçka është duke shkuar sipas rrjedhës dhe sipas planifikimeve që ka bërë edhe projekti. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi, pyetje për ministrin Kujtim Gashi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit!

Pyetja është bërë më 24. 11. 2017, domethënë ka kaluar kohë që kam parashtruar këtë pyetje dhe pyetja për ministrin është: zoti ministër, kur do të përfundojë ndërtimi i objektit për operën e baletit “Ibrahim Rugova” dhe a ka ndonjë plan konkret që ndahet në faza të përcaktuara kohore finalizimi i këtij objekti?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

E nderuar deputete,

Më lejoni që t’ju informoj se ndërtimi i objektit të teatrit, operës dhe baletit “Dr. Ibrahim Rugova” është projekt kapital, i cili ka filluar në vitin 2006 dhe nga ajo kohë nuk është bërë asnjë veprim i duhur në këtë projekt. Pas vënies së gurthemelit në vitin 2009, projekti kryesor i është nënshtruar revidimit të tij, ku reviduesi i projektit ka paraqitur defekte të ndryshme nëpër faza, e veçanërisht në pjesën e projektit që ka të bëjë me akustikën.

Sa për informimin tuaj, projekti kryesor që ishte hartuar nga një byro projektuese në Gjermani në vete përfshinte edhe pjesën e një qendre komerciale, e ku planifikohej që nga të hyrat e kësaj qendre të funksionojë edhe mirëmbajtja e objektit të operës dhe baletit, e që investimi në këtë projekt parashikon koston rreth 30 milionë euro. Shumë, natyrisht, e papërbalueshme për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Gjatë mandatit të kaluar qeverisës ish-ministri i MKRS-së ka kërkuar që të fillohet me përgatitjen e detyrave projektuese për një konkurs të ri ndërkombëtar të projektimit, me qëllim të ndërtimit të një objekti më pak të kushtueshëm. Në parcelën ku ndodhet gurthemeli gjithashtu është planifikuar të ndërtohet edhe Muzeu i Arteve Bashkëkohore, ku për qëllim kishte ndërtimin e një kampusi kulturor. Në atë kohë ishte formuar grupi punues për përgatitjen e detyrës projektuese, por deri në fund të mandatit, pa asnjë rezultat. Në planifikimet e MKRS-së për vitin 2018, përkundër faktit që ky projekt është jashtëzakonisht i kushtueshëm dhe i papërbalueshëm për buxhetin e MKRS-së, sigurisht që do të vazhdohet me

projektin kapital në fjalë, ku do të përcaktohen detyrat projektuese si dhe i njëjti do të vazhdojë me hapjen e konkursit ndërkombëtar të projektimit, duke bërë përzgjedhjen e projektuesit për hartimin e një projekti të ri, të rëndësishëm si për komunitetin kulturor, ashtu edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Dhe, në fund, më lejo, e nderuar deputete, të theksoj faktin se që nga koha kur është proklamuar shumë dhe është bërë zhurmë rreth këtij projekti, nuk është bërë asnjë hap i duhur drejt realizimit të këtij projekti. Unë edhe një herë po e konfirmoj që në vitin 2008, deri në fund të vitit 2008 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do ta ketë të gatshëm hartimin e këtij projekti dhe pastaj do të shohim mundësitë se si do ta investojmë këtë projekt kapital. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ka pyetje shtesë, zonja deputete? Jo! Atëherë, kishte qenë mirë që në janarin e vitit të ardhshëm të vihet gurthemeli, ministër, i teatrit, operës dhe baletit “Ibrahim Rugova”.

Zonja Luljeta Veselaj-Gutaj ka pyetja për ministrin Shyqiri Bytyqi, por nuk është ministri, për atë arsye edhe e kam kaluar. A doni ta bëni pyetjen?

Zonja Valentina Bunjaku-Rexhepi po ashtu keni pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, a doni ta bëni? Urdhëroni, zonja deputete!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Nuk dua të shtroj pyetjen, meqë ministri nuk është prezent, sepse është pyetje e dedikuar ministrit të Arsimit dhe pyetja është e parashtruar shumë herë dhe do ta shfrytëzoj rastin kur të jetë këtu ministri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Vjosa Osmani-Sadriu, pyetje për ministrin, po ashtu nuk është këtu, zotin Rrustem Berisha. A doni ta bëni pyetjen? Urdhëroni, zonja deputete!

VJOSA OSMANI-SADRIU: Zoti kryetar, në qoftë se mund ta sqaroni a do ta kem edhe një mundësi pas kësaj, meqenëse ministri nuk është këtu që ta lexoj herën e ardhshme, sepse është me rëndësi që të marr përgjigje.

KRYETARI: Kemi mundësi ta bartim, por zakonisht, zonja deputete, ti e di, ke përvojë, kur nuk përgjigjen apo s’po kanë mundësi të përgjigjen...

VJOSA OSMANI-SADRIU: Është një pyetje që besoj është në interes që të marrim përgjigje dhe ministri i FSK-së zakonisht nuk mungon, por ka gjasa që mund ta ketë pasur ndonjë obligim, kështu që po kërkoj të shtyhet për seancën e radhës pyetja.

KRYETARI: Bëjeni edhe një herë pyetjen, mund ta përsëritësh. Deputeti Haxhi Shala, pyetje për ministrin Flamur Sefaj.

HAXHI SHALA: Moti ka qenë kjo pyetje, por sidoqoftë ndoshta po mundohem ta mbaj në mend. Zoti ministër, i kemi disa qytetarë të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit, të cilët që nga paslufta jetojnë në Kosovë dhe tash pas rregullimit të një ligji në Serbi, ata pasi nuk banojnë në pjesën e Serbisë andej, kanë mbetur këndej nuk po kanë mundësi të regjistrohen në vendbanimet e tyre, kanë mbetur pa dokumentacione edhe në Kosovë, edhe në Serbi. Si qëndron puna me këta? A ka mundësi që pasi kanë qenë banorë, kanë banuar në Kosovë që 18 vjet, a ka mundësi që t'u rregullohen dokumentacionet?

Po e shoh që edhe ministri ka ardhur pa përgatitur, mund ta shtyjmë, edhe unë s'e kam ditur që e kemi sot. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Faleminderit për pyetjen, ju e dini se kjo çështje është proceduar dhe do të rregullohet përmes Ligjit për të huajt. Besoj që kjo përgjigje mund të merret edhe nga deputeti që më herët e ngriti këtë çështje, por për të gjitha detajet do t'ju dërgoj pastaj me shkrim që ju t'i analizoni në mënyrë precize. Por, sidoqoftë statusi i qytetarëve që vijnë nga Republika e Serbisë dhe që kanë mbetur me një status, le të themi "zona franka", do të rregullohet nëpërmjet rishikimit të Ligjit për të huajt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministren Albena Reshitaj. Zoti deputet, ministrja nuk qenka, tash do ta bëni, urdhëro, zoti deputet, fjala për ju.

HAXHI AVDYLI: Faleminderit!

Unë dua ta shpreh një shqetësim të banorëve të Përdrinisë, është lumi Topllua, i cili kalon rajonin e Përdrinisë që derdhet në Drinin e Bardhë dhe kalon në fshatrat e Suharekës, në fshatrat e Prizrenit, siç janë: Medves, Zojz, Piranë dhe është i degraduar tej mase nga eksploatimi i paligjshëm i zhavorrit, aq shumë është i degraduar sa që gjatë verës i përngjan një përroske të ujërave të zeza, ndërsa gjatë dimrit e në vjeshtë ka dalje nga shtrati dhe dëmtim të fushave të mbjella të këtij regjioni, i cili kryesisht është bujqësor.

Banorët e kësaj zone, domethënë banorët e këtyre fshatrave e kanë bërë një petition dhe në emër të 30 mijë banorëve të Përdrinisë, edhe pse ministrja nuk është këtu dhe vjen nga ai regjion,

besoj që ajo do ta marrë këtë shqetësim edhe përmes Kuvendit dhe përmes mediave si kërkesë dhe si pyetje dhe çka do të ndërmerret në sanimin, në pastrimin dhe në zgjerimin e shtratit të lumit dhe a ka ndonjë plan konkret që të financohet sanimi i gjendjes së këtij lumi, si dhe a ka plan që të gjendet zgjidhja edhe për derdhjet e ujërave të zeza, të cilat po ndodhin në lumin Topllua dhe i cili ky lumë ka rëndësi shumë të madhe për këtë regjion, duke i dëmtuar edhe fushat e mbjella, të cilat e furnizojnë edhe Kosovën me produktet e tyre.

Prandaj, unë si kërkesë, por edhe si pyetje dhe si apel për Ministrinë e Ambientit që të ndërmerret, që të sanohet gjendja e këtij lumi, i cili për momentin jo që ka qenë një lumë me rëndësi, po tash po shkakton edhe më shumë dëme se sa që ka shkaktuar përpara në ujtiqe, është shfrytëzuar për ujtiqe, por edhe për gjëra të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin Flamur Sefaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Zoti ministër Sefaj,

Pyetja ime ka të bëjë me gjendjen e sigurisë në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, lidhet më mirë të them me testimet e fundit të sigurisë, të cilat kanë ndodhur në aeroportin ndërkombëtar, po ashtu edhe në shërbimin e navigimit ajror kur është thënë apo më mirë është dëshmuar, sepse ka dështuar mbrojtja dhe lehtësisht janë futur mjete eksplozivi, duke kaluar rrezet X dhe janë futur në pjesën kur cenohet siguria e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Pyetja ime është se ju si e keni konsideruar këtë çështje, si është gjendja dhe të cilat janë masat?

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju!

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: Faleminderit!

I nderuar deputet, po përgjigjem në mënyrë pragmatike, unë kam urdhëruar që të bëhet një test, i cili është test rutinor që e kryejnë të gjitha aeroportet ndërkombëtare edhe në rajon, në Evropë dhe në gjithë botën. Testi është bërë, kanë dalë disa mangësi, të cilat po ashtu janë, le të themi, të tipit rutinor. Janë dhënë të gjitha rekomandimet dhe menaxhmenti i Aeroportit i ka ndërmarrë të gjitha masat e duhura. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është aeroport i sigurt. E kemi ftuar edhe një institucion prej Bashkësisë Evropiane, i cili këto ditë ka vepruar aty, i ka bërë testet e duhura që janë të parapara në bazë të normave ndërkombëtare. Në disa norma të shkruara ne nuk kemi qasje dhe disa nuk i dimë, sepse nuk jemi anëtarë të disa organizatave që merren me përcaktimin e kriterëve për sigurinë e aeroporteve, por sidoqoftë edhe aty në raportin e parë të cilin unë e kam parë, dhe dje kam marrë personalisht pjesë në briefing të tyre në aeroport, kanë dalë disa mangësi, të cilat mund të gjenden në gjithë rajonin dhe në gjithë Evropën.

Menaxhmenti, po ashtu edhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha institucionet do t'i ndërmarrin të gjitha ato masa të nevojshme për ta bërë aeroportin sa më të sigurt.

Por, po ju them që ato masa kanë të bëjnë në këtë moment më së shumti me trajnimin e personelit, por jo me pajisje, apo me sistem të sigurisë në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Keni pyetje shtesë, zoti deputet? Po!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti ministër!

Nga ajo që u kuptua, ashtu si unë e kuptova, dhe që është interes i publikut është ruajtja e imazhit të Aeroportit Ndërkombëtar, besoj se edhe udhëtarët që udhëtojnë, jo vetëm brenda, por edhe ata që vijnë nga jashtë, ndihen të sigurt dhe që këto shërbime të jenë të sigurta. Por, edhe nga përgjigjja juaj nuk arrita ta kuptoj, apo ndoshta këtu mund të nënkuptohet, e paske edhe ministrin e Infrastrukturës afër, që mund të ketë edhe ndonjë tendencë, ta quaj kështu kushtimisht, për lëndimin e imazhit, sidomos te kjo pjesa e sigurisë, sepse ashtu siç e theksuat nëse nuk është e qartë edhe pjesa e trajnimit dhe e testimin, atëherë del e paqartë edhe për mua, apo edhe për njerëzit e profesionit, sepse pjesë që janë testuese...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FLAMUR SEFA: Për ta sqaruar edhe një herë, duhet ta dalloni çështjen e sigurisë dhe sigurimit. Janë dy fusha të ndryshme, po sidoqoftë ndërlidhen dhe koordinohen ndërmjet dy ministrive, që ju i cekët.

Po e përsëris edhe një herë, Aeroporti është absolutisht i sigurt. Njerëzit janë të trajnuar në nivele profesionale. Ka vend për përmirësime si gjithkund, por të mos përçohet ndonjë mesazh i gabuar që Aeroporti nuk është i sigurt. Mendoj se nuk duhet ta ritrajtojmë tash shumë shpesh këtë çështje, se s'ka nevojë. Është çdo gjë në rregull. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministrin Valdrin Lluka. Deputetja s'është këtu. Edhe një herë, deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministren Albena Reshitaj. Asnjëra s'janë këtu. Deputetja Saranda Bogujevci, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. Urdhëro, Saranda!

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit!

Dua ta pyes ministrin se a është në dijeni për rrënimin e Kullës Demë Ahmeti në komunën e Podujevës.

Kërkesa ka qenë që kulla të restaurohet, por ajo është rrënuar tërësisht nga Komuna e Podujevës. Nëse është në dijeni, a ka ndërmarrë Ministria e Kulturës diçka në këtë drejtim? Dhe, tjetra për mua është shumë shqetësuese qysh në Llap dhe Gollak thuajse nuk është ruajtur trashëgimia kulturore hiç. Është marrë me qytetet tjera të Kosovës, por sa i përket anës së Llapit dhe Gollakut thuajse nuk është punuar asgjë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka ministri Gashi. Urdhëro!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit i nderuar kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

E nderuar deputete,

Fillimisht më lejoni të ju njoftoj se projekti i restaurimit të Kullës së Demë Ahmetit në Podujevë është projekt që është financuar nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Republikës së Kosovës, e jo nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve dhe Memorialëve të Kosovës si financuese e këtij projekti, sipas procedurës së paraparë me legjislacionin në fuqi ka aplikuar për marrjen e pëlqimit për restaurimin e monumentit nga institucionet kompetente.

Projekti në fjalë është trajtuar nga Komisioni për Vlerësimin e projekteve restauruese konservuese, që funksionon në kuadër të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, i cili e ka aprovuar projektin ideor, por me disa kushte, ndër të cilat investitorit i është kërkuar që të prezantohen detajet e çdo intervenimi në restaurim e konservim të monumentit në fjalë. Në ndërkohë, investitori, duke mos e respektuar vendimin e IKMM-së, e ka rrënuar monumentin pa poseduar leje për këtë veprimtari, si dhe në kundërshtim me vendimin e institucionit kompetent, veprim që bën shkelje ligjore.

Duke e konsideruar këtë veprim si tepër shqetësues edhe për mua dhe të papranueshëm, unë si ministër kam kërkuar urgjentisht nga institucionet kompetente, në këtë rast Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, si dhe Zyra Ligjore e Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, që të iniciohet procedurë për kallëzim penal ndaj shkelësve të ligjit, në këtë rast ndaj investitorit.

Andaj, pres që organet e drejtësisë ta ndriçojnë këtë rast dhe për të njëjtin të japin llogari para drejtësisë. Sido që të jetë, marr për shkas këtë rast, si dhe rastet tjera me prioritet. Me të marrë detyrën, i kam iniciuar procedurat për themelimin e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, andaj besoj fuqishëm se ky mekanizëm, pra Inspektorati për Trashëgimi Kulturore do të ndikojë dukshëm në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë sonë të çmuar kulturore.

Dhe, gjithashtu, më lejoni të ju informoj se është hera e parë që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht Departamenti Ligjor, i fillon procedurat për kallëzime penale ndaj të gjithë

atyre që po e dëmtojnë trashëgiminë tonë kulturore. Është rasti i parë, sido që të jetë për disa ditë do të fillojë punën edhe Inspektorati dhe inspektorët e Ministrisë së Kulturës do t'i kemi në terren sa u përket temave të rëndësishme, veçanërisht këtyre të trashëgimisë kulturore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë? Jo! Atëherë, vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Skënder Reçica.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër Reçica,

Është legjislatura e tretë që deputetët e Republikës së Kosovës bëjnë pyetje në vazhdimësi, pa marrë parasysh se prej cilit subjekt janë, sepse është një çështje, e cila tash po bëhen tetë vjet që nuk po zgjidhet. Besoj se pyetjen e keni marrë, ka të bëjë me pensionet e qytetarëve të Republikës së Kosovës që punojnë në Zvicër, që e dimë se nuk po i marrin, siç janë pensioni i pleqërisë, familjar dhe i invaliditetit, për shkak se Zvicra e ndërpreu njëanshëm marrëveshjen me Kosovën, ndonëse me një vonesë të pajustificueshme, më 1 qershor të këtij viti u nënshkrua marrëveshja ndërshtetërore për sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës.

Dihet se për t'u bërë e plotfuqishme kjo marrëveshje duhet ratifikuar në të dy parlamentet e shteteve. Pse ka vonesa në këtë drejtim, ministër?

KRYESUESI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

E nderuar deputete Baftiu, faleminderit për pyetjen e juaj!

Në pyetjen tuaj që ka të bëjë me marrëveshjet për sigurimet sociale ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës, ju njoftoj se marrëveshja bilaterale për sigurimet sociale ende nuk është nënshkruar.

Grupet teknike që kanë qenë të emëruara për negociimin e marrëveshjes për sigurimet sociale ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës e kanë përfunduar draftin final të marrëveshjes për sigurime sociale, pastaj marrëveshjen administrative për zbatimin e marrëveshjes për sigurime sociale, si dhe janë pajtuar për formën e formularëve që do të përdoren për këmbimin e të dhënave të kërkuara nga të dyja palët, praktikisht individët që i parashetrojnë kërkesat. Për të gjitha këto veprime ekzistojnë procesverbalet në të gjitha fazat e negociimit deri në përmbylljen e bisedimeve.

Për informimin tuaj, më 1 qershor 2017 ka pasur vetëm nënshkrim të teksteve finale të draftit të marrëveshjes së përgjithshme dhe draftit final të marrëveshjes administrative dhe këto janë nënshkruar nga kryesuesit e grupeve teknike të të dy delegacioneve pas përfundimit të negociatave.

E nderuar deputete,

Për informimin tuaj dhe të të gjithë qytetarëve për këtë çështje mjaft të rëndësishme, ju informoj se nga ne si Qeveri nuk është shkaktuar asnjë vonesë. Personalisht, me ta marrë detyrën si ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale kam qenë dhe jam në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet zvicerane dhe me ambasadorin e Zvicrës në Kosovë.

Ju informoj se dje e kam pasur takimin e fundit me ambasadorin Lebet dhe në bazë të informatave që kam marrë nga autoritetet zvicerane, së shpejti do ta kemi datën për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje ndërshtetërore. Shpresojmë që kjo të ndodhë kah fundi i muajit mars, përkatësisht fillimi i muajit prill. Dhe, vetëm pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të dërgohet në ratifikim në parlamentet respektive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë?

BESA BAFTIU: Po, faleminderit!

Ministër, pothuajse të njëjtat fjalë në vazhdimësi i kanë thënë edhe ministrat paraprakë, siç e cekta qysh prej vitit 2008. Prandaj, pyetja ime konkrete është kur do të nënshkruhet kjo marrëveshje dhe kur qytetarët e Republikës së Kosovës që kanë punuar në Zvicër do t'i gëzojnë këto të drejta?

KRYESUESI: Urdhëroni ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit edhe një herë për pyetjen shtesë!

Ajo që dua të ju siguroj ju dhe gjithë opinionin e gjerë e të gjithë qytetarët është se ne, personalisht unë, pasi e kam marrë detyrën në vazhdimësi kam qenë në kontakt me autoritetet zvicerane. Ju them shumë sinqerisht që nganjëherë po e ndiej veten se jam bërë i bezdisshëm me ambasadorin e Zvicrës në Prishtinë. Nuk shkon java pa kontaktuar dhe pa i bërë presion, për çka i kërkoj falje publikisht. Nuk varet nga ne. Personi apo zyrtari zviceran që është paraparë për ta nënshkruar marrëveshjen e ka pasur agjendën shumë të ngarkuar dhe tani ai person është president i Konfederatës së Zvicrës dhe problemi qëndron tek agjenda e tyre. Nuk ka asnjë çështje tjetër që mund të shkaktojë ndonjë vonesë. Këto janë përgjigjet që i kam marrë unë nga autoritetet zvicerane. Dhe, së fundmi, dje kam marrë një datë orientuese, që do të jetë fundi i muajit mars, përkatësisht fillimi i muajit prill. Kjo është ajo që unë e kam. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Asnjëri s'janë këtu. Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Abelard Tahiri. Avdullahu s'është këtu. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. Urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Njëra prej çështjeve për të cilën kam bërë pyetje parlamentare i keni dhënë sqarimet edhe publikisht dhe me nënshkrimin e Rregullores për të filluar zbatimin e Ligjit për sponsorizime. Çështja ka të bëjë me dy ligje, të cilat janë miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Ligji për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe Ligji për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, të cilat kanë hyrë në fuqi më 17. 1. 2017.

Këto dy ligje nuk kanë filluar të zbatohen në praktikë për shkak se ministria nuk ka arritur që me kohë t'i nxjerrë rregulloret përkatëse, që mundësojnë zbatimin e këtyre dy ligjeve. Prandaj, pyetja ime është, i nderuar ministër, se kur do të nxirren rregulloret përkatëse për zbatimin dhe funksionalizimin e këtyre dy ligjeve? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Zëvendëskryeministër,

Faleminderit për pyetjen që e keni ngrehur, e që ndërlidhet me një nga prioritetet e mia më të rëndësishme si ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e që është gjetja e mënyrave alternative për financimin e sportit në Kosovë.

Me marrjen e mandatit si ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit e kam bërë të qartë se një nga prioritetet e mia më të rëndësishme është pikërisht kompletimi i infrastrukturës ligjore për sponsorizimin e aktiviteteve sportive, kulturore, rinore dhe normalisht ne si ministri kemi punuar në vazhdimësi dhe me përgjegjshmëri të madhe që ta finalizojmë këtë prioritet.

Siç keni mundur ta shihni edhe nëpër medie këtë javë, jam jashtëzakonisht i lumtur që edhe para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe para qytetarëve të Republikës së Kosovës të ju informoj se këtë javë e kam nënshkruar njërin nga aktet më të rëndësishme për financimin e sportit, kulturës dhe rinisë në vend, Rregulloren për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si një obligim që del nga Ligji i sponsorizimeve.

Duke pasur parasysh rregullimin që bën kjo rregullore, e që konsiston me përcaktimin e kritereve, procedurave dhe formës së vërtetimit të sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit si fusha të interesit publik, ne jemi të bindur që miratimi i kësaj rregulloreje shënon edhe finalizimin e infrastrukturës ligjore, që rregullon çështjen e sponsorizimeve. Andaj, besojmë fuqishëm që edhe e kemi hapur një dritare të fuqishme për financimin e sportit në Kosovë, por edhe të kulturës dhe rinisë.

Ne vlerësojmë që nënshkrimi i kësaj rregulloreje paraqet një nga momentet më të rëndësishme të fuqizimit të sportit në vend. Nga kjo foltore e shfrytëzoj rastin të apeloj te të gjitha bizneset në Kosovë që t'i bashkohen kauzës së zhvillimit dhe avancimit të sportit, kulturës e rinisë nëpërmjet sponsorizimeve.

Më lejoni të ju falënderoj edhe juve, zoti deputet, që keni qenë pjesë e udhëheqës i këtij grupi punues. Ka qenë një punë jashtëzakonisht kolosale dhe e gjithë atyre që kanë punuar bashkërisht me mua i falënderojmë për një punë jashtëzakonisht të madhe, sepse edhe sporti dhe biznesi do të jenë bashkë në financimin dhe zhvillimin e sportit në Kosovë, por edhe të kulturës dhe rinisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Keni pyetje shtesë? Po, urdhëroni!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër, në veçanti për nënshkrimin e kësaj rregulloreje dhe në emër të të gjithë sportistëve dua të ju falënderoj që për një periudhë të shkurtër kohore keni arritur ta kompletoni këtë rregullore, e cila është dashur të miratohet brenda gjashtë muajsh pas miratimit të ligjit, por që paraardhësit tuaj nuk e kanë bërë. Nuk mund ta falënderojmë ministrinë, ose përgjegjësit brenda Ministrisë së Shëndetësisë, të cilët e kanë ngecur këtë rregullore dhe rregulloren e cila fillon, e implementon, ose është obligative për ligjin për sanksionimin dhe parandalimin e dhunës në sport, sepse është një prej ligjeve gjithashtu bazike për zhvillimin e sportit dhe për t'i parandaluar edhe dukuritë negative, por edhe dhunën në sport.

Gjithashtu, i nderuar ministër, pyetja ime e radhës është: A keni menduar, sepse sipas rekomandimeve të Kuvendit parashihet edhe për sportin, parashihet edhe Ligji për menaxhimin dhe sigurinë e objekteve sportive, prandaj dua një përgjigje, sepse është një çështje shumë me rëndësi, në veçanti pas këtyre investimeve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, zoti deputet!

Po, është në planifikimet e agjendës sonë. Edhe Ligji për menaxhimin e objekteve sportive, gjithashtu do të jetë një prej prioriteteve. Tashmë e kemi formuar edhe grupin punues dhe është duke u punuar në këtë drejtim. Besoj që shumë shpejt do ta keni edhe në Parlament për miratim. Natyrisht se do të jetë një punë jashtëzakonisht e madhe, por grupi që është themeluar është duke punuar intensivisht në finalizimin e këtij ligji, i cili është jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm, po aq sa ishte edhe Ligji për sponsorizimin.

Kështu që besoj se për një kohë të shkurtër, kah mesi i këtij viti, mund ta kemi të gatshëm edhe Ligjin për menaxhimin e objekteve, i cili do t'u ndihmonte gjithashtu edhe klubeve, edhe federatave, por edhe sportit në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Uran Ismaili. Ministri s'është këtu, dëshironi ta bëni pyetjen? Po!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Pasi ministri nuk është këtu, atëherë po e transferojmë pyetjen për seancën e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pyetjet që janë parashtruar për herë të parë, sepse këto pyetje kanë qenë të bartura nga seancat paraprake.

Deputeti Sami Kurteshi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Kryeministri s'është këtu, dëshironi ta bëni pyetjen?

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po, unë po e bëj, sepse me siguri ai e merr mesazhin.

Pyetja ime ka të bëjë lidhur me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 4/08, i datës 13 tetor 2017.

Zoti kryeministër, më 13 tetor 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 04/08 e ka aprovuar ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 50 mijë eurove për mbulimin e shpenzimeve për ekspertizë të pavarur ndërkombëtare lidhur me vdekjen e aktivistit politik Astrit Dehari në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

I nderuar zoti kryeministër Haradinaj, ju personalisht bashkë me stafin tuaj, më 7 nëntor 2017 i keni takuar prindërit e Astrit Deharit në lidhje me këtë çështje. Tani, jo një muaj, por kanë kaluar dy muaj dhe as familja e as avokati i familjes nuk kanë asnjë informatë lidhur me veprimet e ndërmarra nga Qeveria juaj. Unë ju lus që të na njoftoni se çfarë është ndërmarrë nga Qeveria

juaj në këtë drejtim dhe kur mund të pritet një vendim për lejimin e një hetimi të pavarur ndërkombëtar, sipas kërkesës së familjes? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, s'mund të përgjigjeni ju. Kryeministri mund të përgjigjet në emër të ministrave, por jo anasjelltas. Faleminderit!

Deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Ministri s'është këtu, me sa shoh. Dëshironi të bëni pyetje?

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Unë do ta kisha bartur për seancën e ardhshme nëse vjen ministri, nëse s'vjen..., shëndosh.

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Njëjtë?

Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për ministrin Palë Lekaj.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Ndonëse pyetjen e kam parashtruar pothuajse një muaj më herët dhe prej asaj kohe deri më sot kanë ndodhur disa zhvillime sa i përket kësaj çështjeje, ju tashmë e keni nënshkruar, me sa jam njoftuar nga mediet, edhe një kontratë për kredi me Bankën për Zhvillim Evropian lidhur me punimet në autostradën Prishtinë - Pejë, përkatësisht me vazhdimin e segmentit të saj prej fshatit Leçan apo Kijevë deri në, sa e di unë, Zahaç. Mirëpo, është një shqetësim i banorëve të disa fshatrave, të cilët kanë kontaktuar edhe me Kabinetin tuaj, se parashihet një devijim i rrugës, do të thotë rruga nuk do të bie nga magjistranja e vjetër, por do të ketë një devijim, i cili do të prekë një pjesë të madhe të tokave bujqësore.

E para, ju lutem na njoftoni nëse është ky vendim përfundimtar dhe a ka leje apo miratim edhe prej Ministrisë së Bujqësisë, sepse tani po flasim për shndërrim nga toka, që është e destinuar si tokë bujqësore, në tokë që po përdoret në këtë rast për ndërtim të autostradës me ç'rast ne po ashtu po humbim edhe tokë bujqësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka ministri Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës,

Zonja dhe zotërinj,

E nderuar deputete Pantina,

Ju siç e dini, projekti i ndërtimit të rrugës nga Prishtina në Pejë është një projekt i kamotshëm, i nisur, por i papërfunduar.

Me të ardhur në krye të Ministrisë së Infrastrukturës, bashkë me ministrin Hamza dhe me mbështetjen e parezervë të kryeministrit Haradinaj dhe në bashkëpunim të plotë me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Ambientit, e kemi përshpejtuar dinamikën për të rinisur së ndërtuari pjesën e mbetur të këtij projekti.

Ministria e Infrastrukturës, në bashkëpunim me VBIF-in dhe me IBRD-në e ka përfunduar plotësimin e studimit të fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor ne segmentin Kijevë-Zahaç, në gjatësi prej 32 kilometrash. Si pjesë e këtij studimi, kompania konsulente, duke i vlerësuar kriteret teknike dhe mjedisore i ka dorëzuar dy variantet për trasenë nga Kijeva deri në Zahaç.

Vlerësimi i varianteve të trasesë është kryer nëpërmjet metodës së multikritereve dhe kompania konsulente, duke i vlerësuar të gjitha aspektet teknike dhe mjedisore, e ka përgatitur raportin përmbledhës me rekomandimin për variantin e trasesë së re të projektit të zgjerimit nga Kijeva në Zahaç.

Ministria e Infrastrukturës, pas shqyrtimit të varianteve të propozuara, e ka aprovuar variantin e trasesë së re nga Kijeva-Zahaç, si variantin më të favorshëm, sipas të cilës duhet të punohet projekti kryesor me të gjitha elaboratet përcjellëse. Këtu e përmendët me të drejtë edhe lejen nga Ministria e Ambientit, edhe lejen për ndërtim, edhe lejen për shndërrimin e tokës pjellore në tokë ndërtimore dhe të gjitha këto, pasi të përfundojnë, pastaj fillon edhe shpallja e interesit publik.

Pas miratimit të variantit është duke vazhduar me punimin e projektit zbatues për këtë segment rrugor, ku tash është aprovuar projekti preliminar nga Kijeva-Zahaç, i përgatitur nga ana e kompanisë konsulente dhe është duke u negociuar marrëveshja e kredisë me IBRD-në dhe IBF-në, ju e dini që është nënshkruar kontrata prej 71 milionë euro, 87 milionë do të jetë nga Banka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! A keni pyetje shtesë? Po!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit, ministër!

Tashmë kjo qenka, siç po thoni, punë e përfunduar, edhe pse unë e theksoj edhe një herë se banorët e asaj ane janë tejet të shqetësuar, sepse po humbet toka bujqësore.

Meqë u përmend më herët Aeroporti i Prishtinës, unë në shtator kam bërë një pyetje për transportin publik dhe ju patët premtuar se kjo punë do të rregullohet brenda muajit. A janë lëshuar linjat e transportit publik nga aeroporti i Prishtinës dhe nëse po, në cilat qytete?

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI PAL LEKA: Sa i përket interesit të qytetarëve, unë mendoj që rrugët janë për qytetarët dhe kanë impakt pozitiv edhe në zhvillimin ekonomik, është bërë fizibiliteti dhe me siguri pas fizibilitetit, janë marrë të gjitha veprimet dhe unë e di shqetësimin. Jam takuar disa herë me qytetarët dhe u kam premtuar që kyçja në autostradën që të jetë e mbyllur, duhet të jetë me standarde, për të mos i rrezikuar qytetarët, po të njëjtën kohë që të mos i lëmë pa kyçje dhe do të merren standardet që janë gjithkund në Evropë, nuk do të ketë largësi më të madhe se 4 deri 5 kilometër për kyçje, sepse e frekuentojnë shumë fshatra. Jemi të përkushtuar që në bashkëpunim me qytetarët dhe me standardet evropiane për autostrada të realizohet ky projekt.

Sa i përket linjës të qarkullimit për aeroport, e kam theksuar dhe po e theksoj, të gjitha procedurat janë kryer në afatin që ju kam thënë, fatkeqësisht pas shpalljes së interesit publik nuk ka aplikuar asnjë kompani dhe tani më vjen keq që unë kam qenë i detyruar ose të stimuloj atë vijë, ose në bashkëpunim me kryetarin e Komunës së Prishtinës të bëjmë një zgjidhje.

Kemi biseduar me deputetin Dardan Sejdiu, që shumë shpejt do të dalim me një propozim, meqë nuk ka pasur interes prej asnjë kompanie. Prandaj, kjo është ajo çështja dhe unë kam mundur që t'i shkel procedurat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministren Albena Reshitaj, ministrja nuk është këtu, a dëshironi të bëni pyetjen?

LIBURN ALIU: Po e lëmë për herën tjetër.

KRYESUESI: Keni edhe një pyetje.

LIBURN ALIU: Dy pyetje!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mirjeta Kalludra, pyetje për ministrin Valdrin Lluka.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç jeni në dijeni, pas hetimit që ka zhvilluar Avokati i Popullit, ushtrimet e padisë edhe Gjykata e Apelit pas Gjykatës Themelore ka vendosur që të pezullohet vendimi i Zyrës së Rregullatorit të

Energjisë, i cili detyronte qytetarët, pra konsumatorët që nëpërmjet faturave të energjisë të paguajnë për energjinë që nuk e kanë shpenzuar vetë, po që është shpenzuar nga konsumatorët e katër komunave veriore të Republikës së Kosovës.

Pyetja ime, që është shqetësim i shumë qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës, drejtuar ministrit është: Cila do të jetë mënyra dhe kur do të fillojë kompensimi i konsumatorëve, të cilët padrejtësisht janë faturuar për energjinë elektrike, të cilën nuk e kanë shpenzuar dhe cilat veprime i keni ndërmarrë deri më tani që të fillojë zbatimi i marrëveshjes së Brukselit për energjinë?

KRYESUESI: Fjalën e ka ministri Lluka.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë,

E nderuar deputete Kalludra,

Ne, normalisht e kemi filluar menjëherë zbatimin e vendimit të gjykatës, ku nga data 1 dhjetor nuk tariforen qytetarët për pjesën e veriut.

Ky është një problem mjaft i madh politik, jemi duke punuar në këtë aspekt për zbatimin e marrëveshjes që është nënshkruar, sepse zbatimi i marrëveshjes nënkupton edhe funksionimin dhe fillimin e ngarkimit me tarifa direkt te qytetarët e veriut.

Jemi duke u marrë me këtë punë, tash së fundi kemi gjetur një pajtueshmëri pothuajse në regjistrimin e kompanisë në anën veriore për furnizim me energji, e cila ishte pjesë e diskutimit të dialogut në Bruksel, i cili dështoi, për fat të keq dhe besoj që me këtë punë ne do t'i hapim rrugën që KOST-i ose Transmisioni i Kosovës të regjistrohet në Organizatën Evropiane të Transmisioneve dhe mandej me automatizëm të fillojnë qytetari në veri të paguajnë rrymën.

Sa i përket kthimit të këtyre mjeteve që janë paguar deri më tani, jemi duke shikuar modalitetet, normalisht, nuk është temë për momentin e diskutimit, sepse fokusi tërësisht është se si t'i fusim në tarifë, në pagesa, pra, qytetarët e veriut.

Prandaj, në momentin që kemi një zgjidhje për këtë aspekt, do t'ju informoj në kohën e duhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë?

MIRJETA KALLUDRA: Nëse do të kishte pasur mundësi ministri të na japë një afat kohorë ose më konkretisht, këto janë tema shqetësuese dhe a do të bëhet ndonjë afat ose ndonjë marrëveshje më konkrete?

KRYESUESI: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Po, faleminderit!

Si afat kohor që i kemi vendosur vetes është qershori i këtij viti, ta përfundojmë pjesën ku Transmisioni i Kosovës anëtarësohet në Organizatën Evropiane të Transmisioneve dhe normalisht të fillojë funksionimi i kompanisë për furnizim me energji në anën veriore.

Si target e kemi qershorin e këtij viti, edhe pse kishim shpresa që do të bëhej edhe më herët një gjë e tillë, sepse në momentin që regjistrojmë kompaninë në veri, domethënë gjejmë pajtueshmëri, me automatizëm fillon procesi i anëtarësimit të KOST-it në Organizatën Evropiane të Transmisioneve, domethënë ka mundësi që të bëhet edhe më herët, çdo gjë varet me dialogun në Bruksel. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mirjeta Kalludra, pyetje për ministrin Valdrin Lluka, prapë. Urdhëroni, zonja deputete.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

Pyetja ime lidhet me pyetjen e mëhershme. Energjia elektrike që është shpenzuar nga konsumatorët e katër komunave veriore të Republikës së Kosovës, pra ZRRE-ja ka obliguar konsumatorët e pjesës tjetër që përmes faturave mujore të paguajnë.

Në media është raportuar, i nderuar ministër, se edhe për ujin e pijes të shpenzuar nga konsumatorët e katër komunave veriore është duke paguar Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pyetja ime është: A është e vërtetë se për ujin e pijes që shpenzohet nga konsumatorët e katër komunave veriore, është duke paguar Qeveria? Nëse po, cila është baza ligjore dhe sa është vlera mujore dhe vjetore që paguan Qeveria? Nëse është duke paguar Qeveria e Kosovës për ujin e pijes për komunat veriore, cilat veprime do të ndërmerren pas situatës së krijuar apo vendimet e gjykatës në raport edhe me energjinë elektrike, të cilën edhe e ceka më herët?

Po ashtu pyetja është edhe për mbeturinat në këtë pjesë të Kosovës, kush është duke paguar?

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit!

Në bazë të Ligjit për buxhetin që është miratuar në Kuvendin e Kosovës parashihen subvencione për të gjitha ndërmarrjet publike që i kemi në nivel qendror, në këtë rast e kemi edhe Ujësjellësin Rajonal Mitrovica si dhe kompaninë rajonale të mbeturinave që është “Uniteti”. Të dy këto përfitojnë nga buxheti i Kosovës për subvencionim për t’i mbuluar shpenzimet operative aty që nuk kanë mundësi të inkasimit të mjaftueshëm, sidomos për shkak të pjesës veriore.

Prandaj, ajo pjesë, për shkak se nuk inkasojnë nga veriu, ka pjesë që nuk inkasohen as nga ana jonë, pra nga ana e jugut, kjo do të thotë që Qeveria e Kosovës është duke u ndihmuar nëpërmjet subvencionimit.

Në këtë rast kemi ndihmuar ujësjellësin me diku rreth 900 mijë euro përafërsisht për vitin 2017, gjë që i ka mundësuar t’i mbulojë të gjitha humbjet që kanë përfunduar te “Ibër Lepenci”. Pagesat që janë bërë në këtë rast është “Ibër Lepenci”, mandej përdoren për shpenzimet e kemikateve të ndryshme që përdoren për trajtimin e ujit, pra janë shpenzime që futen direkt në lidhje me përpunimin e ujit apo me furnizimin me ujë.

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë? Po!

MIRJETA KALLUDRA: Meqenëse ne kemi një të kaluar, e cila është e dhimbshme për popullin shqiptar, edhe për qytetarë që kanë njerëz të vrarë në luftë, atëherë kjo bëhet edhe më shqetësuese kur qytetarët e pjesëve të tjera të Kosovës duhet të paguajnë për pjesën veriore. Nëse shkon me këto subvencione, po i bie se ne paguajmë edhe për ujë, ministër, sa e kuptova unë. Në qoftë se janë si subvencione, domethënë Qeveria paguan për pjesën veriore prej taksave të qytetarëve edhe për ujë, edhe për mbeturina.

KRYESUESI: Urdhëroni, ministër, mund ta vazhdoni përgjigjen.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, kryesues!

Kur të vijë puna te Ujësjellësi Rajonal Mitrovica, ne kemi një problem më të madh politik, sepse furnizimi vjen nga pjesa veriore, kurse përpunimi bëhet në anën jugore. Prandaj, ka ndjeshmëri politike në aspektin se nëse dëshiron të marrim masa më drastike, atëherë mund të komplikohet situata shumë më tepër.

Prandaj, për momentin zgjidhja është që të vazhdohet në këtë aspekt, duhet të ndihmohet ndërmarrja rajonale, siç është ujësjellësi në këtë kohë dhe është e vërtetë ajo, domethënë me buxhetin e Republikës së Kosovës, pra me taksapaguesit tanë pjesa e humbjeve që i gjeneron ujësjellësi për shkak të mospagesës së tarifave, prapë po them si në veri, ashtu edhe në jug, mbulohet përmes subvencioneve për ta mundësuar ekzistimin e ndërmarrjes për një funksion normal të saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, ju njoftoj që kemi kohë vetëm edhe për një pyetje, kjo është e fundit për këtë seancë.

Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për ministrin Mahir Yagxhilar. Urdhëroni, deputete!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit, ministër për prezencën!

Në fakt, pyetja që jua kam drejtuar është shumë e thjeshtë, kohët e fundit ne i kemi një sërë vendimesh, përfshirë këtu edhe vendimin e kryeministrit për rritjen e pagave, edhe pagën e tij personale, por edhe pagën e zyrtarëve të lartë politikë.

Në anën tjetër janë më shumë se dy vjet që ne presim Ligjin për pagat, por edhe në këtë legjislaturë nuk ishte në plan që ta sillni si projektligj nga Qeveria. Pra, në planin legjislativ të qeverisë nuk ishte i përfshirë Ligji për pagat.

Pyetja ime thjesht është se kur doni ta sillni Ligjin për pagat në Kuvend?

KRYESUESI: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI MAHIR JAGXHILAR: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për pyetje, e nderuar deputete Pantina,

Vërtet nuk është në strategjinë legjislative, sepse duke u bazuar në Rregulloren që së pari duhet të aprovohet koncept-dokumenti për Ligjin për pagat, atëherë automatikisht do të transferohet edhe në strategjinë legjislative.

Ndërsa nga aspekti edhe i agjendës evropiane, edhe në koordinim me Komisionin Evropian sa i përket grupit të veçantë për reformën e administratës publike Ligji për pagat nga buxheti i Republikës së Kosovës, bashkë me dy ligjet e tjera, të Administratës Publike, si organizimi i administratës publike dhe për zyrtarë publikë duhet të aprovohen në muajin qershor.

Koncept-dokumenti është në procedurat qeveritare dhe besojmë që këto ditë do të aprovohet, edhe menjëherë do të vazhdojmë me ligjin. Siç dihet, ligji edhe në mandatin e kaluar është proceduar, por pastaj është kërkuar edhe nga Komisioni Evropian sipas rregullave të hartohet koncept-dokumenti, ne pranuar, koncept-dokumenti është përfunduar, por janë edhe procedurat qeveritare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! A keni pyetje shtesë? Po!

SHQIPE PANTINA: Ministër, ju jeni anëtar i Kabinetit qeveritar, ku merren vendimet, ku natyrisht shumicën e vendimeve i nënshkruan në fund kryeministri, por besoj se ai duhet ta marrë edhe mendimin tuaj.

Vendimi i fundit ose ndër vendimet e fundit të kryeministrit ishte ai për rritjen e pagave, a ju ka konsultuar juve? Në bazë të cilit ligj është bërë ky vendim apo edhe ju konstatooni se është një vendim i jashtëligjshëm?

KRYESUESI: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI MAHIR YAGXHILAR: Është një çështje shumë politike, vërtet në Kosovë nuk ekziston Ligji për paga, në këtë aspekt hartohet, deri tash të gjitha vendimet sa u përket pagave janë realizuar përmes vendimeve të Qeverisë.

Në këtë aspekt, unë besoj që së bashku do të punojmë edhe këtë herë në muajin qershor të bëjmë së bashku edhe aprovimin e Ligjit për pagat, i cili do të rregullojë të gjithë përfituesit nga buxheti i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë e kemi mbyllur këtë pjesë të seancës.

Lus Administratën që ta konstatojë kuorumin, sepse për pjesën tjetër na duhet kuorumi që të fillojmë punën. Faleminderit!

Atëherë në sallë janë 70 deputetë, e vazhdojmë punën.

Të nderuar deputetë,

Së pari, në bazë të nenit 42, pikë 2 të Rregullores së Kuvendit kemi një propozim me shkrim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës. Kështu që unë ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, që të paraqesë dhe të arsyetojë propozimin. Urdhëroni!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka një propozim për plotësimin e rendit të ditës së seancës plenare më 25 janar 2018, pra të sotshme, për shqyrtimin e dytë të Projektligjit numër 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, e ka shqyrtuar dhe ka amendamentuar Projektligjin për tatimin e pronës së paluajtshme dhe raportimin e amendamentit e ka propozuar për shqyrtim në komisionet e tjera të përhershme.

Komisionet e tjera të përhershme e kanë shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e propozuara dhe kanë paraqitur rekomandimet e tyre.

Në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2018, komisioni ynë ka votuar raportin final me amendamente për Projektligjin për tatimin e pronës së paluajtshme dhe ka propozuar që shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-005 për tatimin e pronës së paluajtshme të bëhet në seancën plenare të datës 25 janar 2018, pra në datën e sotme, në seancën e sotme, përmes shmangies nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafin 7 dhe nenin 57, paragrafi 9 të Rregullores së Kuvendit.

Arsyeja pse e bëjmë këtë është se miratimi i këtij ligji brenda muajit janar ndërlidhet me mundësinë se Qeveria e Kosovës të përfitojë në financim apo një grant rreth 5 milionë euro nga Qeveria suedeze për zbatimin e ligjit, respektivisht reformës që parashihet me këtë ligj.

Nëse projektligji nuk miratohet sa më shpejt, pra brenda muajit janar të vitit 2018, ky grant prej 5 milionë eurove rrezikon të mos përfitohet nga Qeveria e Kosovës për shkak të procedurave vjetore të planifikimit buxhetor të Qeverisë së Suedisë.

Prandaj, ne kërkojmë si komision edhe i lusim deputetët që të votojnë propozimin e plotësisht të rendit të ditës për seancën e sotme plenare.

Meqenëse një grant i tillë ndihmon dhe krijon hapësirë për nxjerrjen e akteve nënligjore, për të cilat është përcaktuar afati gjashtëmuor nga dita e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare dhe i shërben kompletimit të legjislacionit në fushën e tatimit në pronën e paluajtshme dhe fillimit të zbatimit të tij nga data 1 janar 2018, siç parashihet me ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas procedurës, së pari duhet të marrim qëndrimin e shefave ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ne pajtohemi plotësisht që ky projektligj t'i ndjekë procedurat e përshpejtuara të shqyrtimit, është shumë e nevojshme, ka pasur edhe një konsensus të plotë edhe në komisionin përkatës, të gjithë deputetët e kanë mbështetur idenë që ky projektligj të trajtohet me shpejtësi në seancë, edhe duke pasur parasysh domosdoshmërinë, sepse prej kësaj përfitojmë edhe një ndihmë si shtet i Kosovës.

Prandaj, duke pasur parasysh edhe këtë gjë, ne e mbështesim që ta ndryshojmë rendin e ditës dhe ta plotësojmë edhe me këtë pikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Ky është një ligj shumë i rëndësishëm dhe besoj shumë që do t'u ndihmojë pushteteve lokale, komunave edhe Ministrisë së Financa në menaxhimin më të mirë të tatimit në pronë dhe në reformimin e plotë të kësaj çështje.

Ne e mbështesim plotësisht që kjo të renditet në agjendën e seancës së sotme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet përfshirjen e kësaj pike në rend të ditës.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, deputeti Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

I Parlamentarna grupa Srpske liste podržava da se ovaj Zakon nađe na današnjem dnevnom redu.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah futjen e kësaj pike të rendit të ditës.

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma për Kosovën”, deputeti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Edhe “Nisma” e mbështet futjen në rend të ditës të kësaj pike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, nuk e kanë kërkuar fjalën.

Të nderuar kolegë,

Ju rikujtoj që kërkohet deklarimi me votim për propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës në shqyrtimin e dytë të Projektligjit për tatimin në pronë e

paluajtshme si dhe për shmangien nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7 dhe në nenin 57, paragrafi 9 të Rregullores së Kuvendit.

Për t'ju shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancë plenare, pra do të thotë nga neni 84 i Rregullores së Kuvendit.

Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

A ka deputetë pa kartelë? Jo.

Atëherë kanë marrë pjesë në votim 64 deputetë. 63 janë për, asnjë kundër dhe një abstenim.

Konstatoj që miratohet propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës në shqyrtimin e dytë të Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, me shmangie nga afatet procedurale të parapara në nenin 15, paragrafi 7 dhe me nenin 57, paragrafi 9 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Kjo pikë do të radhitet si pika e 13-të e rendit të ditës.

Urdhëro, Glauk, shef i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, e ke kërkuar fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Meqë jemi te rendit i ditës, unë kisha bërë edhe një propozim tjetër, që pika e cila është propozuar këtu dhe e cila figuron si e pesëmbëdhjeta në rend të ditës, Shqyrtimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës për vitin 2017-2026, propozoj të hiqet nga trajtimi në këtë seancë, për shkak që mendoj se deputetët dhe tema për të cilën po flitet duhet të jenë më të përgatitur. Kjo temë e meriton një shqyrtim më të veçantë, është njëra prej temave më të rëndësishme në dhjetëvjeçarin e ardhshëm të Republikës së Kosovës. Është një strategji, e cila tash edhe pas nënshkrimit të kontratës të Qeverisë së Kosovës me “Controul Global” e kërkon të gjithë vëmendjen e merituar, kështu që nuk mendoj që duhet të jetë njëra prej thjesht 20 pikave të rendit të ditës, ku ne e shqyrtojmë veç nëse flasim nga 2 apo 3 deputetë prej secilit grup parlamentar. Mendojmë që duhet të jetë si pikë e veçantë e një seance të ardhshme, të cilën ne mund ta propozojmë, ku do të flitet vetëm për energjinë në Kosovë dhe vetëm për këtë strategji të veçantë të përpiluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Nëse Qeveria pajtohet që këtë ta tërheqim dhe ta lëmë për një seancë të ardhshme, ku do të jetë e vetmja pikë e rendit të ditës, atëherë edhe me mbështetjen e deputetëve, kjo do të ishte shumë e mirë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë kemi një mocion procedural, për të cilën së pari duhet të deklarohen shifat e grupeve parlamentare, e pastaj edhe seanca në votim. Meqë ju e dhatë këtë propozim, është e kuptueshme që edhe pajtoheni, kështu që pyes përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

AVDULLAH HOTI: Thashë që është e rëndësishme kjo temë, nuk e vë në dyshim duke pasur parasysh edhe nënshkrimin e kontratës të re për investime në këtë sektor. Por, unë besoj që edhe në këtë seancë mund t'ia kushtojmë vëmendjen e duhur diskutimit në këtë temë. Ne do të pajtoheshim edhe ta shtynim nëse ka ndonjë arsye të fortë pse duhet një debat i veçantë për këtë strategji. Pra, nuk kemi ndonjë qëndrim pse duhet të shkojë në seancë tjetër. Ne mund të bisedojmë, mund të diskutojmë gjerësisht një ditë të plotë vetëm për këtë pikë të rendit të ditës. Nuk kemi ndonjë qëndrim për këtë çështje nëse është më mirë në këtë seancë, apo në seancën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, përfaqësuesi Memli Krasniqi. Urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse kjo draft-strategji i ka kaluar të gjitha procedurat, edhe diskutimet publike, edhe procesin në komision, edhe deputetët e kanë marrë materialin me kohë, ne nuk e shohim të arsyeshme që të shtyhet, sepse s'e kemi kohën e limituar për të diskutuar. Kur t'i vijë rendi kësaj pike, ne mund të diskutojmë edhe 10 orë nëse është e nevojshme, mund secili deputet ta shfrytëzojë kohën e vet, t'i trajtojë dhe adresojë të gjitha çështjet. Kështu që besoj nuk është mirë t'i shtyjmë disa prej pikave që mezi i kemi sjellë në rend të ditës, kështu që ne konsiderojmë që të mbetet pika ashtu siç është dhe të shqyrtohet kur t'i vijë rendi sot apo nesër, nëse duhet të vazhdojë seanca. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedavajući!

I Poslanička grupa Srpske liste smatra da nema razloga da se ova tačka odloži na neku narednu sednicu, nego da je razmatramo kada bude došla na red.

KRYESUESI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, shefi i Grupit Parlamentar, Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Edhe ne mendojmë se meqë është në rend të ditës dhe i ka kaluar të gjitha procedurat, atëherë nuk ka nevojë të tërhiqet nga rendi i ditës.

KRYESUESI: Faleminderit! Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar "Nisma për Kosovën".

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Me aq sa e kuptova propozuesin, ai kërkon më shumë kohë, por nuk e kuptova, apo nuk e tha, po unë nuk e kuptova se sa kohë mendon, një javë, dy javë, 10 ditë, nëse me kohë e ka menduar që të shtyhet për një javë apo 10 ditë është diçka tjetër, nëse me kohë e ka menduar që brenda

seancës nuk mund të diskutojmë, kjo është çështje tjetër, se e thanë edhe parafolësit, mund të flitet sado që derisa të gjithë deputetët ta shterojnë debatin, pra 10 minuta një deputet nuk është se është pak kohë për ta thënë atë çka ka për ta thënë.

Dhe, unë mendoj që këtu në këtë rast, ai së pari ia drejtoi Qeverisë një pyetje. Është mirë që edhe Qeveria të marrë pozicion çfarë mendon. A ka nevojë, a i prish planet e Qeverisë në agjendën e saj nëse shtyhet për një javë. Kështu e kuptova, me sa e di unë, dhe nëse është kjo në funksion të asaj që Parlamenti të jetë më i përgatitur, deputetët të jenë më të përgatitur për të debatuar sa i përket kësaj çështjeje, pse jo, nuk është ndonjë problem. Nëse Qeveria mendon se prish punë në hapat e saj, në agjendën e saj, në projektet e saj, atëherë le ta lëmë kështu siç është, që kur të vijmë në këtë rend ditës, nëse ka nevojë edhe një ditë të tërë, dhe siç po shihet nuk e di a do të mund ta kryejmë edhe nesër këtë seancë, duke pasur parasysh që është e ngarkuar me mjaft pika të rendit të ditës.

Pra, do të kisha pas dëshirë ta dëgjoj edhe një herë zotin Konjufca, a e ka fjalën që edhe një javë i duhet kohë, apo e kanë menduar me kohë, në kuptimin që brenda seancës nuk mund të debatojmë mjaftueshëm. Aktualisht nuk kam ndonjë qëndrim para se ta dëgjoj së paku edhe një herë Glaukun, pastaj edhe Qeverinë se cili është pozicioni i saj, sepse nuk na e drejtoi neve, më shumë ia drejtoi Qeverisë këtë pyetje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, askush nuk është në sallë. Atëherë, ia jap fjalën edhe një herë propozuesit të mocionit që ta sqarojë pozicionin e tij.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, kërkoj falje dhe më vjen shumë keq nëse nuk jam kuptuar drejt. Mendoj se strategjia për dhjetë vjetët e ardhshme sa i përket sektorit të energjisë do të ndikohet fundamentalisht nga kontratat, të cilën e ka nënshkruar Qeveria e Kosovës për ndërtimin e termocentralit të ri. Dhe, meqenëse kjo në themel e ndikon dhe e përcakton strategjinë e shtetit tonë në raport me sektorin energjetik, atëherë është fare e qartë që kemi të bëjmë me një kontratë, e cila u publikua vetëm para 4-5 ditësh, kurse vëllimi i saj është i jashtëzakonshëm. Është një marrëveshje prej 1 000 faqeve, me shumë detaje teknike, e cila kërkon një kohë të caktuar për t’u analizuar dhe për ta pasur një ekspertizë më të saktë dhe më të drejtë të kësaj çështjeje.

Prandaj, trajtimi me kaq nguti pikërisht sot i kësaj, kur do të mund të ndodhte sot një javë ta zëmë dhe kur Kuvendi i Kosovës do të lirohej nga krejt këto 20 pika, e do ta kishim fokusin e mjaftueshëm edhe një kohë për t’u përgatitur më mirë, unë nuk po shoh këtu çfarë ka të keqe, nuk po shoh kurrëgjë subversive le të themi në propozimin tim, ashtu që deputetët edhe të jenë më të përgatitur, të marrin informata më të sakta, edhe prej institucioneve brendapartiake, të cilat e analizojnë në veçanti këtë sektorin e energjisë, sepse këtu po flitet se çka do të ndodhë në dhjetë vjetët e ardhshme me njërin prej resurseve tona më të rëndësishme, që është qymyri dhe

prodhimi i energjisë. Cilat janë perspektivat dhe drejtimet e zhvillimit të këtij sektori dhe, tek e fundit, çfarë do të ndodhë me vetë qytetarët e Kosovës, sepse janë konsumatorë. Kemi tashmë paralajmërimet e para dhe vetë kryeministri e pranon që çmimi i energjisë elektrike do të rritet, por pak më vonë.

Ekspertët thonë disa që do të rritet për 50%, kështu që janë aq tema të rëndësishme sa nuk do të mund t'i trajtojmë shkel e shko. Kjo është arsyeja pse e kërkova një javë që do të ishte e mjaftueshme për të qenë në më të përgatitur.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, fjalën e ka kërkuar deputetja Sala Berisha-Shala, e cila është edhe kryetare e Komisionit për Zhvillim Ekonomik.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar Shala!
Përshëndetje Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë dhe kolege deputete, dhe
Të gjithë ju të pranishëm.

Edhe unë mendoj që nuk e kemi ndonjë arsye shumë të fortë që ta heqim nga rendi i ditës strategjinë e energjisë, veç po dua t'ua rikujtoj deputetëve se këtë dokument Qeveria e ka sjellë në Parlament më 19 tetor 2017. Komisioni e ka shqyrtuar më 22 dhjetor 2017, domethënë ne i kemi tejkalluar edhe limitet kohore që janë të parapara brenda dy muaj ditësh kur vjen dokumenti nga Qeveria në Kuvend, ta shqyrtojnë komisionet përkatëse. Komisioni e ka shqyrtuar, madje ne si komision para se ta futim në rend të ditës për shqyrtim këtë dokument të rëndësishëm, siç është Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës, ne e kemi dërguar për mendim në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë me seli në Vjenë. E kemi dërguar dokumentin dhe na e ka kthyer mendimet dhe është në përputhje të plotë me direktivat dhe kriteret që i kërkon komuniteti i energjisë, pjesë e të cilit është edhe shteti ynë, edhe Kosova.

Në komision të gjitha grupet parlamentare i kanë përfaqësuesit e vet. Ne kemi debatuar në komision dhe komisioni e ka miratuar me shumicë votash, duke konkluduar se kjo strategji është hartuar në përputhje me Ligjin për energjinë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë. Përndryshe, nuk besoj që e ka ndonjë reflektim të theksuar nënshkrimi i kontratës për Termocentralin Kosova e Re, që do të ndikonte në shthurjen e kornizave kryesore të kësaj strategjie. Ligji është jashtëzakonisht i mirë, sepse e parasheh që strategjia, sado që është afatgjate, dhjetë vjet, ne me ligj jemi të obliguar që ta rishqyrtojmë çdo tre vjet atë.

Prandaj, edhe nuk e shoh të arsyeshme për ta hequr nga rendi i ditës. Ne mund të debatojmë në kohë të mjaftueshme dhe deputetët kanë pasur kohë domethënë prej tetorit, tani jemi në janar, tre a katër muaj ditë, dhe kanë pasur kohë që ta shqyrtojnë strategjinë e energjisë. Megjithatë, dëshiroj ta dëgjoj edhe fjalën e ministrit Lluka në lidhje me këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ia jap fjalën edhe ministrit, por tani kjo është agjendë e Kuvendit, është në rend të ditës. Fjalën e ka kërkuar edhe një herë shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti. Urdhëro!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Tash pas shpjegimeve të deputetit Konjufca dhe duke qenë se nuk ka asnjë urgjencë që kjo të diskutohet sot kjo strategji në këtë seancë, siç ishte rasti me Ligjin për tatimin në pronë, ne pajtohemi që ta shtyjmë për një javë, në mënyrë që një grup i deputetëve që kërkojnë më shumë kohë për t'u përgatitur për të debatuar për këtë çështje, t'ua japim mundësinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, seanca duhet të deklarohet me votim. Unë lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim. Në sallë janë 74 deputetë. Votojmë tash!

Faleminderit! A ka deputetë pa kartelë? Jo! Atëherë kanë votuar 61 deputetë. Për janë 24, kundër janë 34 dhe 3 abstenime, që do të thotë se ky mocion procedural nuk është miratuar. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seanca e mëparshme

E përsëris edhe një herë që në sallë janë të pranishëm 74 deputetë, pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme, e mbajtur më 22 dhjetor 2017. A ka vërejtje? Me sa shoh, nuk ka vërejtje.

Atëherë, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme, e mbajtur më 22 dhjetor 2017.

4. Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtjen me armë nga zoti Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, për ta informuar Kuvendin lidhur me këtë çështje. Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë.

Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta, sipas nenit 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës. Në bazë të nenit 44, pika 8 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,

kryeministri Ramush Haradinaj e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështjen e ngritur në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash.

Ndërkaq, koha e përcaktuar për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar është, si në vijim: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” 32 deputetë - 48 minuta; Grupi Parlamentar i LDK-së 27 deputetë - 40,5 minuta; Grupi Parlamentar i PDK-së 23 deputetë - 34,5 minuta, minus 7 minuta për kryeministrin, 27,5 minuta. Grupi Parlamentar Lista serbe 10 deputetë - 15 minuta, minus 2,5 minuta për kryeministrin, i bie që i mbeten 12,5 minuta. Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 10 deputetë - 15 minuta, minus 2,5 minuta për kryeministrin, 12,5 minuta. Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” 6 deputetë - 9 minuta, minus 1,5 minuta për kryeministrin, mbeten 7,5 minuta. Grupi Parlamentar “6+” 6 deputetë - 9 minuta, minus 1,5 minuta për kryeministrin, mbeten 7,5 minuta. Pa grup parlamentar janë 6 deputetë, të cilëve u takojnë 9 minuta.

Atëherë, së pari e ftoj propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën dhe i ka dhjetë minuta që ta paraqesë këtë fjalë. Zoti Avdullah Hoti, shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Lus regjinë që ta hapë mikrofonin për zotin Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeverisës,

Ne e kemi kërkuar sot këtë interpelancë me kryeministrin për veprimet e një anëtari të lartë të Kabinetit të tij, që paraqesin fillimisht kundërshtim me etikën për sjelljen që duhet ta kenë zyrtarët e lartë qeverisës për rrezikim të sigurisë publike, të jetës së njerëzve dhe gjithashtu veprimet që bien ndesh me Kodin Penal të Kosovës.

Ky debat, kjo interpelancë duhet të ndodhë në praninë e kryeministrit, është e papërgjegjshme nga ai, është obligim kushtetues që ai të paraqitet para deputetëve në raste të tilla. Ne, kryesues, kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të vendoset më poshtë në agjendë, të vazhdojmë me pikat tjera dhe debatin për këtë interpelancë ta bëjmë kur kryeministri të jetë këtu në sallë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, meqë propozuesi vetë e kërkon që të zhvendoset si pikë e fundit e rendit të ditës, unë besoj që s’duhet të marrim mendim dhe as të deklarohe mi më tutje. E lëmë, është pjesë e kësaj seance. Dhe, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës

5. Shqyrtimi i propozim-Rezolutës për miratimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm - Agjenda 2030 për Kosovën

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 52 të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar propozim-Rezolutën për miratimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm - Agjenda 2030 për Kosovën. Propozim-Rezoluta u është shpërndarë deputetëve më 18 dhjetor 2017. Së pari, e ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zonjën Besa Baftiu, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë propozim-Rezolutë. Urdhëro, zonja deputete!

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me UNDP-në e ka hartuar draft-Rezolutën për miratimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, të njohura ndryshe si objektivat globale, janë një thirrje universale për veprim, për t'i dhënë fund varfërisë, për ta mbrojtur planetin dhe për të siguruar që të gjithë njerëzit të gëzojnë paqe dhe prosperitet.

Të nderuar deputetë dhe deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Samiti i Kombeve të Bashkuara për miratimin e agjendës zhvillimore u zhvillua nga 25 shtatori deri më 27 shtator 2015. Në këtë samit, objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm u miratuan nga të gjithë anëtarët e OKB-së si objektiva për të arritur nga të gjitha vendet dhe arritja e tyre do të kërkojë angazhime politike, financiare të të gjitha vendeve. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm janë vazhdimësi e objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit, të cilat u miratuan nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në tetor 2008.

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke marrë parasysh këto që u thanë më sipër dhe duke u bazuar në motivin kryesor për ta dhënë një kontribut për një Kuvend të orientuar drejt zhvillimit, me kënaqësi ju ftoj të votoni për Rezolutën për miratimin e agjendës së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, duke u angazhuar për t'u bashkuar me 193 vende në mbarë botën në përmbushjen e këtij plani për zhvillim. Po ashtu, e shfrytëzoj këtë mundësi për të falënderuar për bashkëpunim koordinatorin për zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë për mbështetjen e deritashme dhe gatishmërinë që të na ndihmoi në procesin e realizimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Kolegë deputetë, ju e keni tekstin e Rezolutës përpara, por për hir të opinionit do ta lexoj atë, e ju ftoj ta votoni unanimisht:

REZOLUTË

për miratimin e objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm - Agjenda 2030 për Kosovën

Përderisa Agjenda 2030 dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, të miratuara nga Kombet e Bashkuara, më 25 shtator 2015, do t'i nxisin përprojekjet globale për t'i dhënë fund varfërisë, për t'i mbrojtur njerëzit për mjedisin dhe ta vendosin planetin në një kurs të qëndrueshëm gjatë 15 vjetëve të ardhshme;

Duke pranuar se objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm përbëhen nga dimensione ekonomike dhe mjedisore që prekin më tej fushat që përfshijnë çështje të tilla, si: energjia, rritja ekonomike, barazia, konsumi, prodhimi i qëndrueshëm, si dhe shoqëri paqësore;

Duke pranuar se objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm përbëjnë kornizë të ndërlidhur që përqendrohen në dimensione ekonomike, sociale, mjedisore të zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirë dispozita për t'i mobilizuar burimet e nevojshme për të mbështetur zbatimin;

Të vetëdijshëm se Kuvendi i Republikës së Kosovës është zotuar për këtë agjendë të re globale nëpërmjet planifikimit strategjik të Kuvendit, i miratuar në qershor të vitit 2016;

Derisa paragrafi 45 i Agjendës 2030 kujton rolin thelbësor të parlamenteve nëpërmjet miratimit të legjislacionit dhe miratimit të buxheteve, dhe rolit të tyre në sigurimin e përgjegjësisë për zbatimin efektiv të angazhimeve tona, si në paragrafin 79, ku thuhet se roli i parlamenteve në mbështetjen e shqyrtimit të rregullt dhe gjithëpërfshirës të progresit në nivel kombëtar;

Të vetëdijshëm se Qeveria e Republikës së Kosovës do të duhej t'i përkthejë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm global në strategji kombëtare të zhvillimit 2016-2021, të miratuar në janar 2016, dhe në përputhshmëri me specifikat e vendit tonë, përfshirë edhe rreth aspektit kohor;

Duke përkujtuar se deklarata e Konferencës së Katërt Botërore e kryetarëve të parlamenteve, e miratuar më 2 shtator 2015, ofron udhëzime të mëtejme për Kuvendin e Republikës së Kosovës rreth zbatimit të agjendës së re globale;

Me ndërgjegje të mirë se përmirësimi i ekonomisë dhe i mirëqenies të të gjithë qytetarëve të Kosovës nëpërmjet arritjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm do ta ndihmojë vendin të bëhet burim i stabilitetit përbrenda, si dhe në rajon, me besim se arritja e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm do t'i përparojë proceset e integritit në BE, si dhe bashkëpunimin rajonal ndërkombëtar;

1. Të vendoset që Kuvendi i Republikës së Kosovës do t'i miratojë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm, ose Agjendën 2030, bazuar në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme, të miratuar nga 193 shtete liderë nga mbarë bota, më 25 shtator 2015, dhe të lidhura me deklaratën e Konferencës Botërore të kryetarëve të parlamenteve si pika kryesore të referencës mbi të gjitha politikat për zhvillim të qëndrueshëm.

2. Të angazhohet për të ndihmuar zbatimin e kësaj kornize të re globale nëpërmjet miratimit të legjislacionit, duke përfshirë edhe miratimin në kohë të buxhetit të nevojshëm.

3. Ta rishikojë kur është e nevojshme strukturën ekzistuese të komisioneve dhe të gjitha proceset e brendshme, ashtu që në mënyrë efektive dhe koherente të përfshihen të gjitha objektivat relevante nëpërmjet Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si komision kryesor dhe komisioneve tjera relevante që përfshin: Komisionin Parlamentar për Integrim në BE, Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione, Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Planifikim Hapësinor, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

4. Përcjell zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Qeverisë për zhvillim, strategjive të integritit në BE dhe strategjive të tjera që integrojnë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë mbajtjen e takimeve të rregullta me shoqërinë civile, sektorin privat dhe qytetarët, në përgjithësi.

5. Kërkoj nga Qeveria raportim për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021, duke përfshirë edhe rreth objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm përmes një rishikimi të plotë vjetor nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

6. T'i shqyrtojë raportet kombëtare të progresit që të mund të paraqiten nga Qeveria në Kombet e Bashkuara si pjesë e shqyrtimit global në forumin e nivelit të lartë të OKB-së për zhvillim të qëndrueshëm.

7. Të organizojë në fund të çdo viti mbledhje me Qeverinë, komunitetin ndërkombëtar, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët në përgjithësi për debat publik rreth statusit të progresit të synimeve relevante të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për zhvillimin e vendit tonë.

Të nderuar deputetë,

Në emër të Komisionit për Shëndetësi ju ftoj që ta mbështetni këtë rezolutë dhe të votoni unanimisht për të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Tani do ta marrin fjalën sipas radhës kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, me sa shoh fjalën e ka kërkuar deputetja Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e përkrah miratimin e kësaj rezolute. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe rolin e Kuvendit të Kosovës, ne do të mundohemi që kjo rezolutë të mos mbetet vetëm një copë letre që nuk do të zbatohet, por do të angazhohemi që me kohë të miratohet legjislacioni dhe që të sigurohen fondet për zbatimin e rezolutës, që ka një rëndësi shumë të veçantë për Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Haxhi Abdyli. Urdhëro!

HAXHI ABDYLI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike i japim përkrahje aprovimit të rezolutës për miratimin e objektivave të qëndrueshëm, sepse kjo paraqet një agjendë zhvillimore për Kosovën deri në vitin 2030, sepse përfutuese më e madhe e kësaj agjende dhe këtyre objektivave janë vendet në zhvillim, ku bën pjesë edhe Kosova.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah me unanimitet këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Urdhëroni!

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm Agjenda 2030 për Kosovën bazohen në arritjen e objektivave të zhvillimit të mileniumit si plan për t’i dhënë fund varfërisë së skajshme, që janë objektiva globale dhe bëjnë thirrje universale për veprim dhe për t’i dhënë fund pra varfërisë dhe për ta mbrojtur planetin tonë në pikëpamje ekologjike nga ndotja e të tjera, për t’u siguruar të gjithë njerëzit që ta gëzojnë paqen dhe prosperitetin e mirëqenien.

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm u miratuan nga të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara si objektiva për t’u arritur nga të gjitha këto vende. Arritja e tyre kërkon një angazhim politik dhe financiar të të gjitha këtyre vendeve, prandaj edhe po e shqyrtojmë kur po e marrim obligimin që ta aprovojmë këtë objektiv. Siç u tha, këto objektiva bazohen në objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit dhe Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në legjislacionin e vet të tretë në Rezolutën për objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit në vitin 2008 dhe ne kemi qenë aktivë si komision dhe si deputetë për aprovimin e këtij legjislacioni dhe të rezolutës.

Shoqëria jonë ka kontribuar në proceset konsultative të Kombeve të Bashkuara, të quajtura “Debat post 2015”, që kanë çuar në zhvillimin e agjendës së re, e që është globale, që është “Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm”. Ne gjithashtu në mandatin e kaluar, në vitin 2016, e miratuar Strategjinë kombëtare të zhvillimit për vitet 2016/2020, që është udhërrëfyes për synimet e zbatimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Miratimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të programit tonë të zhvillimit i mundëson qasje të mëtejme shoqërisë sonë në shoqërinë globale dhe bashkëpunim më të ngushtë me vendet tjera në mbështetje të këtyre objektivave. Gjithashtu, premtion përqendrimin e shoqërisë sonë te njerëzit dhe përmirësimin e kushteve të jetës së tyre, e respekton gjininë dhe respekton të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë në grupet e marginalizuara dhe të ndjeshme.

Platforma e zhvillimit të qëndrueshëm mbetet në qendrën e agjendës së politikës së jashtme të Bashkimit Evropian dhe të punosh për realizimin e këtyre objektivave do të thotë të angazhohesh për realizimin e synimit drejt integritit në familjen e madhe evropiane dhe në familjen globale. Kjo do të thotë se zotohemi që t’i japim fund varfërisë, të përkushtohemi për sigurimin e të drejtave të njeriut, të paqes dhe prosperitetit. Puna jonë e avancon vendin tonë në bashkëpunim me mbrojtjen e mjedisit, gjithashtu avancon edhe në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara dhe agjenda zhvillimore e saj në nivelin lokal në vend dhe në kuptimin ndërkombëtar, siç e thashë më lart.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do të votojë për rezolutën dhe unë personalisht juve, kolegë deputetë, ju ftoj që të kemi konsensus për ta votuar të gjithë këtë rezolutë në favor tonin, rezolutën për miratimin e agjendës së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, sepse kështu angazhohemi për t’iu bashkuar 193 vendeve në mbarë botën dhe përmbushjen e këtij plani për zhvillimi global dhe për zhvillimin e vendit tonë në veçanti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Lista serbe? S’ka asnjë përfaqësues në sallë. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Në vitin 2016, Qeveria e Kosovës e ka miratuar Strategjinë kombëtare të zhvillimit 2016/2020 dhe këtu i ka integruar gjithashtu synimet e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në udhërrëfyesin e tyre për zbatim. Kështu që Kosova praktikisht ka marrë obligime për zbatimin e kësaj rezolute.

Dua ta falënderoj NDP-në që ka bashkëpunuar ngushtë me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjithashtu bashkërisht me komisionin ka ndikuar në hartimin e kësaj rezolute. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah dhe do ta votojë këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Enver Hoti, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën”, e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka trajtuar rezolutën dhe e mbështesim plotësisht. Mendojmë se kjo rezolutë përmban edhe obligime dhe përgjegjësi për institucionet e vendit dhe jemi të bindur që do të përgjigjemi konform objektivave që i parasheh Agjenda Kosova 2030. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “6+” askush s’është në sallë. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën. Me sa shoh, asnjë deputet s’e ka kërkuar fjalën, kështu që lus Administratën ta konstatojë praninë e deputetëve në sallë.

Në sallë janë 52 deputetë, që do të thotë se s’kemi kuorum. Ndërkaq kartelat e instaluara i kanë 104 deputetë. Meqë deputetët janë në ambientet e Kuvendit, unë i lus që të kthehen në sallë, sepse pa kuorum ne s’mund ta vazhdojmë seancën, do të detyrohemi ta ndërpresim.

Atëherë, në sallë aktualisht janë 62 deputetë. Unë lus regjinë dhe kolegët deputetë që të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! A ka deputet pa kartelë? Një, vota është për. Atëherë, në votim kanë marrë pjesë 64 deputetë. 64 janë për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Rezolutën për miratimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm Agjenda 2030 për Kosovën.

6. Shqyrtimi i parë i Projekt-Kodit të drejtësisë për të mitur

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projekt-Kodin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Unë së pari e ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projekt-Kodin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Më lejoni që të paraqes para jush për miratim Projekt-Kodin e drejtësisë për të mitur.

Hartimit dhe finalizimit të këtij drafti i kanë prirë një varg takimesh dhe diskutimesh, si dhe është bërë në koordinim të ngushtë me aktorët relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë, me theks të veçantë me përkrahjen e UNICEF-it, Zyrës së Bashkimit Evropian, pastaj Odës së Avokatëve të Kosovës, Qendrës për Punë Sociale, Policisë, Prokurorisë, Këshillit Gjyqësor, si dhe Shërbimit Sprovues dhe Korrektues të Kosovës.

Në vijim po i paraqes disa nga çështjet më të rëndësishme, të cilat i përmban Projekt-Kodi i drejtësisë për të mitur. Pra, është zgjeruar numri i parimeve garantuese dhe mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve, si dhe është paraparë një kapitull i veçantë, i cili i rregullon masat ndihmëse, si dhe mbrojtëse, për fëmijët si kryerës të veprave penale, pra nën përgjegjësi penale për fëmijët nën moshën 14-vjeçare. Është rritur lloji i masave të diversitetit, si dhe janë përcaktuar kushtet dhe mënyra e shqiptimit të tyre. Është paraparë që koha e kaluar në paraburgim, si dhe çdo privim tjetër nga liria që të llogaritet në kohëzgjatjen e masës së shqiptuar të dërgimit të të miturit në institucionet e tipit edukativo-korrektues, dënimi me burg ndaj të miturit dhe dënimi me gjobë, si dhe është përcaktuar edhe afati i paraburgimit prej 30 ditëve deri në gjashtë muaj, përjashtimisht deri në 12 muaj për raste specifike.

Në kuadër të propozimeve të reja është edhe zgjerimi i numrit të veprave penale, kur gjyqtari për të mitur apo trupi gjykues për të mitur i gjykon personat madhorë në rast kur fëmija paraqitet viktimë. Është vendosur një kapitull i veçantë, i cili ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë. Po ashtu, dua të theksoj se dispozitat e këtij projekt-kodi janë në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të BE-së, me ç'rast i është nënshtruar vlerësimi të përshtatshmërisë me legjislacionin e BE-së, si dhe është bërë vlerësimi financiar, si dhe i ka kaluar të gjitha konsultimet në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores së punës së Qeverisë.

Konsideroj se aprovimi i këtij projekt-kodi është në funksion të kompletimit të kuadrit ligjor në sektorin e drejtësisë dhe avancimin e standardeve më të larta sa i përket trajtimit të të miturve, andaj propozoj miratimin e këtij Projekt-Kodi të drejtësisë për të mitur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Atëherë, së pari e ka fjalën kryetarja e Komisionit për Legjislacion, deputetja Albulena Haxhiu. Urdhëroni!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 12. 12. 2017, e shqyrtoi Projekt-Kodin nr. 06/L-006 të drejtësisë për të mitur.

Ka pasur diskutime natyrisht në Komisionin për Legjislacion dhe anëtarët e Komisionit për Legjislacion e kanë mbështetur këtë draft-kod, projekt-kod, dhe kanë konsideruar që është më i

avancuar sesa kodi aktual që është në fuqi, andaj edhe i kanë dhënë përkrahje dhe kërkojnë nga deputetët e Kuvendit që ta miratojnë të njëjtin.

Po ashtu, në qoftë se më lejohet do të flisja edhe në emër të Grupit Parlamentar. Edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar Projekt-Kodin për të mitur dhe jemi të pajtimit që të njëjtin ta përkrahim, duke pasur parasysh që i njëjti është më i mirë në shumë raste sesa kodi që është aktualisht për të mitur. Megjithatë, konsiderojmë që gjatë fazës së grupeve punuese duhet të përfshihen edhe disa çështje që më tepër, për bindjen tonë, janë nevoja për të mos lënë interpretime, që disa nga dispozitat dhe kapitujt që janë të paraparë të qartësohen në mënyrë që mos të lënë hapësira për interpretime, që pastaj po keqpërdoren.

Prej përvojës që kam, domethënë vizitat që i kam realizuar nëpër qendrat korrektuese, me theks të veçantë edhe atë në Lipjan, unë jam jashtëzakonisht e shqetësuar me kushtet, sidomos të të burgosurve, në këtë rast të të miturve. Është e vërtetë që ne kemi kontribuar në kuadrot, apo ligjet ose pakon ligjore, që kanë të bëjë me sistemin e drejtësisë, ta zëmë në këtë rast me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale. Është ligji i mirë, natyrisht besoj se të gjithë pajtohemi, me disa përjashtime në disa nene, por edhe ky Projekt-Kod është mirë i shkruar, por problemi po mbetet te zbatimi i këtyre ligjeve.

Pra, në muajin dhjetor isha në vizitë në Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe aty pata rastin t'i shoh problemet me të cilat ballafaqohen të miturit. Së pari, ka raste kur të miturit lihen në të njëjtën dhomë me ata që janë dënuar apo akuzohen për vepra tepër të rënda penale, pra të burgosur apo të paraburgosur të rritur, gjë që është e ndaluar edhe me konventa ndërkombëtare, por po ashtu edhe me ligjet aktuale.

Në Lipjan e kemi një të mitur që është lënë në dhomë me të paraburgosura që janë për vepra të rënda penale. Pastaj, ka mungesë të stafit, sidomos të punëtorëve socialë dhe të psikologëve, vetëm një. Është e pamundur që me këtë staf të punohet në risocializim, në riedukim. Pra, shteti duhet të përkujdeset që kur një i mitur, por edhe një i burgosur, e kryen dënimin, ai në momentin kur të dalë nga burgu të jetë i risocializuar, i riedukuar, në mënyrë që të mos i përsërisë veprat penale, pra të bëhet dhe të sillet në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Unë mendoj që kjo duhet të jetë shqetësim edhe për Qeverinë, edhe për Ministrinë e Drejtësisë, madje ndoshta është mirë që ministri të na tregojë se çfarë po bën në këtë drejtim, sepse përnjëmend është jashtëzakonisht shqetësuese.

Dy çështje tjera desha t'i përmend në këtë Projekt-Kod, kanë të bëjnë me parimet, domethënë parimet që i rregullon, është neni 2. Mendoj që janë më tepër përskrime, të cilat duhet që në secilën prej parimeve, të cilat janë të parapara në këtë Projekt-Kod, duhet të ketë edhe qartësi por edhe definime më të qarta për zbatuesit e këtij kodi. Po ashtu, sa i përket paraburgimit ka

pasur raste të shumta kur një i mitur, përveç të tjerëve që janë të paraburgosur, që qëndrojnë me vite të tëra në paraburgim, shpërpushur me Kodin Penal, por edhe me atë për ekzekutimin e sanksioneve penale, ka pasur edhe të mitur që kanë qëndruar në paraburgim, ndoshta dy e tre vjet. Kjo duhet të adresohet dhe të ndalohet një herë e përgjithmonë për të gjithë të burgosurit, sepse e kuptojmë se në paraburgim nuk ekzistojnë privilegjet sikur i ka një i burgosur, prandaj edhe koha në paraburgim është jashtëzakonisht më e vështirë, sesa ajo kur tashmë je i dënuar, pa dashur ta paragjykoj këtu fajësinë.

Po ashtu, edhe sa i përket ndërmjetësimit të kapitulli 2 besoj se duhet të ketë një harmonizim me Ligjin për ndërmjetësim, projektligji në këtë rast që është në procedura të Kuvendit, me kodin aktual. Por, po ashtu duhet të definohet qartë që me të miturit duhet të merren gjyqtarë dhe prokurorë që janë të specializuar për rastet e të miturve.

Këto janë disa nga vërejtjet tona si grup parlamentar. Ne në parim, e mbështetim. Unë si kryetare e Komisionit për Legjislacion kam marrë edhe shumë vërejtje prej organizatave që i monitorojnë edhe qendrat korrektuese, por edhe merren me të drejtat e të miturve, duhet t'i marrim parasysh edhe vërejtjet e tyre, që janë jashtëzakonisht me vend dhe sigurisht duhet të punojmë që ta kemi një kod shumë më të avancuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Meqë deputetja Haxhiu foli edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, unë ia jap fjalën deputetit Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projekt-Kodi i drejtësisë për të mitur është njëri prej projektligjeve më të rëndësishme në fushën e drejtësisë penale, sepse ka të bëjë me të miturit të cilët kanë kryer vepra penale dhe të cilët sistemi duhet t'i trajtojë në aspektin e riedukimit, në aspektin e risocializimit dhe në aspektin e rikthimit në shoqëri.

Për t'i ofruar këto shërbime, atëherë normalisht që institucionet që merren me korrektimin dhe riedukimin e të rinjve që kanë kryer vepra penale duhet të kenë kapacitete, si në aspektin social, në aspektin sprovues, në aspektin e shërbimit psikologjik dhe në aspektin e riarsimimit. Pra, është një sistem kompleks, i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse në një moment të caktuar të miturit mund ta gjejnë veten si kryerës të veprave penale, por shoqëria duhet të jetë jashtëzakonisht e kujdesshme, sepse këta të rinj potencialisht kryerës të veprës penale mund të shndërrohen në kontingjent afatgjatë kriminal dhe për këtë arsye mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme që ky kod të jetë shumë mirë i shkruar dhe po ashtu të jetë lehtësisht i zbatueshëm.

Në këto rrethana, mendoj se, meqë jemi në leximin e parë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i jep përkrahje këtij Projekt-Kodi dhe normalisht që do t'i shohim të gjitha mundësitë që ta arrijmë maksimumin e avancimit të tij, duke angazhuar edhe institucione vendore dhe ndërkombëtare të specializuara në drejtësinë për të mitur, sepse thamë që është jashtëzakonisht e rëndësishme që ta dobësojmë mundësinë e kontingjentit kriminal afatgjatë për grupe dhe individë kriminelë, të cilët mund të kenë ambicie që këta të rinj edhe në qendrat e riedukimit t'i rekrutojnë dhe t'i kenë si kontingjent të tyre.

Pra, mendoj se është një fushë jashtëzakonisht e rëndësishme dhe në këto rrethana Lidhja Demokratike e Kosovës e trajton me shumë seriozitet dhe i jep përkrahje këtij Projekt-Kodi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Partia Demokratike e Kosovës, kush do të flasë? Deputeti Nezir Çoçaj, urdhëroni!

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projekt-Kodin me numër 06/L-006 të drejtësisë për të mitur dhe si të tillë në parim do ta mbështesë. Ndërsa, gjatë leximit të dytë të këtij Projekt-Kodi do ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, deputeti Igor Simiq e ka fjalën.

IGOR SIMIĆ: Poštovani predsjedavajući,

Uvaženi kolege poslanici,

Poslanička grupa Lista srpska podržace u prvom čitanju ovaj zakon, ali ćemo u narednom periodu u skladu sa poslanikom i Zakonom dati svoje amandmane.

Ono što mogu da kažem u ovom trenutku jeste da je ovaj zakon napravio značajan iskorak u skladu sa evropskim trendovima, kada je u pitanju primena diverzionih mera restorativne pravde, koja će omogućiti da maloletni učinioci krivičnih dela izbegnu proces koji bi se vodio prema njima pred institucijama, i na taj način onemogućicemo stigmatizirajući efekat koji bi sam krivični postupak mogao da ima prema maloletnicima. S druge strane, ono što moram da napomenem jeste jedan od osnovnih zahteva kada je u pitanju donošenje ovog zakona, i što će biti deo naših amandmana jeste da se kroz zakon jasno definiše da sva lica koja u postupku prema maloletnicima postupaju, moraju imati odgovarajuća znanja iz oblasti dečjih prava i svega ostalog kako bih se zaštitio maloletnik koji učestvuje u samom procesu, ali istovremeno kako bi se kao društvo ponašali odgovorno prema maloletnim učiniocima krivičnih dela.

Niko se ne rađa kao nasilna osoba, već je nasilje uopšte naučeni oblik ponašanja i na taj način mi moramo kao društvo da adekvatno odgovorimo, kako bi sve institucije u zemlji sprečile da ta maloletni učinioci krivičnih dela prerastu u klasične kriminalce, koji će vršiti teže oblike krivičnih dela u narednom periodu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka kërkuar deputeti Shkumbin Demalijaj. Urdhëroni!

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, kryesues!
Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah Projekt-Kodin për drejtësi për të mitur.

Duke mos dashur të ndalem te fushëveprimi i tij dhe parafolësit, ne e kemi shqyrtuar në Komisionin Parlamentar edhe këtë çështje që e rregullon këtë trajtim që nga delikuenca e të miturve të kriminalizuar deri te trajtimi i fundit, risocializimi i tyre në shoqëri. E përkrahim këtë Projekt-Kod dhe besoj se gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit në lexim të dytë do ta japim kontributin dhe ta kalojmë në lexim të dytë këtë projekt-kod. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma për Kosovën”, shefi i Grupit Parlamentar, Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!
Grupi Parlamentar i “Nismës për Kosovën” e ka shqyrtuar Projekt-Kodin për të mitur dhe në lexim të parë gjithsesi, ashtu sikur të gjitha grupet parlamentare, do t’i japim mbështetje këtij projekt-kodi dhe shpresojmë që deputetët e “Nismës” në procesin nga sot deri në leximin e dytë do të bëjnë amendamente dhe do të plotësojnë aty ku mendojnë dhe besojnë se mund të përmirësohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, nuk është asnjë deputet nga ky grup në sallë.

Deputetët e paraqitur për diskutim nuk ka. Ministri Tahiri e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni, zoti ministër.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Çështjen që ngriti zonja Haxhiu ka të drejtë, mirëpo ne në tetor të vitit të kaluar e kemi përruar Qendrën e Re Korrektuese si donacion i Bashkimit Evropian në Lipjan dhe mund të them se të miturit që mbahen në atë qendër kanë kushtet ashtu siç trajtohen të miturit në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Pra, është larg më mirë se në të gjitha vendet e rajonit.

Një prej sfidave më të mëdha që është ballafaquar kjo Qendër Korrektuese për të Mitur ka qenë çështja e shkollimit të tyre, mirëpo tash së bashku me ministrin e Arsimit dhe kryetarin e Komunës së Lipjanit kemi arritur shumë afër një memorandumit të bashkëpunimit, ku edhe këta të mitur, për aq kohë sa do të mbahen në këtë Qendër të paraburgimit do të kenë mundësi që të mos e humbin shkollimin e tyre, pra do t'u ofrohen këto shërbime në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit si dhe Komunën e Lipjanit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

E përsëris, nuk kemi deputetë të paraqitur për diskutim.

Të pranishëm në sallë janë vetëm 49 deputetë, e janë 103 me kartela.

Unë lus deputetët që të kthehen në sallë, sepse sipas Rregullores nëse nuk kemi kuorum, ne s'mund të vazhdojmë, do të detyrohemi të ndërpres seancën.

Atëherë në sallë janë 67 deputetë.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votë për miratimin në parim të Projekt-Kodit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit!

A ka deputetë pa kartelë? Një, dy, tre, domethënë për, katër, pesë.

Atëherë në këtë proces votimi kanë marrë pjesë 68 deputetë.

62 janë për, plus sa janë me dorë pa kartelë, 5, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim. Konstatoj që Kuvendi miratoi në parim Projekt-Kodin e Drejtësisë për të mitur.

Ngarkohen komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë Projekt-Kodin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike

Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Së pari ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të paraqesë dhe të arsyetojë këtë projektligj. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Në kuadër të strategjisë për kontrollin e brendshëm të financave publike 2015-2019 janë përcaktuar objektivat dhe veprimet në zhvillim të mëtutjeshëm të sistemit të kontrollit të

brendshëm të financave publike, i përbërë nga menaxhimi financiar, kontrolli dhe auditimi i brendshëm.

Një ndër aktivitetet e planifikuara për përmbushjen e angazhimeve që ka marrë Ministria e Financave ka të bëjë me domosdoshmërinë e hartimit të Projektligjit për kontroll të brendshëm të financave publike dhe miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Nëpërmjet këtyre masave synohet përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike dhe krijimi i një sistemi modern dhe efikas për menaxhimin e fondeve publike.

Në kuadër të kësaj, Ministria e Financave synon të ndërmarrë një nismë tejet të rëndësishme për rishikimin, përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës ligjore që rregullon të gjitha komponentët e kontrollit të brendshëm të financave publike, bashkërendon legjislacionin nacional me legjislacionin e BE-së dhe ofron funksionim më efikas këtij sistemi në sektorin publik në Kosovë.

Në këtë aspekt ligji i ri i kontrollit të brendshëm të financave publike do të ndihmojë Republikën e Kosovës në trasimin e rrugës për hapat e ardhshëm në përmbushjen e kritereve të kapitulli XXXII, Kontrolli financiar për negociatat me BE-në.

Legjislacioni i tillë duhet gjithashtu të konsiderohet nga BE-ja si një sinjal pozitiv në përgatitjen e Kosovës për pranimin e përkrahjes me fonde.

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike që përfshin menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm si dhe harmonizimin e tyre në pajtim me standardet ndërkombëtare për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm.

Dispozitat e fushëveprimit të këtij projektligji janë të obligueshme për të gjitha subjektet e sektorit publik në Kosovë që menaxhojnë pronën publike dhe përdorin fonde publike. Siç janë subjektet e qeverisjes qendrore dhe lokale, si dhe fondet e veçanta, ndërmarrjet publike, institucionet financiare dhe organizatat jofitimprurëse, si dhe organizata të tjera që shpenzojnë fonde publike në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Nga aspekti përmbajtësor ky projektligj ka gjithsej 36 nene. Projektligji është i ndarë në gjashtë kapituj.

Synim final që bart reforma në këtë fushë ka për qëllim përmbushjen e angazhimeve që e ka marrë Qeveria e Kosovës, të cilat janë të formuluar në një serë dokumentesh, duke përfshirë

nenin 97 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Raportin e fundit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën.

Ne jem të hapur dhe mirëpresim të gjitha sugjerimet tuaja që ndihmojnë në avancimin e këtij draftligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputetin Driton Selmanaj, që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin në emër të komisionit. Urdhëro, Driton!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 dhjetor 2017 ka shqyrtuar dhe ka miratuar në parim Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Vlerësimi ynë është që ky projektligj për kontrollin e financave publike ka për objektiv që të përmirësojë, të fuqizojë dhe të standardizojë edhe më tutje bazën ligjore dhe organizative në nivel qendror dhe lokal.

Përkundër asaj se ne e kemi pasur Ligjin për auditimin e brendshëm, i cili tani me këtë projektligj, shfuqizohet si i tillë.

Projektligji gjithashtu rregullon sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike që përfshin menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm si dhe harmonizimin e këtyre në pajtim me standarde ndërkombëtare, për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm.

Projektligji gjithashtu rregullon menaxhimin financiar dhe kontrollin, ku rregullohet llogaridhënia menaxheriale e udhëheqësit të subjektit të sektorit dhe zyrtarit kryesor administrativ, zyrtarit kryesor financiar, drejtuesve të niveleve bartëse dhe mbajtësve të tjerë të buxhetit, të subjekteve të sektorit publik.

Anët pozitive të këtij projektligji janë që për periudhën dyvjeçare secili auditor i brendshëm që punon në sektorin publik duhet të jetë i certifikuar.

Përmes këtij projektligji arrihet të fuzionohen kompetencat në fushën e auditimit të brendshëm që jepen me Ligjin mbi mbikëqyrjen e financave publike, Ligjin mbi auditimin e brendshëm si dhe rregullat e thesarit për auditimin e brendshëm dhe kontrollit në fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Mendoj se ky projektligj i plotëson zbrazëtirat ligjore që kanë dalë pas aprovimit të strategjisë të kontrollit të brendshëm të financave publike.

Dhe, në fund, komisioni pas shqyrtimit në parim të këtij projektligji vlerëson se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 56 të Rregullores së Kuvendit për procedim dhe shqyrtim të parë si dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Në fakt, unë po flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, të cilët i ftoj që ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është radha të marrim qëndrimet e grupeve parlamentare. Tashmë e kemi qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Po të ishte shteti ashtu qysh duhet, ky përbën njërin prej ligjeve më të rëndësishme, sepse ka të bëjë drejtpërdrejt me atë dimensionin që unë e konsideroj si esencial, të mënyrës se si kontrollohet shpenzimi i financave dhe ka të bëjë drejtpërdrejt me kontrollin e brendshëm të shpenzimit.

Pra, duhet ta ketë secili shtet demokratik dhe sidomos aty nga perspektiva e asaj ku duam të bashkohemi në Bashkimin Evropian. Kontrolli i brendshëm i financave duhet të jetë shumë efektiv e këtu në Kosovë vlen të përmendet një paradoks, i cili na ndodh ne si dukuri, me ç’ rast shumë prej institucioneve që i kontrollojnë Auditori i Jashtëm, Auditori i Përgjithshëm.

Kemi institucione, me ç’ rast në raportin e Auditorit të Përgjithshëm gjejmë shumë defekte, aty hasim të gjetura, të cilat janë skandaloze, ndodhin aty defekte të shumta sa i përket kontrollit të shpenzimeve dhe pasqyrave reale.

Kurse, në anën tjetër, kemi raporte të brendshme të auditimit, të cilat thonë që aty gjithçka është në rregull. Çka do të thotë kjo? Kjo tregon që hallka më e dobët në Republikën e Kosovës sa i përket kontrollit të financave publike, mënyrën qysh entitetet, të cilat janë shpenzuese dhe institucionale në Republikën e Kosovës e kanë krejtësisht të paorganizuar apo të paorganizuar deri në atë masë siç do të duhej të ishte kontrolli i brendshëm i financave publike.

Nëse e lexoni me vëmendje këto vitet e fundit Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, aty identifikohet qartë që dobësia më kritike e Republikës së Kosovës është niveli edhe standardi i kontrollit të brendshëm, i auditorëve të brendshëm të kontrollit të financave publike.

Dhe, këtu në Kosovë kemi rastin kur ndonjëherë ndodh që auditori i brendshëm të gjejë vetë shkelje, të cilat janë të rënda në institucionin ku ai vepron dhe këtë e ka kompetencë. Ai është i ngarkuar me këtë detyrë që të shqyrtojë e të kërkojë krejt dokumentacionin, krejt faturat e nevojshme të harxhimeve dhe të krijojë raporte e pasqyra të qarta të harxhimeve. Njerëz, të cilët si auditor të brendshëm kryejnë detyrën e tyre qysh duhet dhe institucioneve të caktuara u gjejnë keqpërdorime, ka raste në Republikën e Kosovës kur këta auditorë ndëshkohen politikisht për punën e mirë që kryejnë.

Unë këtu vitin e kaluar e kam përmendur njërin prej këtyre, auditorin e brendshëm të Agjencisë së Inteligjencës të Kosovës.

Është auditori Naim Brahimaj, i cili për shkak të keqpërdorimeve që i ka gjetur brenda këtij institucioni është ndëshkuar, është ndëshkuar për punën e ndershme dhe profesionale që e ka bërë në këtë institucion. Kjo tregon për nivelin dhe për standardin e auditimit të brendshëm.

Këtu janë krijuar disa rrjete shumë të rrezikshme kriminale nëpër disa institucione, të cilat në mënyrë konsensuale e keqpërdorin në mënyrë kriminale paranë publike dhe krijojnë aty brenda atmosferë të terrorit që kushdo që e zbulon krimin, duhet të jetë i gatshëm të përballet me pasoja, ose të qesin edhe prej punës edhe kurrë nuk mund të kthehesh më në punë. Ky është një shembull i keq që ka ndodhur në Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës. Merreni me mend, njeriun e largojnë prej punës duke thënë që ke treguar si shpenzohen këto financa, kjo është një nxjerrje në publik e sekretit shtetëror, merreni me mend. Në Kosovë konsiderohet që nëse ta gjejnë hajninë e keqpërdorimit sa u përket financave publike, ti konsiderohesh që ke nxjerrë sekret shtetëror të rëndësishëm në publik dhe për këtë ndëshkohesh.

Pra, me fjalë të tjera, ky ligj që ka të bëjë me auditimin e brendshëm, është shumë i rëndësishëm, ama shumë i rëndësishëm nëse zbatohet. Nëse shkon kështu qysh ka shkuar deri tash në Kosovë, ky ligj nuk është zbatuar dhe me plotësimet e ndryshimet e këtij ligji nuk do të zbatohet sërish, pse? Sepse për t'u zbatuar ligjet duhet pasur vullnet politik të Qeverisë, e vullneti i Qeverisë që po kërkohet në këtë rast, është vullnet për ta luftuar krimin, e ky vullnet nuk ekziston në Kosovë.

Prandaj, kam shumë dyshim që edhe ky ligj shumë i mirë që po e miratojmë, do të jetë ligj në letër, pa kurrfarë efekte në tërë atë masë të qindra e qindrave të auditorëve të brendshëm që janë nëpër të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetit Mërgim Lushtaku, si përfaqësues i Grupit Parlamentar të PDK-së.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar me kujdes Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe kemi parë që duhet të votohet në lexim të parë dhe gjatë dy leximeve besoj që do të japim edhe kontributin tonë me amendamente të caktuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, nuk është lajmëruar asnjë deputetë. Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Duke e ditur se ky projektligj ka kaluar përmes komisionit të kësaj fushe, po ashtu duke e ditur se përmes këtij projektligji rregullohet dhe qartësohet sistemi i kontrollit të brendshëm të financave publike, edhe duke e ditur se kjo ka qenë kërkesë jo vetëm e Qeverisë, por edhe shumë fokus grupeve gjatë viteve që disa çështje të kësaj natyre të rregullohen me ligj.

Ne si grup parlamentar do ta votojmë në parim dhe do ta japim kontributin gjatë rrugëtimit të këtij projektligji deri në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma për Kosovën”, deputeti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne si “Nismë” i japim mbështetje të fuqishme këtij ligji dhe mendimi ynë unanim është se është nga ligjet më të rëndësishme, por dëshiroj të them diçka që Kosovës prej shpalljes së pavarësisë e këndeje nuk i kanë munguar dhe nuk i mungojnë ligjet e mira, por i mungon mekanizmi i zbatimit të këtyre ligjeve.

Ndoshta në mungesë të këtij ligji është bërë një keqpërdorim flagrant i parasë publike dhe si deputet, edhe si qytetar asnjëherë nuk e kam kuptuar pse kanë ekzistuar faktikisht zyrat e auditorëve, përderisa as ministritë, e as Prokuroria e shtetit nuk i ka marrë seriozisht të gjeturat e jashtëzakonshme dhe një punë të jashtëzakonshme që e kanë bërë auditorët e shtetit.

Dëshiroj të marr një shembull shumë të thjeshtë, po shumë domethënës, që ta kontrollosh paranë publike, i nderuar ministër i Financave, në vendet perëndimore do të thotë që unë të vij në zyrën tënde ose të Dhuratës dhe të kërkoj të gjitha shpenzimet që i keni bërë nëpër restorante, darka, dreka. Do të dal te një shembull konkret, se ju kam miq, prandaj ju mora si shembull.

Në Suedi, Sekretarja e Shtetit e Suedisë në orarin zyrtar ka pirë një gotë verë të kuqe me një gazetar suedez të televizionit numër katër dhe ky ia ka fotografuar faturën dhe e ka dërguar përmes Viberit në redaksi. Akoma kjo Sekretarja e Shtetit pa shkuar në zyrë, kryeministri e ka larguar nga puna.

Unë ju them me ndërgjegje të plotë që kam informacion nga kamerierët e restoranteve në Prishtinë që këshilltarët e disa ministrave pinë në kohë dreke verë të kuqe me çmim 90 euro.

Unë kam informacion të saktë nga automekanikët në Prishtinë dhe në Kosovë që shumë shoferë të ministrave shkojnë dhe marrin fatura gjëja për ndërrimin e gomave të dimrit, po shyqyr që nuk i njihni a janë të dimrit a të verës, sikurse unë, dhe nuk rrëshqitni diku e ta thyeni qafën.

Unë si deputet kam kërkuar që dy muaj t'i kem shpenzimet e drejtorit të Valës, sepse kam informacion që ai bën keqpërdorime të jashtëzakonshme, pinë gjithë natën me paratë publike, e nuk më kanë ardhur këto shpenzime.

Në qoftë se, zoti ministër, arrin të krijosh një mekanizëm të tillë të kontrollit nga auditorët, po edhe që të jenë publike të gjitha shpenzimet tuaja, edhe për ne si deputetë, por edhe për gazetarë, atëherë besoni që vetëm në këtë formë do të luftohet korrupsioni dhe do të luftohet keqpërdorimi i parasë publike.

Po e përfundoj fjalimin tim me një thënie brilante që e kemi dëgjuar të gjithë: në Kosovë rrogat janë të vogla, po të ardhurat janë të mëdha. Pse ndodh kjo gjë, vetëm për shkak të keqpërdorimit të parasë publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Grupi Parlamentar "6+" nuk ka asnjë përfaqësues në sallë.

Deputetë të paraqitur për diskutim nuk ka.

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Atëherë në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Në sallë janë 67 deputetë, do të thotë kemi kuorum.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! A ka deputetë pa kartelë?

3 deputetë janë pa kartelë. Atëherë, në votim kanë marrë pjesë 65 deputetë. 63 janë për, 1 kundër dhe 1 abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike, ndërkaq ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Së pari, i jap fjalën ministrit të Drejtësisë, zotit Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe të arsyetojë këtë projektligj. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Më lejoni që të paraqes para jush për miratim Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Hartimi dhe finalizimi i këtij projektligji është rezultat i punës së vazhdueshme të Ministrisë së Drejtësisë në funksion të avancimit të kuadrit ligjor në përgjithësi, e me theks të veçantë të legjislacionit të fushës së luftimit dhe të parandalimit të korrupsionit.

Gjithashtu, miratimi i këtij projektligji është pjesë e agjendës evropiane të reformave. Përmes angazhimeve tona, duke u përfshirë edhe aprovimin e këtij projektligji, konsideroj se institucioneve kompetente po u ofrojmë legjislacion adekuat, në mënyrë që puna e tyre të jetë sa më efikase dhe efektive në drejtim të parandalimit dhe luftimit të dukurive negative, veçmas korrupsionit dhe, në këtë aspekt, konfliktit të interesit. Miratimi i këtij projektligji është hap para në angazhimin për t'i dhënë përgjigjen e duhur nevojës për të kufizuar dhe ndaluar veprimet dhe angazhimet e zyrtarëve publikë gjatë ushtrimit dhe pas mbarimit të detyrës në një funksion publik. Përcaktimi i qartë i situatave të konfliktit të interesit dhe parandalimit të tij, përbën qëllimin thelbësor të këtij projektligji.

Të nderuar deputetë,

Projektligji përmban këto çështje kryesore: parasheh një numër të konsiderueshëm të ndalesave për zyrtarët publikë, si u ndalohe kryerja e punëve të tjera, përmes të cilave në çfarëdo forme mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të funksionit publik; zyrtari i lartë nuk ka të drejtë të punësohet ose të emërohet për një periudhë deri në 2 vjet pas përfundimit të funksionit publik në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe të institucioneve bartëse të tyre, të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik.

Ndalimi që të përdoren informacionet e siguruar gjatë ushtrimit të funksionit publik për qëllim të punësimeve të tjera në të ardhmen, për interesa private, të veta ose të një personi të afërt apo të besuar në një periudhë deri në dy vjet pas përfundimit të këtij funksioni publik. Përcaktimi i papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, i cili parasheh që zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i

personave juridikë, privatë, pra fitimprurës. Në kuadër të projektligjit janë trajtuar dhe paraparë obligimet e zyrtarëve dhe eprorëve të tyre në situatat e konfliktit të interesit. Me marrjen e detyrës dhe gjatë ushtrimit të saj, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrë më efektive të mundshme çdo situatë të konfliktit të tij të interesit. Çdo udhëheqës dhe institucion udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Të nderuar deputetë,

Nëpërmjet këtij projektligji është bërë përpjekje t'i kushtohet vëmendje e veçantë aspektit preventiv, përkatësisht parandalimit të konfliktit të interesit. Vlen të theksohet se ky projektligj është hartuar dhe finalizuar në bashkëpunim me përfaqësuesit e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si ekspertë të Këshillit të Evropës, Zyrës së BE-së në Kosovë, dhe konsiderojmë se ligji do të ndikojë në avancimin e mëtutjeshëm të luftimit të dukurive të tilla në vendin tonë. Andaj, bazuar në rëndësinë që e ka miratimi i këtij projektligji, si në drejtim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga agjenda evropiane e reformave, si dhe avancimin e mëtejshëm të legjislacionit të kësaj fushe, ju ftoj për miratim të Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionin publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, zonjën Albulena Haxhiu, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më 12. 12. 2017 e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe i rekomandon seancës që të njëjtin ta përkrahë në parim.

Po ashtu, më lejoni të flas edhe në emër të grupit parlamentar. Së pari, më duhet të theksoj faktin që kur flasim për parandalimin e konfliktit të interesit, nuk mund t'i anashkaloj dy raste: e para, është rasti i rritjes së pagave nga Qeveria aktuale për vete, pra afro 100%. Ne e kemi dërguar këtë rast në Agjencinë Kundër Korrupsionin, sot e dëgjova me vëmendje ministrin e Drejtësisë teksa flet për parandalimin e konfliktit të interesit, por zoti ministër, me sa e di unë, ju po ashtu keni ngritur dorën për t'ia rritur pagën vetit, apo jo. Sepse, me sa e kam parë edhe ti ke qenë i pranishëm në mbledhjen e Qeverisë dhe si ministër i Drejtësisë nuk keni bërë thirrje, madje lëre që s'keni bërë thirrje, por edhe vetë keni votuar dhe unë besoj që nuk ka nevojë për hipokrizi, apo jo. Unë pres shumë shpejt që Agjencia Kundër Korrupsionit ta trajtojë dhe ta finalizojë këtë rast dhe unë jam e bindur që ai vendim do të shfuqizohet, sepse është nxjerrë në bazën e konfliktit të interesit, madje secili prej juve që e keni ngritur dorën lart keni bërë vepër penale. Këtë e penalizon edhe Kodi Penal.

Tjetra, është rasti i zonjës Arta Rama Hajrizi, kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Nuk raporton rastin ose nuk e bën të ditur që njëri prej kandidatëve që ka kandiduar për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, është kushëriri i saj dhe ajo e përgatit testin edhe për kushëririn e saj dhe pastaj detyrohet komisioni, që përbëhet nga kryetari i Kuvendit dhe përfaqësuesit e subjekteve politike, por edhe Gjykatës Kushtetuese, në këtë rast, që ta ndalojë procesin për shkak se zonja Rama e ka kryer veprën penale të konfliktit të interesit. Pra, çfarë shembulli po japim te qytetarët e Republikës së Kosovës, për sa kohë edhe Qeveria, edhe bartësit e lartë e shkelin Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe bëjnë veprë penale të konfliktit të interesit.

Dhe, sa i përket projektligjit, “Vetëvendosje” në këtë fazë nuk mund ta përkrahë të njëjtin, pra do të abstenojmë. Është e vërtetë që janë adresuar disa çështje që kanë qenë problem, por megjithatë, nuk janë adresuar të gjitha çështjet me të cilat ne përballemi sot.

E para, ka të bëjë me atë që ka shumë zyrtarë në Republikën e Kosovës që janë zyrtarë të lartë, të cilët kanë 2, 3, 4, 5, 6 vende të punës sot në Republikën e Kosovës, ka zyrtarë të lartë që i kanë gjashtë vende pune. Kjo çështje ende nuk është adresuar me projektligjin aktual. Pra, sërish mund të kemi zyrtarë “supermenë” që i mbajnë diku gjashtë vende pune, nëpër secilin institucion, secilin bord, s’po flasim vetëm për deputetët të Kuvendit të Republikës së Kosovës, po flasim edhe për zyrtarët e Qeverisë që në vend që të ishin ndoshta në seancat parlamentare, janë nëpër fakultete duke ligjëruar ose nëpër vende të tjera të punës dhe unë mendoj që është koha e fundit ku ne duhet ta adresojmë këtë problem, sidomos duke marrë parasysh shkallën e papunësisë që është në Republikën e Kosovës.

Tjetra, ka të bëjë me mungesën e kategorizimit të konfliktit të interesit. Unë e di që kjo është kërkuar edhe nga shoqëria civile. Ende nuk është bërë një kategorizim i konfliktit të interesit sipas niveleve apo pozitive të ndryshme të zyrtarëve publikë. Pra, këtë e kanë kërkuar edhe organizata “Qohu”. Po ashtu, ky draftligj nuk siguron mbrojtje për personin, i cili e raporton konfliktin e interesit. Zoti Konjufca, shef i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, e përmendi më herët një rast, kur është larguar nga puna një auditor, i cili e ka raportuar korrupsionin. Ne e kemi në fuqi Ligjin për mbrojtjen e informatorit, por ai ligj është në plotësisht i pazbatueshëm, madje zyrtarët që punojnë nëpër institucionet publike as nuk janë në dijeni që mund të mbrohen, sepse ai ligj nuk është vënë në zbatim asnjëherë.

Pra, edhe ky projektligj duhet të mbrojë personin që ofron informata për rastet e konfliktit të interesit. Po ashtu, afatet ligjore duhet të përcaktohen strikt dhe saktë, të gjitha afatet ligjore për zyrtarët e lartë, që duhet ta paraqesin konfliktin e interesit për Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda të cilit afat është i detyruar të marrë vendim në raport me konfliktin e interesit. Njëra prej arsyeve pse ne nuk e përkrahim këtë projektligj është edhe neni 22, pika 2. ku thotë që iniciimi i

procedurës për konflikt të interesit në Agjenci nuk mund të fillojë në qoftë se kanë kaluar dy vjet nga data e kryerjes së veprimit, përveç kur parashihen ndryshe me ligj.

Domethënë, kjo është një amnisti për shkelësit e ligjit, sepse ne jemi në dijeni që ka pasur raste të shumta kur Agjencia Kundër Korrupsionit ka neglizhuar, nuk i ka përfillur rastet e konfliktit të interesit. Tek pasi që e kanë përfunduar pozitën e tyre Agjencia Kundër Korrupsionit ka nisur është marrë me hetimin e atij rasti. Pra, unë mendoj që nuk duhet të ketë parashkrim dhe ky nen duhet të hiqet.

Edhe një herë, “Vetëvendosje” do të abstenojë në këtë fazë, do të përpiqemi maksimalisht që në grupet punuese t’i marrim parasysh edhe disa vërejtje të Agjencisë Kundër Korrupsionit që nuk ishin përfshirë në këtë draft. Po ashtu, edhe vërejtjet e organizatave, të cilat tashmë i kanë deponuar në Komisionin për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Korab Sejdiu. Urdhëro!

KORAB SEJDIU: Të nderuar qytetarë,

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar dhe është në mbështetje të këtij ligji. Natyrisht, vërejtjet tona eventuale do t’i paraqesim në mes të dy leximeve dhe vlen të potencohet se ky tash është ligji, si të themi, i katërti që nga shpallja e Pavarësisë dhe problemi nuk ekziston te ndërrimi i ligjit, po si duket te ndërrimi i njerëzve. Po shihet qartë se ka mungesë të zbatimit të dispozitave ligjore sa i përket konfliktit të interesit dhe çështja ndërlihet jodomosdoshmërisht te mangësitë në ligj, të cilat shumë lehtë mund t’i përmirësojmë, por ndërlihet me problematikën e zbatimit të këtyre dispozitave, qoftë nga administrata shtetërore, qoftë nga gjyqësori me ndëshkimet e tyre të lehta për konfliktet e interesit dhe, thënë të drejtën ndërlihet edhe me mentalitetin tonë, ku duhet një herë e përgjithmonë të kuptojmë që të respektojmë dispozitat ligjore që janë imperativ për të gjithë ne, përfshirë këtu edhe konfliktin e interesit.

Kështu që në parim e mbështesim dhe propozimet tona për amendamentet do t’i paraqesim në procedura të rregullta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Nezir Çoçaj e ka fjalën. Urdhëro!

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij

projektligji, ne po ashtu ftojmë edhe deputetët që janë në këtë sallë ta përkrahin këtë ligj, ndërsa gjatë leximit të dytë do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Lista serbe, s'është paraqitur askush. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Shkumbin Demalijaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah projektligjin. Ndërkaq, lidhur me çështjet që përdoren në historikun apo në vazhden e fjalimeve politike, dua të them një gjë se lidhur me rritjen e pagave në Qeveri, nga praktika gjithmonë e dimë mirë se kanë ndodhur vazhdimisht kjo çështje që Qeveria i ka rritur pagat vetë. Ndoshta, mund të flitet për një pagë të madhe në rritje, mirëpo e kam thënë edhe në komision gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në lexim të parë se portieri nuk i nënshkruan vendimet e Qeverisë, apo dikush tjetër, gjegjësisht kanë të drejtë të thirren politikisht, por kjo praktikë ka ndodhur edhe më herët që kryeministrat e kanë bërë të njëjtën gjë, i kanë nënshkruar këto vendime.

Në tjetrën anë, është se është e vetmja Qeveri që në fillim të mandatit i ka rritur pagat për gjithë sektorin publik. Të gjithë e kanë bërë për çështje të votave, në fund të mandatit për të fituar ndonjë votë, është e vetmja Qeveri, i vetmi kryeministër që në fillim të mandatit, do të thotë me buxhetin e parë që e ka votuar Kuvendi ka bërë rritje të pagave në gjithë sektorin publik, në administratën publike që do të vazhdojë edhe gjatë viteve të ardhshme.

Ndërkaq, për pjesën tjetër të projektligjit, ligji është për t'i rregulluar këto çështje. Kemi një komision të mirë të buxhetit edhe mbikëqyrjes së financave publike, besoj se duhet të ofrohen plotësim-ndryshime edhe në Ligjin mbi pagat që kjo çështje të rregullohet njëherë e përgjithmonë dhe të dihet përgjegjësi e kujt është çështja e rritjes së pagave, për shkak se po kapemi vetëm në këtë segment. Edhe në gjatë amendamentimit të projektligjit do të japim kontributin tonë si Grup Parlamentar i Aleancës.

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma për Kosovën”, deputeti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Edhe “Nisma për Kosovën”, ashtu sikur të gjitha grupet parlamentare, në fakt sikur shumica e grupeve parlamentare, i jep mbështetje këtij projektligji në lexim të parë dhe besojmë që në procesin nga leximi i parë deri në leximin e dytë deputetët jo vetëm të “Nismës”, por të gjithë do të japim kontributin e tyre që këtë ligj ta bëjnë më të mirë, nëse e mendojnë se i mungon ndonjë gjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, nuk është paraqitur askush. Ndërkohë është paraqitur deputeti Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”. Urdhëro, Danush!

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Grupi “6+” e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe ndërkohë do ta japë edhe kontributin gjatë leximit të dytë.

KRYESUESI: Faleminderit! Për diskutim deri më tani janë paraqitur dy deputetë. Së pari, sipas radhës, i jap fjalën deputetit Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë jam përpjekur të shoh tekstin e projektligjit, përveç vërejtjeve që u dhanë, nuk dua t’i përsëris. Është një çështje domethënëse që ky ligj përveç qëllimit që ka, ka edhe një funksion, funksioni i ligjit është të përcaktojë parimet, rregullat dhe proceduar lidhur me sjelljet e lejuara dhe të ndaluara të zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Mirëpo, nganjëherë me dashje ose pa dashje, gjuha, përveç që e kemi prej tultit, kjo që po e shkruajmë është shumë e rrezikshme. Merreni me mend, qysh do të vepronte agjencia apo edhe vetë gjykata nëse detyrohet të interpretojë një nen të tillë ose një normë të tillë, siç është neni 5, paragrafi 6, po të dëgjohet gjuhësisht me kujdes. Thotë: “Zyrtarit nuk i lejohet të kryejë ose të mos kryejë një veprim të kundërligjshëm”. Ai gjykatës do të thotë shumë në rregull është, krejt çka ke bërë, që s’i ke ndaluar veprimet e kundërligjshme, është në rregull, grahi tutje. Prandaj, edhe ai auditori, edhe agjencia, edhe gjithkush tjetër thotë, në rregull është, ligji po thotë ashtu, unë e respektoj normën ligjore, e ndërtojmë shtetin dhe fund. Kjo është një çështje, mandej kemi edhe finesa të tjera që janë shumë interesante dhe kalojnë ashtu në ligj pa u vërejtur. Unë po e vërej vetëm një, vetëm sa për të parë ku jemi. I njëjti ligj, paragrafi 7, thotë: “Zyrtari për punën që kryen në ushtrimin e funksionit nuk ka të drejtë të pranojë apo të kërkojë shpërblim tjetër, si dhe ofrimin e premtimit të shpërblimit”. Ngadalë, cili guxon ashtu hapur, shprehimisht të thotë ose më jep kaq para ose ama këtë shpërblim, po e bëj këtë. Jo, megjithatë, ky ligj nuk i parasheh mundësitë, në të vërtetë të sanohen mundësitë e krijimit të rrethanave përmes zvarritjeve që të detyrohet qytetari, konsumatori që të paguajë mito.

Shko në një ministri të caktuar sot, këto ditë në Republikën e Kosovës, për marrjen e një vërtetimi. Duhet pritur një javë një vërtetim që i ka vetëm dy fjali dhe që lejon ose ndalon kryerjen e një veprimi. Cilat janë arsyetimet, unë po e them hapur: arsytimi, për shembull, thotë: “këqyre, tash kemi dalë, është ora 11 e gjysmë, fillon pauza”. Merreni me mend, ky është një arsytim i një zyrtari në Republikën e Kosovës, ditën tjetër kur shkon thotë: “Jo nuk është shefi këtu, e ka mbyllur zyrën, vulën s’e kemi, s’mund ta nënshkruajmë dokumentin”. Këto janë të gjitha ato finesat, shumë subtile, të shumë zyrtarëve të korruptuar që nuk guxojnë, natyrisht nuk guxojnë të kërkojnë drejtpërdrejt mito ose ndonjë shpërblim, sepse sot e kemi këtë teknologjinë e zhvilluar e po frikësohen mos po i fotografojnë e po i incizojnë me telefona.

Mirëpo, i krijon rrethanat e tilla që dikush është i detyruar, qytetari është i detyruar të paguajë mito ose korrupsion për të kryer një punë. Unë s'po dua t'i përsëris këto fuqi mbinatyrore të "supermenëve" që punojnë nëpër institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe i mbajnë nga gjashtë vende të punës, brenda 24 orëve dhe në fund të vitit, kur e shkruajnë raportin, raportet janë shembullore sikur të ishim në Japoni, Suedi apo Zvicër, e jo në Kosovë, dhe në fund konstatohet që asnjë punë nuk është kryer. Unë mendoj se ky ligj synon edhe ka qëllim rregullimin për parandalimin e konfliktit të interesit, por gjuha e përdorur në disa pjesë të këtij ligji është skandaloze dhe, në të vërtetë, është e kundërta e asaj që e synon ligji. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Sa i përket këtij ligji, konsideroj se dy çështje janë të rëndësishme, së pari e rëndësishme është që të bëhen përmirësimet, të cilat u përmendën nga parafolësit dhe përmirësime edhe të disa çështjeve të tjera, të cilat nuk u përmendën sot këtu dhe, së dyti, është shumë me rëndësi që ky ligj të mos e pësojë fatin e njëjtë siç e ka pësuar gjer më tani, sepse është njëri nga ligjet, i cili më së shumti është sjellë nëpër sirtarët herë të Qeverisë, herë të Kuvendit, ka ardhur në Kuvend, është kthyer, arsyeja dihet, por dihen edhe pasojat.

Nga vonesa e këtij ligji ka pësuar ky vend në shumë aspekte, kurse arsyeja është sepse me vonesën e këtij ligji kanë përfutuar zyrtarë të lartë të këtij shteti, prandaj, përveç kërkesës që të korrigjohen nenet dhe ligji në pika të cilat u përmendën nga parafolësit, është shumë me rëndësi që ky ligj sa më shpejt të procedohet, të kryhen përmirësimet e nevojshme, të vijë në Kuvend dhe të aprovohet. Përndryshe, sado që zgjat ky ligj, iu zgjatet jeta keqpërdorimeve nga njerëzit, të cilët do të duhej të parët të dalin dhe t'i kundërshtojnë këto keqpërdorime, siç po ndodhin edhe me punësimin e shumëfishtë, edhe me çështjet e tjera, të cilat u përmendën më lart. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën, atëherë të nderuar kolegë në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Në sallë janë 63 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! A ka deputetë pa kartelë? Një! Atëherë, në votim kanë marrë pjesë 60 deputetë me elektronikë dhe një me dorë, 61, nga të cilët 45 janë për. Asnjë votë kundër dhe 16 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Edhe në këtë rast ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet

e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Skënder Reçica, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Në emër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe në emër të ministres Reshitaj, më lejoni që ta paraqes Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në kuadër të përgjegjësive të veta, në vazhdimësi është duke e trajtuar problematikën e ndërtimeve pa leje. Pas miratimit dhe zbatimit të ligjit të kaluar për ndërtime pa leje nr. 04/L-188, i cili ka qenë në fuqi nga shkurti 2014 deri më 5 shkurt 2017, rezultateve të arritura nga ky proces, por edhe identifikimi i disa sfidave dhe çështjeve që duhet adresuar, Ministria e Mjedisit e ka nisur procesin e hartimit të projektligjit të ri.

Gjatë zbatimit të ligjit të kaluar për ndërtime pa leje, ministria dhe komunat kanë evidentuar 352 386 ndërtime, të cilat janë përfshirë në regjistrin kombëtar të ndërtimeve pa leje. Prej këtij numri janë dorëzuar 8 461 aplikime për legalizim. Një numër kaq i madh i ndërtimeve pa leje ka qenë vështirë i imagjinueshëm gjatë hartimit të ligjit të parë, që rrjedhimisht paraqet një rën nga sfidat kryesore në këtë proces, duke imponuar rishqyrtimin e kërkesave procedurale dhe ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional. Përveç kësaj, ky ligj ka prekur edhe çështje tjera që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore të planifikimit hapësinor, menaxhimit të tokës dhe ndërtimit, shumë prej të cilave janë çështje të vjetra, por që shpërfaqen edhe në këtë proces.

Duke i parë këto sfida, që janë shprehur edhe prej komunave, edhe qytetarëve tanë, është bërë e qartë që korniza ligjore për trajtimin e ndërtimeve pa leje ka nevojë për ndryshim dhe është i nevojshëm hartimi i ligjit të ri. Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje është finalizuar nga grupi punues dhe i njëjti është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 10 nëntor 2017. Sfidat e identifikuara në procesin e deritanishëm të trajtimit të ndërtimeve pa leje adresohen nga ky projektligj nëpërmjet:

- trajtimit të të gjitha ndërtimeve pa leje deri në hyrjen në fuqi të ligjit; - procedurave të thjeshtuara për legalizim dhe regjistrim në kadastër, për t'u ndihmuar qytetarëve që t'i gëzojnë të drejtat e tyre pronësore dhe të realizojnë përfitime nga pronave të tyre;
- taksave më të lira, 1 euro për m² për kategorinë e parë të ndërtimeve dhe 2 euro për m² për ndërtimet e kategorisë së dytë;
- caktimit të përgjegjësive dhe obligimeve për institucionet përkatëse; - përfshirjes së të gjithë faktorëve në zbatimin efikas të ligjit;
- ofrimit të shërbimeve nga komunat nëpërmjet një zyre të vetme shërbyese për legalizimin e ndërtimeve pa leje;
- inkorporimit të ndërtimeve të legalizuara në dokumentet e planifikimit hapësinor;
- programeve të veçanta për trajtimin e ndërtimeve pa leje në prona publike, prona shoqërore, toka bujqësore nën ujë dhe komasacion, korridore të infrastrukturës, zona të mbrojtura e tjera;
- afatit të mjaftueshëm për aplikim 2 vjet, me mundësi vazhdimi edhe për dy vjet tjera.

Duke pasur parasysh se numri i ndërtimeve pa leje dhe shtrirja e tyre në tërë territorin e Republikës së Kosovës paraqet sfidë që kërkon qasje të re nëpërmjet kornizës ligjore, ju ftoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe ta miratoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tani e ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Daut Haradinaj, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin në emër të këtij komisioni. Urdhëroni!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Ne e kemi shqyrtuar në parim në komision këtë projektligj dhe t'jua them të drejtën, jo pse projektligjet tjera nuk janë të rëndësishëm, por edhe jemi dakorduar edhe si anëtarë të komisioneve, edhe si përfaqësues të partive politike, që ky ligj konsiderohet njëri prej ligjeve më të rëndësishme edhe që i atakon drejtpërdrejt qytetarët e Kosovës. Ka edhe implikime buxhetore, por megjithatë rekomandimi është që Qeveria do t'i sigurojë mjetet dhe do ta mbështesë, por më lejoni që të shpjegoj pse është kaq i rëndësishëm ky projektligj.

Ju them se e para është Prishtina që prin me mbi 50%, po flas në nivel komunal, e cila është me ndërtime pa leje. Fill pas tyre shkojnë institucionet e Kosovës në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe autostradat, që tash kanë filluar të aplikojë, aeroportet, e të mos flasim, bën vaki edhe ndërtesat e institucioneve kryesore, nuk e di sa janë të pajisura me dokumentet formale, ose me lejet përkatëse.

Po e marr edhe një shembull, në një komunë të caktuar, ndërtimet pa leje, ose të themi ndërtimet që janë bërë në të kaluarën shkojnë mbi 99%, dhe kjo natyrisht që e kërkon një ndërhyrje shumë të shpejtë. Ne jemi dakorduar që këtë ligj në afatin optimal do ta kapërcejmë edhe në komision. Të gjithë si anëtarë të komisionit kemi qenë shumë konstruktivë, bashkëpunues, dhe mendoj se

ky projektligj i lehtëson të gjithë qytetarët, sidomos ata që kanë blerë banesa, për shembull, e nuk u njihet e drejta e hipotekës për kredimarrje ose huamarrje bankare.

Pra, ftoj kolegët e mi deputetë që t'i japin mbështetje këtij projektligji dhe sa më shpejt edhe komisionit t'i kryejë procedurat e veta në të ardhmen, ta kryejnë diskutimin publik, por në të njëjtën kohë kisha kërkuar dhe kisha apeluar edhe te mediet që t'i japin shumë hapësirë këtij ligji për shkak se po flasim për rreth një milion e gjysmë banorë që atakohen drejtpërdrejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Sa i përket projektligjit që e kemi për ndërtimet pa leje, për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta mbështesë, edhe pse vetë trajtimi i ndërtimeve pa leje apo legalizimi, thënë me një fjalë, në fakt është një ligj i padrejtë, por edhe pse është i padrejtë është jashtëzakonisht i domosdoshëm.

Dua të them që në Kosovë, në procesin e ligjit të kaluar të legalizimit janë identifikuar rreth 350 000 ndërtime pa leje. Vetëm në komunën e Prishtinës janë 46 000 ndërtime të identifikuara pa leje. Dhe, tash, duhet ta kemi të qartë që me këtë ligj të gjitha këto ndërtime legalizohen, ka mundësi të legalizohen dhe kjo do të jetë një lloj padrejtësie në raport me ata ndërtues, të cilët janë përpjekur t'i respektojnë procedurat dhe ligjet, janë mundur të ndërtojnë me leje dhe të cilët kanë hequr duke i ndjekur këto procedura, duke paguar taksa, duke ndjekur procedura të shumta për pranime teknike, e kështu me radhë, dhe tash përnjëherë pranë tyre ndërtesat që janë ndërtuar pa leje do të kenë mundësi të legalizohen me taksa shumë të ulëta, me procedura shumë të shpejta, t'i marrin përnjëherë të gjitha dokumentet dhe, në fakt, kjo përbën një lloj padrejtësie ndaj tyre.

Po, vërtet është kështoj, por duke e pasur faktin që i kemi 350 000 ndërtime dhe është e pamundur që ato ndërtime tash ose të rrënohen, ose të dënohen këta ndërtues, duke pasur parasysh që vetë shteti dhe institucionet i kanë lënë të ndërtojnë, tash është e domosdoshme që këto ndërtime t'i trajtojmë, t'i legalizojmë, të dimë se çka do të legalizojmë, të dimë se çka nuk do të mund të legalizohet, duke pasur parasysh kriteret që janë paraparë me këtë projektligj.

Dua të them që, meqenëse ligji i kaluar në një aspekt ishte i suksesshëm, për shkak se regjistroi shumë ndërtime pa leje në tërë Kosovën, por, në anën tjetër, nuk doli i suksesshëm për shkak se patëm një numër tepër të vogël të aplikimeve për legalizim, duhet dhe janë marrë besoj mjaftueshëm masa edhe nga ministria në bashkëpunim me komunat, ku edhe Komuna e Prishtinës, edhe komunat tjera kanë dhënë mjaft kontribut në hartim të këtij projektligji.

Sidoqoftë, tani projektligjin e kemi përpara, do të kemi mundësi që në punën në komision të merremi me të dhe të bëjmë edhe disa ndryshime të nevojshme dhe do të mund të kemi mbase edhe dëgjime publike, prandaj unë qysh tash do të mund vetëm të ju them se në këtë projektligj varet jashtëzakonisht shumë nëse do të ketë apo jo sukses mënyrën sesi institucionet e Kosovës, edhe komunat, edhe Qeveria, edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, do të sillen në raport me ndërtimet pa leje.

Nëse në Kosovë nuk ndalen ndërtimet pa leje, unë mund të ju them me sigurinë më të madhe që ky ligj do të dështojë. Nëse ndërtuesit pa leje vazhdojnë dhe ndërtojnë pa leje, atëherë inkurajohen të gjithë ndërtuesit, të gjithë ata që tanimë i kanë bërë ndërtimet pa leje që të mos aplikojnë fare për legalizim, sepse do ta kenë shpresën që do të na vijë një ligj tjetër për legalizim më vonë. Dhe, pa pasur një këmbëngulje nga Ministria e Planifikimit dhe nga Inspektorati i Ministrisë, duke shkuar dhe duke bërë inspektime nëpër të gjitha komunat, duke stimuluar inspektoratet komunale që të ndalen ndërtimet pa leje, ta kemi të qartë që ky ligj nuk do të ketë sukses.

Tjetra? Ministria duhet ta ketë të qartë që çfarëdolloj zbrazëtie ligjore, e në këtë rast zbrazëti mjaft e padefinuar është çështja e datës dhe mënyrës së definimit të një ndërtimi pa leje, a do të trajtohet apo jo. Në projektligjin e kaluar e kemi pasur një orto-foto. Orto-foto në datën kur është punuar nuk ka korresponduar fare me datën në të cilën është caktuar dita prej të cilës më nuk mund të trajtohen ndërtimet pa leje.

Unë mendoj që ministria tash duhet të ndajë buxhet dhe të bëjë orto-foto të re, dhe data prej kur mund të trajtohen ndërtimet pa leje të jetë data e bërjes së asaj orto-fotos, në mënyrë që të mos ketë dilema fare për ndërtimet, se a janë ndërtuar pas kësaj ose asaj date, sepse në këtë projektligj thuhet që prej ditës kur hyn në fuqi, të gjitha ndërtimet që deri në atë ditë do të mund të legalizohen, ato që ndërtohen pastaj nuk do të mund. Dhe, kësisoj, për ndërtimet që janë bërë pastaj palët do të duhet të sjellin dokumente që të verifikojnë dhe të vërtetojnë që ndërtesa e tyre pa leje është bërë para datës së futjes në fuqi të këtij ligji.

Kjo lë hapësirë të madhe për manipulim, prandaj duhet bërë një orto-foto tjetër dhe dita prej kur bëhet legalizimi duhet të jetë dita e asaj orto-fotos. Duhet të bëhet një propagandë, një fushatë e sensibilizimit të qytetarëve, të bëhet e qartë që taksat janë mjaft të ulëta dhe komuna do të ketë mundësi për raste sociale që t'i ndihmojë ata dhe, sidomos, sa u përket ndërtesave kolektive që janë ndërtuar pa leje duhet bërë thirrje të gjithë investitorëve dhe banorëve në ato ndërtesa pa leje që mundësia që këto nëpërmjet legalizimit atyre ua shpëton një numër të madh të hapave, ta zëmë siç është edhe pranimi teknik. Ka tepër shumë ndërtesa në komunën e Prishtinës dhe në gjithë Kosovën, të cilat janë ndërtuar me leje, por kanë bërë tejkalime dhe për shkak të tyre ata nuk mund ta bëjnë pranimin teknik, nuk mund të marrin leje përdorimi. Në këtë rast, të gjithë ata e kanë mundësinë që nëpërmjet legalizimit, duke e paguar shtesë taksën vetëm për pjesën e

tejkalimit që ata e kanë bërë, përnjëherë t'i kryejnë të gjithë hapat proceduralë të pranimit teknik dhe ta marrin lejen e përdorimit.

Kësisoj, të gjithë, shume e shumë familje në komunën e Prishtinës, të cilët kanë blerë banesa dhe nuk mund t'i marrin të dhënat pronësore në kadastrë të atyre banesave, sepse nuk janë bërë pranimet teknike, duhet të bëjnë presion mbi investitorët prej të cilëve i kanë blerë banesat, ose nëse ata nuk janë, sikur që kemi raste kur edhe kanë vdekur, apo nuk janë këtu, të organizohen banorët e atyre banesave, në mënyrë që të bëjnë aplikimin për legalizim dhe me pak shpenzime ta realizojnë pranimin teknik.

Ajo çfarë duhet po ashtu të përmendet, të shtohet në këtë ligj, është se nuk janë definuar qartë, duhet të bëhet definim më i qartë ndërmjet kategorive të ndërtimeve. Dhe, po ashtu duhet të trajtohen çështjet e ndërrimit të destinimeve. Ka raste kur për një ndërtesë është ndërruar destinimi, dhe ky është në fakt ndërtim pa leje. Duhet të hetohen uzurpimet e hapësirave të përbashkëta brenda ndërtesave dhe si duhet bërë ai legalizim, pra në rastin e bodrumeve të shumta të ndërtesave të cilat janë bashkëpronësi dhe janë uzurpuar nga dikush dhe ata tash kërkojnë legalizim. Kjo lidhet drejtpërdrejt me Ligjin për ndërtesat në bashkëpronësi, pastaj çështja e mbindërtimeve, që prapë është ndërtim në bashkëpronësinë e banorëve të të njëjtës ndërtesë.

Duhet të definohet çështja e bashkëpronësisë në tokë, në rastet kur është ndërtuar ndërtesa pa leje, por toka është në pronësi të një pronari tjetër. Duhet pra të bëhet harmonizimi ndërmjet Ligjit të legalizimit me Ligjin për ndërtesat në bashkëpronësi, me Ligjin për kadastrën dhe me Ligjin e pronësisë dhe të drejtave tjera sendore. Po ashtu, çka është tepër me rëndësi, ky ligj mund të rrezikojë të dështojë prapë në rast se Qeveria nuk e merr parasysh çështjen e stafit, i cili duhet të angazhohet për realizimin e këtij ligji. Meqenëse me këtë ligj taksat për legalizim do të jenë tepër të vogla, komunat nuk do të kenë mundësi të paguajnë staf shtesë në bazë të financave që mund t'i marrin nga ky ligj, nga rastet që do t'i trajtojnë dhe duke pasur parasysh që në ligjin e kaluar, gjithë ai staf shtesë që ka punuar në legalizim kanë qenë me kontrata mbi vepër dhe Ligji për kontratat mbi vepër nuk lejon që të ketë më shumë se gjashtë muaj, e ky ligj ka afat, së paku ai tjetri ka pasur afat prej tre vjetësh, dhe ky do të ketë afat mbase edhe më të gjatë, sepse do të ketë edhe lista të pritjes, këtu Qeveria duhet ta definojë mënyrën se si do të angazhohet stafi dhe si do të paguhet ai staf, që të ketë sukses ky ligj.

Po ashtu, duhet ta kemi të qartë se për rastet sociale është komuna ajo që duhet t'i bëjë matjet, t'i bëjë projektet bazë, në mënyrë që këto raste të legalizohen pa pasur nevojë as për pagesë, as për projekt, që është jashtëzakonisht e drejtë, mirëpo duhet të mendohet për këta.

Pra, Qeveria bashkë me Ministrinë e Financave duhet t'u ndajnë buxhet komunave, në mënyrë që ky ligj të jetë i suksesshëm, përndryshe do të kemi dështim dhe do të kemi ligj të radhës prapë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji që po e shqyrtojmë për trajtimin e ndërtimeve pa leje, të gjithë besoj se pajtohemi se është një ligj i rëndësishëm së veçantë dhe pa dashur të hyj në historikun, sepse është e vërtetë që titulli i tij kur thotë: "... për trajtimin e ndërtimeve pa leje" thotë shumëçka. Por, unë po mundohem shkurt të them se nuk duhet të harrojmë që vendi ynë ka kaluar nëpër një aparteid shumëvjeçar dhe ka kaluar nëpër një luftë të tmerrshme dhe një tranzicion, e që natyrisht si në çdo vend të botës krijohet kjo problematikë, që është edhe te ne.

Por, është e vërtetë që ne ndoshta nuk kemi qenë në nivel të detyrës sa duhet, që vërtet kësaj çështjeje t'i bëjmë zgjidhje më shpejt, sepse qytetarët e vendit janë të bllokuar për shkak të këtij ligji, që nuk i ka përmbushur kërkesat e tyre.

Ne si komision, njëkohësisht edhe si Lidhje Demokratike e Kosovës e kemi shqyrtuar me vëmendje këtë ligj. Për të mos i përsëritur të gjitha ato që i tha kolegu im, parafolësi Liburn Aliu, i cili i shpjegoi shumë mirë në aspektin profesional, unë po shtoj që kemi edhe disa vërejtje në aspekte të përgjithshme të vetë hartimit të ligjit, e që ne të gjithë e dimë se sipas Udhëzimit Administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, pra udhëzuesi i cili parasheh që neni nuk mund të ketë më shumë se 3 apo 4 paragrafë, kur duhen më shumë paragrafë, e hartuesi i aktit normativ duhet të marrë në konsideratë ndarjen e tekstit në disa nene. Pra, e theksova këtë sepse ky ligj e ka këtë problematikë në strukturën e tij dhe ne si komision duhet të punojmë në këtë drejtim.

Kërkoj që natyrisht ne duhet të kemi shmangie nga përdorimi i fjalëve të huaja në këtë ligj dhe besoj se do të punojmë. Po e marr shembull fjalën "hostmin", e cila unë nuk e di çka është dhe neve duhet të na jepet sqarim nga ministria që e ka hartuar ligjin. E kemi një vërejtje që për shembull aty duhet të parashihet afati për njoftimin paraprak, paragrafi 7 i këtij neni, ndër të tjera, parasheh njoftimin paraprak për kryerjen e rrëtimeve, mirëpo nuk është paraparë një afat i saktë kohor. Rekomandojmë pra që njoftimi paraprak të parashihet në afat kohor.

Përkufizohet certifikata e përdorimit, paragrafi 3 i këtij neni ndër të tjera përmend certifikatën e përdorimit, të cilën e konsideron të barasvlershme me certifikatën e legalizimit, mirëpo një shprehje e tillë nuk është e përkufizuar për qëllim të këtij ligji. Pra, referuar situatës në fjalë, rekomandojmë që kjo shprehje të përkufizohet në nenin përkatës, respektivisht nenin 3.

Kemi edhe disa vërejtje, natyrisht. Unë nuk po dua t'u marrë kohë kolegëve, por ne do të punojmë në komision dhe ne si Lidhje Demokratike e Kosovës do të kemi amendamente të caktuara dhe konsideroj që ligji shpejt do të jetë në përdorim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, duke e ditur rëndësinë dhe nevojën e madhe të këtij projektligji, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Ne do të përqijemi si grup parlamentar që nëpërmjet anëtarëve tanë në Komisionin Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ta japim kontributin, vërejtjet dhe sugjerimet tona si grup parlamentar.

Andaj, për të mos ju munduar sot me shumë të dhëna rreth këtij projektligji, ne e mbështetim në parim dhe i ftojme deputetët që ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, deputeti Igor Simiq.

IGOR SIMIĆ: Poštovani predsjedavajući!

Kada je u pitanju ovaj predlog zakona, mi smo unutar Srpske liste o njemu raspravljali i smatramo da je zakon u određenim segmentima dobar i da je potreban građanima. Ipak mi ćemo svoje amandmane predložiti u skladu sa zakonom. Ono što mogu kao kratko obrazloženje da dam, to je da će se amandmani odnositi pre svega da se ovaj zakon ne može primenjivati na građevine, koje su izgrađene korišćenjem činjenice da je zemljište uzurpirano.

Time bi se zakon opredelio za poštovanje principa vladavine prava, umesto za princip legalizacije onoga što je protivpravno. To će istovremeno i potvrditi osnovne principe koji su definisani Ustavom u članu 46, stav 1, kojim se garantuje pravo na imovinu, odnosno 46, stav 3, u kome se kaže da se niko ne može arbitrarno lišiti lične imovine, kao i u vezi sa članom 54 Ustava, citiram: Svako ima pravo na sudsku zaštitu u slučaju kršenja ili uskraćivanja nekog prava, koji je garantovano Ustavom, kao i pravo na efikasne pravne mere ukoliko se utvrdi da je pravo prekršeno.

Takođe usled sličnog događaja imamo i odluku Ustavnog Suda Kosova u predmetu KI 187-13 od 16. 04. 2014. godine. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

S'po i përsëris fjalët edhe një herë, por po ndërlihem edhe me atë që unë nuk e thashë edhe në fillim që ky ligj është perfekt, por anëtarët e komisionit besoj që do ta japin kontributin, besoj që do të kemi edhe amendamente, jo vetëm prej anëtarëve të komisionit, po ma merr mendja edhe prej ekspertëve, qoftë edhe të shoqërisë civile, por po e shpjegoj edhe një gjë shumë të thjeshtë.

Ky ligj të paktën një të mirë e ka, që i ka tri kategori dhe i selekton. I ka tri kategori, dy kategoritë e para i menaxhon ose i udhëheq komuna, ndërsa kategoria e tretë që konsiderohet pak më e rrezikshmërisë së lartë është e ministrisë.

Në të njëjtën kohë, e tha edhe Liburni, që i stimulojmë ndërtuesit tjerët pa leje. Unë mendoj se ky ligj duhet t'i trajtojë të gjitha ato ndërtesa që nuk i plotësojnë kushtet për legalizim. Edhe ky ligj e parashih, Liburn, që ato ndërtesa të cilat nuk duhet legalizuar dhe nuk i ka paraparë plani urbanistik i Komunës, ato nuk mund të pajisen me dokumentin përkatës dhe si të tilla shpallen në kuptimin e rrënimit. Kur folët edhe për studimin orto-foto të vitit 2013, po ashtu ai studim e ka përcaktuar saktë se cilat ndërtime mund të legalizohen dhe cilat jo. Meqenëse po kërkohet edhe një studim shtesë orto-foto, sa për informacion edhe të opinionit publik, dihet fare mirë se ai ka kosto shumë të madhe, shkon mbi 3 milionë e gjysmë dollarë, nëse s'gaboj. Kjo ka qenë e stimuluar financiarisht prej Qeverisë amerikane, por në këto rrethana nuk e di sa kemi mundësi.

Sido që të jetë, ne do të jemi shumë aktivë edhe gjatë ushtrimit të detyrës sonë si anëtarë të komisionit dhe besoj se ky ligj do t'i lehtësojë njerëzit, të cilët na kanë shkruar me dhjetëra letra dhe kanë kërkuar të miratohet sa më shpejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "Nisma për Kosovën", fjalën e ka deputetja Albulena Balaj-Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe "Nisma për Kosovën" e mbështet në parim shqyrtimin e parë të Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Ky projektligj përfshin një fushë, e cila është në interes të shumë palëve dhe e cila do të duhej, në fakt, të rregullohej shumë më herët, por edhe tash nuk është vonë. Kontributin tonë si deputetë të "Nismës" do ta japim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar "6+", Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi "6+" e ka shqyrtuar projektin në fjalë dhe në parim do ta përkrahim.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka deputet të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën. Kuvendi duhet të deklarohet me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Lus Administratën të konstatojë sa deputetë janë në sallë.

Në sallë janë 64 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Deputetë pa kartelë, një.

Në votim kanë marrë pjesë 64 deputetë, 61 janë për, asnjë votë kundër dhe një abstenim. Konstatoj që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Unë në vazhdim ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe të arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit synon rregullimin e kuadrit ligjor për investimin e mjeteve të privatizimit në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, trajtimin e fondeve të agjencisë si dhe disa ndryshime operative lidhur me funksionimin më të mirë të agjencisë.

Konform vendimit numër 07/39 Qeverisë së Republikës së Kosovës për përmirësimin e ambientit të huamarrjes në Republikën e Kosovës, ky projektligj mundëson investimin e mjeteve të privatizimit në tregun e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në llogaritë

rrjedhëse, ku paguhet interes apo në depozitat e afatizuara në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, dispozitat përkatëse për rregullimin e Fondeve të AKP-së do të mundësojnë transferimin e një pjese të mjeteve të privatizimit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit për Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës.

Këto mjete do të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, në përputhje me dispozitat e këtij projektligji, si dhe në projektet madhore me interes për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të krijohet edhe një mekanizëm për shpronësimin e pronave të ndërmarrjeve shoqërore që janë të nevojshme për sektorin publik.

Nëpërmjet këtij mekanizmi Qeveria e Republikës së Kosovës, si autoritet shpronësues, do të paguajë vetëm 20% të mjeteve financiare dedikuar për punëtorët përfitues të ndërmarrjeve shoqërore dhe tarifën administrative për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me kusht që të mos ketë konteste të tjera.

Ky mekanizëm synon të adresojë kryesisht nevojat për hapësira dhe objekte për sektorin publik.

Propozim i rëndësishëm së veçantë në këtë projektligj është edhe rregullimi i duhur i mandatit të Bordit të drejtorëve dhe i drejtorit të Sekretarisë ekzekutive të Bordit, të cilët do të emërohen për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje si dhe vazhdimi i mandati të drejtorëve në detyrë deri në zgjedhjen e mandatimin e nomenklaturës së re të Bordit të ri të Agjencisë Kosovare të Privatizimit nga Kuvendit i Kosovës.

Në bazë të vlerësimit të Ministrisë së Financave, zbatimi i këtij projektligji nuk do të sjellë kosto shtesë financiare për buxhetin e Republikës së Kosovës. Andaj, ju rekomandoj që ta votoni në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin e Komisionit. Urdhëro, Lumir!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndryshimet dhe plotësimet kryesore të propozuara në Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit kanë për qëllim kryesor krijimin e bazës ligjore për mundësinë e lejimit të investimit

të mjeteve të privatizimit në letra me vlerë, me qëllim të rregullimit të trajtimit të fondeve të përkohshme dhe rregullimit të proceseve operative të agjencisë në fjalë.

Në bazë të ndryshimeve të propozuara, mjetet financiare në fondet e mbetura dhe fondet e përkohshme parashihet të barten në llogari të veçantë bankar në Thesarin e Kosovës dhe llogariten që janë pjesë e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës.

Po ashtu është e paraparë edhe mundësia për kthimin eventual të këtyre fondeve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, sipas kushteve të caktuara.

Qeveria, sipas këtij ligji, merr përgjegjësinë që të kthejë në AKP fondet e kërkuara në rastet kur kërkohet nga autoriteti i likuidimit për të paguar shpenzime të tjera apo kërkesat kreditore sipas nenit 40 të shtojcës së Ligjit për AKP-në.

Po ashtu, janë bërë rregullimet për koston financiare për pagesat e afruesve të shërbimeve profesionale dhe shpenzime të tjera të likuidimit.

Në të gjitha rastet kur ka fonde, ato do të paguhen nga llogaritë e likuidimit të ndërmarrjes shoqërore përkatëse.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar në parim projektligjin dhe ka vlerësuar se i njëjti plotëson kushtet formale-juridike të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë atë në lexim të parë.

I nderuar kryesues,

Do të shfrytëzoj rastin të jap edhe opinionin e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Ne e mbështesim projektligjin në fjalë. Kemi dhënë dhe komentet tona në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ato janë dy, ndër to dy më kryesoret janë që neni 4 të ndryshohet dhe të përcaktohet se mjetet përdoren ekskluzivisht për financimin e investimeve kapitale, jo për zhvillimin ekonomik, sepse zhvillimi ekonomik është term shumë më i gjerë se sa investimet kapitale.

Dhe e dyta është që neni 10, paragrafi 1, të mos lejohet siç është paraparë me ligj që Bordi i drejtorëve të rregullojë me rregullore të veçanta vendime që mund t'i marrë, por të gjitha vendimet që Bordi mund t'i marrë, të rregullohen me ligjin në fjalë.

Këto vërejtje i kemi prezantuar edhe në komision, kemi gjetur edhe mirëkuptimin e sponsorizuesit të ligjit.

Për të gjitha arsyet të thëna më parë dhe për faktin që më në fund po krijohet një kornizë ligjore që lejon shfrytëzimin e mjeteve të AKP-së në Kosovë, një çështje e diskutuar për shumë kohë.

Lidhja Demokratike e Kosovës e mbështet projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj përfaqësuesin e Lëvizjes “Vetëvendosje” që të japë qëndrimin e Grupit Parlamentar, nuk është paraqitur askush, me sa shoh. Deputeti Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: I nderuar nënkryetar,

Duke marrë parasysh historikun e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe madje të aseteve të rëndësishme të Republikës së Kosovës në fushën e këtyre aseteve, siç është përfshirja në privatizim dhe historiku i saj, si një trend negativ, mossjellja e zhvillimeve të mëtejshme të ekonomisë, ndërrimi i destinimeve të shumë aseteve, të cilat janë privatizuar, pra marrë parasysh ndryshimin e destinimeve, marrë parasysh kontratat, të cilat shpesh nuk janë respektuar dhe, në këtë mes, të këtij trendi negativ të privatizimit, edhe pse është mirë kur hyn në procesin ligjor privatizimi, sepse AKM-ja më herët kishte vetëm kontrata, të cilat një privatizim faktikisht i paligjshëm nuk do të mund të ketë as procese gjyqësore për devijimin e tyre eventuale, gjë që ka ndodhur kjo.

Prandaj, duke marrë parasysh edhe këto trende edhe më tej, nuk mund të merret më tej tumirja e këtij ligji, përderisa ende ekziston nevoja për një strukturim edhe më të mirë të Ligjit për privatizim, i cili edhe më nuk është, kurse trendi ka dëshmuar te ne se është negativ dhe Lëvizja “Vetëvendosje” nuk është e gatshme ta përkrahë në tërësi, pa e parë edhe strukturën e fundit të këtij ligji në lexim të dytë.

Prandaj, edhe mund të preferohet abstenimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së e ka dhënë qëndrimin. Grupi Parlamentar i PDK-së, deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësim dhe ndryshim e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe është i mendimit se plotësim-ndryshimet e bëra në ligj i zgjedhin disa mangësi të cilat i ka ligji aktual si dhe hapin mundësinë për investimin e mjeteve të realizuara nga procesi i privatizimit në projekte kapitale që janë interes për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Me këto ndryshime krijohet mundësia ligjore që mjetet në fondin e mbetur dhe në fondin e përkohshëm të barten në llogari të veçantë në Thesarin e Kosovës dhe në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit aktual rregullon edhe disa çështje të tjera që kanë të bëjnë me çështjet administrative si dhe mënyrën e funksionimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Plotësim-ndryshimet e ligjit rregullojnë edhe çështjen e kostos financiare për pagesat e ofertuesve të shërbimeve profesionale dhe shpenzimeve të tjera të likuidimit.

Nga deklarata financiare, e cila i është bashkangjitur këtij projektligji, shohim se ky projektligji nuk ka kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, përkundrazi ndikon në rritjen e mjeteve në kuadër të buxhetit, të cilat mundësojnë edhe më shumë investime kapitale që janë në interes për neve.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe vota jonë do të jetë për këtij projektligji, kurse kontributin tonë do ta japim në Komisionin për Buxhet dhe Financa në amendamentimin e këtij ligji, në mënyrë që të bëhen edhe disa plotësime, të cilat janë të nevojshme për ta përmirësuar këtë ligj dhe të jetë më i zbatueshëm në praktikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, me sa shoh nuk është paraqitur askush, po deputeti Slavko Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

I Parlamentarna grupa Srpske Liste razmatrala je Nacrt Zakona o izmenjen Zakon o Kosovskoj agenciji za privatizaciju, i mi u načelu podržavamo ovaj Nacrt Zakona i svoj doprinos ćemo dati kroz funkcionalne i stalne Komisije u kojima smo zastupljeni, kako bi ovaj Zakon bio optimalan prilikom drugog čitanja i sve poslanike pozivam da podržavaju ovaj Zakon. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe në parim e përkrahim. Ndërsa kontributin do ta japim në komisionin përkatës.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën” fjalën e ka deputeti Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe ne si grup parlamentar kemi shqyrtuar këtë ligj, duke e parë rëndësinë e këtij ligji për shfrytëzimin e buxhetit të grumbulluar në këtë agjenci, i cili buxhet do të shfrytëzohet për investime kapitale në interes të qytetarëve.

Ne si grup do ta përkrahim këtë ligj në parim dhe kontributin tonë do ta japim në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Danush Ademi. Urdhëro Danush!

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi “6+” ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe në parim do ta përkrahim, kurse kontributin do ta japim në leximin e dytë.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani janë dy deputetë, të cilët e kanë kërkuar fjalën.

I pari është deputeti Armend Zemaj. Urdhëro, Armend e keni fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit,

Ministër,

Kolegë deputetë,

Do të ishte normale që mjetet e grumbulluara të shfrytëzoheshin ashtu siç do të duhen nga një qeveri serioze, sidomos nga ajo që ne gjithmonë thirremi në projektet kapitale dhe ato mjete të mos konsiderohen si të mbyllura dhe zhvillimi i Kosovës të ketë ngecje, por në kushtet të cilat ndodhet sot Republika e Kosovës, me këtë Qeveri dhe logjikën qeverisëse që është parë tre muajt e kaluar, unë mendoj që Kuvendi, në këtë aspekt Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet të jetë i vëmendshëm dhe të sanksionojë me norma ligjore shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

Ajo çka ka qenë shembull deri më tash janë diku përafërsisht 150 milionë që Qeveria ka qenë shumë dorëlibër, duke i falur, mbi të gjitha duke krijuar mekanizma të cilët vetëm po e rrisin pakënaqësinë e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore. Kjo ka të bëjë sidomos me atë pjesën e ambalazhuesve të huaj, diku që përflitet 60 milionë apo kjo pjesa tjetër tash 63 milionëve të “Bektel”-it dhe pjesa që shihet qartë që ka afëra korruptive, 28-milionëshi i shpronësimeve në Hade dhe Shipitullë, duke marrë parasysh që në raportin e kaluarën kanë qenë diku më pak apo më shumë se 5 milionë euro.

Këto janë tregues të qartë që keqpërdorimi i parasë publike është në trend tani, ndoshta do të quhej dorëlibër në shpërndarjen e këtyre mjeteve, nuk po e përmend pjesën e pagave dhe rritjen marramendëse të tyre në një afat shumë të shkurtër kohor, apo me një përqindje të lartë, por besoj që shpërndarja e këtyre mjeteve buxhetore duhet të jetë ashtu siç është menduar, mbi të gjitha dhe ashtu siç po përfillet që duhet të jetë gjithmonë në investimet apo në projektet kapitale.

Për mendimin tim do të votoj apo do të abstenoj nga ky projektligj, nga kjo kërkesë, sepse besimi në këtë Qeveri që këto mjete do t'i shfrytëzoj për të mirën e publikut është shumë i vogël, pa marrë parasysh edhe nevojën, por ajo çka mbizotëron është keqpërdorimi i parasë publike që ka ndodhur në këta muajt e fundit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Slavko Simiq.)

KRYESUESI: Hvala kolega! Za reč se javio poslanik Naser Rugova, izvolite.

NASER RUGOVA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër, do të jem shumë i shkurtër, vërtet ka qenë e nevojshme plotësim-ndryshimi i Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ku do të rregullohen mjaft mekanizma që do ta bëjnë më efikase këtë agjenci. Tek e fundit, kjo është agjenci e shtetit të Kosovës dhe në kushtet normale Qeveria, shteti pra do të duhej të kishte dorë më shumë edhe tek mjetet, por edhe te asetet.

Edhe unë jam ithtar dhe e mbështes propozimin e kryetarit të Komisionit Funkcional që ato rregullativa të brendshme të rregullohen dhe të precizohen me ligj, sepse ligji në një farë forme kur po u lihet akteve nënligjore dhe rregulloreve të brendshme të institucioneve, mbase po ka një diskrepancë dhe po shmanget nga qëllimi parësor i ligjit.

Arsyeja pse e mora fjalën, zoti ministër, është që të rregullohet me këtë ligj edhe shfrytëzimi i pronave dhe asetëve me interes strategjik nacional. Për Qeverinë qendrore, por edhe për qeveritë lokale, për komunat, sepse kemi raste të tilla kur komuna merr vendim, asambleja, dhe janë mjetet në bashkëpunim me qeverinë qendrore për një shkollë, për një ambulancë, për një qendër kryesore të mjekësisë familjare apo për një shtëpi kulture dhe nuk ka pronë ku ta ndërtojë, kurse ka prona të tëra, të cilat pothuajse 18 vjet janë të pashfrytëzuara.

Andaj, në interes të qytetarëve, në radhë të parë, të pushtetit lokal, por edhe të qeverisë qendrore për investime nacionale strategjike kërkoj që të rregullohet me këtë ligj që edhe asetet e caktuara, jo vetëm të aspektit monetar, t'u lihet, t'u krijohet mundësia, me marrëveshje gjithnjë, edhe qeverisë nacionale, po edhe qeverive lokale që t'i shfrytëzojnë këto prona në interes të zhvillimit ekonomik dhe në interes të qytetarit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zahvaljujem poslanice!

Pošto više nema prijavljeni za reč, da li predstavnik Vlade želi nešto da doda, gospodine ministre. U redu.

Molim režiju i poslanike da se pripreme za glasanje.

Molim poslanike da glasaju sada. Hvala!

Molim još jednom poslanike da sednu na svoja mesta i da glasaju, zato što nemamo kvorum za ovu tačku.

Molim režiju i poslanike da se pripreme za glasanje. Glasamo sada!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: E përsëritim edhe një herë votimin.

67 deputetë janë në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tani!

A ka deputetë pa kartelë, një. Atëherë në total bëhen 58 deputetë.

Atëherë ky proces i votimit nuk është i vlefshëm, meqë nuk kemi kuorum s'mund ta vazhdojmë seancën.

Kështu që unë detyrohem t'i ndërpres punimet dhe do të vazhdojmë nesër në orën 10:00, në këtë pikë.

Avdullah Hoti e ka kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryesues,

Ju e dini që me pajtimin edhe të deputetëve të tjerë ne e shtymë pikën e ditës për interpelancë me kryeministrin.

Unë kërkoj në emër të grupit parlamentar që kjo pikë të renditet e para nesër, kur ta hapim seancën.

KRYESUESI: Në rregull! Faleminderit! Atëherë vazhdojmë nesër në orën 10:00.

* * *

E enjte, 26 janar 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 25 janar 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Do ta vazhdojmë seancën. Jemi te pika e katërt e rendit të ditës:

4. Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtjen me armë nga z. Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike

E ftoj zotin Armend Zemaj në cilësinë e propozuesit të interpelancës ta marrë fjalën.

Zoti Zemaj vetëm pak, zoti Krasniqi ka propozim diçka. Urdhëro, zoti Memli Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryetar, faleminderit!

Mendoj për çështje procedurale, dje në fillim të seancës propozuesi ka kërkuar që kjo pikë të zhvendoset në fund të rendit të ditës, dhe ne kemi votuar për këtë çështje. Para se të filloj, prapë për çështje të procedurës, mendoj që është mirë ta marrim verdiktin e deputetëve për ta rikthyer këtë pikë të rendit të ditës këtu. Ne do ta mbështetim, por së paku ta respektojmë një vendim që e marrim paraprakisht dhe nëse duam ta ndërrojmë atë vendim, ta ndërrojmë me deklaram të deputetëve. Unë e mbështes nëse kërkesa e propozuesit të interpelancës është për ta filluar sot ditën prapë me këtë pikë, përkundër asaj që e kemi lënë për fund, por së paku ta votojmë si deputetë për ose kundër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në fakt, pati një konsultim para vazhdimit të seancës, kjo ishte arsyeja pse e futa në rend të ditës, por formalisht mund, me aq sa po e shoh, edhe propozuesi ishte i pajtimit, zoti Zemaj tash e merr fjalën, por në të njëjtën kohë e bëjmë edhe një deklaram formal në qoftë se dëshironi, edhe kryeministri aktual është këtu. Zoti Zemaj, për procedurë, a je për fillimin e menjëhershëm të pikës së katërt të rendit të ditës?

ARMEND ZEMAJ: Po, kryetar! Arsyeja e zhvendosjes së pikës ka qenë mungesa e Kabinetit qeveritar, kështu që pasi kryeministri është këtu ne dëshirojmë që kjo pikë të jetë ashtu siç ka qenë e vendosur, pikë e parë e rendit të ditës.

KRYETARI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së e pranoi si fakt nëse është edhe propozuesi. Në qoftë se s'ka dikush kundër, a vazhdojmë? Zoti Demalijaj, nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Përshëndetje, kryetar!

Për deputetët,

Në radhë të parë mendoj se nuk është dashur që të diskutohet hiç, se në radhë të parë është shkelje e Rregullores së Kuvendit kjo çështje, sepse për t'u interpeluar diçka e tillë duhet që në radhë të parë të jetë e përfshirë puna e Qeverisë ose e një ministrie të caktuar. Pra, çështjet që ndodhin dhe janë pjesë e mekanizimit të drejtësisë ose të sigurisë, trajtohen në rrethana tjera. Unë besoj se me Rregullore të Kuvendit, sekretari mundet ta gjejë, këto tema nuk është dashur të trajtohen. Unë e përkrahi iniciativën e kryeministrit që të jetë i pranishëm me ne dhe të interpelohet, por një çështje e tillë, meqenëse është pjesë e Kabinetit të tij, që ka ndodhur diçka në rrethana tjera, por nuk është lidhur me punën e Qeverisë ose të ndonjë ministrie të caktuar kjo çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Demalijaj! Ka pasur interpretim rreth kësaj çështjeje, qëndrojnë edhe argumentet tuaja, por megjithatë që t'u ikim keqkuptimeve, pothuajse ka qenë e paevitueshme për ta futur në seancë, përndryshe më tepër ka të bëjë me çështjet e organeve të drejtësisë.

Sido që të jetë, ka ardhur si pjesë e seancës, atëherë po e vazhdojmë, pasi është futur, por si precedent për herët e ardhshme çështjet që zyrtarët kanë të bëjnë me organet e drejtësisë, i çojnë në organet e drejtësisë. E votojmë formalisht vetëm me ngritje dore, a jeni për vazhdimin e seancës me interpelancë menjëherë? Vetëm me ngritje dore!

Po e shoh që është një shumicë absolute, prandaj futemi prapë menjëherë në vazhdim të seancës. E ftoj zotin Armend Zemaj, në cilësinë e propozuesit të interpelancës, ta marrë fjalën. Dhjetë minuta ka të drejtë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pasi e kemi parë që kjo çështje për dikë duket formale, unë vetëm po ju tregoj që për kërkesën tonë për këtë interpelancë jemi nisur nga parimi se institucionet e Republikës së Kosovës duhet të udhëhiqen nga njerëz të përgjegjshëm dhe me etikë, nga njerëz që nuk kanë rënë ndesh me ligjin, e aq më pak dhe asnjëherë nga ata që e degradojnë imazhin e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 69 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 44, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka thirrur në interpelancë parlamentare kryeministrin Ramush Haradinaj për çështjen për ta informuar Kuvendin dhe qytetarët e Republikës së Kosovës mbi pamjet e shfaqura në medie të zyrtarëve të lartë qeveritarë, një ndër ta zëvendëskryeministër dhe njëherësh ministër i Diasporës dhe

Investime Strategjike, duke përdorur armë zjarri, duke shtënë dhe duke e rrezikuar jetën dhe shëndetin publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Arsyetim: Lidhja Demokratike e Kosovës, duke marrë parasysh zotimin publik që institucionet e Republikës së Kosovës duhet të udhëhiqen nga njerëz të përgjegjshëm dhe me etikë, duke u bërë shembull i mirë në vendosjen e parametrave të besimit të shëndoshë në raport me qytetarët dhe imazhin e jashtëm të vendit tonë, është më se e domosdoshme që të mos lejohet degradimi i këtij besimi apo prishja e imazhit edhe ashtu të lënduar të qeveritarëve në raport me publikun e gjerë. Skenat e paraqitura në medie me karakter kriminal, të ndaluara dhe të dënuara me Kodin Penal të Kosovës, nga njerëz në hierarkinë qeverisëse tregojnë anën e një logjike dhe koncepti që përkthehen si kapje e shtetit për të kontrolluar çdo gjë me skenat e frikës dhe treguesin e forcës ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Andaj, është detyrë e jona që të kërkojmë llogari ndaj kësaj heshtjeje institucionale si përgjegjësi ligjore dhe ekzekutive ndaj personave të tillë. Qytetarët e Kosovës dëshirojnë siguri, nuk paguajnë taksa për aventurat e qeveritarëve, ata dëshirojnë siguri personale për ta dhe për familjet e tyre. Nuk duan rrezikimin e jetëve nga paedukata dhe papërgjegjësia etike e ministrave dhe Kabinetit të tillë qeveritar. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon përgjigje të prerë nga Qeveria dhe kryeministri Haradinaj ndaj skenave të publikuara nga ministri dhe zëvendëskryeministri i Kosovës. Po ashtu, në prani dhe pjesëmarrje edhe të zyrtarëve tjerë qeveritarë nëpërmjet veprimeve të tij me gjuajtje me armë ka bërë rrezikim të përgjithshëm të jetës së njerëzve, jo vetëm duke krijuar shkelje të rëndë të ligjit, por edhe shkelje të normave dhe etikës së institucioneve të vendit tonë.

Në shtetin e së drejtës, autoritetet e atij vendi, jo vetëm që e respektojnë legjislacionin dhe organet e sigurisë, por janë shembull i mirë në sjelljen e tyre dhe kjo tregon degradim institucional, krijon pasiguri juridike dhe është fyerje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Teksti i interpelancës që propozohet për votim:

Në përputhje me nenin 44, paragrafi 4, pika e 10 e Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës fton deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta votojnë mocionin në vijim:

M o c i o n

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon përgjegjësi nga Qeveria karshi këtyre veprimeve të rrezikshme dhe me shkelje të rënda ligjore, veprime të tilla të dënueshme edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës neni 374, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, dhe neni 375 përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm.

2. Kërkojmë menjëherë shkarkimin e zëvendëskryeministrit, njëherësh ministrit të Diasporës dhe Investimeve Strategjike, si dhe personave tjerë qeveritarë të përfshirë në këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e ngrehur për interpelancë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli,
Të nderuar deputetë,
Të gjithë kolegë të Kabinetit qeveritar,
Medie,
Të nderuar qytetarë,

Lënda për të cilën është thirrur interpelanca, në aspektin ligjor, edhe për respekt të deputetëve, po e shpjegoj, qëndron si vijon: Policia e Kosovës ka intervistuar pesë persona në këtë lëndë, ndër ta edhe zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, zotin Gashi.

Po ashtu, Policia ka konfiskuar dy revole që janë me ajër të kompresuar, po u quakan ashtu, të modifikuara për gjuajte. Njëkohësisht, këto janë të dhënat e Policisë, kjo lëndë tani është në Prokurorinë e Gjakovës, sepse qenka nën juridiksionin e kësaj prokurorie. Nëse duam që të jemi të sinqertë, nuk është e hijshme në shekullin XXI, po e quaj ashtu, t'i ekspozohet as publikut, as njerëzve me gjuajte me armë, por po ashtu, nëse duam të flasim pak realisht për jetën tonë, ende janë disa tradita në jetën tonë, nuk janë zhdukur krejtësisht, dhe tani jemi në atë periudhën kur ne të gjithë dakordohemi që t'u japim përparësi ligjeve në fuqi, Kushtetutës së vendit dhe të sillemi në përputhje me obligimet që kemi, si publike, si qytetare. Pikëpamjet e mia personale janë pak më tradicionale dhe për këto mbaj përgjegjësi, qoftë si individ, qoftë si i zgjedhur, qoftë në cilindo funksion që e kam.

Mirëpo, e përsëris ky rast dhe kjo interpelancë, dhe kjo tërheqje e vërejtjes, ta quaj ashtu, është një porosi se të gjithë duhet të korrigojemi në disa aspekte që kanë të bëjnë, pra përfshirë edhe traditën. Kam dëgjuar dikë që e ka përmendur traditën edhe në fillimet shumë të hershme e deri te sotmja. Jam dakord që Kosova edhe në traditën e vet të veprojë në përputhje me jetën, me realen, me Kushtetutën, me ligjet. Nuk dua të paraqes këtu pozicion të atij që është i befasuar me këtë që ka ndodhur dhe të atij që është mërziur ose është shqetësuar tepër, por e marr edhe një herë si mundësi që pikërisht trajtimin e kësaj teme në Parlament, e në interpelancë, ta kthejmë pra në vëmendje dhe të jemi, po e quaj ashtu, të orientuar kah zbatimi i ligjit, kah Kushtetuta dhe kah praktikat, në të cilat vetë kemi rënë dakord të hyjmë dhe traditën ta kultivojmë, dikush kishte thënë "ta kultivojmë në arkiva", ta kultivojmë në mënyrën që nuk e rrezikon jetën e askujt, nën një, edhe që s'bie ndesh me ligjin dhe me Kushtetutën e vendit.

Kërkesa për masa tjera, për mua tani është e hershme, për çfarëdo mase ndaj cilitdo të përfshirë, për shkak se është në proces ligjor dhe nuk parashihet të avancojmë ne me veprimet përderisa kjo temë është në proces ligjor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, Sami Kurteshi nga Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, apo Glauku. Unë do t’i thërras atëherë kryetarët e grupeve parlamentare për qëndrim.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Tash, ky Dardan Gashi nuk i ka shikuar reklamat e KFOR-it dhe ka gjuajtur aty në atë tubimin që e kanë pasur dhe natyrisht që kjo është një sjellje e keqe e një zyrtari të lartë publik të Republikës së Kosovës. Për shkak që kjo Qeveri ka ardhur në mandatin e saj duke dhënë premtime të mëdha për sundim të ligjit dhe për ta dhënë një shembull të mirë figurat publike me sjelljen e tyre, që natyrisht është së pari sjellje e mirë për shkak që është e nevojshme shumë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pra, ky është një problem, sepse kemi pasur thjesht shkelje të ligjit prej një figure të lartë publike, sepse është i dyti i Qeverisë. I dyti i Qeverisë e ka bërë këtë veprim! Por, unë mendoj që problemi merr dimension më shqetësues kur kuptohet se ku ka ndodhur kjo ngjarje. Kjo ngjarje ka ndodhur në shtëpinë e zëvendëskryeministrit tjetër, që është i dyti tjetër i Qeverisë, pra ai i dyti tjetër i Qeverisë i ka thirrur këta të tjerët dhe këta kanë gjuajtur në shtëpinë e tij dhe krejt kjo ka qenë e incizuar edhe është bërë temë e diskutimeve shoqërore, për të cilën po flasim edhe këtu. Por, edhe më shqetësues bëhet problemi kur ne e kuptojmë pse janë mbledhur ata aty. Janë mbledhur për të festuar që zëvendëskryeministri tjetër ka dalë i pafajshëm prej drejtësisë për shkak të aktakuzës për korrupsion. Pra, janë mbledhur këta të festojnë për shkak që një figurë shumë e rëndësishme e Qeverisë, në rregull kur ka qenë ministër i Infrastrukturës, ka dalë i pafajshëm dhe është shumë keq, sepse po shkelet ligji kur njerëzit që kanë dalë të pafajshëm prej drejtësisë po festojnë.

Domethënë, mënyra qysh festojmë ne kur të dalim të pafajshëm prej drejtësisë është duke e shkelur një ligj tjetër, dhe kjo është me të vërtetë jo fort e hijshme dhe jo fort e duhur për të ndodhur. Ne i kemi dëgjuar dy deklaratatë të kësaj Qeverie kur kanë dalë në publik dhe janë pyetur për këtë ngjarje. Njëra ka qenë e kryeministrit, tjetra e ministrit të tij të Drejtësisë, Abelard Tahiri. Kryeministri doli dhe tha, që në njëfarë mënyre më shumë e justifikoj sesa e qortoj zëvendëskryeministrin. U përmendën traditat, por krejt i kundërt ka qenë ministri i tij i Drejtësisë dhe ky është një lloj paradoksi. Kryeministri më shumë e ka arsyetuar zëvendëskryeministrin, kurse ministri i Drejtësisë ka qenë fort i rreptë. Dua të them i rreptë në deklaratatë, se këta kurrë nuk janë të rreptë në veprime, por për nga deklaratatë së paku ka qenë fort i ashpër.

Tha “ky e ka shkelur ligjin, ky zëvendëskryeministri dhe duhet të përgjigjet përpara drejtësisë”, domethënë asnjë kompromis sa u përket veprimeve të tij të paligjshme. Qeveria edhe pak u çudit, sepse njëri prej ministrave të vet po e lëshon një këso deklaratë, kur është krejt e kundërt me atë të kryeministrit, ku ky më shumë e justifikoi Dardan Gashin. Por, krejt çka kuptojmë në fund dhe shija shumë e keqe që e lë një veprim i tillë, edhe si veprojnë organet e sigurisë është kjo - në vendin tonë po përvijohen gjithnjë e më qartë dy kategori të njerëzve: është kategoria e qytetarëve të zakonshëm dhe e pushtetarëve specialë. Këta pushtetarët specialë, çka do që të bëjnë, nuk vlerësohen me standarde të njëjta prej ligjit nëpërmjet mënyrës qysh vlerësohen qytetarët tipikë, qytetarët e thjeshtë, që janë persona privatë, tek e fundit.

Thënë të drejtën, për këtë që ka ndodhur, unë nuk e arsyetoj hiç Dardan Gashin, por e kuptoj. Në ato tubimet e yndyrshme edhe me plot mish e raki, ku shahirët presin dhe grijnë, dhe ku burrëria shpaloset në mënyrën qysh gjuan allti, bëhet njeri trim edhe pa qenë hiç. Domethënë, çohet e gjuan Samiu, çohet e gjuan Endriti, i këqyr njeri që po gjuajnë të gjithë me rend, thotë “po çka kam edhe unë që s’ia kërcas një”. Domethënë, qysh është krijuar këtu ambienti, atmosfera, s’ka faj as kryeministri, për arsye që me të vërtetë kultivon disa sjellje të çuditshme, por unë jam megjithatë për atë që në fund të fundit personi publik duhet ta ketë një maturi dhe të mos jepet në situata turlifare, sepse, tek e fundit, kemi marrë përgjegjësi publike, apo jo. Kështu që duhet të jetë në nivel të detyrës njeriu.

Tash, dua të dal pak edhe te përdorimi i armës, sepse kjo është një çështje shumë e rëndësishme në Republikën e Kosovës, përveç tjerash, edhe për shkak që këtu në Republikën e Kosovës po dënohen njerëz, edhe deputetë, për shkak të interpretimit të asaj se çka është armë. Pika qendrore e aktakuzës të Prokurorisë, e cila nëpërmjet një aktakuze në gjykatë i dënoi katër deputetë të “Vetëvendosjes”, Albin Kurtin, Albulena Haxhiun, Donika Kadaj-Bujupin dhe Faton Topallin, pika qendrore e aktakuzës është interpretimi i armës se çka është armë. Pra, kjo tregon që pushteti fatkeqësisht e ka shtrirë dorën e tij drejtpërdrejt mbi Gjyqësorin, sipas interesave të veta dhe jo sipas interpretimeve të ligjit. Pse? Sepse, këtu është interpretuar veprimi ynë për t’i ndalur dy projekte shumë të dëmshme: Zajednicën dhe një demarkacion, i cili u argumentua që ishte i gabueshëm. Me veprimet tona që i kemi bërë këtu për të mirën e Republikës së Kosovës ka filluar një proces gjyqësor pikërisht mbi këtë pikë, se deputetët paskan përdorur armë të rrezikshme.

A po e shihni ku kemi ardhur?! Kur arma është e zjarrit, armë zjarri që të mbytë, që të vret, dhe kur këtë e përdor një pushtetar nuk është problem, ama kur këtë e përdorin disa deputetë që nuk kanë pushtet dhe janë të opozitës, edhe një diçka që hiç nuk është armë bëhet armë, sepse kështu po do pushteti. Pra, kjo tregon për standarde plotësisht të dyfishta në Republikën e Kosovës dhe kjo tregon se në çfarë niveli është sundimi i ligjit në përgjithësi, dhe vullneti i qeverive për demokraci dhe për shtet ligjor.

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Më paska marrë malli të dëgjoj debat politik dhe unë e përgëzoj Glaukun për mënyrën sesi i lidhi argumentet dhe nuk është se nuk ka argumente që vlejné, mirëpo nganjëherë ajo që më shqetëson është interesimi për ato argumente që janë të dobishme për atë çka përfaqëson dhe pastaj një dozë e abuzimit. Pse, Glauk? Shiko, nëse unë në Gillogjan ose ti në Sillovi te Sherifi, në familjen tënde e ke vendosur ta përdorësh një mjet të caktuar, nëse është armë, nëse e ke dakordimin e atyre që janë aty nuk e di kë e ke rrezikuar. Ndërsa, po e zëmë, nëse unë e përdor sot këtë ujë këtu, nëse s'e kam dakordimin e këtyre tjerëve, se dikur ne kemi qenë bashkë, situata dallon pak. E atmosfera festive, pa marrë parasysh çfarë ka qenë motivi, se për motivin mund të them pse duhet të festoj nëse e drejta ka dalë, dhe unë s'e kam asnjë dilemë në ato që po i thua.

Por, ju lutem, ta mbajmë njëfarë korrektësie! Tradita e gjuajtjes me armë te shqiptarët ekziston prej se e mbaj mend veten. Kushdo që është këtu, jam i bindur që ka këtu njerëz, nuk di sa mund të jenë që s'ka ndodhur një herë në një situatë kur e kanë parë një skenë të tillë. Unë jam plotësisht dakord me ty që nuk i takon kjo atij që mban përgjegjësi ligjore dhe nuk e jep imazhin e mirë dhe nuk është porosi e mirë dhe këtu as nuk kemi pse e teprojmë duke folur, mirëpo ju lus të jemi sa më të saktë në mënyrën e argumentimit.

Qytetari special dhe pushtetari special. Më special je sot të gjuash për qejf, nëse je qytetar, dhe shumë të privilegjuar janë nëpër ndeja të veta, të diskriminuar në këtë rast janë pushtetarët, nëse flasim për këtë temë, pra special është qytetari, kurse i diskriminuar është pushtetari për faktin se mban përgjegjësi ligjore. Ama ne e dimë që kur ka dasma, kur vjen Diaspora, e dimë krejt çfarë ndodh në Kosovë, e dini ju vetë, i dëgjoni, kur është Viti i Ri, kur është tjetra... sa pak fishekzjarrë kineze shfrytëzohen në Kosovë, e sa të Kaliçanit, të gjithë e dimë.

Unë jam dakord që kjo interpelancë të jetë si porosi, si vërejtje, të dërgohet një, po them ashtu, të vendoset një kriter për të ardhmen. Por po ashtu, në Kosovë, kur e kemi një temë, nëse mund ta ruajmë substancën e asaj teme për të mirën e këtij vendi. Veprat për të cilat janë dënuar deputetët, për shembull, për mua janë të papranueshme. Unë s'mund të dal t'u them gjykatësve "ti ke bërë gabim", ose prokurorëve, se megjithatë nuk parashihet ashtu, atëherë bëhem pushtetar special. Por, sa më përket mua personalisht janë të papranueshme ato vendime dhe unë besoj shumë që ky Parlament do t'ia japë një epilog asaj suate, aq sa e ka në kompetencë të veten.

Vetëm ju lutem, dëgjoni, nëse i ruajmë argumentet po i ruajmë, nëse kalojmë në lojë politike po kalojmë dhe vazhdojmë.

KRYETARI: Kryetar i grupit, ti e ke kohën e grupit mund ta përdorësh, por thashë të futemi në interpelancë. Urdhëroni, zoti Konjufca, fjala për ju.

GLAUK KONJUFCA: Mendoj që edhe më mirë do të kishte qenë po të ishte i pranishëm edhe personi, për të cilin po flasim. Kryeministri po i jep shumë zor duke e arsyetuar zëvendëskryeministrin e tij, kur ai shumë më mirë do të mund të përgjigjej për atë që i ka ndodhur. Dhe, e dyta, këtu kemi një ministër të drejtësisë, i cili ka dhënë shumë fjalë të ashpra, kurse procesi nuk është askund.

Sa i përket njeriut që ka gjuajtur, unë besoj që Ramushi di të gjuajë shumë mirë, për shkak të përvojës, për shkak të karrierës, për shkak të veprimtarisë të lavdishme edhe në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si njëri prej komandantëve më të zotët të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ama kryeministër, nuk e di sa e njeh Dardan Gashin, po të ndodhë që Dardan Gashi t'ia marrë dikujt alltinë shpejt prej brezit, e të dalë në dritare të gjuajë dikah pa e "centruar", a beson që duhet evakuuar krejt popullatën në një perimetër prej një kilometri katror atypari?! Ky është halli im. Unë besoj që ju të tjerët dini të gjuani mirë, por personi që është... A e keni parë që ai as alltinë e vet nuk e ka pasur?!

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, a dëshiron dikush për grupin parlamentar? Haxhi Abdylit e ka fjalën.

HAXHI ABDYLI: Unë po e marr fjalën si deputet, jo në emër të grupit.

KRYETARI: Kërkoj falje, po e përfundojmë njëherë në emër të shefave të grupeve parlamentare, se propozues ishte Armendi, por... Vjosa Osmani, në emër të grupit.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Do të tentoj që ta trajtoj këtë temë nga një aspekt komplet tjetër dhe arsyeja e vetme pse po marr pjesë në këtë debat është për të folur për pasojat që kanë pasur qytetarët e Republikës së Kosovës, gjithnjë qytetarë tërësisht të pafajshëm për raste të papërgjegjshme të përdorimit të armëve.

Para disa vjetësh, në natën e Vitit të Ri, festa me armë është shndërruar në tragjedi për familjen Kastrati nga Peja. Shpresa Kastrati, nënë e një fëmije vajzë disamuajshe, po vëzhgonte festën e Vitit të Ri, kur u godit nga një plumb qorr. Ajo e humbi jetën përderisa ishte në shtëpinë e saj dhe përderisa mendonte se është e sigurt të festojë bashkë me vajzën e saj disamuajshe. Vajza e saj sot po rritet pa nënë dhe prindërit e Shpresës, besoj shumë, ashtu siç kanë deklaruar edhe më herët, janë ndjerë të shokuar me një serë deklaratash dhe veprimesh nga përfaqësuesit e popullit, përfshirë edhe mungesën e seriozitetit me të cilën u fillua të trajtohet sot kjo çështje.

Në mesnatën e 31 dhjetorit 2010, një fëmijë i vogël nga Prizreni, që po ashtu kishte dalë të shikonte fishekzjarrët, u godit në kokë dhe e humbi jetën nga plumbi qorr. Secili prej nesh, para

se të vijmë në këtë interpelancë, është dashur ta dëgjojmë rrëfimin e nënës së tij. Edhe ai mendoj se ishte i sigurt të festojë në qytetin e tij, për shkak se ligjet që ne i kemi miratuar bashkë me Kushtetutën, që është në fuqi, nuk i lejojnë plumbat qorr dhe nuk e lejojnë festën me armë.

Para një muaji, përafërsisht në dhjetor 2017, një grua e moshës 38 vjeçe është goditur nga një plumb bredhës në kryeqytet, në qendër të Prishtinës, pra. Predha e armës ka ardhur nga jashtë objekti dhe e ka goditur viktimën, e cila ishte në korridor, duke e pritur vajzën e saj. Prandaj, kur i dëgjojmë të gjitha raste dhe këto janë shumë pak në mesin e qindra rasteve, që qoftë kanë vdekur si rezultat i plumbave qorr, apo “i asaj që quhet festim me armë”, ose kanë mbetur me pasoja të rënda, unë mendoj se nuk ka as burrëri e as trimëri, por ka vetëm mungesë përgjegjësie kur ne flasim me terma aq teknikë e aq qesharakë për një çështje që na takon neve dhe askujt tjetër ta rregullojmë dhe të sigurohemi se ligji vlen për të gjithë dhe të sigurohemi që për shkelje të atyre ligjeve paguajmë të gjithë njësoj, pavarësisht nëse janë qytetarë pa asnjë funksion publik, apo zëvendëskryeministra.

Unë e ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Sefaj, që sot ta njoftojë këtë Kuvend për të gjitha fondet që Ministria e Punëve të Brendshme i ka shpenzuar për fushatën “Festo me zemër, e jo me armë”. Ka të shumta të cilat, siç po e shoh, si video mjaft të mira, do të duhej së pari të shfaqeshin në këtë Kuvend, e pastaj edhe në Qeveri, për ta kuptuar seriozitetin dhe pasojat e veprimeve të papërgjegjshme.

Këtu u fol për pikëpamje tradicionale, u fol për traditën e gjuajtjes me armë, mirëpo unë besoj që nuk ka njeri në këtë vend që nuk pajtohet se i kemi goxha edhe disa tradita të këqija. Në qoftë se është një vend ku duhet të luftohen traditat e mbrapshta, traditat që rezultojnë me humbje jete të qytetarëve, ai vend është ky. Shembulli i mirë duhet të jepet këtu, shembulli i mirë duhet të jepet nga ata që e qeverisin vendin dhe nuk mjafton të thuhet që rasti është nën hetime, sepse fatkeqësisht e kemi parë që ligji nuk po vlen njësoj për të gjithë, por duhet të ndalet këtu duke e votuar mocionin, nëpërmjet të cilit një zëvendëskryeministër që e ka dhënë një shembull kaq të keq, shkarkohet nga pozita e tij publike. Ashtu edhe qytetarët e tjerë, të cilët mund të mendojnë në të ardhmen që të festojnë me armë do të mendojnë dy herë për pasojat që mund t’u shkaktojnë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Përndryshe, në qoftë se ne heshtim, e aq më keq qeshim, siç i dëgjuam shumë të qeshura sot këtu, atëherë faji do të gjuhet nga një anë në tjetrën. Por, të jeni të sigurt, në qoftë se ky Kuvend nuk vepron sot, faji i plumbave qorr nuk do të mbetet më jetim. Faji i plumbave qorr do të jetë i njëqindnjëzet deputetëve që janë ulur këtu, bashkë me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe kur të dalim në dritare për të parë fishekzjarrët në natën e Vitit të Ri në fund të këtij viti, që sapo ka filluar, shpresoj që secili prej nesh do të mendojë për Shpresën dhe për shumë shpresa të tjera, të cilat kanë pësuar nga veprime të tilla dhe për familjet e tyre, të cilat sot besoj me shumë dhembje, por edhe me seriozitet, presin nga kjo seancë një rezultat që do të jetë në të mirë të tyre,

por edhe do të japë shembull të respektimit të ligjit e të Kushtetutës në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka kërkuar përsëri fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ndjenja ndaj atyre që kanë pësuar, si rasti i Shpresës e i një fëmije, nuk është privilegj i njërit nga ne, në këtë rast as i një deputeti, as i një grupi parlamentar. Është e drejtë dhe ndjenjë që e ndajmë të gjithë.

Njëkohësisht, sa herë që e ekzagjerojmë një temë, në vend se ta sjellim kah një mes, ku i bashkojmë ata që ndjejnë, i ndajmë. Unë kam parë plot raste kur njerëzit e kanë keqpërdorur një ngjarje të caktuar në emër të një ndjenje dhe vetvetiu i kanë irrituar të tjerët. Nëse ne jemi një shoqëri që po e marrim drejtimin tonë sot, ka shoqëri që ekzistojnë me qindra vjet, ndër to është edhe Amerika. Kanë ligje për armë, kanë ligje për përdorim të armëve, për sjellje me armë, për gjuajtje me armë në pronën e tyre dhe ke shtete në Amerikë që e kanë të lejuar përdorimin e tyre.

Tani, ju lutem, nëse është qëllimi për t'u ndihmuar institucioneve të vendet, ose Parlamentit, të shfrytëzohet një vepër të caktuar për ta ngrëhur vetëdijen, shyqyr që jemi të tillë. Nëse është qëllimi për ta ndërlidhur këtë me dhembjen e me të tjera, i ndajmë prapë njerëzit në pikëpamje të veta, i marrim disa vota kur të vijmë zgjedhjet, votat e viktimave, por nuk jam për të shkuar kësaj rruge. Kush e ka në plan vërtet për ta korrigjuar, për ta sjellë kah mes, pse jo. Nëse është qëllimi tjetër, vazhdojmë secili në pikëpamjen e vet.

KRYETARI: Keni minuta të grupit parlamentar, kjo varet prej grupit parlamentar, kjo është koha juaj. Urdhëro, fjala për ju.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Në respektimin dhe zbatimin e ligjit nuk ka mes. Ai ose zbatohet, ose nuk zbatohet. Kjo nuk është çështje negociimi, është çështje e respektimit të Kushtetutës dhe dispozitave ligjore në mënyrë të barabartë për një zëvendëskryeministër, ashtu edhe për qytetarët e tjerë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të kenë ligje të tilla, mirëpo në të njëjtën kohë e kanë numrin më të madh të incidenteve me armë për kokë banori.

Ne duhet t'i shikojmë ligjet tona, të cilat e ndalojnë secilin qytetar, në këtë rast edhe zotin Gashi si zëvendëskryeministër, që të përdorin armë dhe rrjedhimisht e rrezikojnë jetën e qytetarëve. Ai e ka rrezikuar jetën e qytetarëve, prandaj edhe ne jemi këtu për ta zbatuar ligjin. Nuk është çështje votash, është çështje e zbatimit të ligjit, për të cilin ju, zoti kryeministër, por edhe secili prej nesh, duhet të jemi shembull.

KRYETARI: Memli Krasniqi e ka fjalën, në emër të grupit parlamentar.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në fakt, unë desha që t'ia kaloj përfaqësuesit të grupit, por meqenëse e kemi kohën të ndarë po i them disa fjalë.

E vërteta është që ne të gjithë në këtë sallë e dimë, besoj po e shohin edhe qytetarët që janë duke na përcjellë, që kjo interpelancë është thirrur për kushedi çfarë arsyeje, por jo për arsye të shqetësimit të madh që kanë pasur propozuesit për çështjen e rrezikimit, ose për çështjen e shkeljes potenciale, ose faktike, që e ka bërë zëvendëskryeministri. U pa edhe nga atmosfera me të cilën po zhvillohet debati, deri te ky dramatizimi, tentim-dramatizimi i fundit, sepse, pak a shumë, krejt kjo pati karakteristika komike deri më tash, siç ka pasur në të gjitha diskutimet, prej ditës kur është publikuar ajo video.

Përndryshe, sikur propozuesit të jenë me të vërtetë seriozë, unë veç një pyetje e kam: A mund të garantojë krejt ai grup parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës që asnjë anëtar i tyre asnjëherë nuk e ka bërë të njëjtin veprim, të gjuajë me allti në një prej gëzimeve që kanë mundur t'i kenë në familje, pavarësisht çfarë qofshin ato, kur u ka lindur ndonjë djalë pas pesë vajzave, ose ndonjë vajzë pas pesë djemve, ose kur e kanë marrë ndonjë nuse? Kjo është e para, se nëse po duam të bëhemi puritanë deri në këtë nivel, e ta denoncojmë veç pse e kemi pa të xhiruar një person publik, atëherë ne të gjithë këtu jemi persona publikë. Bile, ne jemi deputetë, e kemi marrë besimin e qytetarëve, pak më shumë sesa anëtarët e Qeverisë, që janë të emëruar. Dhe, unë po pyes, a mund të garantojnë që asnjëri prej tyre, kurrë asnjëherë, për sa kohë kanë pasur përgjegjësi publike, nuk e kanë shkelur ligjin në atë formë?

Është një pyetje. Le të thuan po, dhe unë menjëherë po tërhiqem, por të mos habiten kur mandej mund të thotë dikush që i ka parë ndoshta në ndonjë dasmë, në ndonjë gëzim ose zifafet, ose kur i kanë fituar ndonjëherë ndonjë palë zgjedhje në ndonjë komunë.

Po dua të them dhe po e përmend këtë për të treguar që këtu nuk është qëllimi për ta trajtuar temën si të tillë, por normalisht është pak më shumë politikë, pak më shumë është çështje e një partizimi të kësaj çështjeje dhe të përipiqen për ta gjetur edhe një arsye për ta sulmuar Qeverinë, derisa ka shumë çështje më substanciale, të cilat duhet t'i trajtojmë ne në këtë Kuvend të Kosovës. Kjo e para.

E dyta, pak më herët zonja Osmani e dramatizoi këtë çështje, duke i përmendur emrat e viktimave, që besoj se është goxha e rëndë, sepse na shtyn ta ndiejmë veten keq për secilin rast dhe pa dyshim që raste të tilla meritojnë ta kenë trajtimin e plotë, të paktën për t'u munduar për t'i dënuar ata që janë përgjegjës për humbje jetësh, për plagosje, apo për çfarëdo rasti tjetër. Por, ta gjuash fajin tash te cilido person, në këtë rast te zëvendëskryeministri, duke e ndërlidhur me disa raste tepër tragjike dhe të dhimbshme për secilin që i dëgjojmë, unë nuk mendoj aspak se është etike, është sikur të thuash që ne e kemi parë dhe e kemi xhiruar njërin prej

zëvendëskryeministrave, ose ministrave duke vozitur në autostradë 200 km në orë dhe duhet tash ta demonizojmë e ta penalizojmë atë njeri, nëse e di ai që ka mundur të bëjë ndeshje dhe ta marrë veten në qafë, ose edhe dikë tjetër në komunikacion. Dhe, për fat të keq, viti që e lamë pas ka qenë ndër vitet më të rënda sa i përket numrit të vdekjeve në trafik.

Ta vozitësh automjetin me 200 km në orë është vepër penale po ashtu, është rrezikim i jetës së të tjerëve dhe shumë më shumë raste tragjike të humbjes së jetës në kemi pasur në komunikacion, siç thashë. Dhe, unë prapë po pyes: A ka të tillë që mund të garantojnë në cilindo grup parlamentar, edhe në Qeveri, që asnjëri prej tyre kurrë nuk dalin përtej rregullave të komunikacionit, duke rrezikuar të bëjnë shkelje? Bile, unë në këtë rast e përsërit edhe ndryshimin e ligjit, i cili ka paraparë dënime shumë më të rrepta për shkeljet në trafik. Pse? Sepse, shumë njerëz kanë vdekur pikërisht në komunikacion. Por, tash, nëse e gjeni një deputet, ose një ministër, ose një zëvendëskryeministër, ose një prej shoferëve të tyre, për kohën sa ata janë në detyrë zyrtare duke i shkelur këto rregulla, a duhet tash ne t'i kthejmë edhe t'i përmendim rreth 100 viktima apo sa kanë qenë vitin e kaluar, si shembuj dhe të themi “ngadalë, se edhe ju keni mundur ta bëni një rast të tillë”.

Nuk e shoh aspak të drejtë këtë korrelacion, duke u munduar pastaj të identifikohet ky rast me raste tepër të dhembshme. Por, po e përfundoj me dy-tri fjalë rreth traditës. Traditat e identifikojnë dhe e definojnë secilin popull, qofshin ato tradita më të vjetra, qofshin ato tradita më të reja, qofshin tradita që i takojnë një të kaluar, që në shekullin 21, siç po thoni disa, nuk duhet të ekzistojnë, po janë pjesë, deshëm apo s'deshëm. Le të mundohet kush të dojë të bëhet sa të dojë politikisht korrekt, janë pjesë e një trashëgimie shpirtërore të një populli. Ne mund të pajtohemi sot, të themi “valla duam t'i ndërrojmë traditat”, këtë traditë, atë traditë... Shumë tradita kanë ndryshuar, është e vërtetë. Ndryshon evoluimi, ndryshon emancipimi, ndryshon zhvillimi i përgjithshëm, por të përpiqemi menjëherë me vendim, me interpelancë, të themi “prej sot e tutje këto tradita s'vlejnë”, kjo është absolutisht e pamundur. Ne mund të mendojmë se si ta kontrollojmë në të ardhmen një veprimtari të tillë. Nëse ka shembuj, ose mund t'i krijojmë vetë precedentët, por të mos thotë dikush që kjo është diçka e jashtëzakonshme.

A është e jashtëzakonshme? A mund të thotë dikush që Dardan Gashi ka bërë diçka që nuk është e zakonshme në Kosovë? Që nuk është e zakonshme për popullin shqiptar? Dhe, të mos ma keqpërdorë kurrkush e të thotë po e arsyetoj. Nuk po e arsyetoj. Çfarë jam duke dashur të demaskoj, është fakti që, siç thotë populli, “mos u bëni më katolikë se papa”, dhe prapë po kthehem te pyetja fillestare: A mund të më garantoni që asnjëri prej grupit tuaj kurrë nuk keni gjuajtur allti kur keni pasur ndonjë gëzim? Në qoftë se mund të thoni, unë publikisht ju kërkoi falje dhe ju them, “më falni allahile, se ju qenkeni ndryshe prej krejt popullit tonë”. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë? Kanë të drejtë të kërkojnë replikë, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Kush e merr fjalën? Shefi i Grupit Parlamentar, Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, ajo që deputeti Krasniqi e demaskoi është logjika e tij dhe cinizmi për këtë temë.

Unë e pyes atë, a ndihet ky keq që një zyrtar i lartë i Qeverisë së tij bën veprime që s'mund t'i cilësosh ndryshe? E kuptoj logjikën, a janë në përputhje me mentalitetin e sjelljes kanunore, e tjera e tjera... Po, a ndihet ai keq që një zyrtar i lartë i Qeverisë së tij sillet sikur jashtë çdo etike, që të mos përdor unë tjetër fjalë këtu? Këtu është esenca. Tash, nëse ti e relativizon këtë çështje, është problem i cinizmit tënd, por të lutem m'u përgjigj, a ndihesh ti keq që e ke në Qeveri një zyrtar të tillë? Qysh mund të shkojmë përpara, çfarë shembulli japim nr për qytetarët e vendit?

Normalisht, ne do ta ngremë çdo shkelje tash dhe kurdo në të ardhmen, por s'mund t'i relativizoni çështjet kështu. S'mund ne të tolerojmë që me logjikë gangsteri të gjuajtjes me armë, që rrezikojnë sigurinë publike, të lejojmë që zyrtarë të lartë të sillen kështu.

Të lutem përgjigju, a ndihesh ti keq që e ke një zyrtar të tillë në Qeveri?

KRYESUESI: Po, fjalën e ka deputeti Memli Krasniqi. Pas atij, zoti kryeministër.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shikoni, ju nuk u përgjigjet në pyetje. Nuk përgjigjet njeriu me pyetje, ose me kundër-pyetje. Unë tri herë të njëjtën pyetje jua shtrova, ju s'po jepni përgjigje, e po më bëni kundër-pyetje në diçka që u përgjigja më herët. Thashë që në asnjë mënyrë nuk e arsyetoj dhe absolutisht nuk është për t'u ndier mirë kur një zëvendëskryeministër, ose edhe qoftë një deputet, një person në pozicion të lartë publik, e bën një veprim të tillë.

Ajo që e thashë edhe në fjalën time është pikërisht kjo. Sundimi i ligjit nuk duhet të ketë kompromis dhe asnjë njeri nuk mund të jetë më i barabartë se tjetri para ligjit. Kjo është para. Ajo që e thashë unë, a jeni ju aq puritanë dhe prapë, po insistoj të më përgjigjeni, nëse mund të përgjigjet kushdo që merr përgjegjësi, ja ti si shef i grupit, zoti Hoti, a mund të garantosh se asnjë prej deputetëve të grupit tënd nuk ka gjuajtur me allti asnjëherë? Dhe, nëse s'mund të garantosh, nëse s'mund të garantosh, atëherë a vlen krejt kjo, krejt ky standard, që po e kërkon për zëvendëskryeministrin Gashi edhe për ata deputetë që kanë gjuajtur me allti në gëzime të caktuara? Por, të mos bëhemi tash që ka ndodhur diçka që s'e kemi parë kurrë, diçka që është e jashtëzakonshme, diçka e re, diçka e tmerrshme, sepse unë nuk po dua ta arsyetoj këtë, po duhet tri herë ta përsëris, ndoshta edhe për juve, që s'po doni ta kuptoni ndoshta, edhe për ata tjerët që

mund ta keqinterpretojnë. Mirë se erdhi edhe zëvendëskryeministri. Aspak s'është i arsyeshëm veprimi i tij, por a është ky i vetmi? Unë për këtë po të pyes.

Hajde tash përgjigjuni ju, se unë ua dhashë përgjigjen në pyetjen e juaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryeministri. Urdhëroni, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nëse kolegët deputetë, i nderuar Avdullah, kur u bisedua për interpelancën, ka pasur diskutime se a është në përputhje me Rregulloren, a ia vlen, a është në rregull, ku di unë çka. Edhe unë kam menduar që është mirë të ndodhë kjo interpelancë, se në fund të fundit, na ballafaqon, na e kthen vëmendjen, na tregon pak a shumë për aspektet që është mirë t'i kemi parasysh.

Edhe unë mendoj që qëllimi i interpelancës, ta zëmë, ideja që të diskutohet për një vepër të tillë, e që mundësisht pastaj të ndikojë të jemi të kujdesshëm, jo të mos na zënë me fotografi, po të mos i praktikojmë ato, është në rregull dhe e falënderoj Kuvendin për këtë.

Po ashtu nëse më duhet të them, më vjen keq, për shembull, nuk më vjen mirë që një pjesëtar i Kabinetit, një deputet ose një zyrtar i zgjedhur ndodh në një situatë ose në pozitë që porositë janë konfuze për qytetarët ose për të tjerët. Kjo nuk është mirë.

Jam thellë i bindur që do ta korrigjojmë veten në plot tema, në plot aspekte të jetës tonë, jo veç ne që jemi në Qeveri, po të gjithë.

Ajo që ju kisha lutur është po ashtu të mos e marrim këtë si indiference të Qeverisë ose mospërfillje ndaj aspekteve që kanë të bëjnë me rrezikimin e jetës së njerëzve me ata që kanë pësuar e me plot aspekte të tjera.

T'ju them të drejtën, dikur kjo ka qenë praktikë më e madhe në Kosovë, unë e di që është rralluar, pra ka rënë nga niveli.

Më kujtohet, një herë kam qenë vetë në një vend që ka ndodhur dhe jam frikësuar kur kanë shtënë brenda, e s'kisha dëgjuar që ka me gaz. Kur dikush ka shtënë, jam frikësuar. Po sigurisht, isha shumë afër, ka qenë në zona të Gollakut, edhe kur ka shkrepur brenda, nuk kisha parë më parë dhe jam tmerruar. Pashë që nuk lëvizti asgjë rreth nesh, atëherë më kanë treguar se është me gaz.

Tani po ju them, nëse vërtet është kështu, nëse ka qenë me gaz dhe nëse Policia e konfirmon, unë nuk i di lejet e përdorimit të tyre, po atëherë s'jemi duke folur për vepër që ka mundur të

rrezikojë jetën e dikujt tjetër, nëse është kështu, po nëse është e vërtetë, atëherë flasim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar për replikë Avdullah Hoti, le të përgatitet Ahmet Isufi.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Ta thjeshtojmë këtë diskutim.

Besoj që edhe kryeministri, edhe deputeti Krasniqi, edhe të gjithë pajtohen se veprimet e zëvendëskryeministrit Gashi janë kundërshtim me Kodin penal, me dy nenet të Kodit penal, 374 dhe 375, e para.

Dhe, e dyta, janë në kundërshtim me etikën e sjelljes së zyrtarit të lartë qeveritar. Nëse pajtohemi në këto dy pika, unë mendoj që veprimi që duhet të ndërmarrë kryeministri janë të qarta, pa hyrë fare në diskutimin e Kanunit, për ato që vazhdimisht është deklaruar kryeministri që nuk është bërë nami që është gjuajtur me armë ose në ato fshatra askush nuk frikohet, e harron që ka gra e fëmijë, pleq e të tjerë që duan qetësi në shtëpi, e jo të dëgjojnë krisma të armëve kohë e pa kohë, pa asnjë nevojë.

Prandaj, ju kisha lutur, dua përgjigjen në këtë: a pajtohemi që këto veprime janë në kundërshtim me nenet e Kodit penal, edhe në kundërshtim me etikën e sjelljes së zyrtarit të lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Prapë, kryeministri e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Pjesës së parë etike, e tjetër, po them më së pari me ligj, gjuajtja me armë është vepër e dënueshme, besoj se është ashtu.

Por nëse, Avdullah, ka qenë me gaz, është njëjtë a? Ligji e ndalon edhe atë, e nuk e di, nëse është ashtu, keni të drejtë, më falni.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka Ahmet Isufi, shef i Grupit Parlamentar të AAK-së.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kjo interpelancë konsideroj se është krejt e panevojshme, për shkak se në bazë të Rregullores që u përmend edhe më herët, dihet pse thirren interpelanca.

E dyta, bash ata që po thirren në emër të rendit, të ligjit, të drejtësisë, nuk po i lënë hapësirë drejtësisë që ta kryejë detyrën e vet. Pse të thirret kjo interpelancë e të politizohet, herë të kthehet në vajtim, e herë në gallatë, nuk është mirë.

Po ju them që nuk është mirë të keqpërdoren në raste të veçanta dhe një parlament të humbë kohë pas një rasti, i cili është, në fund të fundit, në organe të rendit dhe të drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri Sefaj. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Po përgjigjem rreth pyetjes së deputetes Osmani.

Fushata është sponsorizuar nga KFOR-i, ndërsa është menaxhuar dhe implementuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, në veçanti nga Policia e Kosovës. Ka qenë një fushatë e mirë, e dobishme, konstruktive, ka ndikuar në uljen e rasteve dhe të trendëve të mëhershme.

Duke pasur parasysh argumentin tani që është hapur, është shumë serioz dhe delikat, është mirë që ne të gjithë këtu së bashku të mos e trajtojmë me terminologji folklorike, duke e dituar se ka pasur viktima nga raste të tilla.

Sidoqoftë, të gjitha këto janë të rregulluara nga ligji dhe nga ligjet, ligjet janë të mira dhe të drejta dhe si, të tilla, duhet të zbatohen nga të gjithë.

Në këtë rast, mund të them se Policia e ka kryer detyrën e vet, ka proceduar të gjitha veprimet të cilat kanë qenë të nevojshme, tani lënda në fjalë është në duar të prokurorisë.

Mendoj se të gjithë ata që kanë marrë pjesë në këtë ngjarje para së gjithash duhet të trajtohen nga sistemi i drejtësisë, e pastaj nga sistemi politik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lista serbe, me sa shoh nuk është paraqitur askush, nuk e dëshirojnë fjalën.

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovës”, Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë,

Po e filloj fjalën time me këta lart që po drejtojnë këtë seancë dhe janë mbi Rregulloren, e kanë vendosur veten mbi Rregulloren, çka duan bëjnë, pse thonë se ne jemi interpretues të vetëm të Rregullores, domethënë ne bëjmë çka duam, edhe kur të bie shi, ne këndojmë, kështu bëjnë.

Tash çka thonë këta, çka thotë Rregullorja...

KRYESUESI: Zoti deputeti, ju kërkoj të përqendroheni te pika e rendit të ditës, ne nuk interpretojmë Rregulloren, interpretimi i Rregullores do të thotë ka ndikim.

BILALL SHERIFI: Neni 44 i Rregullores thotë kështu, për interpelancën, jam në rend të ditës.

Një grup parlamentar ose gjashtë e më shumë deputetë, mund të parashtrajnë kërkesë për interpelancë për të shqyrtuar një çështje që lidhet me punën e Qeverisë ose të një ministrie.

Dardan, kërkoj mandej të na tregosh çfarë pune të Qeverisë ke shqyrtuar atje në atë ndejë që t'ju shpjegosh deputetëve, e para.

Ta shohim se cilën punë të qeverisë po e trajton kjo interpelancë. Unë do ta kisha kuptuar sikur kjo pikë e rendit të ditës të kishte qenë debat parlamentar. Okej, debat, aty është livadh, kush do thotë, po një interpelancë është shumë e kufizuar, tregon se duhesh një punë të Qeverisë, të një ministri, të kryeministrit, ta trajtosh në interpelancë, e para.

E dyta, çka dëgjuam sot këtu, një aktakuzë. Pra, Parlamenti është shndërruar në një sallë gjyqi, ku e kemi një prokuror, këtu e patëm një dëshmitar, pa qenë hiq aty, dhe deputetë, juria në fund, një aktgjykim e kishin përgatitur që e kishin quajtur rezolutë. Aktakuzën ai, dëshmitari këndeje, deputetë, juria, tash në fund të votohet janë apo nuk janë fajtorë, çka është kjo?

Të gjithë që e morën fjalën iu referuan atyre çka ata besojnë se kanë pasur fakte. Glauku beson që aty ka parë raki, ka parë yndyrë dhe ajo i ka 'hallakat' njerëzit dhe kanë nisur të gjuajnë. Glauk, besomë që më pak ndikon rakia se bari, më pak ndikon rakia dhe yndyra se bari, Glauk. Bari juaj që u kishte çua në orgji seksuale, e kam fjalën, që ju e keni thënë, jo unë, njerëzit tuaj e kanë thënë, jo unë. Atëherë merru me ata të tutë që e kanë thënë, se nuk e kam thënë unë. Po kaq, kaq, mos e teproni, së paku, së paku, atë çka kemi dëgjuar në këto dy javë ua kanë hequr krejt të drejtën të moralizoni. Beso të kishte qenë kjo interpelancë para nja 2-3 jave, e kisha shtie kryet nën tavolinë edhe kisha thënë: "Hej, shuj se këta po flasin". Ama tash po them boll më, ju lutem, e kemi parë që nuk dalloheni nga kjo pjesë e shoqërisë, se aty ishim krejt, aty ishim krejt, dikush dje, dikush sot, dikush nesër, hajde ta shfrytëzojmë këtë, ta shndërrojmë në një debat si të përmirësohet dhe si të shkojmë në një drejtim, ku traditat zëvendësohen me diçka tjetër më pozitive.

Po, të kërkoj për diçka që si me prerje cezariene shërohet, nuk është korrekte, veç pse të kam zënë në një qosh, tash po ta hi, nuk është korrekte.

Dakord jam që të gjitha dukuritë negative duhet të kundërshtohen, duhet të luftohen, po të pranohet një fakt që kjo kërkon një proces të gjatë, të mundimshëm, dekada, ndoshta edhe më shumë se 3-4 dekada.

Nuk është mirë të keqpërdoren fatkeqësitë e tjerëve për të goditur të tjerët, një kundërshtar politik, nuk është mirë. Ajo edhe ndodh, bëj edhe unë nesër, po nuk është mirë, edhe nëse e bëj unë nesër, nuk është mirë.

Unë kaq pata sa për fillim, jemi grup i vogël, s'kam më shumë se 9 minuta dhe do t'u lë pak rend shokëve, kolegëve të tjerë, se natyrisht që kemi çka të themi, pra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kjo interpelancë normalisht që është në përputhje me Rregulloren e punës së Kuvendit, mbi bazën e saj është caktuar dhe me vendimin unanimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, kjo është e para si sqarim.

E dyta, unë mendoj që në fjalën e deputetit pati dhe përmbajtje dhe fjalorë që konsideroj nuk përputhet në tërësi me atë që ne e quajmë gjuhë parlamentare dhe etikë e sjelljes në këtë institucion. Kërkoj që kjo të mos përsëritet, nëse tentoni që të përsëritet derisa unë jam këtu, s'do ta lejoj, do t'ju a ndërpres fjalën.

Vazhdojmë, replikë me Bilallin nuk ke të drejtë. Grupi Parlamentar "6+", kush e kërkon fjalën? Albert Kinolli, urdhëroni.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar "6+", pas diskutimeve të llojllojshme të kolegëve të nderuar, mendojmë se përdorimi i armës si në ahengje, po ashtu edhe në raste të tjera bazuar në traditën tonë të lashtë paraqet rrezik potencial, paraqet shembull ndoshta jo të mirë për rininë dhe fëmijët tanë. Mirëpo mendojmë se e mira e gjithë kësaj ngjarje është që gjithçka ka përfunduar pa rrezik dhe pa pasoja.

E dyta, siç tha edhe vetë zoti kryeministër, me rastin në fjalë janë duke u marrë institucionet e drejtësisë dhe ne plotësisht e përkrahim në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë te pjesa tjetër, do t'ua jap fjalën deputetëve sipas radhës që e kanë kërkuar dhe duke e respektuar një shpërndarje sipas grupeve parlamentare.

Fjalën e ka së pari deputetja Drita Millaku. Urdhëro!

DRITA MILLAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë dhe qytetarë,

Të gjithë jemi dëshmitarë të gjuajtjes me armë zjarri të zëvendëskryeministrit dhe ministrit Dardan Gashi në odën e zotit Limaj për një festë, e cila ka mundur lehtësisht të kthehet dhe të shndërrohet në tragjedi.

Në anën tjetër, kemi reagimin e menjëhershëm të mediave dhe të shoqërisë civile, të cilët menjëherë kanë reaguar për një veprim të gabuar të tyre dhe e kanë parë si të rrezikshëm, të cilën një zyrtar i lartë i shtetit e ndërmerr.

Si reaksion i kësaj kryeministri Haradinaj u prononcua dhe tekstualisht tha se kjo nuk është ndonjë shkelje, për të cilën edhe vetë paska ndërmarrë veprime të tilla, të cilat iu kanë lutur nikoqirët dhe ai vetë paska bërë një vepër penale shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, pasi gjuajtja me armë kështu kualifikohet, edhe me Kodin penal.

Shtrohet pyetja: a vlen Kodi penal edhe për kryeministrin, zëvendësministrat e tij dhe të dimë, apo ligjet vlejné vetëm për një shtresë të caktuar të shoqërisë?

Zoti kryeministër,

Ne jemi një shtet juridik dhe ligjor dhe do të duhej të vlente edhe për ju, edhe për zëvendësuesit tuaj dhe për ministrat tuaj.

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministrat dhe zëvendësi juaj që është edhe ministër, e ka shkrepur armën e zjarrit në një vend, i cili është i ndaluar me ligj, pra e ka thyer ligjin dhe predhat e armës të tij kanë mundur të vrasin edhe të plagosin.

Ju nuk duhet të gjuani me armë, sepse e ndalon ligji, por edhe pse bëheni shembull i keq për qytetarët, pa dallim moshe, e sidomos për të rinj, të cilët mund edhe të ndikoheshin nga veprimet tuaja.

Në fund, zoti kryeministër Haradinaj,

A mund t'u jepni shpjegim të gjithë atyre qytetarëve, të cilët janë trajtuar dhe janë dënuar nga drejtësia për këtë vepër? A duhet të kërkojnë dëmshpërblim ata? Pra, këtu janë dy mundësi: ose të jepni llogari për veprimet tuaja, ose të amnistohen të gjithë ata që janë dënuar për këtë vepër?

Pra, të legalizohen gjuajtje me armë dhe ta ktheni shtetin në një shtet kaubojsht.

Krejt në fund, desha t'ia bëj me dije kryeministrit se zakonet dhe kanunet ka kohë që janë zëvendësuar me ligje pozitive.

Është një fjalë popullore që thuhet: “Diqysh nuk i shkoje as për fytyre”. Njëmend, zotit Haradinaj është e vërtetë se i shkon për fytyre të gjuajë, po diqysh zotit Dardan Gashi nuk i shkonte për fytyre.

Ma kujtonte një kohë kur kemi qenë fëmijë dhe luanim me pushka, ashtu, diqysh ashtu dukej.

Dhe, krejt për fund, dua të them se e dimë që askush nuk do të japë llogari, sepse në këtë shtetin tonë u shkel Kushtetuta dhe askush nuk ka dhënë llogari, e lëre më për gjuajtje armësh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë pajtohem se është krejtësisht absurde dhe jo normale që këtu, një parlament i tërë, 120 deputetë, me të gjitha obligimet e tjera të merremi tash me një ministër, i cili punën më të madhe që e ka bërë në këto katër muaj është një skandal gjuajtjeje me armë zjarri.

Por, një vend normal, me integritet minimal të Qeverisë, Parlamenti ishte kursyer prej një trajtimi të tillë.

Një vend normal, një Qeveri normale do ta shkarkonte anëtarin e vet në momentin e parë, pra po në atë moment, po atë natë që ky zyrtar bën shkelje të ligjit. Kaq i thjeshtë është protokollin i përgjegjësive nëpër vende normale, s’lypet mend më shumë.

Po tash, në një Kuvend i tërë megjithatë po merremi me një skandal, sepse Qeveria nuk po funksionon si një Qeveri e një vendi normal.

Përballë një skandali të turpshëm publik e krejtësisht të qartë, pa asnjë dyshim, pra, një shkelje të ligjit bërë publike, ajo është inekzistente, ajo nuk po arrin të tregojë as shenjën e vetme të integritetit politik e moral, përgjegjësive ndaj qytetarit, për çfarë është e thirrur gjithmonë.

Tashti për ta bërë pak të qartë, sepse relativizimet s’mund ta zvogëlojnë skandalin. Shtënia me armë zjarri në një ambient të hapur është vepër penale, shtënia si akt është vepër penale. Rrezikimi i jetëve të qytetarëve tanë nga shtënia me armë zjarri është vepër edhe më e rëndë penale.

Ministri dhe jo vetëm ai, zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës është përfaqësues i qytetarëve të Republikës, i interesave të një vendit tanë. Shkelja e ligjit, kryerja e një vepre penale prej zëvendëskryeministrit të Republikës është komprometim i interesave të qytetarëve

tanë, është edhe komprometim i dikasterit që ky e drejton. Të mos harrojmë, bëhet fjalë për përgjegjësin e investimeve strategjike në Kosovë.

A merrni me mend për pak se si do ta konsideronte veten një investitor i jashtëm që vjen në Kosovë e të takohet me një ministër që bën shkelje ligji e sillet si kapadai me armë zjarri në brez?

Ma çfarë integriteti e përfaqësimi, e me çfarë sigurie ne i trajtojmë tash investitorët e jashtëm, pra kjo është çështje më serioze se sa një shkelje e rëndomtë, ka pasoja edhe në investime strategjike.

Pra, akti si vepër penale nuk është kulmi i këtij skandali, madje kulmi i skandalit nuk vjen as prej mosreagimit të Qeverisë, paradoksisht kulmi i skandalit vjen prej reagimit të Qeverisë, prej deklaratës fillestare të kryeministrit.

Në vend të masës së përjashtimit të varësit të tij, në momentin që ka ndodhur shkelja e ligjit, kryeministri i kishte dhënë mbështetje, kishte thënë, nëse ju kujtohet, punë e madhe që shkelet ligji.

Qytetarë të nderuar,

Kolegë deputetë,

Këtu s'bëhet më fjalë veç një skandal e veç për një aksident, bëhet fjalë për mendësi politike.

Pra, kemi një situatë ku zëvendëskryeministri shkel ligjin, e kryeministri e arsyeton shkeljen e ligjit.

Kemi një situatë ku thirrësit për mbrojtjen e ligjit dhe ekzekutimin e ligjit, bëjnë shkeljen dhe arsyetimin e ligjit, pra nuk funksionon asnjë siguresë në sistemin qeverisës dhe në mungesë të përgjegjshmërisë e penalizimit moral e politik, do të vijojë edhe papërgjegjshmëria e institucioneve të tjera rend.

Pra, kur e mbron ti kështu publikisht ministrin tënd, institucionet e tjera do të jenë të dekurajuar për të vepruar.

Kështu që, që t'jua shpjegoj, sepse veç u bë e qartë nga fjala në vijim, Policia e dekurajuar dhe e frikësuar nga deklaratat publike do të hetojë rastin për muaj të tërë, do t'i trajtojë të gjithë miqtë që kanë qenë në atë aheng dhe, në fund, siç e kuptuam edhe prej arsyetimit të sotëm, do të konsiderojnë se arma me të cilën zëvendëskryeministri ka shtënë, ka qenë veç një armë gazi, pra një lodër, në një odë shqiptare, kështu do të jetë epilogu i hetimeve.

Edhe zëvendëskryeministri me shokë do t'ia hedhin sërish, e një Kosovë e tërë do ta kuptojnë inskenimin e një teatri të turpshëm, përfshirë prej Qeverisë, Policisë, hetuesisë e më poshtë.

I nderuar kryeministër,

Ju keni obligim sot që para qytetarëve të Kosovës, njerëzve që të kanë votuar, po sidomos ndaj njerëzve që nuk të kanë votuar, e që janë shumicë në vend, të tregoni një sjellje prej burrështetasi dhe sjellja prej burrështetasi të Republikës nënkupton që ju para vetes duhet të vendosni veç ligjin dhe standardet më të larta ligjore dhe kushtetuese në vend, asgjë tjetër, asnjë arsytim tjetër.

Ju s'jeni sot veçse një politikan, e pozita që ju ngarkon ju jep fuqi edhe më shumë se kaq.

Jeni kryeministër, prijës i qytetarëve të Republikës së Kosovës, shembull për shumë gjenerata dhe si shembull që jeni, duhet t'u tregoni familjeve kosovare, të rinjve e të rejave të këtij vendi, taksapaguesve të rregullt, atyre që me mund secilën ditë e kalojnë pa shkelur ligjin dhe duke bërë qytetarin e zellshëm të Republikës se asnjë shkelje ligjore nuk duhet të tolerohet.

Ju sot duhet të keni qëndrim të qartë, të prerë, të patjetërsueshëm, të korrigjoni veten e t'u tregoni qytetarëve tanë se shkelja e ligjit asnjëherë nuk është në rregull, siç keni thënë, se shkelja e ligjit, në fakt, është punë e madhe.

Prandaj, ju ftoj këtu që të ushtroni këtë shembull me dinjitet, të kaloni përtej interesave partiake, lidhjeve me koalicionin që po ju mbajnë peng, e tregoni udhëheqje moderne, për çfarë ka nevojë ky vend.

Ju ftoj që sot varësin tuaj ta shkarkoni për sjellje të keqe, komprometim të pozitës që mban, rrezikim të detyrave që i ushtron dhe, në fund, për shkelje të ligjit, siç do të duhej të sillej një vend normal. Me gjeste si këto eventuale, i nderuar kryeministër, ju do të ktheni pak dinjitet në këtë vend që dita-ditës po sharron më thellë në llumin e kapadainjve, gangsterëve e të fortëve mbi ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

S'do mend që ngjarje të tilla, ku eksponentë janë figura politike, drejtues të shtetit, mund të jenë edhe tema të debateve në Parlament. Shpeshherë ky Parlament ka ngritur debate që kanë qenë njëkohësisht edhe tema ose obligime të trajtimit të institucioneve të sundimit të ligjit. Ndoshta, kjo interpelancë, të kishte qenë në një periudhë pas një vendimi, cilido që të ketë qenë ai i organeve kompetente, do të kishim pasur ndoshta më shumë material.

Sido që të jetë, është në dorën e deputetëve dhe kjo ka ndodhur sot, jemi për të debatuar. Më mirë të mos kishte ndodhur kjo ngjarje, por edhe më keq sikur kjo ngjarje të ishte përcjellë edhe me viktima. Fatmirësisht, nuk ka pasur dhe, siç tha edhe kryeministri, qoftë edhe për të vendosur vëmendjen që ngjarje të tilla të mos përsëriten, ia vlen. Unë mendoj që sot më shumë se sa kaq, meqenëse këtu tash foltojta përdoret edhe për agjenda, që është normale, ne jemi politikanë të gjithë, as nuk duhet ta mbështetim para murit cilindo eksponent, në këtë rast zëvendëskryeministrin, t'i lëmë drejtësisë që të vendosë e pandikuar për këtë rast në përputhje me ligjin. Unë kam një porosi për dy ministrat sot këtu: për zotin Dardan Gashi. Ministër, ne e dimë që e njohim të gjithë, mendoj që nuk pajtohem që nuk i shkon kjo, por minimumi që mund ta bëjë Dardani është të nxisë një fushatë në emrin e tij dhe të kolegëve, një fushatë e cila do të parandalonte përdorimin e armëve ose cilado mjeteve në vende të ndryshme, qoftë të mbyllura, qoftë publike. Mendoj kjo e pakta që do ta bënte, meqenëse kjo temë u ngrit dhe mendoj që ka përgjegjësinë e duhur që ta bëjë këtë në ditët ose në muajt në vijim.

Për ministrin e Brendshëm mendoj që më shumë se kaq sot u përmendën edhe viktima dhe raste sidomos gjatë festave për Vitin e Ri, kemi evidenca që fatmirësisht janë në zvogëlim, por kemi raste të tilla, dhe jo vetëm nga përdorimi i armëve nga qytetarët, por edhe nga masat e tjera plasëse, jo vetëm fishekzjarrët, por edhe bombolat që bëjnë zhurmë dhe mendoj që është në dorën e Ministrisë së Brendshme të planifikojë lejet për import të atyre masave plasëse, të cilat rrezikojnë sidomos fëmijët dhe tash është koha, fillimi i vitit, që ju të bëni kufizime për importin, edhe për mënyrën e përdorimit të këtyre masave. Mendoj që fishekzjarrët është mirë të jenë, sepse festat sot janë në trend të bëhen me to, por këto bombolat plasëse që janë vetëm shpenzim i kotë i milionave të qytetarëve, edhe janë rrezik për fëmijët. Shifrat, statistikat tregojnë se është një numër shumë i madh i fëmijëve që kanë pasur pasoja nga përdorimi i tyre. Mendoj që është në dorën e Qeverisë që të bëjë kufizimin, sepse është një departament që merret me këto në Ministrinë e Brendshme dhe që jep lejet për importin e këtyre masave. Mendoj që më shumë se sa interesat e biznesit, duhet të ketë interes Qeveria, institucionet, që të parandalojnë rrezikun nga përdorimi i këtyre masave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu. Urdhëroni!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Një interpelancë i thirrur nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe çështja për të cilën ne po e diskutojmë, në fillim them që nuk e arsyetoj, por në fakt, pse e mora fjalën është pikërisht për shkak se nga iniciuesi i kësaj interpelance, në një kohë kur ne jemi dëshmitarë të veprimeve tona në Kuvend, mandatin e kaluar, kur ne vërtet i kemi bërë disa veprime që janë publike, e që asnjëherë nuk i kemi ikur drejtësisë, veprime të cilat dihen për shkak të dy marrëveshjeve që i kemi kundërshtuar dhe i kundërshtojmë në vazhdimësi. Por në atë kohë pikërisht në këtë Kuvend nga deputetët e zgjedhur të popullit që në radhë të parë janë deputetë, pastaj vijnë anëtarët e Qeverisë që janë të emëruar dhe një veprim i deputetit Zemaj, në kohën kur ndodhën ato

veprimet tona, ka qenë gjuajta me gotë të qelqit dhe sinqerisht prej asaj kohe deputetët e Parlamentit të Kosovës ja në çka pinë ujë, si rezultat i gotës së qelqit që u thye për ta gjuajtur një kolege tonën deputete.

Kjo ka ndodhur pikërisht këtu, në këtë sallë në Parlamentin e Kosovës dhe kurrë nuk u mor diçka për atë veprim. Pra, asnjëherë deputetët nuk duhet të jenë shembuj të tillë, por megjithatë asnjëherë nuk i fshihemi drejtësisë dhe mbi të gjitha u tha më herët që ligjet për dikë vlejné, e për dikë jo. Por, njëkohësisht po në të njëjtën fjalë, pak më vonë, u tha që ligjet nuk kanë mes: ose zbatohen, ose nuk zbatohen. Prandaj, sinqerisht Kuvendi ka shumë e shumë detyra, për të cilat punë ose ligjet që ne i kemi obligim për t'i miratuar, janë ligjet me të cilat ua rregullojmë jetën qytetarëve të vendit dhe pa dashur edhe një herë që të arsyetoj, sepse vërtet nuk është e arsyeshme ajo çfarë ka ndodhur, unë e kam dëgjuar edhe zëvendëskryeministrin në një kërkim falje, por le t'u mbetet organeve të drejtësisë, të cilat ne u besojmë dhe, mbi të gjitha, do të duhej të punojmë në drejtimin për t'u dhënë edhe më shumë kompetenca dhe për të treguar shembuj të mirë të veprimeve të secilit, por mbi të gjitha them, të deputetëve, sepse Qeveria, anëtarët e Qeverisë janë të emëruar dhe për shumë veprime të tjera unë si deputete nuk kisha dashur në një moment të isha deputete, por mbi të gjitha, emri i deputetit është një shembull që do të duhej të tregojë, njëkohësisht edhe i zëvendëskryeministrit, edhe i secilit anëtar të Qeverisë, një shembull për të gjithë dhe kisha thënë që interpelancat ndodhin, sepse vetë kemi qenë opozitë gjatë dhe është mirë të ndodhin, por Kuvendi ka shumë e shumë punë për të bërë dhe po na presin shumë punë të tjera, me të cilat qytetarët po presin, pra për ta rregulluar jetën e tyre dhe, mbi të gjitha për të ecur përpara me agjendat e vendit.

Prandaj, edhe një herë thirrje që sinqerisht jemi shembuj dhe mbi të gjitha të jemi shembull kur të ngremë për diçka një çështje që nuk është një veprim i mirë, por së pari duhet të jemi shembull vetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministri Limaj. Urdhëroni, zoti zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Natyrisht në Parlament dhe vetë Parlamenti trajton tema të ndryshme me interes të publikut dhe objektivi i këtyre debateve është që të vijmë në përfundime, e përfundimet e kanë qëllimin ose të ngrenë çështjen sa më në nivel, sa më lart në trajtim dhe të kthejmë vëmendjen e organeve kompetente që të merren me problematikën, ose të kërkojmë gjithsesi që të trajtohen temat nëpërmjet organeve.

Kam përshtypjen që interpelanca të cilën po e zhvillojmë sot është pa materie dhe duke llogaritur që është ngritur nga një grup politik shumë serioz, i cili ka një përvojë politike të trajtimit të problematikave që ndodhin në vend, besoj që mbajtja e kësaj agjende më tepër se një muaj është joserioze në qasje. Dhe, më tepër këtë e shoh në kontekstin e ndikimit medial, se sa në arritjen e objektivit aty ku pretendohet nga fjalët që u thanë. Së pari, Parlamenti i Kosovës do të doja të mos ishte një Parlament hipokrit, por përnjëmend të ishte shqetësuar për shkelje të ligjit. Shumë do ta kuptoja ngritjet e çështjeve, ose shqetësimin për shkelje të ligjit sikur të ishin ngritur këtu shqetësime të mëdha që vërtet është shkelur ligji në Kosovë. Ne jemi duke folur për një veprim që s'është dashur të ndodhë, se a është kriminal apo s'është kriminal, s'e vendosni ju, e vendos gjykata. Për një veprim, i cili ka marrë adresim dhe po trajtohet dhe ata do të vijnë në përfundim. Kush jemi ne të trajtojmë, të përfundojmë dhe të japim konstatime çka ka ndodhur. Thashë, e kisha kuptuar një parlament ku është shumë i fokusuar dhe nuk toleron veprime qofshin të pahijshme, qofshin shkelje ligjore.

Para se të flas për atë çështje, që të tregoj se sa hipokrizi ka këtu dhe nuk jemi në rregull, të nderuar miq, e tregon më së miri: si është e mundur që për kaq vjet në këtë Parlament asnjë deputet s'u ngrit të flasë një fjalë ose pasi u krye kjo çështje, se në këtë vend qysh shkelet ligji dhe qysh persekutohen njerëzit. Si në këtë Parlament nuk u çua dikush të thotë se si është e mundur të fabrikohen mesazhe, të falsifikohen mesazhe e të mbahen njerëzit tetë vjet nëpër burgje, në hetime dhe në persekutime. Si është e mundur? Si nuk e shqetëson një deputet e të thotë pse nuk i shkoni ata policë, ata zyrtarë, kushdo që i ka futur duart të nxirren para drejtësisë. Si është e mundur një kolegut tuajin deputet tetë vjet e kanë stigmatizuar, e kanë akuzuar, s'kanë lënë gjë pa i bërë me familje dhe asnjëherë s'kam dëgjuar asnjë zë nga ju e të thoni: "Ngadalë, se po shkelet ligji".

Mos, s'e duron ky vend, ky shtet ligjor të fabrikoni, të montoni, s'e lejon ky shtet, nuk e pranon ky Parlament një situatë të tillë. Asnjëherë, është e vërtetë s'e keni përdorur, unë po them është për të kërkuar llogari, veç pak, Armend, pastaj fol, ti e di që s'përzihem unë. Unë jam duke folur në kontekstin e shqetësimit të shkeljeve ligjore dhe çka ndodh tash, sepse nuk është realizuar plani i disa grupeve kriminale, bandave, edhe të mediave, shkojnë e bëjnë temë një veprim që unë po them, s'ka dashur të ndodhë, për çka. Këtë unë e di saktë pse është bërë kjo. Qëllimi është se s'është realizuar plani i tyre. Të eliminojnë njerëz, këtë absolutisht asnjëherë s'kam folur edhe nuk e arsyetoj si veprim, por ta shohin organet, të paktën kjo po adresohet në organe. A dini sa çështje në këtë vend janë të patrajtuara dhe të paadresuara në ligj. A dini sa njeri vuan prej paligjësisë që bëhen në vend? A dini, more sa njeri është në burg pa të drejtë? A dini sa padrejtësitë bëhen në këtë vend, a dini sa tema duhet t'i drejtojmë në këtë Parlament, e ne merremi këtu a ishte me gaz a pa gaz.

Dhe, unë e kuptoj të ketë debat, po absolutisht, parandalimi, mospërdorimi, siç u tha këtu, normat ligjore, lëreni më këto, a ka qenë traditë a s'ka qenë traditës, nuk janë në rregull, s'janë të

hijshme, s'bën të bëhen, është debat, pa dyshim, po të vijnë në përfundime. Nuk besoj që ajo temë ka pasur materie të shkohet drejt në interpelancë, pavarësisht kush e ka shtyrë, e ka motivuar të vijë deri këtu, e unë jam i bindur që ky grup serioz ka rënë në një kurth krejt, për mendimin tim, të panevojshëm, pa materie për të dalë temë. Ka shumë tema të tjera që duhet bërë për interpelancë.

Natyrisht, është e drejtë e deputetëve, po që s'ka materie, është e qartë, sot kemi mundur të flasim për shumë gjëra të tjera, për shembull, sot ka ndodhur 500 mijë euro, 500 mijë euro po i paguan shteti i Kosovës për ato pasaporta, përveç 5 milionë që i ka dhënë në arbitrazh, edhe 500 mijë tjera, të paktën kështu janë zërat që duhet të konfirmojnë a është e vërtetë a jo. E trajtojmë, është e këndshme kjo vërtet, kjo është e këndshme te ne, se jemi mësuar, se niveli ynë është aty, thashetheme, gjuajti, s'gjuajti, hëngër mish, s'hëngër mish. E dëgjon qytetari, mendon se kështu e merr votën. Na përshkruan atë farë skemën, ta merr mendja sikurse Sali Protopapa, a e keni parë filmin? Mos ashtu, kurrkush s'ju ndalon, fjala është e lirë, por besoj që është pak e tepruar.

Tani edhe një gjë tjetër, ne jemi rival politik, kundërshtar politik, mendojmë ndryshe, por në këtë Parlament shumicën e rasteve është ruajtur pjesa personale. Në qoftë se nuk e durojmë njëri-tjetrin personalisht, nuk është mirë të përdorim debatin edhe në aspektin personal, sepse duhet të ruajmë dinjitetin e Parlamentit. Edhe tjetra, do Zoti që Kosova problemin më të madh për interpelancë e ka këtë temë. Do të ishin njerëzit më të lumtur të këtij vendi, në qoftë se kemi problemin më të madhin këtë që po e trajtojmë sot. Por, ajo që unë po e them, miqtë e mi, është do ta kisha kuptuar edhe shqetësimin e shumë këtyre këtu që na flasin për ligjin sikur të kishin ngritur dhe denoncuar paligjësitë që po bëhen e që janë bërë vazhdimisht në këtë Parlament. Atëherë, do ta kisha kuptuar seriozitetin, do ta kisha mirëkuptuar edhe këtë çështje për ta çuar deri në fund.

E fola këtë, po në kontekstin e asaj që ka ndodhur rasti është pas përfundimit të gjyqimit të Ministrisë së Transportit dhe ka këtu deputetë, jo shumë shqyrt, për të tjerët i vlerësoj dhe i shpreh mirënjohjen time që kanë qenë të kujdesshëm, por ka këtu deputetë që vota kanë marrë, më kanë fyer në çdo studio për atë proces gjyqësor, ka. S'kanë qenë deputetë, tash janë deputetë, por s'ka gajle. Për ata po e përdor, thashë, sepse ngjarja ka ndodhur pas asaj, në vend që sot ne të themi si është e mundur në këtë vend të na ndodhin gjithë këto gjëra që po na ndodhin dhe ne njëfarë mënyre po mbesim të heshtur. Po merremi me gjëra krejt periferike, të cilat në fund të fundit kanë adresim, ka adresim ligjor për këtë çështje. Ne po themi s'bën të përzihemi, se këtu tani pastaj po dalim shumë herë hipokrit, po themi s'bën që të përzihemi në organet ligjore. Atje organet kanë nisur adresimin, unë do ta kuptoja po të mos kishte filluar procedura, ka filluar ajo procedurë, hetohet, vjen në përfundim, është adresuar. Por, ka me mijëra çështje në këtë vend që nuk po adresohen e që janë skandaloze, e që janë të dëmshme, e që dëmtojnë shoqërinë tonë, vendin tonë ose individë të këtij vendi.

Po është e këndshme për debat, është. Ne po ju ofrojmë njerëzve tanë vetëm lajme të këqija, vazhdojmë me lajme të këqija, tallemi me njerëz, terrorizojmë njerëz dhe kjo është një si, të thuhet, është një filluskë, kur nuk futemi në esencë të problemeve, me të cilat ballafaqohet vendi ynë, atëherë merremi edhe me përshkrim të festave ose të ngjarjeve familjare, në të cilën ka ndodhur veprimi që s'do duhej të ndodhte, por ka ndodhur.

Prandaj, ju ftoj, miq, të mos humbim kohë në debate të kota, të trajtojmë tema të cilat besoj që janë shumë të rëndësishme dhe nga këto tema të dalim të dobishëm për vendin tonë. Diskreditimin e njerëzve ose fitimin e një vote më tepër nuk është rruga kjo, as që mund të fitoni më shumë vota e as që mund të diskreditoni dikë. Janë rrugë të tjera që mund të fitoni vota më shumë, me projekte të mira, me ide të mira, me vizion të mirë, të preken tema të cilat janë të rëndësishme për vendin, por me këtë, besoni, nuk mund të ecim larg. Kështu që, edhe një herë po e përmbyll fjalën time, do të doja shumë që të ishte tema më e madhe dhe më e rëndësishme në vendin tonë kjo që ka ardhur deri në nivel interpelance. T'i lëmë organet ta bëjnë punën e tyre dhe t'i kthehemi përfundimisht ndonjë pune të mbarë dhe të mençur për vendin tonë, të cilat kemi shumë dhe të filloni dhe kërkoj nga ju, hajde të jemi më të guximshëm t'i shohim ato që po e shkatërrojnë këtë vend. Ka qindra, mijëra skandale, probleme, tema, me të cilat Parlamenti i Kosovës duhet të merret. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë e ka kërkuar fjalën deputeti Armend Zemaj, përgatitet deputeti Sami Kurteshi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë jo vetëm për zëvendëskryeministrin Limaj, por edhe për disa kolegë deputetë që rrinë kujdestarë kështu të personalizimit të gjërave të ulëta, t'i quaj kështu kushtimisht, por vetëm po e lexoj paragrafin e fundit që e kemi përgatitur në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, edhe aty është edhe përgjigjja pothuajse në 80% të fjalimit të zëvendëskryeministrit Limaj.

“Në shtetin e së drejtës autoritetet e atij vendi jo vetëm që respektojnë legjislacionin dhe organet e sigurisë, por janë shembull i mirë në sjelljen ndaj tyre, andaj kjo tregon degradim institucional”.

Krijon pasiguri juridike, zoti Limaj. Kjo është ajo pasiguria juridike që edhe ju folët për tetë vjetët e kaluara. Nuk dua të tërheq prapë paralelizma, por Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Grupi Parlamentar, po flas edhe në të kaluarën jo që ka qenë e vëmendshme ndaj pasigurisë juridike, por ka bërë thirrje që kjo të minimizohet dhe të luftohet në Republikën e Kosovës. Ka edhe shembuj të tjerë, ka edhe shembuj të tjerë të personalizimit, ka edhe shembuj të tjerë të eliminimit qoftë edhe të tendencës së kundërshtarëve politik, por kjo interpelancë nuk ka të bëjë as me njërin, as me tjetrën, por në kuadër të kësaj ne prapë kërkojmë që të mos ketë pasiguri juridike në Kosovë. Ata që janë legalistë e kuptojnë dhe e shohin çdo ditë se çka ndodh nga

organet tona të drejtësisë dhe se si interpretohen dhe si atakohen persona të caktuar, qoftë vetëm me një shkresë, në anën tjetër me një grumbull dosje mbyllën sytë. Kjo është ajo çka ne po flasim.

Edhe unë jam me atë që nuk ka vota dhe nuk duhet të ketë vota prej këtyre gjërave, ne po flasim për disiplinë dhe logjikë qeveritare, ku shteti i si drejtës duhet të funksionojë për të gjithë. Jo aty ku ndodh një problem i caktuar, por aty ku eliminohet një rrezik i përgjithshëm i jetës së njerëzve që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Ndërsa, për fund, aq shumë skandale po bën kjo qeveri që tjerat disi po duken minore në shtetin e së drejtës. E kemi ngritur edhe këtu tendencën, ngutjen për t'u paguar ai 5-milionësh, zoti zëvendëskryeministër, pa u përfunduar procedurat e brendshme ligjore, ashtu siç e thotë Ligji për arbitrazhin. Ndërsa sot dëgjuam që edhe të njëjtit biznes i janë falur edhe 500 mijë euro të taksave të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kah po na çon kjo gjendje? Andaj, unë po e përmbyll, besoj që kjo do të jetë më shumë thirrje, jo vetëm përgjegjësi e vigjilencë, se pjesa tjetër ligjore është minore në krahasim me veprat e tjera që kanë bërë individët dhe çdo ditë që proklamohen edhe në media, edhe deklarata ndaj njerëzve, individëve të caktuar për veprat kriminale që kanë ndodhur në Republikën e Kosovës. Por, unë prapë do të mbështes jo vetëm juve, por edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës nëse arrin përmes legjislacionit të krijojë siguri juridike për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, jo në mënyrë individuale, por në mënyrë të përgjithshme, kjo ka qenë edhe logjikë e shumë neve që jemi marrë me çështjet e ligjit dhe legjislacionit këtu. Kjo ka ndodhur edhe brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës, pikërisht edhe për çështjet tash, po më vjen keq që po e përmend, edhe për çështjet e imunitetit. Domethënë, disa individë të caktuar, nuk po dua të personalizoj, as të jem subjekt i asaj, nuk kemi lejuar që të ketë pasiguri juridike ashtu siç nuk e thotë ligji dhe Kushtetuta, ndërsa ka individë, ka grupe politike që është e vërtetë që kanë bërë edhe kauza rreth ngjarjeve të individëve dhe të subjekteve të caktuara.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ajo fjala e popullit “nxirr një kashtë, dalin gjashtë” u dëshmuar në këtë rast, që është shumë shqetësuese. Njeri mundet të pajtohet me shumë vërejtje, shumë gjëra mund t'i thotë që s'janë ashtu, por u përpoq të bëhet njëfarë relativizimi. Megjithatë, nuk është e drejtë që dikujt t'i tërhiqet vërejtja, për shembull si zonjës Osmani, që përmend rastet e vdekjeve nga plumbat qorr. Ajo është një e vërtetë, bre, pse po duam ta relativizojmë, të ikim prej fakteve, ato janë fakte.

Çështje tjetër është kjo çka po bisedohet, megjithatë, nga iniciuesit e interpelancës, unë e dëgjova edhe tekstin e mocionit, megjithatë kemi të bëjmë me një përgjegjësi të Qeverisë që është e natyrës etike dhe që ka të bëjë me Kodin e sjelljes së anëtarëve të Qeverisë, edhe në rastin më të

rëndë, kryeministri do të mund ta shkarkonte ose ta suspendonte ministrin, ose anëtarin e Qeverisë së vet për shkelje të ligjit, po si normë etike. Mirëpo, kjo dëshmon diçka tjetër shumë më të rëndë se krejt këto parti që e kanë pasur pushtetin tani e 18 vjet e kanë shkatërruar drejtësinë, e kanë kriminalizuar drejtësinë, Gjyqësorin, Prokurorinë. Prandaj, kurrkush nuk e kthen kokën në atë anë, se kjo është punë e Prokurorisë. Këtë ka mundur ta kryejë prokurori dhe Gjykata shumë shpejt t'i marrë ata që kanë bërë veprime të paligjshme, t'i japë sanksionet dhe kjo do të merrte fund. Pikërisht këtu e kemi problemin, prandaj ne bisedojmë në këtë Parlament çka të bëjmë, dhe kërkojmë mandej zbatimin e ligjit. Jo, ne bëjmë ligje, të mira ose të këqija, edhe jemi detyruar secili prej nesh si person t'i respektojë ato ligje, por ne nuk i zbatojmë ligjet. Kjo është çështja.

Ky shkatërrim i drejtësisë i ka pasojat në çdo pore të jetës. Kjo nuk është diçka e jashtëzakonshme, kjo ka ngjarë, u bë përpjekje për ta relativizuar sipas atij parimit “ai që nuk ka bërë gabim, le të gjuajë gurë mbi mua”. Ne nuk jemi këtu për relativizim absolut të krejt lëshimeve. Mirëpo, po bëhet përpjekje sepse relativizimi, ose ashpërsimi ka natyrë politike. Vërtet ne jemi politikanë, por kjo nuk na arsyeton të humbim kohë gjithsesi për gjërat, e mandej t'i nxjerrim gjërat pa kurrfarë nevojë, sikur e nxori ai miku im, shoku im nga “Nisma”, i nxori çështjet sikur të jetë interpelanca kundër “Vetëvendosjes”, sikur të flitet këtu për barin e për drogën e për seksin e për orgjitë seksiste. Mos, se janë turp këto të përmenden.

Sa për informim, ne jemi në gjendje t'i hapim të gjitha temat, tabutë, që kjo shoqëri nuk guxon t'i hapë, por jo një keqinterpretim i tillë i gjërave dhe i diskutimeve që bëhen në një vend. Po, ne flasim edhe për ngacmimin seksual, ne flasim për gjithçka, sepse kjo shoqëri i përmban ata, por s'guxon t'i hapë. Ne i hapim, por jo t'i interpretojmë gabimisht.

Çështja tjetër që unë e vërejta, ju s'po e dëgjoni me kujdes çka tha ministri i Punëve të Brendshme. Tash dëgjoni, iu drejtua zonjës Osmani, fjalimit të saj, po unë po ju them çka tha. Tha: “këtu nuk ka nevojë të përdoret terminologji folklorike”. Iu drejtua deputetëve. Për këtë fjali do të duhej shkarkua këtë ministër. Vetëm për këtë fjali. Ky Kuvend duhet t'i mbledhë votat dhe ta shkarkojë, se fjalimet e deputetëve i quan “terminologji folklorike”. Jo, ka bërë mirë, edhe ky bën mirë kështu, dhe vazhdimisht do të bëjë kështu, derisa të ketë deputetë këtu që thonë “mirë ka bërë”. Prandaj, mos kërkonit imunitet për gjërat që i bëni, ose i flisni, se s'keni imunitet, se ministri i Punëve të Brendshme i interpreton si “terminologji folklorike”. Këtu nuk vërehen këto gjëra. Unë e di se ka edhe gjëra tjera që u thanë, s'po dua të hyj te gjërat tjera që u thanë, s'po dua të hyj te tradita, shpjegimi i traditës e ato krejt, por mua po më shqetësojnë këto gjëra.

Unë mendoj që interpelanca e ka kuptimin e një kodi të mirësjelljes së Qeverisë, që është zbatuese e ligjit dhe ne mund të diskutojmë për të, mirëpo këtu “nxirr një kashtë, dalin gjashtë” edhe po e humbim kohën kot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë, fjalën e ka kërkuar Bilall Sherifi. Ka të drejtë. Urdhëro!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Pata të drejtë edhe parëz, po çfarë të bëj, jeni ulur atje lart, s'po merrni vesh.

Sami, marre është të bëhen, e jo të përmenden, një. Dy, sikur të kishe thënë që kjo seancë, ky debat, kjo temë është dashur të trajtohet në Kuvend, por në një formë tjetër, në funksion të sensibilizimit të publikut, në mënyrë që traditat gradualisht të zëvendësohen me ligje pozitive, do ta kisha kuptuar. Por, që ti nuk po thua, nuk po e ngre ashtu siç është, qysh mirë e di, që kjo temë nuk ka qenë për interpelancë, kjo po më shqetëson, se të njoh mirë si njeri që bukur e lexon germën ashtu siç thotë, nuk e lexon më shumë frymën, siç po e lexojnë këtu veç frymën e germën hiç.

Unë nuk bëj pjesë në kategorinë e njerëzve që ul kokën. Nuk nguc i pari kurrë, ama i dyti mezi pres. Kur të përmendsh raki, kur të përmendsh yndyrë, priti pastaj edhe ato të tjerat. S'po i përmend edhe një herë se i përmende ti, e kryesuesi ma tërhoq vërejtjen, më tha s'bën t'i përmend, po pres tash të ta tërheq vërejtjen edhe ty që s'bën të përmenden ato fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju siguroj që s'na duhen këshilltarë për këto çështje. Nëse e kam të nevojshme, unë kam ndihmë këtu në bazë të Rregullores. Po, kundër-replikë! Urdhëroni!

SAMI KURTESHI: Po, megjithatë, unë me Bilallin kemi miqësi të vjetër. Unë po të them që s'ke kuptuar drejtë, ose s'ke dashur të dëgjosh, ose të kuptosh drejtë, një. Ne nuk kemi folur për gjërat që bëhen, ne kemi folur për gjërat tabu në këtë shoqëri dhe kemi thënë ato s'i lejojmë. Prandaj, ke keqkuptuar, ose ke dashur ta keqkuptosh atë që është thënë në rrjetet sociale dhe në fjalitë publike.

E dyta, unë pikërisht këtë po e them, s'kemi Gjyqësor as Prokurori, se kjo interpelancë s'do të kishte zënë vend sot këtu. Pse s'kemi Gjyqësor, as drejtësi? Sepse partitë në pushtet e kanë shkatërruar drejtësinë, e kanë kriminalizuar. Kjo ishte poenta ime. Faleminderit!

KRYESUESI: Edhe një herë, fjalën e ka kërkuar deputeti Bilall Sherifi. Unë ua tërheq vëmendjen, i keni një minutë e dy sekonda.

BILALL SHERIFI: Veç po e konfirmoj miqësinë e vjetër, por gjithashtu po e konfirmoj që kemi dallime tash për shumë çështje, shoku Sami. Edhe kjo interpelancë nuk ka materie, siç e tha edhe zëvendëskryeministri. Kjo temë ka mundur të trajtohet ndryshe, por jo në interpelancë, siç është ftuar. Po mirë, tash jemi këtu, hajde të debatojmë. Sa i përket asaj pjesës tjetër, unë nuk e kam thënë. Njerëzit tuaj, dëshmitarët tuaj, se Glauku u bë dëshmitar pa qenë aty, tash dëshmitarët tuaj

po flasin për ju, s'po flas unë. Kaq, unë veç e komentova një diçka që e kam lexuar nga njerëzit tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani më duhet të saktësoj që ne po e përsëritim që s'ka materie, por po flasim për një gjë që ka ndodhur, kështu që ka materie dhe kushtet formale janë plotësuar, prandaj jemi këtu. Sipas radhës, fjalën ia jap deputetit Haxhi Abdylit.

HAXHI ABDYLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Është për të të ardhur keq që sot ne duhet të diskutojmë për veprimet e një zëvendëskryeministri dhe një ministri për Diasporë dhe Investime Strategjike, për veprimet e tij, por edhe për shembullin që po e përçon te gjeneratat e reja, te qytetarët e Kosovës, por e përçon edhe pamjen e shtetit tonë të Kosovës, sepse ky është një zyrtar i lartë i shtetit dhe në këtë drejtim veçanërisht kur ky e udhëheq sektorin e investimeve strategjike.

Është e vërtetë që ne kemi shumë tema, por ne duhet t'i ngremë këto tema dhe e inkurajoj edhe Qeverinë edhe deputetët që t'i ngremë edhe temat tjera, dhe mendoj që ndoshta është një mbivlerësim për këtë zëvendëskryeministër, që ne sot të bëjmë interpelancë për të, sepse ky edhe nuk ka ndonjë bazë, as elektorale, as të votave, edhe pse e mban diku 10% të pushtetit në këtë Qeveri.

Mendoj se më e rëndë se gjuajtja e zëvendëskryeministrit Dardan Gashi, është mbrojtja që po i bëhet këtij zëvendëskryeministri. Kjo është gjuajtja më e rëndë. Kur kryeministri e arsyeton, e mbron, në të njëjtën kohë e përlligj në shekullin 21, atëherë këtë e shoh si gjuajtje më të rëndë, sepse jemi duke jetuar në shekullin 21 dhe ne më shumë po i japim përparësi kodit të kanunit e traditave, sesa Kodit Penal dhe kjo nuk duhet arsyetuar. Ne duhet t'i ndërrojmë ato tradita të këqija. Çka është më e keqja ne nuk po arrijmë as ta qortojmë, ne nuk po arrijmë as ta dënojmë, dhe po flasim edhe për veprimet juridike. OK, veprimet janë aktuale, por janë edhe veprimet politike, kur një zyrtar i lartë e bën një shkelje dhe shkarkohet. Pse të mos shkarkohet?

Çfarë hipotekash ka ky njeri që të mos shkarkohet, kur ne e patëm shembullin para ca ditëve që u shkarkuan dy zëvendësministra. Dy zëvendësministra të komuniteteve, të cilët e njohën këtë shtet, njëri që foli në gjuhën shqipe në Qeveri dhe e përmendi Republikën e Kosovës u shkarkua, zoti Berzati. U shkarkua edhe Numan Baliq, një zëvendësministër, i cili është shembull i bashkëpunimit të pakicave me komunitetin shumicë, i cili e ka dhënë një kontribut edhe në vitet '90-ta për njohjen e shtetit të Kosovës dhe për lirinë e Kosovës. Ai u shkarkua dhe nuk po kemi guxim që ne ta shkarkojmë një zëvendëskryeministër për një shkelje dhe t'i japim shans edhe aspektit juridik, por janë edhe veprimet politike të cilat duhet t'i ndërmarrë një kryeministër, kur një zyrtar apo vartës i tij bën shkelje.

U tha këtu që të garantojë që ndoshta dikush nga LDK-ja nuk ka gjuajtur. Unë nuk kam parë, as nuk kam dëgjuar që ndonjë zyrtar i lartë, që ka qenë në pushtet, ka gjuajtur ose ka bërë ndonjë shkelje. Normalisht, atëherë do të ishim ne që do të duhej të kërkonim të shkarkohej ai. U tha nga udhëheqësi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Memli Krasniqi, që bëjmë shkelje edhe me makinë 200 km në orë, vozitim. Po bacë, po atëherë e marrim dënimin, ai është dënimi i policit dhe e paguajmë atë dënim dhe ajo nuk duhet të arsyetohet. Nëse ne vozitim dhe nuk dënohemi ,ajo është diçka tjetër, por nëse zihemi, dënohemi. Dhe, në këtë rast, zëvendëskryeministri i Kosovës është zënë në vepër, është zënë me fotografi duke gjuajtur dhe duhet ta marrë dënimin si politik, si juridik. Kjo është çështja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po e shqyrtojmë një temë, realisht një interpelancë të ngrehur nga Lidhja Demokratike për informimin e kryeministrit lidhur me gjuajtjen me armë të zëvendëskryeministrit Gashi. Realisht, ne për këtë çështje jemi informuar nëpërmjet medieve, e kemi parë edhe videon e tjera, megjithatë konsideroj se shkelja e ligjit është e dënueshme, pavarësisht nga kush bëhet, qytetarët apo zyrtarët e lartë të shtetit, aq më shumë kur kemi të bëjmë me rastin e një zyrtari të lartë, siç është zoti Gashi, zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës, konsideroj se është një shembull jo i mirë për qytetarët, e në veçanti për rininë.

Ne si deputetë nuk jemi këtu për të interferuar në organet e drejtësisë, e as për t'i mbrojtur veprimet e zotit Gashi, pavarësisht nëse janë në traditën tonë, zakonet tona. Nëse janë në shkelje të ligjit, ne e dimë që edhe në këtë vend pushtetet janë të ndara, e kemi pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe Gjyqësorin, dhe nuk është mirë në këtë fazë të përzihemi, derisa zoti ministër i Punëve të Brendshme theksoi se e kanë proceduar në organet e Policisë rastin në Prokurori dhe ajo është kompetente që ta çojë më tutje, e Gjykata është ajo që e merr vendimin dhe mendoj se ndoshta ne për këtë çështje është dashur të bisedojmë pasi ta kemi një vendim nga organet e drejtësisë.

Kemi shumë tema që i preokupojnë qytetarët tanë, nga ato sociale deri pak më herët, u tha nga një mik që kemi raste ndoshta në shkolla, kur kanë qenë temperaturat shumë të ulëta ku nxënësit tonë mësojnë. Ndoshta më mirë t'i ngremë disa çështje që ndikojnë direkt në cilësinë e jetës, apo të zhvillimit të vendit. Në të njëjtën kohë, nuk është mirë ne që të shikojmë në emër të viktimave që kanë rënë si pasojë e gjuajtjeve me armë në vendin tonë, të gjuajtjeve të paautorizuara, apo tragjediave që u kanë ndodhur familjeve tona për shkak të pakujdesive apo shkeljeve të tilla ligjore nëpër ahengje të ndryshme, apo në festa të ndryshme. Nuk është mirë ne si deputetë të këtij vendi të shikojmë në tragjedinë e dikujt e të fitojmë poenë politikë. Asnjëri këtu nuk e tha

që është një veprim i ligjshëm, por në të njëjtën kohë të mos shikojmë të përfitojmë në veprimin që e ka bërë tash zëvendëskryeministri.

U tha këtu nga disa deputetë, që realisht po të kishte gjuajtur Ramushi ndoshta s' do të kishte bërë interpelancë, se ka gjuajtur edhe kur ka qenë koha, por i ka befasuar Dardani, megjithëse edhe Dardani nuk ka gjuajtur prej vendit, u çua doli në dritare, prandaj konsideroj që Prokuroria ia merr si rrethanë lehtësuese. Andaj, kërkuj nga kolegët deputetë që të merremi me punët që na takojnë të merremi, t'i dënojmë si raste, por këto raste nuk i gjykojmë ne, por i gjykojnë organet e drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryesues!

Kur po flasim për nevojën e interpelancës sot, edhe unë po them se ndoshta vërtet s'ka pasur nevojë të thirret interpelanca, por në momentin kur është bërë publike videoja ku zëvendëskryeministri dhe ministri gjuan me armë, ai të paktën që është dashur ta bëjë është të jepte dorëheqjen, edhe si akt moral, edhe si përgjegjësi publike para qytetarëve të Republikës dhe do të na kursente nga ky debat sot.

Por, që dikush të thotë që nuk ka temë për debat, jua rikujtoj që po flasim për një dukuri tejet shqetësuese që po ndodh dhe të mos them që përditë, por në baza periodike po merr jetën e qytetarëve tanë. Këtu tash deputeti para meje tha si rrethanë lehtësuese t'ia marrim se zëvendëskryeministri paska gjuajtur jashtë, e nuk e ka rrezikuar rrethin aty që ishin me të, paska gjuajtur jashtë. A është rrethanë lehtësuese që ka gjuajtur jashtë dhe ka mundur ta qëllojë dikë tjetër aty, ndërsa i paska kursyer ata persona që paskan qenë në dhomë.

Ajo që është shumë shqetësuese sot në këtë debat është tendenca që të minimizohet përgjegjësia politike e një zyrtari të lartë shtetëror. Nuk bëhet fjalë këtu për një individ që quhet Dardan Gashi, por ne po flasim për një zëvendëskryeministër të Republikës së Kosovës, mesazhin që e përçon kjo Qeveri dhe ky Kuvend kur e fton në përgjegjësi. Tendenca që të barazohet me çdo qytetar tjetër të Republikës së Kosovës nuk mund të qëndrojë. Po jap vetëm një shembull të thjeshtë. Kur u rritën pagat e zyrtarëve të lartë, u tha se kanë përgjegjësi të larta dhe duhet t'u rriten pagat 100-200%. Ndërsa, qytetarëve të tjerë, që nuk kanë edhe aq përgjegjësi, pagat do t'u rriten për 4%. Vetëm një shembull, kur kjo Qeveri thirret në përgjegjësitë dhe detyrat që duhet t'i kryejë. Por, kur kryhen vepra - shkelje e Kodit Penal të legjislacionit në fuqi, atëherë tendencat janë që të barazohet me çdo qytetar që nuk bart përgjegjësi publike dhe politike.

Kjo lëndë po thuhet se është në Prokurori. Duke e ditur që Gjyqësorin e kapur dhe të gjitha institucionet tjera, ne e dimë epilogun e këtij rasti. Ne nuk presim që ky zëvendëskryeministër do të marrë dhe do të gjykohet bazuar në veprën që e ka kryer, por çka t'u themi atyre qindra mijëra

eurove që i ka derdhur kjo Qeveri dhe qeveritë e kaluara për fushatat vetëdijesuese që të mos gjuhët me armë në ahengje dhe tubime tjera, sepse kjo ka për pasojë vdekje të qytetarëve nga plumba qorr, dhe unë si mjeke, jo një herë, por shumë herë, kam pasur rast të jem në praninë e viktimave dhe të jem aty ku i kanë parë viktimat e plumbave qorr, dhe assesi nuk kam mundur që sot të kursehem dhe të mos marr pjesë në këtë debat.

Vërtet u tha edhe këtu që tendenca që të minimizohet dhe arsyetohet rasti në fjalë është shumë më e rëndësishme sesa vetë akti që është kryer. Meqenëse, fatmirësisht, nuk kemi viktimë, kjo assesi nuk mund ta arsyetojë zyrtarin e lartë të Qeverisë dhe mesazhin që është përçarë nga ky akt. Edhe një herë po them, në momentin kur është bërë videoja publike, më e pakta që zëvendëskryeministri është dashur ta bëjë është që të dorëhiqet vetë dhe kështu të japë përgjegjësi morale e etike para qytetarëve dhe ta japë shembullin më të mirë dhe pas aktit të dorëheqjes, edhe unë pajtohem, siç tha edhe zoti Zenuni këtu, mund të marrë pjesë pastaj në fushata vetëdijesuese, pasi vetë kërkoi falje për aktin që e ka kryer, në fushata vetëdijesuese pastaj, dhe t'i përkrahë fushatat e Qeverisë pastaj kundër përdorimit të armëve, se, tek e fundit, lërimi traditat, kthejuni legjislacionit në fuqi, kthejuni Kodit Penal. Ju lus, nëse Qeveria dhe zyrtarë të lartë, duke përfshirë edhe deputetët, që këtu u tha, paska edhe deputetë që gjuajnë, secili që kryen akte të tilla duhet të përgjigjet konform veprës që bën.

Prandaj, unë e përkrah mocionin e Lidhjes Demokratike sot, meqenëse zëvendëskryeministri nuk dha dorëheqje vetë, atëherë besoj që është përgjegjësi e kryeministrit që ta shkarkojë, sepse e ka bërë një vepër të papranueshme konform postit politik që ushtron dhe mesazhit që e përçon te qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka kërkuar deputeti Hajdar Beqaj. Urdhëroni!

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Ndoshta kolegja deputete nga "Vetëvendosje" ka keqkuptuar, zonja Kollçaku. Unë nuk thashë që ne të bëjmë këtu rrethana lehtësuese, thashë se ne nuk jemi këtu... dhe është mirë ne në Parlament t'i lëmë linçimet dhe gjykimet. S'jemi këtu as për të gjykuar, as për të linçuar, ne të gjithë po themi se gjuajtja me armë është shkelje ligjore. Nuk kemi interferim te gjobat që i bëjnë gjykatat. Ne e dimë, ato i bëjnë në bazë të Kodit Penal. Ndoshta ka qenë arma me gaz, ka qenë pa gaz, ka pasur... e të tjera, e tjera... merren shumë rrethana, por nuk e thashë atë që e thatë ju, se nuk jemi këtu ne për të dënuar, as për të linçuar, as për të gjykuar.

Ne thamë që çdo shkelje ligjore, pavarësisht nga kush bëhet, është shkelje ligjore dhe nuk është për t'u mbështetur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, replikë! Zonja Famire Kollçaku, urdhëroni!

FATMIRE KOLLÇAKU: I nderuar deputet!

Ashtu siç e ke thënë, edhe unë e kam përsëritur. Ju thatë, mund t'i merret si rrethanë lehtësuese fakti që zëvendëskryeministri qenka çuar në këmbë dhe ka gjuajtur me armë jashtë dhomës, e unë thashë si mund të merret ajo si rrethanë lehtësuese, nëse nuk i ka rrezikuar kolegët e vetë që i ka pasur përreth, në momentin kur ka gjuajtur jashtë ai e ka rrezikuar dikë tjetër jashtë, dhe ajo fare nuk mund të merret si rrethanë lehtësuese. Këtë e ke thënë, s'ka nevojë të komentojmë më tepër.

KRYESUESI: Hajdar Beqa, urdhëro! Një sqarim, Hajdar, më fal!

Grupi Parlamentar i PDK-së, secili i ka minutat e vet dhe këta e vendosin vetë se si do t'i përdorin. Urdhëro!

HAJDAR BEQA: Nuk është mirë të keqinterpretohen, deputete, këto që i thamë ne, se prapë po ta përsëris, nuk je ti as unë këtu për të gjykuar, as për të linçuar. Është gjykata, janë prokuroritë, ua lëmë punën organeve përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë e doni fjalën? Fatmire Kollçaku, urdhëro!

FATMIRE KOLLÇAKU: Është video-incizimi, është transkripti, të gjitha çka ka thënë janë, kështu që u krye.

KRYESUESI: Prapë Hajdari!

HAJDAR BEQA: Deputete, mund të shkosh në Gjykatë kur të mbahet seanca, të dëshmosh atje dhe të bëhesh ndonjë dëshmitare, nuk jemi, prapë po them, për të bërë gjykimin këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë sipas radhës së paraqitjes së deputetëve. Fjalën e ka deputeti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,

Kryesues i nderuar,

Kolegë të nderuar,

U përmend këtu që kemi shumë punë më të mençura si Kuvend për t'i trajtuar sesa kjo dhe, me sa di unë, sipas nenit 65, pika 9 e Kushtetutës, mbikëqyrja e Qeverisë është pikërisht një prej punëve që i kemi dhe fatkeqësisht po na bie ta mbikëqyrim Qeverinë se a po e shkel Kodin penal. Do të thotë është baza më elementare, se të gjithë ne këtu më me dëshirë do të flisnim për të arriturat e Qeverisë apo për zbatimin e planit qeverisës, se sa për këtë nivel minimal të përgjegjësisë.

Por, sido qoftë, po filloj të trajtoj pikën e rendit të ditës me një rast, i cili para disa viteve më pati ardhur një vajzë e re nga diaspora, e cila gjatë vizitave verore kishte shtënë në ajër me një armë gazi dhe natyrisht, reagimi i policisë, i organeve të rendit, siç është i shpejtë për qytetarët tanë, menjëherë kishin filluar hetimet dhe i ishte ngritur aktakuzë.

Ajo frikësohej tani se kur të kthehet në Angli nuk do të mund të studionte drejtësinë. Po flasim për një mentalitet të një shoqërie, ku i cenohet një personi edhe studimi i drejtësisë nëse ata kanë kryer një vepër penale, jo në Angli, po kudo në botë. Do të thotë, po flasim për kësi mentaliteti dhe a e kemi ne atë mentalitet?

Në fakt, atë mentalitet si mund ta kemi kur kryeministri i vendit ngrihet edhe fol për dakordancë për të kryer vepër penale.

Unë në atë video incizim që e kam parë, nuk kam parë askund që me ngritje dore kanë votuar kush është për, kush kundër, kush abstenon. Po mbi të gjitha nuk mund të ketë dakordancë për ta shkelur Kodin penal.

Ministri i Punëve të Brendshme flet për dy armë të konfiskuara, por kushdo që e ka parë atë video-incizim, e sheh qartë që janë më shumë se dy armë që përdoren.

Flitet për traditën si arsyetim për ta shkelur Kodin penal, traditë e kemi pasur edhe vëllavrasjen si hakmarrje, por po mundohemi ta heqim, se nuk jemi në Mesjetë, edhe trajtimin e gruas në nivel të pabarabartë, po edhe atë po mundohemi ta kurojmë. Dhe, tradita në një mentalitet të shëndoshë nuk mund të përdoret për t'i shkelur ligjet, të cilat vetë ky Parlament i ka sjellë.

Ne e kemi një mentalitet krejt ndryshme nga ai që duhet të mbizotërojë. Kemi një mentalitet, ku ligji është rekomandim, ecni nja 10 hapa mbrapa kësaj salle, e shihni sa po zbatohet Ligji për kontrollin e duhanit. Vetë këta deputetë që e kanë miratuar atë ligj, e shkelin me dy këmbët dhe në hapësirë publike pinë duhan. E tash shtrohet pyetja? Ne si mbajtës të posteve publike, pavarësisht cilës parti, pavarësisht cilit organ i takojmë, a duhet të merremi në përgjegjësinë minimale, kur themi se është në rregull ta mbani atë postë, veç mos kryej ndonjë vepër penale, mos u gjej i fajshëm dhe në rregull është. A po duhet ta krijojmë një përgjegjësi më të lartë. Një përgjegjësi, ku ne udhëheqim me vepra, e jo me fjalë, jo si ajo meseleja që thotë “bën çka them, e jo çka bëj”. Jo. Ne duhet të udhëheqim me atë që bëjmë.

Niveli i përgjegjësisë nuk mund të jetë ai minimali për të gjithë ne që jemi mbajtës të posteve publike. Niveli i përgjegjësisë duhet të jetë shumë më i lartë, duhet të tregojmë njëfarë etike politike, njëfarë etike qeverisëse që është shumë më e lartë se sa ai minimal i kryerjes së veprës penale.

Nuk dua ta zgjas shumë, po përderisa ne e konsiderojmë ligjin sugjerim, po flas për neve si mbajtës të posteve publike, ne nuk kurrë do të mund ta kthjellim këtë vend, nuk mundemi dhe nuk kemi fytyrë as të kërkojmë prej qytetarëve që t'i zbatojnë rregullat që ne i përcaktojmë. Më falni, kur është e drejtë që vendi të bëhet vend që mbizotërohet nga i forti, e jo nga ligji. Nëse ne e dëshirojmë këtë vend të jetë vend i ligjeve, ku mbizotëron ligji, atëherë ju lutem, të gjithë ne të sillemi në atë mënyrë edhe t'i respektojmë, pavarësisht a na konvenojnë a jo, a na ka nxehur pak rakia në një tubim a jo, a na kanë nxehur shahirët që u përmend më herët, shahirët me sharkia e me çiftelia.

Kështu që ju lutem, sillni ashtu si e meritoni, e meriton respektin, postin të cilin e mbani dhe të përçojmë një mesazh të qartë për qytetarët tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Po më duket dikush paska dashur të ma ndalë mikrofonin. Desha t' ju falënderoj, edhe grupit që e ka bërë këtë kallëzim penal për Kuvendin e Kosovës.

Mendoj që sot e kemi shndërruar Kuvendin në një gjykatë për t'i gjykuar ata që thirren në sistemin ligjor. Na akuzuan që e prishim mazhin, rrezikimin e qytetarëve, skenën me karakter kriminal, e tjerë, e tjerë.

Mendoj që ata që thirrin këtë kanë votuar për krijimin e sistemit të drejtësisë dhe e kemi lënë që sistemi i drejtësisë të merret me çështje të caktuara.

Dhe, ky rast është në procedurë të drejtësisë dhe besoj që ata do ta japin mendimin e tyre për një shkelje apo mosshkelje.

T'i kthehemi burimit të traditës sonë. Mendoj që shumë nga ne nuk kanë ardhur nga shtetet e tjera të jetojnë në Kosovë këtu, e nuk janë shtetas të huaj, në vendin e tyre. Po nëse janë këtu dhe kanë jetuar këtu, besoj që janë rritur me traditat tona, me kulturën tonë, mentalitetin tonë, me gjuhën tonë.

Gjuha jonë, edhe e kulturës, edhe e letërsisë, edhe e atyre që e kanë nënshkruar këtë është që të jetojmë me tradita tona, të punojmë me ato që e zhvillojnë vendin tonë dhe me ato që e shtyjnë përpara një proces të zhvillimit. Po në traditën tonë besoj që janë edhe festat, edhe gëzimet, edhe urimet, po një nga ato është, për shembull, edhe gjuajtja me armë.

Nuk besoj që prej këtyre deputetëve në familjet e tyre nuk është gjuajtur asnjëherë, ose shumica prej tyre kanë gjuajtur vetë në gëzimet e tyre, dikush ka gjuajtur kur i ka lindur djali, vajza, dikush kur është martuar, ka edhe të pamartuar ndoshta, po megjithatë. Megjithatë, të gjitha këto

janë bërë edhe nga një traditë që ne e kemi, e kemi trashëguar, dikush thotë e mirë, dikush e keqe, po megjithatë gjithë kjo është ajo forma e lirisë së besimit të largimi i shpirtave të ligj nga shtëpia.

Tash, për t'i larguar shpirtrat e ligj që e kanë rrethuar shtëpinë kur i ka lindur djalë a vajzë, është gëzuar, sigurisht se ka gjuajtur me armë për t' i larguar, sepse ata largohen prej shtëpisë. Kështu që është e mirë kjo të studiohet dhe të analizohet.

Besoj që në gëzimin e familjes që kanë marrë pjesë këta atje, ka qenë një gëzim i madh, një përpjekje 10-vjeçare e torturave shpirtërore familjare, e gjithë, e gjithë, pikërisht edhe ajo gjuajti ka qenë pikërisht për t' i larguar shpirtrat e ligj nga ajo familje dhe të ecë përpara në zhvillimin e saj.

Unë mendoj që ka bërë një hap pozitiv kur ka dalë atje dhe ka gjuajtur, e ka treguar një kulturë prapë, edhe kjo është kulturë të mos gjuhët brenda, në ambientet e mbyllura, sikurse kemi raste kur në Ratkoc kallet shtëpia e ministrit të Financave atë kohë, pikërisht nga gëzimi e gazmendi, e tjerë, e tjerë.

Po megjithatë, edhe komunikacioni që e përmendi shefi i grupit, që vozisin shpejt, besoj që ndërjegjësimi është dënimi brenda vetes, jo vetëm a më zuri polici apo nuk më zuri.

Një nga kolegët tha se në komunikacion kemi vozitur deri në 200 km h, po nuk na ka zënë policia, domethënë nuk kemi bërë shkelje penale. Po, këtë që nuk më ka zënë polici, nuk është vepër, ndërsa ndërjegjësimi, ajo është, nëse janë të ndërjegjëshëm të gjithë ata që kanë nënshkruar dhe asnjëherë nuk kanë bërë një vepër të tillë penale, besoj që ky gjykim e meriton në Kuvend, po të gjithë ata që kanë bërë, ose gjithë ata që e kanë nënshkruar edhe kanë folur, besoj që familjet e tyre janë gëzuar atëherë kur kanë lindur këta edhe kanë gjuajtur me armë pikërisht për t' i larguar shpirtrat e ligj e t kanë thanë “e paçi rrugën e mbarë, u trashëgofshi, u rritshi e u bëfshi të mëdhenj”, pikërisht për të ardhur nëpër Kuvend e për t'u bërë ministra, zëvendësministra, zëvendëskryeministra, deputetë, e tjerë, e tjerë, sepse ky ka qenë ai gëzimi i tyre, i familjeve të tyre.

Edhe në ato këngët e moçme nëpër djepa: “Nina nëna në djep të drurit ti m'u bëfsh plak i katundit”. Kjo është ajo thënie që janë gëzuar njerëzit, janë arsyetuar dhe i kemi larguar shpirtrat e ligj.

Lufta jonë ka qenë t' i largojmë shpirtrat e ligj prej Kosovës, edhe kjo është një nga ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hasani! Vërtet nga ky pozicion nuk më lejohet të komentoj, po edhe po të doja, moralizimet është e pamundur t'i komentosh, por do të them që kur ke parasysh profilin ideologjik të Naitit, ky si fjalim m'u duk i jashtëzakonshëm, se nuk takohen në asnjë pikë. Nëse nuk po e kërkon fjalën për replikë, i jap fjalën deputetes Time Kadrijaj. Urdhëroni!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Zëvendësministrit po dua t'i them që edhe të gjykuar, edhe të dënuar, nuk na ka mbetur tjetër veç të thirret policia e të të prangosë, e të të dërgojnë drejt në burg, sepse sot vërtet këtu nuk jemi në Kuvend, po jemi në një gjykatore, ku secili dënuam, gjykuam, tash nuk na ka mbetur veç edhe ne si deputetë, pasi i paskemi këto kompetenca, të na çojnë në burg.

Sot më shumë në këtë seancë të Kuvendit e patëm një teatër, herë kemi qeshur, unë i kuptoj Glaukun, "Vetëvendosjen", se kanë pasur nevojë për relaks edhe të qeshin, e mirë na bëri të qeshim edhe neve, e herë kemi vajtuar duke i përsëritur raste të tjera, edhe shumë raste që kanë ndodhur, që është një fatkeqësi, sepse i lënduam ato familje duke i përmendur me emra. Ato raste kanë ndodhur kohë pas kohe, janë gjykuar dhe është shumë keq që familjet e tyre sot, me një rast, me një interpelancë që u thirrur për një çështje krejt tjetër, është e padrejtë që ne t'i lëndojmë në vazhdimësi. Bile, bile, edhe rrejtëm duke i shtrembëruar deklaratat e kryeministrit, sepse kryeministri saktë e tha se gjykohet si rast, por rasti është në prokurori, rasti është në gjyqësi dhe ne duhet pritur një vendim dhe më pas të kërkojmë ndonjë shpjegim ose ndonjë veprim të kryeministrit, ndërsa disa deputetë të tjerë thanë që kryeministri e arsyetoi, që nuk është e vërtetë se e arsyetoi.

Më së pakti sot u debatua për atë çka u kërkuar. Vërtet ne po kërkojmë të respektohet gjyqësia, e ne në fakt sot çka po bëjmë, po e shkelim këtë gjyqësi e këtë drejtësi, sepse nuk po i lëmë organet kompetente të merren me këtë çështje, sepse vetë po merremi me to dhe po përzihemi në kompetencat e drejtësisë dhe gjyqësisë.

Nëse vërtet duam ndonjë debat ose interpelancë, duhet pasur materie për një debat apo një interpelancë dhe është shumë fatkeqësi se pa materie po kërkojmë disa çështje që vërtet nuk janë në kompetencat tona dhe po dalim qesharakë. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Slavko Simiq.)

KRYESUESI: Zahvaljujem kolegnice! Za reč se javio u ime Parlamentarne grupe "Nisma" gospodin Enver Hoti. Gospodin Enver Hoti imate na raspolaganje još 29 sekundi za govor. Hvala!

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Shpresoj që më japim këta kolegë këtu të Aleancës ose PDK-ja pak, nja një minutë, ose Vetoni, që vetoni me vullnet. Faleminderit! Faleminderit, Veton!

Ndaj mendimin e shumë kolegëve këtu që sigurisht kjo interpelancë nuk është dashur të ndodhë, ka mundur të ishte një debat, me që ka këmbëngulur kaq shumë LDK-ja që e ka marrë një rol në këtë rast të ndërtojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala, molim režiju da dajë reč gospodinu Vetonu Berišu. Ispred poslanika koji nema parlamentarnu grupu. Hvala!

ENVER HOTI: Faleminderit!

Ne e dëgjuam edhe kryeministrin, mendoj se është mirë që t'iu kishim referuar, se ai na e dha një informacion se gjendja është në organet kompetente, ka ndodhur aty një rast jo i mirë, jo i hijshëm, po është përdorur një armë me gaz dhe nuk mund të ndërtohet një skenarë çfarë ka paraqitur në këtë dokument LDK-ja, duke i dhënë një karakter kriminal, duke e shfaqur si tentativë për të kapur shtetin, si tentativë për t'i frikuar qytetarët, kjo nuk ka ndodhur.

Megjithatë, ne prapë po e shohim se një grup politik nuk mund të dalë jashtë rolit të vet për të ndërtuar skenar nga hiqi.

Unë e falënderoj zotin Hasani që na dha një informacion se është djegur një shtëpi diku e një ministri, sigurisht edhe ai do të shërbejë ndoshta për të ndërtuar ndonjë skenar tjetër, sepse ka dikush role të tilla që mund të ndërtojë skenarë të tillë, por ne mendojmë dhe jam i bindur se të gjithë jemi të arsyeshëm dhe t'i ngremë çështjet dhe t'i ndajmë shqetësimet aq sa kanë peshë dhe të mos tentojmë t'u japim motive të ndryshme, orientime të ndryshme apo të dalim dhe ta traumatizojmë qytetarin.

U tha këtu, u shfaqën edhe aktorë të tjerë, të cilët deshën të bëjnë edhe aktrime, por mendoj se situata tani ka marrë drejtimin e vet, është para organeve dhe ato organe duhet ta japin fjalën e vet, asgjë tjetër dhe asnjë peshë tjetër nuk është mirë që të jepet.

Po, edhe një herë dua ta përsëris se LDK-ja është mirë të dalë jashtë atij roli të ndërtimeve të skenarëve nga hiqi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvndit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Rexhep Selimi. Urdhëroni!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Jo pse kam ndonjë problem me thirrjen e kësaj interpelance, por ndoshta bashkë shumë shpejt mund të ilustrojmë nja pesë probleme që janë shumë më të mëdha në Kosovë dhe, rrjedhimisht i bie që ndonëse kjo çka ne po trajtojmë është goxha problem dhe problem e bëri ndoshta jo vetë ngjarja, po publikimi i ngjarjes, po gjithsesi është jashtë pesë problemeve më të mëdha që ka Kosova. Po mirë, ne po i diskutojmë dhe do t'i diskutojmë sepse shumë probleme më të mëdha janë problemet që i kemi në shëndetësi, infrastrukturë, pastaj edhe në lëmenj të tjerë, pastaj në papunësi, pastaj edhe situata e përgjithshme e sigurisë, shumë më alarmante është situata e sigurisë jashtë asaj ode, se sa në atë odë. Kemi të gjitha ato armë në duar jo të duhura, në grupe të caktuara, e tjera, e tjera.

Kështu që këtë që e thashë nuk do të thotë se nuk duhet të flasim për këtë temë dhe kjo nuk e amnistion Dardanin, e askënd tjetër, pra ajo çka ka ndodhur nuk po e dëgjoj që dikush thotë që mirë, bravo, të lumtë pushka, Dardan, nuk po thonë.

Por, unë ndoshta nuk e prisni nga unë, por unë nuk pres që Dardani do të shkarkohet nga kjo interpelancë, jo. Sepse sikur të shkarkoheshin njerëzit kështu, atëherë do të duhej të shkarkohej para Dardan Gashit, Rikalo, i cili jo vetëm që ka gjuajtur përpjetë, po ka gjuajtur edhe drejt ndoshta, e së paku, sipas dëshmive të qytetarëve të Republikës së Kosovës, ai nuk është që vetëm ka gjuajtur përpjetë, po edhe ka lënduar qytetarë, të cilët kanë dhënë dëshmitë e tyre e vazhdojnë të japin prapë. Pra përderisa nuk është shkarkuar Rikalo, nuk pres që do të shkarkohet Dardan Gashi.

Por, edhe për një arsye tjetër nuk pres që Dardan Gashi do të jetë në top listën e të shkarkuarve, as ndoshta nuk do të duhej të ishte para se të shkarkoheshin edhe të tjerë persona që mbajnë përgjegjësi publike dhe zyrtare, për shembull, para se të shkarkoheshin ose të suspendoheshin oficerë me nivele të larta në polici, të cilët rrahin njerëz rrugëve, para se të shkarkoheshin po ashtu në polici njerëz, të cilët dalin duke numëruar qindra-mijëra euro në video.

Kështu që, për fat të keq, nuk jam shumë pesimist që ky shkarkim do të ndodh, përveçse ne do ta ndajmë këtë edhe me publikun dhe paramendojeni sikur dikush të mos e regjistronte këtë video, ne nuk do ta kishim asnjëherë këtë temë në Parlament. Por, çka mund të bëjë Parlamenti? Çka mund të bëjmë ne tash? Duke mos e amnistuar askënd, secili mund të kontribuojmë për ta krijuar një ambient më të sigurt për të gjithë, duke krijuar nga këto ngjarje edhe ligje të caktuara që e rregullojnë këtë çështje. Duke e dhënë kontributin tonë secili që institucionet e autorizuar shtetërore të sigurisë të jenë të vetmit të autorizuar për mbajtje armësh dhe, po ashtu, që armët me leje të jenë në përputhje me ligjet, pra të mos ketë armë pa leje.

Dhe, në fund, duke i dhënë mundësi edhe Dardanit, në përputhje me ligjin, të shkojë në poligon që të shkarkohet duke gjuajtur, kjo lejohet edhe me Ligjin për armët. Ka poligone të

mjaftueshme, seriozisht të mira, jo pse shumë kush prej neve s'kemi qejf, por tash kemi ligj, ka Ligj për armët, ka poligone sa të duash, ka municion sa të duash, ka masa mbrojtëse dhe do të ishte krejt normale sikur të ndodhte kjo.

Kështu që, ndoshta nuk ka sharkia, qysh po thotë aty, por nuk dua që ta kthejmë tash, por sa i përket traditës, të mos thirremi shumë në traditë, sepse nuk është edhe aq në përputhje me traditën shqiptare gjuajtja në ajër dhe në ambiente të tilla, bile-bile nëse thirremi në traditë, tradita e do që kur të shkosh në kullën e tjetrit arma të varet në gozhdë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje për të gjithë kolegët deputetë dhe të tjerët që po e ndjekin këtë interpelancë, e cila me të vërtetë besoj se është e domosdoshme për faktin që gjatë gjithë kohës sot këtu po synohen të minimizohet.

Fakti është se në vend se ne ta thërrasim zëvendëskryeministrin dhe ministrin Gashi në interpelancë për strategjinë e tij për ngritjen e investimeve strategjike, ne e thërrasim zëvendëskryeministrin dhe ministrin në interpelancë për të treguar për një akt, ose për t'i dëshmuar se ai akt i cili domosdo duhej të pasonte me dorëheqjen e tij tash është në debat te deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës. Çfarë u prezantua këtu në shumicë prej deputetëve të pozitës, është tendenca që rasti të prezantohet si rast i rregullt, e jo përjashtim i rastit. Në fakt, shumë vendime të Qeverisë Haradinaj janë vendime të jashtëligjshme, ose janë përjashtime të rastit të qeverive normale. Por, është ky akt i zëvendëskryeministrit, i cili mund të replikohet te secili qytetar i Republikës së Kosovës.

Përderisa qytetarët e Republikës së Kosovës nuk e kanë forcën, ose nuk e kanë mundësinë që vetes t'ia rritin rrogën për 100%, ose të merren me sjellje tjera veç pse u teket pa bazë ligjore, shumë qytetarë të Republikës së Kosovës, duke filluar prej moshës 13 dhe 14-vjeçare mund të kenë qasje në armë dhe mund të gjuajnë qoftë vertikalisht, qoftë horizontalisht, qoftë ata që ndoshta ua kanë dhënë vetëm një koment pa lidhje në Facebook.

Po synohet të minimizohet një problem, i cili sot në botën e civilizuar, jo që merr debate parlamentare, por merr diskutime shumë të gjera shoqërore dhe të cilat e rrezikojnë jetën e qytetarëve të pafajshëm. Nuk është ky debat jashtë kontekstit të sigurisë së përgjithshme në Kosovë, është esenca e sigurisë dhe e lëvizjes së secilit qytetar të Kosovës. Ministri i Brendshëm u mundua gjithashtu ta zbusë dhe ta minimizojë duke treguar se ndoshta u përdorën folklorizma. Folklorizëm është ajo qasje e ministrit. Le të na tregojë ministri si mund ta arsyetojë, për shembull një lajm. "Më 4 janar 2018, gjuan me armë zjarri arrestohet". Policia e Kosovës e ka arrestuar një person nën dyshimin se i njëjti ka shtënë me armë zjarri në ajër. "Gjatë kontrollit, te

i njëjti është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë, me vendim të prokurorit i dyshuari, pas intervistimit, është dërguar në mbajtje. E diel, 8 tetor: “Arrestohet pasi gjuan me armë zjarri në aheng”. 23 korrik, “Gjuan me armë zjarri në aheng familjar, arrestohet”. Pse zëvendëskryeministri dhe ministri është përjashtim i rastit prej qytetarëve tjerë?! A mund ministri i Brendshëm të dalë këtu dhe të thotë “unë sot publikisht deklaroj që secili polic i Republikës së Kosovës që has në qytetarë të Republikës së Kosovës që gjuan me armë zjarri, pa marrë parasysh pozitës së tyre, do t’i ndal dhe do t’i dërgoj në mbajtje? A mund këtu ndonjë ministër i Qeverisë, njëjtë sikur ka ndodhur në qeverisjen e kaluar, kur djemtë e shefit të Grupit Parlamentar e godasin policin në rrugë edhe largohen me pasoja ndoshta, të cilat nuk kanë qenë fare që do të ishin për secilin qytetar të thjeshtë të Republikës së Kosovës?

E mira e këtij debati parlamentar është se pas këtij debati ne do t’i kemi lajmet e mbushura dhe videot e gjuajtjes së zëvendëskryeministrit dhe të të tjerëve në aheng dhe secili investitor potencial që kërkon në internet emrin e zëvendëskryeministrit do t’i gjejë vjegëzat e lajmeve, të cilat e sjellin edhe aktin që e ka bërë zëvendëskryeministri, por gjithashtu edhe pamjet nga ai aheng. Kolegut, ish-kolegut Gashi i them se kam pritur që ndoshta me ngritjen e tij akademike, intelektuale ose profesionale, të mund të sjellë risi të atij niveli në qeverisje dhe jo të bëjë regres në atë qeverisje. Se ajo çfarë i ndodhi më e pakta nuk është kërkim-falja, është dorëheqja e menjëhershme, për arsye se janë akte që sot burrështetas të mbarë botës, edhe gra në pozita, ndoshta në incidente shumë më të vogla se kjo, japin dorëheqje, kërkojnë falje dhe në fakt tregojnë se pse u vjen keq për atë se çfarë ka ndodhur.

Kryeministri gjithashtu na ka thënë që është kryeministër i vendimeve të forta. Në fakt, e vetmja forcë që po vjen prej kësaj qeverie është forca fizike, dhe forca që po tregohet me armë. Gjithashtu, po i merr shembull Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur kryeministrit i konvenon personalizimi ose mbajtja afër vetes e njerëzve për të cilët ka interes personal, i përmend standardet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kur ndodh që interesi i krejt Kosovës është në rrezik dhe pasojat do t’i mbajnë gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, kryeministri deklaroi se nuk i dëgjon ambasadorët, qoftë edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por i jep llogari Kuvendit. Ky Kuvend pra e thërret në llogari kryeministrin e vendit, zëvendëskryeministrin dhe Kabinetin qeveritar për të treguar se pse ato standarde, të cilat ata po mundohen t’i lidhin me shtetet e zhvilluara nuk janë standarde, të cilat i aplikojnë.

Përndryshe, për informatën edhe të kryeministrit, pasi kaq shpesh po i përmend Shtetet e Bashkuara të Amerikës në raport me posedim të armëve, posedimi i armëve në secilin shtet nëpër botë është në proporcion me numrin e vrasjeve. Në vendet ku ka përqindje më të madhe të armëve të poseduara, përqindja e vrasjeve nga ato armë është më e madhe. Le ta përmend më mirë kryeministri rastin e Kanadasë, Norvegjisë, Izraelit, vende që e kanë një politikë shumë restriktive të posedimit të armëve, sesa që i përmend Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që është rasti më eklatant i posedimit të armëve të shteteve në botë.

Ajo çfarë neve sot këtu na është prezantuar, na është prezantuar një injorancë e skajshme e gjithë Kabinetit qeveritar në raport me një akt të shëmtuar, i cili nuk është në vete se gjykohet vetëm për aktin, është për pasojat dhe ... që e lë te popullata e Republikës së Kosovës. Ka probleme tjera, ka gjithsesi, por ai problem në momentin kur rrezikohen fëmijët në shkolla, kur rrezikohen njerëzit e thjeshtë në ahengje familjare, kur rrezikohet liria e secilit qytetar të Kosovës është për t'u bërë debat në Parlamentin e Kosovës, është për t'u marrë dikush në llogari dhe cili është sot kredibiliteti i Policisë së Kosovës të shkojë në ahengje familjare, të arrestojë njerëz në bazë të pamjeve që publikohen me arsyetimin se tash kjo është e dënuar me ligj, kur secili prej tyre ka të drejtë, e para ta sulmojë policin, e dyta t'i thotë "po vjen të më arrestojë mua, pse s'ke shkuar që t'i arrestosh zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Investimeve Strategjike, se për atë edhe për të tjerët jo vetëm që e kemi parë incizime, por të gjitha janë bërë publike dhe është bërë debat në seancë të Parlamentit".

Nëse jemi duke folur për një shtet totalitar, shtet i cili e ka Qeverinë mbi interesin e secilit, që secili anëtar i Qeverisë mund të amnistohet për të bëmat e veta, atëherë t'u tregojmë njerëzve dhe të themi që sot e kemi për zbatim këto debata, nuk e kemi seriozisht, as sinqerisht. Por, ky debat e ka esencën e vet, boshtin në respektimin e ligjit dhe në sigurinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Dhe, mendoj se si i tillë duhet të trajtohet me seriozitet, me përgjegjësi, dhe jo me diskutime politike, por me diskutime të përgjegjshme dhe të sigurisë kombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Thashë edhe në fillim se epilogun që do ta marrë kjo çështje sot është i kotë, po bëhet bisedë kot, po flasin deputetë kot, them në këtë rast, vetëm për të thënë që pati interpelancë edhe zhvilluam diçka në disa rrethana të jashtëzakonshme.

Po flitet për gjuajte. Është e dënueshme me Kodin Penal, të gjithë e dimë, dhe për të mos e përsëritur, epilogun e gjithë kësaj do ta kthejmë në një aktgjykim. Ne do t'i thërrasim gjyqtarët dhe do t'i gjykojmë ata këtu. Po kemi rast t'i dëgjojmë shumë deputetë lidhur me këtë çështje, bile edhe deri në atë shkallë, edhe parafolësja që është ish-kryetare e Komunës së Gjakovës, për tre vjet rresht është zhvilluar procedurë gjyqësore ndaj një punëtori të Administratës në Komunën e Gjakovës dhe gjykata e ka shpallur të pafajshëm për shkak të halucinacioneve të saj që i ka pasur, që e ka akuzuar se ka thënë një njeri, "dikush është duke dashur të më vrasë".

Ai epilog ka mbërri deri aty që gjykata e ka shpallur të pafajshëm. Edhe sot, thotë për një injorancë të njëanshme, fyerje. Më fyerje është kjo që i thua dikujt injorant apo diçka tjetër, duke e nxjerrë veten shumë të mençur. Në raste të tilla, ose të jashtëzakonshme, për shkak se ne e kuptojmë gjendjen shpirtërore të opozitës në këtë rast, kemi qenë në opozitë edhe vetë. Mirëpo, ky epilog i kësaj interpelance, them që jashtëligjshëm është interpelancë, debat ka mundur që të

zhvillohet, por dihet për çka thirret, e lexuan edhe më herët, por edhe në fillim të seancës e thashë. Por, nuk ka ndodhur në Korenë Veriore një rast, nuk ka gjuajtur kurrkush raketa balistike, as bomba me hidrogjen, po flitet për një armë gazit, raportin e Policisë e lexoi kryeministri në seancë, mirëpo meqenëse i është dhënë kjo e drejtë dhe ky minutazh, le ta shfrytëzojë se e kalojmë edhe këtë test të sotëm.

Kështu që kisha pasur dëshirë që më shumë të merremi me çështje zhvillimore, integruese e tjera, sepse duke filluar prej një arme me gaz po dalim dhe po mbërrimë deri te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe po flasim edhe për legjislacionin e atyre. Sot po flitet hapur në mediumet tona, po lexojmë me emra dhe mbiemra përdoruesit të narkotikëve, për t'iu gjetur dikujt një armë në SHBA e cakton ligji edhe masën e dënimit. Kush gjendet me drogë ka dënim të përjetshëm. Ne sot ia kemi lejuar këtë rrethanë vetes, edhe këtu bëj thirrje te Prokuroria, drejtësia, te të gjitha, që kur përmenden dukuritë negative dhe ato çka e shkatërrojnë rininë tonë, qysh sot duhet që të ndërmerren masa. Po kam qejf ta lë një hapësirë, një 2-minutësh edhe kolegëve tjerë që duan të marrin fjalën, kështu që zoti kryesues kisha pasur dëshirë që të mos i japim karakter anësor.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë frazën e fundit s'e kuptova, por unë duhet të jua tërheq vëmendjen, sepse deputetët të gjithë janë të barabartë, janë kolegë dhe ju nuk keni të drejtë ta quani askënd "deputet kot", sepse ajo është fyerje. Domethënë, atë fjalë duhet ta tërhiqini s'është e lejueshme. Deputetja Kusari-Lila e ka kërkuar fjalën për replikë, në minutat e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Urdhëroni!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Deputetit Demalijaj ia rikujtoj që jemi në institucion dhe unë jam edhe institucionaliste dhe besoj në rend dhe ligj. Halucinacione unë nuk kam pasur, nëse ka pas halucinacione, atëherë ato kanë ardhur prej drejtorit të Policisë së Kosovës, zotit Shpend Maxhuni, dhe Policisë së Republikës së Shqipërisë. Ata e kanë sjellë lajmin se dikush po përgatit vrasje ndaj meje.

Zoti Demalijaj, nëse ju intereson rendi dhe ligji, merrini informatat të sakta dhe debatoni për to në Kuvendin e Kosovës. Mos i merrni paushall fjalët dhe mos gjuani në personale, për arsye se debati i sotëm ka shumë më tepër rëndësi për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe për fëmijët dhe të ardhmen e këtij vendi sesa për diskursin politik të debateve ndërmjet meje dhe jush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demalijaj e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni!

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Respektoj gjithçka që është e natyrës ligjore, institucionale e kushtetuese, e gjithçka që rrjedh dhe jam i thirrur pikërisht për atë, por unë nuk fola për informatën, por fola për epilogun e gjykatës, në drejtësi. Kjo ishte ajo çka e thashë dhe e

përgëzoj punën e institucioneve që vazhdojnë edhe në rastin në fjalë, se për debat unë nuk thashë që jam kundër debatit, por kundër interpelancës.

KRYESUESI: Mimoza Kusari-Lila e ka kërkuar prapë fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Zoti Demalijaj, tregoni konsistencë në deklaratimet e juaja. Ju thatë për halucinacionet e ish-kryetares së Komunës së Gjakovës, tre vjet është mbajtur një proces gjyqësor. Faleminderit!

KRYESUESI: Duket që zoti Demalijaj do të tentojë të tregojë konsistencën, kështu që ia jap prapë fjalën. Ka të drejtë.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: E thashë ashtu, sepse gjykata ka vendosur dhe ai njeri sot është i lirë, dhe sikur rastet e mëhershme që gjetën mbështetje, edhe ai rast është se sot qytetari është i lirë edhe gjykata e ka vendosur një diçka të tillë. Ka është muhabeti i gjithë asaj. Për teket e dikujt, qysh kanë thënë ai, “për inati të resë vdektë im bir”. Faleminderit!

KRYESUESI: Tani e shoh që fjalën e ka kërkuar deputeti Milaim Zeka, por grupi i tij parlamentar nuk ka minuta. Do t’i marr të Partisë Demokratike të Kosovës. Urdhëroni! Situatë interesante, 2 minuta!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Unë vetëm desha të them diçka që interpelancë të këtij viti më kot se kjo nuk mund të ndodhë që ka për të ndodhur në këtë vit, se qysh ia kemi nisur ne me këto interpelanca, pse Dardan Gashi ka gjuajt me revole, e Dardanin po të mundja sot e kisha arrestuar, ja ku është ulur atje. Veç kur të thërrasim ndonjë interpelancë për mënyrën qysh t’i bëjmë fëmijët synet, edhe ta thërrasim kryeministrin e t’i themi “a i bëjmë synet në shtëpi privat, a i bëjmë në spital?”.

Kështu që prapë po them, kemi pasur një milion arsye që ta thërrasim në interpelancë edhe kryeministrin, edhe ministrat për gjendjen e rëndë shëndetësore, për arsimin, për borxhe, për KEK-un, për Postë-Telekomin e Kosovës, për sistemin e privatizimit, për punën e Brezovicës, por këtu bash kush “tërrt” s’po ia bën, se shumica e deputetëve janë të përzier në këto afere. Janë të përzier në afere të lojërave të fatit, në aferat e bixhozit, në aferat e privatizimit, të shkatërrimit të sistemit të drejtësisë, në hetimet e Policisë e tjera, e tjera, prandaj, ju lutem, unë nuk po them që ka deputetë kot, ose ‘çkot’, se atë e përcakton vota, por unë po them që interpelancë më e kotë, më absurde, mos paçim tjetër në këtë vit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Ia jap fjalën deputetit Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,
Kabinet qeveritar,

Akti i gjuajtjes me armë i zëvendëskryeministrit Dardan Gashi është akt i dënueshëm, është shkelje e ligjit dhe sjellje e papërgjegjshme e një zyrtari të lartë publik, i cili do të duhej të jepte dorëheqje. Meqë zoti Gashi nuk dha dorëheqje, atë do të duhej ta shkarkonte kryeministri. Meqë kryeministri nuk e shkarkoi, le ta bëjmë këtë ne dhe unë qysh në krye të herës po them që e mbështes mocionin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Tradita është bartje brez pas brezi e dokeve, zakoneve, besimeve, origjina e të cilave është përgjithësisht e panjohur dhe disi mund vetëm ta hamendësosh atë. Tradita e shqiptarëve për gjuajtje me armë së cilës iu referuan shumë veta këtu sot, është ajo e gjuajtjes hirplotë, plot hir, ku ka rregull dhe takt.

Gjuajta me armë e zëvendëskryeministrit Gashi nuk ishte gjuajta hirplotë nga tradita, por ishte gjuajta delirante. Kolegu im, Glauk Konjufca, do të thoshte që ishte edhe delitante. Por, unë po e theksoj që ishte gjuajta delirante dhe si e tillë nuk ishte gjuajta hirplotë e traditës shqiptare, por ishte gjuajta delirante e një kulture të keqe. Këtu besoj që duhet ta bëjmë dallimin midis traditës dhe kulturës.

Tradita shqiptare nuk është keqe, tradita shqiptare është e mirë, por ka kultura të këqija tek shqiptarët. Pra, nuk është tradita jonë e keqe, por kultura e gjuajtjes delirante është e keqe. Prej nga vjen kjo kulturë e keqe? Unë besoj se ka ca shkaqe socio-historike, se këtu nuk jemi për të bërë gjyq, por mund të diskutojmë për shoqërinë dhe historinë, se deputetë të popullit, që ka edhe shoqëri edhe histori, jemi.

Shqiptarët kanë qenë të shtypur përgjatë gjithë shekullit XX dhe u kanë munguar armët, e madje edhe atëherë kur nuk u kanë munguar armët, shpesh u ka munguar municioni, saqë e dimë se në luftën e fundit çlirimtare të UÇK-së ka pasur kohë e vende, kur ka pasur më shumë ushtarë, sesa pushkë. Në vitet e '50-ta ishte aksioni i mbledhjes e armëve shqiptarëve, në kohën famëkeqe të Rankoviqit, e që u përsërit nga Millosheviqi në vitet e '90-ta. Shqiptarëve u kanë munguar armët kur ato u janë nevojitur më së shumti për vetëmbrojtje. Kjo mungesë dëshpëruese e armëve ka bërë që armët te ne të mos jenë thjesht mjete, por të krijohet një marrëdhënie e veçantë, një raport dëshiror i shqiptarit me armën. E dëshira është mungesë. Kështu kemi ardhur te një marrëdhënie jonormale ndërmjet njeriut shqiptar dhe armës së tij, që përgjithësisht nuk e kishte. Kjo është kulturë e keqe që vjen nga shtypja e huaj, nga pamundësia për vetëmbrojtje, nga pamundësia për kryengritje, nga mungesa e papërballueshme e armës në kohëra me përplot çaste ekzistenciale.

Edhe një herë: nuk është traditë e keqe, por kulturë e keqe. Tradita është e tillë, që disi nuk i dihet tamam origjina. Tradita është vazhdimësi, gjeneratë pas gjenerate, me harresë të origjinës, me një fillim mbase misterioz. Kultura e keqe është reaksion, është reagim i shkaqeve socio-historike dhe ajo duhet hequr në mënyrë strukturore, me institucione, me shtet, me rend, me ligj, por jo vetëm. Sepse, për bindjen time nuk mjafton vetëm shteti i së drejtës, rendi dhe ligji. Ajo që është e nevojshme në mënyrë që ta eliminojmë kulturën e keqe të gjuajtjes delirante me armë që rrezikojnë të tjerët, është edhe ushtria për Kosovën. Po të kishim ushtri për Kosovën dhe aty shërbim ushtarak, për shembull gjashtëmuajsh sikur në Kroaci, atëherë në ata gjashtë muaj të rinjtë dhe të rejtat tona do të kishin aftësim dhe ushtrim ushtarak, i cili do ta bënte të panevojshëm kompensimin nëpërmjet gjuajtjes delirante me armë.

Tradita shqiptare është e mirë. Kjo kulturë e keqe duhet eliminuar me shtet, rend dhe ligj, por jo vetëm: edhe me ushtri të rregullt, që i nevojitet popullit tonë, jo vetëm për ta rrumbullakuar sovranitetin e për ta ruajtur integritetin territorial, por edhe si një faktor i rëndësishëm shoqëror.

Këto i thashë për ta sugjeruar drejtimin e eliminimit të kulturës së keqe, por duke mos devijuar nga çështja thelbësore e sotme, e kjo është që unë e përkrah mocionin për shkarkimin e zëvendëskryeministrit Gashi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Do të jem shumë i shkurtër, meqë s'kam edhe kohë shumë për të folur. E para, normalisht shpreh shqetësimin tim për mungesën e kryeministrit këtu. Ne e kemi thirrur në interpelancë kryeministrin, ai s'vjen këtu, e dërgon personin, i cili ka kryer vepër penale dhe si i tillë nuk e di çfarë mund të na thotë ky, sepse këtë as që e kemi thirrur këtu.

E dyta, dikush po thotë këtu që mirë është të flasim për projekte zhvillimore, ose për integrim. Mirë do të ishte, por sigurisht që të gjithë e dini që kryeministrin e vendit aq shumë e kanë izoluar, sa që vetëm deri në Kukës mund të shkojë dhe ne për tema të tilla s'di pse mund të diskutojmë me të.

Çështja tjetër që po dua ta them unë është që ka një tendencë prej Qeverisë që ta shndërrojë Kuvendin në institucion këshillëdhënës. Kryeministri po thotë “mirë që po diskutojmë, japim mesazhe”. More, ia keni huq keq. Kuvendi nuk është për të dhënë mesazhe, Kuvendi nuk është për të dhënë këshilla. Kuvendi merr vendime dhe madje vendime shumë të rëndësishme. Po çfarë po themi ne këtu? Së bashku këtu edhe me zëvendëskryeministrin Limaj, po ka ndodhur bre, çka të bëjmë, keq që ka ndodhur, po ka ndodhur. Shihe, kanë filluar të shndërrohen në shkaktues të problemit, tash në diagnostifikues të problemit, që vetë e kanë shkaktuar. Ore, s'jeni ju për ta

diagnostifikuar situatën, ju jeni për t'i dhënë zgjidhje, për t'i dhënë vendim problemit i cili ka ndodhur.

Jablanoviqi është shkarkuar nga Qeveria e Kosovës edhe për çështje që s'kanë pasur të bëjnë me punën e Qeverisë, por me deklarata fyese. Po, kryeministri e ka çuar në shtëpi atë. Dhe, tash, ne këtë s'mund ta çojmë në shtëpi, se duhet pyetur Radojçiqin, as Rikalon s'kemi mundur ta çojmë në shtëpi. Prandaj, unë po e lë, meqenëse kolegu im po pret për të folur. Normalisht, unë ju lus që të votojmë e ta shkarkojmë këtë zëvendëskryeministër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Saranda Bogujevci.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Të dashur qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Për mua është shumë shqetësuese qysh është duke u arsyetuar kjo që ka bërë zëvendëskryeministri Dardan Gashi dhe në të njëjtën kohë që është deklaruar kryeministri se është në rregull nganjëherë të gjuhet. Edhe tjetra, nuk është kjo interpelancë kot, kjo është një interpelancë që po diskutohet për diçka që është duke e rrezikuar jetën e qytetarëve prandaj është shumë me rëndësi të diskutohet.

Për shkak se u fol shumë rreth kësaj teme unë do ta tregoj një përvojë personale sa i përket kësaj teme. Disa ditë pas natës së Vitit të Ri, unë e kam gjetur këtë plumb në ballkonin e shtëpisë së familjes sime. Këto janë vrimat ku kanë rënë plumbat. Sa i përket këtij plumbi, hera e fundit që unë kam mbajtur kësi lloj plumbi në dorë ka qenë pas luftës kur ma kanë hequr, për shkak të plagëve që i kam marrë gjatë luftës.

Ne si popull kemi kaluar mjaftë nëpër këso lloj situatash, e 18-19 vjet pas lirisë ne ende po ballafaqohemi me këso lloj gjërash, ku rrezikohet jeta e qytetarëve, pse dikujt i ka ardhur qejfi të gjuajë me armë.

Edhe tjetra, sidomos pas storieve që i përmendi Vjosa, të arsyetohet e të flitet ende se qysh këto storie po shfrytëzohen, kjo është e papranueshme për mua, për shkak se këtu jemi për ta ngrehur zërin e qytetarëve, për shkak se ata nuk mund të jenë këtu dhe të tregojnë historitë e tyre. Duhet të mësojmë prej këtyre historive. Kështu që për mua janë shumë të papranueshme gjithë këto komente që thonë “jo, është duke e shfrytëzuar...”. Duhet të merret me shumë seriozitet. Duhet të largohet si dukuri e vendit tonë. Unë lus që kryeministri së pari t'i tërheqë deklaratat që i ka dhënë, t'u kërkojë falje qytetarëve dhe patjetër që e pranoj kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së për shkarkimin e zëvendëskryeministrit dhe për shkak se zëvendëskryeministri në fakt

ishite dashur të japë dorëheqje. A ka procedurë gjyqësore apo jo, ai është dashur të japë dorëheqje për veprën që ka bërë, për shkak se e ka dhënë një shembull tepër të keq te qytetarët.

E kam edhe një lutje për qytetarët, që të përpiqen ta heqin këtë dukuri, për shkak se janë duke e rrezikuar së pari jetën e familjarëve të tyre, pastaj edhe të qytetarëve përreth. Kryeministri dhe Qeveria duhet të punojnë tepër shumë që ta largojnë këtë dukuri, e jo ta arsyetojnë këtë se është pjesë e traditës, apo kulturës sonë. Domethënë, kjo është e papranueshme, duhet punuar tepër shumë që të respektohet ligji dhe të punohet që të ndalohet kjo dukuri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ilir Deda. Përgatitet deputeti Arbër Rexha. Do të thotë, janë edhe dy deputetë të tjerë, përpos Ilirit, deri më tani të paraqitur për fjalë. Urdhëro!

ILIR DEDA: Do të përpiqem shumë shpejt, për një minutë e pesëmbëdhjetë sekonda...

Është faktikisht për gjynah, që ne tri orë dëgjojmë njerëz që duan ta arsyetojnë shkeljen e dy neneve të Kodit Penal.

Nuk ka arsyetim të shkeljes së Kodit Penal, as nuk ka relativizim të saj dhe mua më vjen keq që ne është dashur faktikisht menjëherë të hyjmë në votim dhe ta votojmë mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së. Nuk është traditë, nuk mund tash veprën penale ta bëjmë traditë, njëjtë siç nuk mund të arsyetohet gjakmarrja. Shteti modern, shoqëritë moderne, ecin përpara. Ligji është aty, ani sidomos veprat penale janë aty që t'i respektojmë të gjithë. Dhe, tash, ju nëse votoni kundër mocionit, i cili ka të bëjë me një zyrtar të lartë publik që ka bërë vepër penale, ju atëherë jeni në anën e shkelësve të ligjit, faktikisht të atyre që kryejnë vepra penale.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së nuk ka më kohë. Ia jap fjalën deputetit Arbër Rexhaj, le të përgatitet deputeti Xhelal Sveçla, i cili është i fundit i paraqitur në këtë pikë të rendit të ditës.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Kjo interpelancë nuk po thirret për Dardanin si subjekt qytetar, por po thirret për Dardanin si person zyrtar, i cili në njëfarë forme do të duhej të ishte edhe një lloj shëmbëlltyre e kësaj Qeverie në kushtet normale dhe demokratike të institucioneve tona.

Mirëpo, çështja është se në Republikën e Kosovës ne po kemi probleme të natyrës psikologjike e shoqërore te fëmijët tanë, sepse këta, pra qeveritarët, të disa qeverive, e kanë dhënë imazhin e të

fortëve dhe ky imazh i të fortëve pastaj po kthehet në psikologji edhe nëpër shkolla dhe fëmijët tanë më pastaj po marrin mësim të keq nga këta të cilët edhe po na udhëheqin.

Sa i përket kontekstualitetit kulturor, unë pajtohem me gjithë ata kolegë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, të cilët shumë mirë e shpjeguan këtë dhe unë mendoj se jemi megjithatë duke jetuar në kohën kur duhet të respektohen ligjet, në kohën që ne e quajmë kohë bashkëkohore dhe se në këtë kohë bashkëkohore jetojmë duke i respektuar ligjet. Unë e kam parë atë xhirim dhe kam parë që me atë armë është gjuajtur nga dritarja dhe nuk e di nëse ka qenë armë gazi, nëse ka pasur nevojë të hapet dritarja dhe të gjuhet jashtë dhe vërtet nëse ka qenë e tillë.

Për fund do të flas edhe për dy imazhe, pra imazhin në sferën të Republikës së Kosovës. Kjo Qeveri ashtu kështu është përbërë edhe nga sekserë që e kanë ndërtuar PAN-in shpejt e shpejt, e njëri prej tyre është ministri e zëvendëskryeministri Dardani, dhe në imazhin ndërkombëtar këta tërë kohën na thirren e na flasin e na shajnë si “Vetëvendosje” dhe vërtet unë e di që menjëherë pas kësaj seance edhe në mediet këtu, por edhe jashtë, do të dalë fytyra e zëvendëskryeministrit dhe ministrit duke gjuajtur me armë dhe pastaj këta dalin e na flasin për imazhe të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Xhelal Sveçla.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Populli e ka një thënie, dikush thotë “ja lepuri”, tjetri thotë “ja gjurmët”.

Shkelja ka ndodhur. A ka ndodhur me armë me municion luftarak apo me gaz, kjo është pak e rëndësishme, meqenëse të dyja janë vepër penale. Por, këtu nuk po flasim për përgjegjësi penale të zëvendëskryeministrit, por po flasim për përgjegjësi politike, prandaj nuk qëndrojnë fjalimet e shumë parafolësve, e po ashtu edhe të kryeministrit, të cilët po tentojnë ta minimizojnë këtë shkelje apo disa besa edhe ta normalizojnë. Do të thotë, ne si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet të kërkojmë përgjegjësi politike nga kryeministri, i cili po tenton ta mbrojë zëvendëskryeministrin për një shkelje të ligjit.

Tash këto po na dalin jo vetëm një shkelje, po na dalin shumë shkelje. Dardan Gashi ka bërë shkelje si qytetar, dhe kjo pastaj është shkelje penale, me të cilën duhet të merret drejtësia. Por, po ashtu ka bërë shkelje edhe si zëvendëskryeministër dhe njëri nga ministrat e kësaj Qeverie. E kjo është çështje për përgjegjësi politike. Nëse flasim për traditë, atëherë edhe zëvendëskryeministri Limaj ka bërë shkelje të kësaj tradite, nëse i ka dhënë leje që në shtëpinë e tij dikush të gjuajë me armë. Shkelje po bën edhe kryeministri, i cili, siç e thashë më herët, po tenton ta minimizojë dhe, po ashtu, po bën shkelje për shkak se duke relativizuar këtë po e pengon zbatimin e ligjit. Dhe, normalisht, kryeministri po bën edhe një shkelje politike,

meqenëse nuk e ka shkarkuar zëvendëskryeministrin në momentin kur ka dalë ajo video në publik.

Nuk kemi çka ta presim drejtësinë për ta thënë fjalën e saj, për shkak se vetë kryeministri e konfirmoi që është shkelje. Këso lloj shkeljesh kanë ndodhur edhe më herët edhe prej zyrtarëve të ndryshëm, që po ashtu janë të filmuara. Nuk kemi marrë ndonjë informatë që dikush ka marrë masa, qoftë ligjore, qoftë përgjegjësi politike. Prandaj, unë jam skeptik dhe nuk dua të pres çfarë thotë drejtësia, për shkak se është përgjegjësi politike.

Tash, çfarë është duke ndodhur në vendin tonë? Duke u relativizuar këto shkelje, ne edhe po i normalizojmë. Lirisht mund të themi se kjo Qeveri është qeveri e skandaleve, për shkak se nuk shkon java pa u publikuar ndonjë skandal i kësaj Qeverie, e nuk kemi parë ndonjë rast ku kryeministri ka marrë masa për këto skandale. Tash, kjo është e dhembshme për shkak se kjo po e tregon një degradim politik, e besa çon edhe në degradim shoqëror.

Është fatkeqësi që të ndihemi ne nga pak fajtorë që i kemi sulmuar më herët figurat politike për shkelje për të cilat edhe ashtu është dashur të sulmohen, por në krahasim me këto skandale të tanishme, janë pothuajse qesharake. Ne...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka më kohë për debat në këtë interpelancë. Kryeministri nuk është këtu që ta marrë fjalën. Kështu që unë ia jap fjalën propozuesit të interpelancës për konkluzione. Propozuesi, sipas Rregullores, i ka deri në pesë minuta kohë që ta paraqesë fjalën e tij. Deputeti Armend Zemaj, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, i falënderoj të gjithë deputetët që debatuan, në formën dhe në mënyrën e vet.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës qëndron prapa mocionit të interpelancës dhe të cilën e kanë të gjithë deputetët para vetes. Kështu që i ftoj më të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta votojnë dhe ta mbështetin këtë propozim-mocion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, të nderuar deputetë, në sallë janë 72 deputetë. Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Memli Krasniqi, e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë e kam një propozim edhe në emër të Grupit të PDK-së që ta lëmë këtë votim pas pauzës, meqenëse pjesa më e madhe e deputetëve nuk janë këtu. Do të ishte mirë me marrëveshje, sepse nuk besoj që mund të kemi votim të suksesshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 72 deputetë, që do të thotë se ka kuorum dhe sipas Rregullores unë jam i detyruar që të procedoj. Kërkohet deklarimi me votim për miratimin e mocionit të propozuar.

Regjia dhe deputetët le të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! A ka deputetë pa kartelë? Jo!

Në sallë janë 77 deputetë, por në votim kanë marrë pjesë vetëm 36 deputetë, që do të thotë se ky votim s'është i vlefshëm dhe duhet të përsëritet. A doni ta përsëritim edhe një herë? Atëherë, pas pauzës, por unë ju njoftoj që, sipas Rregullores, Kuvendi nuk mund të kalojë në një pikë tjetër të rendit të ditës pa u mbyllur pika për të cilën diskutohet.

E vazhdojmë seancën në orën 15:00. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Vazhdojmë seancën.

Po i procedojmë projektligjet, të cilat i kemi pjesë të diskutimeve.

Interpelanca vazhdon menjëherë në momentin kur i kemi 61 deputetë.

Edhe pika e dhjetë mbetet kur bëhen 61 deputetë.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azil

Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Flamur Sefaj, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Më lejoni që para jush të prezantoj Projektligjin për azil, të sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për azil është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, kushtet dhe procedurat plotësuese mbrojtëse të përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e aplikuesve, personave me status refugjati si dhe personave, të cilëve u është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme.

Projektligji për azil është paraparë në masë legjislative afatshkurtër, në kuadër të planit kombëtar të zbatimit të MSA-së, përkatësisht në kuadër të objektivave në fushën e azilit, Kapitulli XXIV, Liria, siguria dhe drejtësia e “acquis” të BE-së.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë transpozuar gjashtë direktiva të BE-së, të cilat kanë të bëjnë me fushën e azilit, si në vijim:

Direktiva numër 2013/33 mbi parimin e aplikantëve.

Direktiva numër 2013/32 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare.

Direktiva numër 2001/55 për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare në rast të fluksit masiv të personave të zhvendosur.

Direktiva numër 2011/95 mbi standardet për kualifikim të shtetasve të vendeve të treta, apo personave pa shtetësi, si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare.

Direktiva numër 2011/51 për ndryshimin e direktivës 2003/109 për zgjerimin e fushëveprimit të saj, për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare, si dhe

Direktivës numër 2003/86 mbi të drejtat e ribashkimit familjar.

Për këtë projektligj janë pranuar dhe deklaratat përkatëse, opinionin për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe opinionin ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integrimit Evropian.

Të nderuar,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e MSA-së, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

E hap debatin për diskutim në parim.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Haxhi Shala, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime të komisionit.

HAXHI SHALA: Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 15 dhjetor 2017 shqyrtoi në parim Projektligjin numër 06/L-026 për azil dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë projektligj.

Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit për të proceduar për shqyrtim të parë në mbledhjen plenare dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sami Kurteshi, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, në emër të grupit e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Sa i përket ligjit, unë kam bërë përpjekje ta bëj analizën edhe përmbajtjesore, edhe formale.

Po deklarohej që në fillim është një ndër ligjet e mira, edhe për këtë i përgëzoj hartuesit e ligjit, që rrallë shihen të bëjnë përpjekje t'i komplotojnë në këtë mënyrë, kjo është një fushë me të cilën unë merrem gjatë, e njoh mirë dhe mendoj se këtu ka vend për përgëzim.

Në aspektin procedural, ky ligj nëse lexohet me kujdes VII kapitujt e tij, nja 20% ka të bëjë me procedura, thjesht, nja 30% sigurisht mbulon fushën e sigurisë, po 100% ka të bëjë me të drejtat e njeriut, kjo është ajo çështja kryesore, se edhe në aspektin procedural, në të gjitha nenet, ku preken vetëm procedurat, qofshin edhe çështjet e sigurisë, prekin të drejtat dhe liritë e njeriut. Në këtë rast kemi të bëjmë me njerëz të cenueshëm, nga faktorë të ndryshëm që e lëshojnë vendin e tyre.

Këtë po e theksoj me qëllim, sepse sido të jetë puna, asnjë njeri në botë nuk e lëshon vendin e vet prej dëshirës. Prandaj, këta janë njerëz të cenuar.

Çka po shoh unë këtu, domethënë, kjo çështja të cilën dua ta ngre dhe vërejtja ime dhe e grupit parlamentar është se ky ligj, përveç Komisionit Parlamentar për Siguri, në të vërtetë është dashur t'i dërgohet me çdo kusht, edhe duhet t'i dërgohet edhe në leximin tjetër Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Nuk mund të shihet ky ligj vetëm nga aspekti i sigurisë, sepse kemi të bëjmë me cenimin e të drejtave të një kategorie të njerëzve që vërtet janë më të cenuarit prej të gjitha kategorive të njerëzve.

Kjo është ana procedurale, të cilën unë dua ta theksoj, kisha kërkuar edhe nga Kuvendi, edhe nga Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut që ta kërkojë zyrtarisht shqyrtimin e këtij ligji, kisha kërkuar edhe nga ministria apo kushdo qoftë që ky ligj para leximit të dytë t'i dërgohet Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut.

Në aspektin përmbajtësor nga ai lexim që kam mundur unë t'i bëj dhe që e kemi bërë ne, unë e kam një vërejtje themelore, e cila ka të bëjë me pjesë të ndryshme që kanë të bëjnë me definimin e disa koncepteve, që mund të jenë edhe lëshime të përkthimeve të ndryshme, sepse ne nuk kemi pasur legjislacion për azilin, por parimi kryesor që preket dhe duhet shihet është parimi kushtetues i proporcionalitetit.

Çdo institucion, çdo organ në Republikën e Kosovës, me rastin e marrjes së çfarëdo vendimi e ka për obligim ta respektojë parimin e proporcionalitetit që çdo vendim të merret bazuar me këtë parim.

Tash sa u përket çështjeve krejt konkrete të këtij ligji, ashtu si e thashë, ky ligj ka të bëjë me të drejtat e njerëzve, e pse këta njerëz janë kategorizuar domethënë, do të thotë për shtetasit e huaj dhe për personat pa shtetësi, të cilët kanë deklaruar qëllimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare.

Ne shqiptarët nga historia e kemi një plagë, kjo është edhe ikja, largimi nga vendi qoftë për shkak të presionit, qoftë për shkak të rrethanave të tjera, po kryesisht për shkak të presionit që kanë bërë pushtetet e ndryshme ndaj njerëzve tanë dhe ne dallohemi ende sot për numrin më të madh të refugjatëve si tërësi etnike.

Unë kam këtu disa vërejtje sa i përket një përzierje statusi i refugjatit dhe azilit, këtu duhet të shikohen me kujdes e të rregullohen, sepse statusi është një gjendje, kurse refugjati është një e vërtetë, një realitet objektiv, prandaj këto nuk duhet të përzihen. Nëse njihet statusi i refugjatit, domethënë i njihet një njeriu, pra ajo nuk është kategori në vete mandej.

Një çështje përmbajtjesore që unë megjithatë dua ta theksoj është parimi i kthimit ose “no refulmo”, edhe këtu një shpjegim gjuhësor thotë “nuk guxon të kthehet në kufijtë e territoreve të vendeve të tjera”. Nuk kemi të bëjmë me kthimin në kufijtë e territoreve, kemi të bëjmë me kthimin në territorët prej nga ose ku ata janë të cenuar në të drejtat dhe liritë e tyre. Kjo duhet të ndryshohet, sepse ne mund ta kthejmë një njeri deri në kufij, mirëpo mund ta lëmë në zonën neutrale dhe kjo duhet të saktësohet, sepse madje dikush thotë jo, jo, është çështja e kthimit deri në kufirin e territorit dhe kjo nuk duhet të lejohet.

Kemi çështje të tjera, në nenin 5, pika 2, ku me rastin e kthimit thotë “duhet të ketë arsye të forta të mendohet se ai paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës”. Në rastin e këtyre njerëzve një trajtim jashtëzakonisht i kujdesshëm për gjetjen e këtyre arsyeve që duhet të shndërrohen ose të bazohen norma ligjore është i domosdoshëm, po ky formulim gjyqësor është pak i rrezikshëm, se arsyeja mandej nuk ka ndonjë kufizim nëse nuk operacionalizohet në norma ligjore të sakta, çka dua të them me këtë.

E përmenda, njohja e statusit të refugjatit dhe koncepti refugjat, rasti i përjashtimit nga mbrojtja plotësuese. Edhe këtu kemi paragrafin 1.4 ku thotë: “Janë ata persona, të cilët paraqesin rrezik për bashkësinë ose për sigurinë e Republikës së Kosovës”. Kjo është vetëm aspekti i sigurisë. Mirë që merret parasysh ky aspekt i sigurisë, po megjithatë këta njerëz janë të rrezikuar, kanë ikur dhe këtu duhet të merret pa tjetër elementi i cenimit dhe i të drejtave të tij.

Ky rrezik për bashkësinë ose për sigurinë e Republikës së Kosovës duhet të baraspeshohet edhe me rrezikun e cenimit të drejtave dhe lirive ose dinjitetit të atij njeriu, po nuk mund të lihet vetëm në këtë formë.

Në nenin 13, Procedurat e veçanta dhe garancitë e pritjes, në një moment thuhet kështu: “Përmes procedurave të veçanta dhe garancive të pranimit, mbështetja e nevojshme për aplikuesit do të kushtëzohet duke u bazuar në rrethanat e tyre personale”.

Unë mendoj se ky formulim gjuhësor nuk është i drejtë, këtu është fjala “do t’u ofrohet atyre”, sepse nëse fillon dikush të kushtëzojë pa operacionalizuar me norma ligjore, na del një problem, po vërtet njerëzve që pranohen u ofrohen të gjitha ato procedura duke u bazuar në rrethana të caktuara.

Kemi nenin 73, Afatet për parashtrimin e ankesës. Unë e di se kjo është nxjerrë nga ligjet tona pozitive, mirëpo po e them, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme në të cilën gjenden njerëzit që e kanë lëshuar vendin e tyre, nuk e njohin vendin, nuk e njohin gjuhën, nuk e njohin rrethanat, afati prej 15 ditësh për ankesë në rast të vendimeve të ndryshme është tepër i shkurtër, edhe pse ata e kanë ndihmën e avokatëve dhe përkthyesve, por ne momentalisht në Republikën e Kosovës e kemi një gjendje të tillë që këto mundësi nuk ua ofrojmë aq shpejt dhe me kualitetin që duhet t’u ofrohet.

Unë natyrisht që e kam edhe vërejtjen e fundit që dua ta them, është neni 101.3, kur kemi të bëjmë me komunikimin e të dhënave personale të shtetit të origjinës apo të prejardhjes.

Në pikën 3, për mua krejt formulimi është problematik, në rast të kthimit ose dërgimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të grupit, urdhëro pasi flet edhe në emër të grupit.

SAMI KURTESHI: Faleminderit!

Është neni 101, është fjala për rastin e dërgimit ose komunikimit të dhënave personale të këtyre personave me shtetin e origjinës apo të prejardhjes.

Nga përvoja jo e Kosovës, po nga përvoja tjetër, kjo mund të jetë çështje problematike jo në çdo rast, në raste shumë të rralla, po ne kemi pasur rastin në Kosovë në vitet e ’80-ta, kur edhe nga shteti zviceran janë dërguar të dhëna për të ikur refugjatë shqiptarë që mandej këtu kanë ardhur dhe janë dënuar me shtatë vjet burg nga ish-pushteti jugosllav.

Prandaj, po e them, çdo vendim institucionet dhe organet shtetërore duhet t’i përmbahen në mënyrë precize edhe të pakushtëzuar parimit të proporcionalitetit me rastin e shqyrtimit të fatit të këtyre njerëzve që janë kategoria më e cenuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj, në emër të grupit parlamentar, fjala për ju.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë po mundohem ta thjeshtëtoj raportin në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Kolegu nga “Vetëvendosja” e elaboroi pothuajse në tërësi ligjin, përmbajtjen e tij, i cili me të drejtë i theksoi disa çështje, të cilat edhe kanë qenë nevojë. Unë e shoh si të vonuar, sepse edhe në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave një ndër kriteret është edhe menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi dhe në këtë fazë ne duhet të japim përkrahje të domosdoshme.

Ajo çka na mbetet është që brenda strukturës ligjore të fuqizojmë kapacitetet e autoriteteve kompetente, që janë me këtë ligj, deri te përmirësimi i kushteve materiale dhe mbikëqyrja, po ashtu e autoriteteve mbi azilin.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i jep përkrahjen në parim dhe mendojmë se në 2-3 elemente që ka të bëjë edhe me planin e MSA-s, po ashtu edhe në zbërthimin e direktivave të BE-së, do të japim kontributin tonë mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Armend! Zoti Fatmir Xhelili, nga Partia Demokratike e Kosovës e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për Kabinetin, ministrin,

Të nderuar deputetë,

Ligji për azil është një ligj, i cili do t'i evitojë disa mangësi, të cilat kanë ekzistuar në ligjin paraprak dhe do të kujdeset që të inkorporojë konventat ndërkombëtare dhe direktivat e Këshillit Evropian si dhe të Parlamentit Evropian, për të qenë ky një ligj funksional, një ligj i zbatueshëm dhe një ligj i harmonizuar me legjislaturat e Bashkimit Evropian.

Ky ligj do të saktësojë edhe do t'i përcaktojë saktë kushtet, procedurat dhe rregullat për statusin e refugjatit për ata që aplikojnë për azil, për ata që kanë nevojë për mbrojtje shtesë, mbrojtje të përkohshme, e të tjerë dhe, besoj që do të jetë një prej ligjeve më të zbatueshëm dhe do t'i plotësojë kërkesat e Bashkimit Evropian për t'i realizuar detyrat prej programit të zbatimit të obligimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Grupi ynë parlamentar do të kontribuojë gjatë leximit të mëtutjeshëm në plotësimin eventual të ndonjë lëshimi që ka ndodhur në ligj dhe do të kontribuojmë në këtë drejtim në komisionin tonë parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Xhelili! Zoti Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për azilin dhe duke qenë se është në lexim të parë, tani ne e përkrahim në parim dhe njëkohësisht kontributin tonë do ta japim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi vetëm dy deputetë për diskutim, Bahrim Shabani, nga “6+”, në emër të grupit, urdhëroni, fjala për ju.

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem se predsedniče!

I Parlamentarna grupa “6+” razmatrala je Nacrt zakona o azilu, i mi čemo takođe u načelu podržati ovaj Zakon a svoj doprinos svakako daćemo kroz rad Komisije.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli, fjala për ju dhe të bëhet gati Arbër Rexhaj, nuk ka të tjerë deputetë për fjalë.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Ju përshëndes, ministra, kolegë, media,

Me të vërtetë sot po ndihem mirë që edhe ne kemi bërë diçka sikur dikush më herët për neve, do të thotë ky është një ligj, i cili është i nevojshëm, dikur apo të mos them që ende vazhdojnë njerëzit tanë të kërkojnë azil dhe kanë pasur trajtim të veçantë.

Prandaj, mua më mbetet vetëm ta përshëndes këtë përgatitje aq të mirë që është bërë nga ministri dhe përgëzoj.

AKR-ja e përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Rexhaj, fjala për ju!

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Ky projektligj rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, të drejtat dhe detyrimet e aplikuesve dhe personave me status refugjati si dhe personave, të cilëve u është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme.

Ky projektligj do të zbatohet për të gjithë shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët kanë deklaruar qëllimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Kosovës.

Duke përfshirë kufirin në ujërat territoriale ose në zona të transitit, për aq kohë sa atyre u lejohe të qëndrojnë në territorin e Kosovës si aplikues për mbrojtjen ndërkombëtare si dhe për anëtarët e familjes, në qoftë se ata janë të përfshirë në aplikacionin e tillë për mbrojtjen ndërkombëtare, në përputhje me këtë projektligj.

Ky ligj është një rëndësie e veçantë, sepse mbron të drejtat elementare të njeriut, siç është e drejta për jetë, në rastin e strehimit apo të azilit, që ndryshe njihet si mbrojtje ndërkombëtare e të drejtave të njeriut.

Në vitin 2011 Kuvendi i Kosovës kishte miratuar Ligjin për azilin numër 04/ L-073, por kishte disa të meta në këtë ligj. Qeveria e Kosovës, si sponsorizuese, është munduar të rregullojë më mirë këtë çështje, por në lexim të thjeshtë, në njëfarë forme vërehet një qasje e shpejtë gjatë të shkruarit të këtij ligji. Për shembull, në nenin 3, paragrafi 1.18, formulimi se personi i cili kërkon strehim si refugjat nuk ka dëshirë të përfitojë mbrojtjen nga vendi që është larguar për shkak të frikës, fjala “dëshirë” mund të shkruhej “nuk mund të përfitojë, sepse i cenohet jeta ose ndonjë e mirë e mbrojtur”. Po ashtu, kjo fjalë “nuk ka dëshirë” bie ndesh edhe me formulimin e po këtij nënparagrafi, ku shkruan se “për shkak të frikës nuk ka dëshirë të kthehet në atë vend”. Ndoshta do të duhej të shkruhej “nuk mund të kthehet”, e jo “nuk ka dëshirë”.

Fjalë joadekuate është edhe fjala tjetër në këtë nënparagraf, ku shkruan “jashtë vendit të banimit të pashëm”, do të ishte më e arsyeshme të shkruhej “në vend të banimit të pashëm” ose “vendit të origjinës”. Në nenin 8, paragrafi 1.1. është formulim jo i qartë, ku thuhet se “të drejtën e statusit të refugjatit nuk mund ta fitojë personi që kryen krime kundër palës”. Cilës palë, pra shtrohet pyetja. Dhe, domethënë është i paqartë. Përkundër asaj që në nenin 1, paragrafi 2, janë përmendur disa direktiva të BE-së që ky ligj ka për qëllim të jetë në harmoni, dhe shpresoj të jetë ashtu, pra në përputhje të këtyre direktivave që rregullojnë këtë sferë, mbrojtjen ndërkombëtare të drejtave të njeriut. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve për votim. Votojmë tash!

84 deputetë kanë votuar. 82 për, 2 kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për azil. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar dhe, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

80 deputetë kanë votuar, 61 për, 19 kundër. Asnjë abstenim. Kështu e kam në ekran, s'besoj që kam gabuar.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Jemi në pikën që e kemi filluar vazhdimin e seancës:

4. Votimi i interpelancës së kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtjen me armë nga z. Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike

Kërkohet deklarimi me votim për miratimin e mocionit të propozuar. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, interpelancën e kemi përfunduar, tani është votimi i mocionit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 49 vota kundër, 36 për, 3 abstenime, Kuvendi nuk e miratoi mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për standardizim

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për standardizim dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, zonjën Sala Berisha-Shala, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti Veseli!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ju të pranishëm

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri, Infrastrukturë dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të neneve 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit në disa mbledhje të mbajtura ka shqyrtuar Projektligjin për standardizim, të propozuar nga Qeveria, ku gjatë shqyrtimit mes dy leximeve kemi hartuar 19 amendamente, ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 16 janar 2018 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

I rekomandohet Kuvendit miratimi i Projektligjit nr. 06/L-019 për standardizim. Ju ftoj t'i miratoni amendamentet. E ka kaluar procedurën e paraparë me Rregulloren nëpër të gjitha komisionet, nuk kemi marrë vërejtje, prandaj ju ftoj që ta përkrahni.

KRYETARI: Faleminderit! Në Projektligjin për standardizim janë propozuar 19 amendamente, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik.

Kolegë deputetë, janë 19 amendamente, në qoftë se pajtohemi, i votojmë të gjitha përnjëherë, në princip, në mënyrë formale, pasi ka unanimitet. A ka dikush kundër këtyre rekomandimeve, amendamenteve të propozuara, nga 1 deri 19, të gjitha përnjëherë? S'ka kundër. Abstenim? Nuk ka! Aprovohen të gjitha!

Atëherë votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar, 71 për, asnjë kundër, 3 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin për standardizim.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Komisioni Funkcional për Buxhet edhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar! Komisioni për Buxhet dhe Financa si Komision Funkcional ka shqyrtuar Projektligjin në takimin e të cilit ka qenë prezent edhe ministri i Financave dhe zyrtarët e ministrisë që kanë dhënë arsyetimet dhe sqarimet e nevojshme për dispozitat e projektligjit dhe kanë propozuar amendamentet, me të cilat janë bërë ndryshime dhe plotësime të nevojshme përmbajtësore, gjuhësore dhe të harmonizimit me terminologjinë juridike.

Komisioni i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara dhe me përkrahje, pra vetëm amendamentet që kanë përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të lajmëruar për diskutim. Në Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme janë propozuar 28 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.

Amendamentet, të cilat janë pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL i votojmë veçmas, pastaj do të mundohem të gjitha, i kaloj ndoshta amendamentet që i ka Komisioni FunkSIONAL për t'i vënë për votim të gjitha bashkë në mënyrë të menjëhershme.

Amendamenti 1, deputetja Evgjeni Thaçi-Drăgusha, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Atëherë, po e mbajmë edhe amendamentet 2, 3, 4, 5, më korrigjo kryetar i komisionit, në qoftë se gaboj, do t'i vë të gjitha që t'i votojmë ato që janë me përkrahjen tuaj.

Amendamenti 1, e vejmë në votim, vetëm formalisht, amendamentet 2, 3, 4, 5, 7, 8, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 24, 27 dhe amendamentin 28. Kini parasysh, të gjitha këto janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Të gjitha këto vihen në votim në parim.

Kush është kundër? Arbeni është kundër. Kush abstenon? Abstenojnë 3 deputetë, të mos i përmend me emra. Të tjerët janë të gjithë pro, nga 88 deputetë prezentë në sallë.

Tash do të shkoj te amendamentet, të cilat nuk e kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro, zoti kryetar!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar! Edhe amendamenti 23 i ka dy propozime. Amendamenti 23a e ka përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

KRYETARI: E bëjmë me dy herë, i qes dy propozimet në bazë të rregullit. Tash shkojmë një nga një te këto, të cilat s'kanë përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 6. Grupi Parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. A votojmë në mënyrë elektronike? Lista serbe, ju kisha lutur, përfaqësuesi i Listës serbe, ju i keni të gjitha amendamentet e propozuara, a dëshironi t'i vëni një nga një për votim, apo të gjitha përnjëherë, përveç amendamentit 23, që është me dy propozime, shkojmë veç. Deklarimi i Listës serbe, kisha pasur dëshirë. Amendamentet tuaja, a dëshironi një nga një apo të gjitha bashkë përnjëherë me votim elektronik? Urdhëro, zoti Milosavlëviq!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!
Mi bih hteli da se svi amandmani glase odjednom.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Atëherë, kështu amendamenti 6, amendamenti 9, amendamenti 10, amendamenti 11, amendamenti 12, amendamenti 22, amendamenti 25 dhe amendamenti 26, amendamenti 23 mbetet jashtë. Do të thotë, votohen përnjëherë, deputetët kur votojnë, votojnë për, kundër, abstenim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

81 deputetë kanë votuar. 13 janë për, 61 kundër, 7 abstenime. Nuk kalojnë këto amendamente.

Tani kemi amendamentin 23, janë dy propozime. Në princip, shkojnë dy propozimet votohen ndaras, ai që merr vota më shumë, ai konsiderohet i miratuar. Në rend të parë e vëmë në propozim amendamentin 23 me propozimin e Komisionit FunkSIONAL, nën "a". Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, në mënyrë elektronike. Votojmë tash!

83 deputetë kanë votuar për amendamentin 23, propozimi i Komisionit FunkSIONAL "a". 72 për, 9 kundër, 2 abstenime.

Shkojmë te varianti i dytë, i amendamentit 23, i propozuar nga Grupi Parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

80 deputetë kanë votuar. 10 për, 62 kundër, 8 abstenime. Do të thotë, amendamenti 23 miratohet, amendamenti i propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 86 deputetë që kanë votuar, 69 për, 10 kundër, 7 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL, zonjën Sala Berisha-Shala, për arsyetimin e raportit.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Raporti vjetor i punës për vitin 2016 të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ndoshta dikush mund të thotë tani jemi në vitin 2018, mirëpo me Ligjin për ARKEP-in është i paraparë që diku prej qershorit fillojnë raportimet dhe në atë kohë kemi qenë në zgjedhje. Kështu që Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 7 nëntor 2017 shqyrtoi raportin vjetor për vitin 2016 të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim. Të miratohet raporti vjetor për vitin 2016 i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Në bazë të nenit 11 të Ligjit 04/ L-109 për komunikime elektronike, në përfundim të çdo viti ARKEP-i paraqet në Kuvend brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës raportin vjetor të veprimtarisë së vitit paraprak. Prandaj, komisioni e ka shqyrtuar dhe e ka miratuar dhe kërkon nga seanca që ta miratojnë këtë raport. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare të Kosovës për vitin 2016 ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2016 brenda afatit ligjor.

Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhëna për shpenzimet e buxhetit sipas kategorive, nënkategorive ekonomike dhe krahasimet me vitin paraprak. Buxheti i ndarë për Autoritetin Rregullativ për vitin 2016 ka qenë 834 mijë euro, ndërsa buxheti përfundimtar ka qenë 777 mijë euro. Janë shpenzuar 97,44% të mjeteve të parapara. Autoriteti Rregullativ për periudhën janar-dhjetor 2016 ka realizuar të hyra në shumë prej 4,7 milionë eurosh, ose 102% të shumës së paraparë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 8.12.2017, pasi që shqyrtoi raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator vlerësoi se raporti përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandoi Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Zoti Glauk Konjufca nga Lëvizja “Vetëvendosje” e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Po, ky raport përmban shumë hollësi teknike, si gjithmonë, për aktivitetet e Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, mirëpo ne si deputetë jemi të

thirrur, sepse nuk jemi ekspertë të këtyre anëve teknike, mirëpo ta analizojmë nga aspekti politik këtë raport.

Ajo që është më shqetësuesja ka të bëjë me operatorët ilegalë të Serbisë, të cilët vazhdojnë të operojnë brenda Kosovës. Kur është përpiluar ky raport, qysh u cek edhe prej kryetares së komisionit, këtu kemi të bëjmë me vitin 2016. Ka qenë një vit i negociatave me Serbinë, ashtu si viti 2015, dy vjet shumë të ngjeshura të negociatave dhe marrëveshjeve me Serbinë, ku siç e dimë njëra prej fushave e cila ka qenë temë e negociatave ishte dhe fusha e telekomunikimeve. Këtu në raport shihet që ka pasur një ndërhyrje dhe ndryshon narracioni i raportit kur arrihet marrëveshja e telekomunikacionit me Serbinë, sepse në fillim të raportit e kemi konstatimin që tre operatorë ilegalë serbë veprojnë, jo veç në veri të Kosovës, në pjesën veriore të Kosovës, por veprojnë edhe nëpër pjesë të tjera të Kosovës, ku ekzistojnë këto komunat me shumicë të banorëve serbë.

Tre operatorë, të cilët përmenden këtu janë: Telekom Serbia, Telenori edhe operatori VIP. Tash këtu në raport, pasi thotë që këta tre operatorë veprojnë ilegalisht, pa kurrfarë licence nga autoriteti respektiv për të vepruar brenda territorit të Kosovës, në fund të raportit, sikur të thuash pasi që ndodh marrëveshja me Serbinë në dhjetor të vitit 2016, e kemi ndërhyrjen, thotë me gjasë këta operatorë janë ndërprerë, veprimtaria e këtyre tre operatorëve ilegalë të Serbisë është ndërprerë në territorin e Kosovës.

Tash, unë kam informata që nuk është ndërprerë dhe, çka është më e keqja, edhe vetë raporti identifikon disa prej vendeve ku ekzistojnë burime teknike, përmes të cilave ato e ushtrojnë, le të themi, atë brezin e tyre frekuencor, e këtu përmenden madje edhe kishat, edhe manastiret e ndryshme, vendet fetare, ku janë të vendosura këta operatorë ilegalë. Për shembull, për Telekom Serbia thotë që i ka 22 vendburime prej nga e transmeton frekuencën dhe këto thuhet që janë edhe nëpër manastire fetare. Kjo është e paprecedent, duhet të kritikohet, qysh është e mundur të shfrytëzohen vendet fetare për gjëra të tilla, ku ka ushtrim ilegal të aktiviteteve, të cilat janë edhe vepra penale. Bile nga fusha dhe nga kuptimi i sovranitetit dhe integritetit territorial, kjo është një vepër e rëndë penale. Për të ushtruar një aktivitet të tillë ilegal, kudo nëpër botë, këto dënohen, a në Kosovë vendosen antena e burime të ndryshme edhe nëpër kisha, edhe nëpër manastire.

Kjo duhet të ndërpritet, një rast në Gorazhdec, për shembull, shfrytëzohet në shkollë, në shkollë është operatori. Shkolla që ka krejt destinim tjetër, domethënë është për t'i mësuar nxënësit, aty kemi një strehim të një aktiviteti ilegal të papranueshëm, i cili duhet të ndalohet. Kështu që kjo, ma merr mendja, që është pjesa më e rëndësishme e këtij raporti, kurse aty jo vetëm për operatorët ilegalë, por edhe për postën fizike. Aty edhe, qysh quhet ajo, "JP Posta Srbije", e cila e ka edhe infrastrukturën fizike. Edhe operimin me rrjetin e saj të kryerjes së aktiviteteve brenda territorit të Republikës së Kosovës, ekziston posta e Serbisë. Për këtë tjetrën thotë që nuk është

ndaluar fare, as pas negociatave. Kjo vazhdon të operojë nëpër territoret ku ka komuna të banuara me serbë, e autoritetet e Kosovës veç këqyrin seri, pra nuk kanë kurrfarë strategjie se si të ndërpriten këto aktivitete ilegale.

Unë nuk e di cili prej ministrave këtu është kompetent për të na e treguar këtë punë, veç a mund të garantoni dhe a mund të thoni me saktësi që operatorët ilegalë serbë janë ndalur në Kosovë? Edhe nëse del ndonjë fakt që këta operatorë edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të veprojnë në mënyrë ilegale në Kosovë, atëherë me siguri që ju si Qeveri duhet të jepni përgjegjësi për të gjitha këto.

KRYESUESI: Faleminderit, Glauk! Kosova e ka një marrëveshje të nënshkruar në Bruksel sa i përket çështjes së telefonisë, por ajo që mua më brengos dhe mirë bëre që fole, është që lidhjet me e-mail-a të Kosovës së pari shkojnë pushojnë në Nish, e pastaj vijnë këtu. Kështu që duhet pasur parasysh këtë.

Fjalën e ka zonja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016 tani në janar të vitit 2018, u tha edhe më herët, nuk ka pothuajse asnjë efekt pozitiv. Kjo e para për dy arsye, sepse edhe rekomandimet e dhëna nga Komisioni Funkcional, Komisioni për Buxhet dhe Financa, këto që i japin sot në këtë seancë plenare nuk merren parasysh dhe nuk kanë kurrfarë efekti. Në fakt, ne presim që pas disa muajsh të vijë edhe raporti i vitit 2017.

E dyta, është fatkeqësi edhe sot e kësaj dite që Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka arritur ta rishikojë Rregulloren e vet, me të cilën do të përcaktoheshin qartë penalltitë për agjencitë e pavarura në rast se një raport i punës i cilitdo institucion të pavarur nuk aprovohet për shkak të performansës së dobët. Këtu dua të jem e qartë, se nuk e kam fjalën vetëm për ARKEP-in, e kam fjalën për të gjitha institucionet që janë të pavarura dhe i raportojnë Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në fakt, t'i raportohet Kuvendit i bie sikur të mos i raportohet askujt.

Po kthehem te ARKEP-i dhe po e vë theksin në disa çështje që mendoj se mund të jenë relevante dhe pse po e shqyrtojmë raportin me vonesë. Në raportin që po e shqyrtojmë, nga ARKEP-i është paraqitur si sfidë kryesore mungesa e pavarësisë buxhetore. Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa e tha që ata kanë realizuar buxhet prej 4,7 milionë eurove, ndërkohë që kanë pasur buxhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës prej 700 000 eurove. Cila organizatë buxhetore nuk do të dëshironte që ta ketë buxhetin disa herë më të madh se ai të cilin ia kanë përcaktuar Kuvendi dhe Qeveria.

Në fakt, ne si grup parlamentar nuk do të pajtoheshim asnjëherë për pavarësinë buxhetore të institucioneve rregullatore, të cilat realizojnë të hyra në bazë të aktivitetit të tyre. Kjo është e ndaluar me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe, para së gjithash, për shkak të mungesës së mekanizmave të kontrollit që i ka Kuvendi, e që për momentin janë vetëm formalë, pa asnjë përmbajtje dhe pa asnjë efekt.

Të nderuar kolegë deputetë,

Prapë krijimi nga ne, ose me lejen tonë, i shumë agjencive, bordeve rregullatore, është temë që të gjithë kemi përgjegjësi ta trajtojmë seriozisht, të shohim dhe të shqyrtojmë jo vetëm performansën e tyre në termat e shpenzimit të buxhetit, por ta rishikojmë seriozisht nevojën për pasjen e tyre, të shohim se cila është vlera e shtuar në sektorin që ato e rregullojnë ose e mbikëqyrin. Në disa sektorë, efekti i tyre është negativ, sepse në vend se të mbikëqyrin dhe të marrin masa për punët që nuk shkojnë siç duhet dhe siç janë paraparë me ligj, ata bëjnë aleancë me keqpërdoruesit e parasë publike, me keqpërdoruesit e pozitës zyrtare, duke punuar për grupe të caktuara dhe në shumicën e rasteve duke e dëmtuar rëndë interesin publik.

Prapë po e theksoj që nuk e kam fjalën vetëm për ARKEP-in, e kam fjalën për shumë institucione, performansa e të cilave është tepër e dobët dhe i raportojnë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Ne duhet që urgjentisht ta shqyrtojmë performansën e të gjitha agjencive që i raportojnë Kuvendit, ta rishikojmë seriozisht nevojën për pasjen e tyre. Kemi folur shumë për këtë temë, por deri më tani asnjë hap konkret nuk e kemi bërë. Është koha të veprojmë, të kalojmë nga fjalët në vepër. Pas rishikimit serioz, Kuvendi do të mund edhe të vendoste se pa cilat agjenci nuk bën dhe cilat nga këto janë të panevojshme, sepse rezultati që ato prodhojnë është zero, ose negativ.

Unë kërkoj falje që në fakt duket se devijova pak nga pika e rendit të ditës, por kjo që po them vlen për të gjitha agjencitë dhe tani prapë po kthehem te ARKEP-i. Raporti i punës gjithashtu evidenton që në vitin 2016, 44% e ankesave të konsumatorëve në fakt nuk kanë marrë përgjigje nga ARKEP-i. Kjo besoj se është një vërejtje e madhe që duhet të adresohet nga Kuvendi në adresë të ARKEP-it. Gjithashtu, në raportin e punës së ARKEP-it ceket se kanë rënë dukshëm investimet kapitale për shkak të mungesës së buxhetit, dhe kjo është evidente në qoftë se investimet kapitale të vitit 2016 krahasohen me investimet kapitale të realizuar në dy vite paraprake. Por, kjo assesi nuk do të duhej të ishte sfidë. Thjesht, një institucion rregullator duhet ta përfundojë ciklin e investimeve kapitale, thjesht infrastruktura e tij duhet të përfundojë, sepse kjo nuk është ndërmarrje private, shoqëri aksionare, e cila e investon dividendën e saj në funksion të rritjes.

Natyrisht që mund të paraqitet nevoja për avancime teknologjike, por jo të vazhdohet secilin vit me tenderë pa kurrfarë përmbajtje dhe të cilët absolutisht nuk kanë ndonjë efekt në performansën pozitive të institucionit.

Të nderuar kolegë,

Me logjikën e asaj që thashë nuk mund të rekomandoj as votim pro, as kundër, sepse sido që të votojmë efekti pothuajse është baras me zero. E ritheksoj edhe një herë se të gjithë së bashku këtu, pozitë dhe opozitë, jemi përgjegjës për të gjitha këto institucione që na raportojnë neve. Performansa e dobët e tyre është performansë e dobët e jona, e për këtë arsye ne duhet të veprojmë se është bërë shumë vonë. Përndryshe, jemi bashkëpjesëmarrës në krimin ekonomik të shumicës së tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar Haliti!

Unë tani do të flas shumë shkurt në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Raporti vjetor i punës së ARKEP-it ofron të dhëna mbi të arriturat e deritashme dhe angazhimet e autoritetit në arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike të përcaktuara me ligjet përkatëse dhe dokumentin e politikave të sektorit të komunikimeve elektronike. Gjithashtu, raporti e paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore për aktivitetet e rregulluara në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës.

Aktivitetet e ARKEP-it gjatë vitit 2016 u përqendruan kryesisht në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në nivel të ofrimit të shërbimeve, sigurimin e cilësisë së duhur të shërbimeve me çmime sa më të arsyeshme dhe oferta konkurruese për përdoruesit fundorë, përkatësisht konsumatorët, duke e siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Të nderuar,

Komunikimet elektronike, digjitalizimi dhe kompetencat tjera që i ka ARKEP me Ligjin për komunikimet elektronike janë tejet të rëndësishme edhe për procesin integruar, por edhe për transformimin e komunikimeve elektronike në funksion të zhvillimit ekonomik. Në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën përmenden një sërë sfidash në fushën e digjitalizimit. Nuk ka pasur progres në përmirësimin e pavarësisë financiare dhe organizative të ARKEP-it, siç e paraqiti edhe kolegja më parë. Këto sfida buxhetore që reflektojnë edhe në burimet njerëzore janë paraqitur edhe në raportin e ARKEP-it, të cilin po e shqyrtojmë tani. Sigurisht se si deputetë

kemi pasur kohë ta analizojmë, sepse komisioni e ka miratuar këtë raport në nëntor të vitit të kaluar dhe deputetët kanë pasur kohë ta analizojnë, edhe grupet parlamentare gjithashtu. Unë po e përfundoj dhe si grup parlamentar po shpreh përkrahjen e rekomandimit të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik për miratimin e raportit vjetor të këtij rregullatori. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur, as nga grupet, as nga deputetët. Përfaqësuesi i Qeverisë, në qoftë se e dëshiron fjalën, zoti Lluka?

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Përshëndetje, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Vetëm një përgjigje sa për informatë të operatorëve ilegalë në veri. Që nga 1 marsi, pra ka qenë e Qeverisë së kaluar, të gjithë operatorët ilegalë të telefonisë mobile i kanë ndërprerë aktivitetet ilegale, kurse Posta vepron vazhdon të jetë ashtu, por ka qenë pjesë e negociatave në Bruksel për të vazhduar, ashtu ka qenë edhe marrëveshja. Këtë e mora si informatë, veç thashë të ju informoj edhe si deputetë. Domethënë, nuk ka operatorë ilegalë të telekomunikacionit për momentin në veri.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, ministër, pyetja ime konkrete është kështu: A i keni ndërprerë ju, apo u besoni vetë atyre që ata duhet ta ndërpresin? Kjo është pyetje esenciale. A i keni ndërprerë ju me veprimtarinë e juaj, apo u besoni atyre kur thonë se nuk veprojnë më? Cila është e vërteta?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lluka, kundër-replikë ose sqarim, si të doni.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Normalisht se ARKEP ka bërë matjet dhe vazhdon t'i bëjë matjet, ku i sheh edhe aktivitetet ilegale dhe sipas ARKEP-it, domethënë nuk ka aktivitet ilegal. Domethënë, është aktivitet i ARKEP-it.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Regjia, bjerini ziles në qoftë se ka deputetë jashtë salle.

Atëherë, po vazhdojmë me pikën e 15-të të rendit të ditës, për shkak se kuorumi... duhet të jetë edhe një në sallë. Tani kuorumi është i mjaftueshëm. Faleminderit!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016. Në sallë janë 78 deputetë. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 71 deputetë. Për janë 47 deputetë, kundër 18, kanë abstenuar 6 deputetë.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016.

15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

I ftoj sipas përgjegjësive diskutuesit. I pari kryetari i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, zoti Nait Hasani, për arsyetimin e raportit në vitin 2018 për vitin 2016. Zoti Nait Hasani, e keni fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, më 18. 12. 2017 e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe ka kërkuar dhe kërkon që ky raport të miratohet në seancë plenare. Ky raport i plotëson të gjitha kushtet dhe është shqyrtuar dhe debatuar në komision bashkë me shefin e Agjencisë dhe ka rekomandimet e veta, po ashtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hasani! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” nuk është paraqitur askush. Nga Grupi Parlamentar i LDK-së askush, nga Grupi Parlamentar i PDK-së është paraqitur Xhevahire Izmaqu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar raportin e ASK-së për vitin 2016 dhe ka e këtë vlerësim: Duke u bazuar në Ligjin ekzistues për statistikën zyrtare, bartësi kryesor i statistikave zyrtare në Kosovë është Agjencia e Statistikave, si dhe Banka Qendrore e Kosovës, bashkë me Ministrinë e Financave.

Raporti i paraqitur nga Agjencia e Statistikave, i bazuar në zhvillimet e aktiviteteve të fundit, në sistemin statistikor të Kosovës ka ndodhur me një zhvillim të dukshëm, vlerësim ky që është pranuar dhe vlerësuar edhe nga Eurostati, pra një institucion qendror për statistika zyrtare në BE. Vlerësimi profesional për sistemin statistikor të Kosovës, në veçanti për Agjencinë e Statistikave

të Kosovës, Eurostatit e ka bërë edhe nëpërmjet raportit Peer-review në bazë të parimeve dhe kritereve që zbatohen për secilin sistem statistikor të vendeve BE-së.

Në bazë të këtij raporti, ASK-ja gjatë vitit 2016 ka arritur të realizojë prioritete të veçanta duke e zhvilluar planin strategjik dhe duke publikuar bruto-produktin vjetor në baza të rregullta tremujore, sipas standardit “T+90 ditë” dhe kjo është arritur në publikimin e tremujorit të tretë për vitin 2016. Gjithashtu është realizuar edhe shkurtimi i afateve të publikimeve tjera, sipas planifikimit. Ka ngritur cilësinë e statistikave të biznesit nëpërmjet realizimit të anketës për freskimin e regjistrimit statistikor të biznesit dhe hulumtimit mbi matjen e kapaciteteve hoteliere në Kosovë. Është shkurtuar afati i publikimit të të gjitha statistikave të biznesit.

Kur flasim për produktet tjera që i ka realizuar Agjencia e Statistikave për vitin 2016 ndalemi po ashtu të të gjitha indekset e çmimeve, kur është shkurtuar koha e publikimit të tyre. Është arritur të zbatohet aplikacioni softuerik për kalkulimin e indeksit të kostos së ndërtimit, pra ka edhe produkte të reja që i ka pasuruar gjatë vitit 2016 me punën e vet.

Gjatë kësaj periudhe, për herë të parë, anketa e fuqisë punëtore është publikuar në baza tremujore. Synimi është gjithashtu shkurtimi i afateve kohore. Për vitin 2016 është shkurtuar për 34 ditë, përkatësisht është publikuar më herët në krahasim me vitin paraprak, pra vitin 2015, sepse ne e shqyrtojmë raportin për vitin 2016, edhe pse është me vonësë. Mostra e anketës së ekonomive bujqësore është ridisenjuar duke i shfrytëzuar të dhënat e regjistrimit të bujqësisë të vitit 2014. Kjo është harmonizuar me metodologjinë më të re dhe definicionet e Eurostatit, dhe është realizuar në dhjetor të vitit 2015.

Për të gjitha produktet, për të cilat flasim se i ka realizuar Agjencia e Statistikave, gjithmonë ka qenë në bashkëpunim me Eurostat. Pra, është mbështetur dhe është vlerësuar me gjithë stafin për punën dhe përgjegjësinë që ka treguar gjatë gjithë këtij aktiviteti. Kemi të arritura të shumta, të cilat besoj që kolegët deputetë i kanë lexuar, sepse raporti është punuar në mënyrë shumë profesionale, e për këtë e vlerësojmë kryeshefin dhe gjithë stafin e ASK-së, mirëpo kemi edhe sfida. Ne e dimë që Agjencia e Statistikave vepron dhe punon në një objekt shumë të vjetër, asnjëherë të rinovuar. Pra, si institucione shtetërore e kemi ndihmuar shumë pak, më shumë është ndihmuar nga organizma ndërkombëtare dhe në këtë drejtim besoj që pas këtij raporti që pritet të vlerësohet pozitivisht, kemi arsye dhe justifikim që të kërkojmë më shumë mbështetje nga Qeveria.

PKD-ja voton pro raportit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, raportin të cilin ne po e shqyrtojmë sot, pra jemi në janar të vitit 2018, është raport i punës së Agjencisë së Statistikave i vitit 2016. Kështu që e ka humbur pak kuptimin diskutimi i këtij raporti, sepse Agjencia e Statistikave në fakt është agjenci qeveritare, nuk është agjenci e pavarur, e cila i përgjigjet Kuvendit, ajo i përgjigjet Zyrës së Kryeministrit. Pra, kur flasim për agjencinë, përgjegjëse në një masë bukur të madhe për punën e saj është edhe Qeveria. Në kohën kur ne po e shqyrtojmë raportin, kjo Qeveri nuk ka qenë në këtë përbërje, pra ka qenë në një përbërje tjetër, prandaj çdo vërejtje që japim nuk besoj se do të shkojë në adresën e duhur, edhe pse shpresoj që Qeveria e tanishme do t'i ketë parasysh ato.

Pra, Agjencia e Statistikave e Kosovës është njëra ndër agjencitë apo institucionet shtetërore tejet të rëndësishme, e cila, për fat të keq, asnjëherë nuk e ka marrë vëmendjen e duhur nga asnjëra nga qeveritë e mëhershme. Të vetmen herë kur flitet më shumë për agjencinë është kur ajo bën regjistrimin e popullsisë, që është njëri nga aktivitetet që kjo agjenci e bën një herë në dhjetë vjet. Megjithatë, kjo agjenci do të duhej të prodhonte, e deri në një masë edhe prodhon, të dhëna tejet të rëndësishme, në bazë të të cilave pastaj, jo vetëm Qeveria, por edhe institucionet tjera do të duhej t'i bazonin planet dhe planifikimet e tyre për aktivitetet, apo sidomos projektet e ndryshme. Por, deri më tani ne shumë pak kemi parë ndonjë institucion të thirret në të gjeturat e agjencisë, e më së paku Qeveria.

Ne edhe më herët, kur diskutuam për strategjinë për energjinë, ta zëmë, nuk e di se sa janë bazuar në të dhënat, të cilat kjo agjenci duhet t'i grumbullojë, në mënyrë që pastaj ne të kemi një planifikim të bazuar në nevoja reale të qytetarëve, por më shumë planifikimi bëhet, ta zëmë, përmendësh.

Kështu që Qeveria as nuk ka investuar mjaftueshëm për rritjen e kapaciteteve të kësaj agjencie, të këtij institucioni të rëndësishëm dhe, në anën tjetër, as nuk i ka përdorur mjaftueshëm të dhënat që ata i publikojnë.

Kjo agjenci më shumë është mbështetur nga organizata ndërkombëtare dhe, thënë të drejtën, është lënë në mëshirën e tyre se sa këto organizata kanë pasur vullnet a dëshirë që ta ndihmojnë këtë institucion, ashtu sikurse edhe të dhënat që i ka publikuar më shumë si duket janë përdorur nga hulumtues të ndryshëm se sa nga vetë institucionet tona, kur ato kanë bërë planifikim, nëse vërtet kanë bërë planifikim në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Pra, agjencia ashtu siç është lënë e pambështetur nga Qeveria, ashtu edhe ka punuar, kaq ka qenë edhe niveli i kualitetit të produkteve që ka nxjerrë, edhe pse ne nuk jemi të thirrur ose, të paktën, unë personalisht nuk mund të jap ndonjë vlerësim për kualitetin e produkteve që ata nxjerrin, hulumtimeve të ndryshme që bëjnë, sepse nuk jam eksperte e fushës.

Por, një shqetësim tjetër është fakti se kjo agjenci në shumicën e herëve dhe është një nga sfidat që përmendet edhe në raport, është se kanë qenë vetë institucionet shtetërore, të cilat nuk kanë ofruar bashkëpunim, nuk i kanë ofruar të dhënat administrative, në bazë të të cilave pastaj agjencia i nxjerr të dhënat, gjegjësisht statistikat e tyre.

Kështu që edhe një herë, është e pakuptimtë të flitet dhe të diskutohet për raportin, përderisa është e nevojshme të diskutohet për vetë agjencinë, çka kërkojmë ne nga kjo agjenci, çfarë lloj raportesh, të dhënash kërkojmë dhe si i përdorim pastaj këto të dhëna në planifikime të ndryshme, në projekte të ndryshme, qoftë kapitale apo të tjera, të cilat Qeveria e Kosovës duhet t'i prodhojë.

Në parim, raporti është në rregull, sepse kjo është çka kanë bërë ata, e për më shumë unë shpresoj se ne së shpejti do ta kemi Ligjin për Agjencinë e Statistikave, e ku ky Kuvend do të diskutojë seriozisht se çka e ka ndërmend të bëjë me këtë agjenci, a do të jetë njëra nga institucionet ku partitë politike në pushtet thjesht punësojnë militantë të tyre politikë, a familjarë, apo do t'ia kushtojmë vëmendjen e duhur, në mënyrë që vërtet të shërbejë si burim i të dhënave, nga të cilat pastaj ne hartojmë politika të mirëfillta shtetërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Nga raporti vjetor për vitin 2016 shihet se në sistemin statistikor të Kosovës ka ndodhur progres i theksuar, krahasuar me vitet paraprake.

Vlerësim pozitiv për progresin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës ka dhënë edhe Eurostat, institucioni qendror për statistikat zyrtare në BE.

Statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës, ashtu si në çdo vend të botës, janë jashtëzakonisht të rëndësishme, qoftë për zhvillimin e politikave të ndryshme zhvillimore, hartimin e ligjeve, hartimin e strategjive afatgjata, hartimin e programeve dhe projekteve kapitale, proceset me rëndësi të zhvillimit socio-ekonomik të vendit, e deri tek pasqyrat apo të dhënat zyrtare që e prezantojnë Republikën e Kosovës në botë.

Edhe gjatë raportimit të përfaqësuesve të agjencisë në Komisionin Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media është konstatuar se në kuadër të raportit 2016 është bërë analiza e prioriteteve të realizuara gjatë vitit 2016, në kontekst të prodhimit, fuqizimit, kornizës planifikuese, dialogut me shfrytëzues, e të tjera.

Në bazë të raportit del se ASK-ja ka arritur të realizojë shumë prioritete.

Shprehur me tregues strukturorë, performansa nga pikëpamja e prodhimit statistikor gjatë vitit 2016, në raport me vitin 2015, ka shënuar rritje në shkallën prej 11,76% në produkte statistikore.

Po ashtu, nga raporti i prezantuar prej agjencisë kemi konstatuar se përkundër rezultateve të preکشme, kjo agjenci ka kaluar dhe po kalon nëpër disa sfida, si mungesa e hapësirës për punë, kushtet shumë të këqija për punë në një objekt të vjetër, mungesa buxhetore, e si pasojë e kësaj, edhe mungesa e resurseve njerëzore.

Po ashtu nga raporti del se kjo agjenci më shumë është ndihmuar nga donatorët ndërkombëtarë, se sa institucionet vendimmarrëse të Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës tashmë ka hyrë në një proces shumë dinamik të integritit evropian.

Kosova dhe BE-ja tashmë kanë një marrëveshje me MSA-në, pra Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Neni 95 i kësaj marrëveshjeje përcakton shumë qartë obligimet e institucioneve të Kosovës lidhur me statistikat zyrtare. Këto obligime janë vendosur edhe në planin kombëtar për zbatimin e MSA-s.

Detyrimet e zhvillimit të statistikave zyrtare gjithashtu janë vendosur në agjendën për reforma evropiane dhe të gjitha raportet vjetore të progresit nga Komisioni Evropian.

Suksesi në rrugën e integritimeve evropiane varet se sa Kosova përmbush obligimet nga zotimet e marra.

Në këtë drejtim, edhe për fushën e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës është vendimtare zbatimi i rekomandimeve që dalin nga vlerësimet e Eurostatit për sistemin statistikor të Kosovës.

Pikërisht në bazë të këtyre rekomandimeve dhe nevojave të tjera për sistemin statistikor të Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të përkrahet dhe të mbështetet shumë më shumë, duke miratuar sa më shpejt ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të statistikave të Kosovës numër 04/L-036, i cili është në riprosesim, si dhe duke e përkrahur më shumë në aspektin buxhetor dhe ofruar kushte sa më të mira të punës për stafin e kësaj agjencie.

Besoj shumë se kjo agjenci do ta ketë vëmendjen e shtuar të Qeverisë Haradinaj.

Aleanca e përkrah këtë raport.

KRYESUESI: Zoti Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

E gjithë vendet e botës ose gjithë klasa politike dhe deputetë në çdo vend të botës e kuptojnë besoj që një agjenci e tillë është pothuajse koka e shtetit. Po të kishim një agjenci funksionale të statistikave, ne nuk kishim me pasur problem edhe me Ligjin zgjedhor.

Ne mendojmë që Qeveria duhet të krijojë një ekip, një grup punues që së bashku me agjencinë të flasin konkretisht për nevojat që kjo agjenci i ka, për arsye se vërtet punojnë në kushte të jashtëzakonshme.

Kosova po ashtu është vend që nuk ka edhe agjenci të lajmeve shtetërore, të gjitha vendet perëndimore e kanë.

Prandaj i mbetet Qeverisë të punojë në këtë drejtim.

Ne si “Nismë” e mbështetim këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e dëshiron fjalën.

Në sallë janë 65 deputetë.

Zoti Krasniqi, uluni, kemi votim. Po vazhdojmë votimin e raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Në sallë janë 66 deputetë. Kanë votuar 56. Po e përsëris edhe një herë votimin, nuk e di pse, edhe një herë po e përsëris votimin.

Regjia, votojmë tani. Faleminderit!

Kanë votuar 65 deputetë, për kanë votuar 56, 4 janë kundër dhe 5 abstenime. Konstatohet që Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016.

16. Shqyrtimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës për vitet 2017-2026

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës për vitet 2017-2026 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ministrin Valdrin Lluka, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës për vitet 2017-2026, zoti Lluka keni fjalën.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë,

Pas një pune të gjatë, procesi konsultues me të gjitha palët e interesit dhe organizata ndërkombëtare aktive në sektorin e energjisë kam kënaqësinë t'ju prezantoj sot për miratim dokumentin më të rëndësishëm në sektorin e energjisë, Strategjinë të Republikës së Kosovës për vitet 2017-2026.

Strategjia e energjisë synon krijimin e një sektori të zhvilluar të energjisë, të padëmshëm për mjedisin dhe shëndetin, në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenies shoqërore në Kosovë, në kuadër të një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë.

Arritja e këtij synimi është bazuar në 5 objektiva strategjike:

1. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike,
2. Integrimi në tregun rajonal të Energjisë,
3. Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja,
4. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror, dhe
5. Plotësimi i caqeve dhe obligimeve në efikasitet të energjisë, burime të ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit.

Elementet kryesore të këtij dokumenti janë: siguria e furnizimit të qëndrueshëm, të besueshëm dhe të pandërprerë me energji elektrike, si kusht për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Sipas kësaj strategjie, Qeveria do të vazhdojë të përkrahë projektin e ndërtimit e termocentralit “Kosova e Re” me kapacitet neto 450 MW, me investime të sektorit privat në kuadër të partneritetit publik-privat.

Bazuar në ecurinë e deritashme të projektit, Qeveria konsideron të realizueshëm këtë projekt deri në vitin 2023.

Ndërtimi i termocentralit “Kosova e Re” do të zbatohet në harmoni me kërkesat e direktivës 2010/75 të Bashkimit Evropian.

Ky termocentral do të ketë edhe mundësinë e kogjenerimit në masën 10% të kapacitetit neto të instaluar, pra rreth 45 megavatë.

Për shkak të pamjaftueshmërisë së kapaciteteve të termocentraleve, resurseve natyrore mjaft të kufizuara ujore dhe erës si dhe duke pasur parasysh përballueshmërinë e kostos së furnizimit me energji elektrike, Qeveria është e detyruar të mbështesë alternativën e vazhdimit të punës të termocentralit “Kosova A” deri në fillimin e prodhimit të energjisë nga termocentrali “Kosova e Re”.

Duke e konsideruar termocentral tepër të nevojshëm për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, Qeveria do të jetë në mbështetje të rehabilitimit të “Kosovës B” në çdo alternativë të financimit.

Rehabilitimi i tij do të bëhet duke marrë parasysh zbatimin e detyrimeve mjedisore të Kosovës, si palë kontraktuese e komunitetit të energjisë.

Periudha e rehabilitimit të termocentralit “Kosova B” do të ndërlidhet me fillimin e punës së kapaciteteve të reja, rezultateve të studimit të fizibilitetit dhe moscenimin e furnizimit të ngrohtores “Termokos” me energji termike.

Bazuar në interesimin e madh të shprehur të investitorëve privatë për aplikim për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, Qeveria konsideron se skemat aktuale mbështetëse, megjithëse kanë dhënë disa rezultate, të cilat janë të pamjaftueshme nevojiten masa shtesë si për largimin e barrierave administrative për investitorët, ashtu edhe për krijimin e politikave të mbështetjes së investitorëve ndërmjet aplikimit të praktikave më të mira në rajon në aplikimin e skemave mbështetëse për nxitjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.

Qeveria parasheh që brenda kësaj periudhe të kemi diku rreth 400 megavatë nga burimet e ripërtëritshme.

Duke qenë se integrimi në tregun rajonal të energjisë ndikon në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, po ashtu reflekton zotimet në kuadër të agjendës së interkonektivitetit të vendeve të Ballkanit perëndimor, Qeveria do të thellojë përpjekjet e nisura në drejtim të integritimit në tregun rajonal të energjisë.

Kjo strategji mbështetë uljen e kërkesave për energji elektrike nëpërmjet masave të efikasitetit të energjisë. Në fokus të kësaj strategjie, përveç energjisë elektrike, është edhe zgjerimi i sistemeve ekzistuese të energjisë termike në një plan afatmesëm si dhe zhvillimi i sistemeve të reja në pjesën e urbanizuara të qyteteve të mëdha.

Kjo strategji synon zhvillimin e të gjitha parakushteve për ndërtimin e infrastrukturës së gazit natyror në një plan më afatgjatë.

Krahas angazhimeve për arritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, Qeveria me mbështetjen edhe të institucioneve të tjera shtetërore, institucioneve ndërkombëtare dhe donatorëve do të angazhohet që të zbatojë praktikën më të mirë të vendeve të ngjashme me Kosovën për trajtimin e komuniteteve të prekura nga aktivitetet e prodhimit të energjisë elektrike.

Bazuar në politikat e Bashkimit Evropian për zhvillimin e sektorit të energjisë në të ardhmen, kjo strategji ka identifikuar nevojën e studimeve për sektorin e energjisë, që përfshin periudhën deri në vitin 2040, të cilat do të zhvillohen gjatë periudhës së trevjeçarit të parë.

Politikat dhe masat e sipërcekura do të zbatohen në programe dhe projekte konkrete në dokumentin pasues të saj. Pra, programi i zbatimit të strategjisë së energjisë për vitet 2018-2020, i cili dokument, sipas Ligjit për energji, duhet të përgatitet dhe të dërgohet për miratim në Qeveri pasi të miratohet strategjia në Kuvend.

Duhet cekur se orientimi strategjik në skenarin referent është vendosur nën harmonizimin e këtyre kriterëve:

Siguria e furnizimit, adekuacia e gjenerimit, bilanci energjetik, kosto e investimeve, niveli i misionimit, mbështetja në integrimin e burimeve të ripërtëritshme dhe integrimi në tregun rajonal.

Strategjia e energjisë e shoqëruar edhe me tetë shtojca që kanë për qëllim të ofrojnë një informacion sa më të plotë për bazën mbështetëse të politikave dhe masave të duhura për arritjen e synimit të strategjisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka zonja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Më duket që grupet parlamentare dhe kryetarja e Komisionit Funkcional e kanë radhën.

KRYESUESI: Zonja Berisha e ka fjalën në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministër,

Të gjithë të pranishëm,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të neneve 62, 65 dhe 67 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22. 12. 2017 ka shqyrtuar Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës për vitet 2017-2026.

Në bazë të nenit 6 të Ligjit numër 05/L-081 për energji, Qeveria i paraqet Kuvendit strategjinë dhjetëvjeçare për miratim, me anë të së cilës përcakton politikat e energjisë dhe të planifikimit për zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë.

Komisioni ka shqyrtuar dhe ministri e ka prezantuar para deputetëve në komision, e ka prezantuar strategjinë në fjalë, komisioni me shumicë votash konkludoi se kjo strategji është hartuar në përputhje me Ligjin për energji dhe Kuvendit i rekomandon për miratim.

Tani, nënkryetar, nëse mund ta shfrytëzoj rastin edhe në emër të grupit të flas.

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe nënkryetar që nuk po dëgjon çka po të pyes,

Nëse ma jep lejen të flas edhe në emër të grupit 2-3 fjalë.

Ministri e paraqiti ekspozenë një dokument shumë të rëndësishëm, siç është Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për vitet 2017-2026.

Një ndër faktorët kryesor të zhvillimit ekonomik të vendit dhe ngritjes së mirëqenies së shoqërisë është edhe siguria e furnizimit me energji elektrike.

Duke qenë se zhvillimi i sistemit të qëndrueshëm energjetik kërkon kohë, vendimet e duhura për të ardhmen e sektorit të energjisë duhet të merren shumë më herët.

Në dokumentin në fjalë janë të apostrofuara problemet dhe objektivat se si të zgjidhen ato probleme. Si probleme themelore, të cilat janë paraqitur në strategji, me të cilat ballafaqohet sektori i energjisë në Kosovë, janë ngecjet në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike nga linjiti dhe rehabilitimi i tyre, për të cilat më parë foli edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik. Mandej, problem tjetër është edhe jomjaftueshmëria e kapaciteteve të gjenerimit për mbulimin e pikut në kohën e sezonit dimëror, mungesa e rezervave të fuqisë

sekondare dhe terciare në sistemin si rrjedhojë e mungesës së gjeneratorëve fleksibil për shkak se 97% e prodhimit vendor bazohet në termo-energji, përkatësisht në energji nga linjiti.

Mandej, një problem që po e përcjell Kosovën dhe sektorin e energjisë është edhe menaxhimi i rrjedhave ndërkufitare nga operatori i sistemit të transmetimit si pasojë e pengesave nga operatori i sistemit të transmetimit të Serbisë. Problem tjetër është edhe mosshfrytëzimi i duhur i potencialit të kursimit të energjisë, si dhe mosshfrytëzimi i duhur i burimeve të ripërtëritshme. Sidoqoftë, Strategjia e Energjisë që është e paraparë në këtë dokument ka përcaktuar pesë objektiva strategjike, siç janë:

1. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike.
2. Integrimi në tregun rajonal të energjisë.
3. Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja,
4. Zhvillimi infrastrukturës së gazit natyror,
5. Plotësimi i caqeve dhe obligimeve në efikasitet të energjisë, burime të ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit.

Materialin, dokumentin e rëndësishëm e kemi pasur të gjithë me kohë shumë herët, besoj që secili deputetë e ka shqyrtuar në mundësitë e veta dhe secili grup parlamentar. Më tutje, zbatimi i kësaj Strategjie të Energjisë paraqet një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, jo vetëm për furnizim të qëndrueshëm me kualitet të lartë, të sigurt dhe të besueshëm me energji në Kosovë, por edhe për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit, si dhe për sigurinë nacionale.

Duke i njohur të gjitha sfidat e sektorit të energjisë në Kosovë, është shumë e qartë se për ta arritur këtë synim madhor kërkohet një kontribut i fuqishëm nga të gjithë pjesëmarrësit, përfshirë institucionet tona, Kuvendin, Qeverinë, por përfshirë edhe institucionet përkatëse ndërkombëtare.

Si Grup Parlamentar e përkrahim rekomandimin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik për miratimin e kësaj strategjie. Ju ftoj ta miratoni edhe ju, kolegë deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e keni fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për vitet 2017-2026, që e kemi para vetes, i ka disa mangësi, të cilat duhet të plotësohen për t'i përmbushur kriteret dhe për ta quajtur "strategji".

Në lexim të parë duket se kësaj strategjie i mungon orientimi i qartë strategjik. Janë disa pika, për të cilat unë dua të flas. Strategjia në masë të madhe merr për bazë kërkesën e tanishme për energji elektrike, duke mos pasur parasysh që kjo kërkesë rritet natyrshëm. Në strategji ceket nevoja për investime në sektorin e energjisë, gjë që është e evidente, por nuk është paraparë saktë se si do të arrihet një gjë e tillë.

Strategjia, për befasinë tonë, gjithashtu nuk merr parasysh eficientësinë e energjisë si burim të energjisë, edhe pse një gjë e tillë tanimë gjithandaj konsiderohet si burim energjie.

Një element tjetër që strategjinë nuk e bën shumë të saktë është fakti se strategjia është hartuar para se të nënshkruhet kontrata për "Kosovën e Re", që nënkupton që shumë elemente të këtij projekti nuk janë të reflektuara në strategjinë 2017-2026. Lidhur me projektin e "Kosovës së Re", shihet se strategjia nuk e ka asnjë element të analizave paraprake për çmimin e përballeshëm të energjisë nga bizneset dhe qytetarët. Kjo mandej na rezulton se kontrata për "Kosovën e Re" nuk e ka marrë fare parasysh koston sociale të prodhimit të energjisë.

Ne të gjithë pajtohemi se është bërë tepër vonë për Kosovën, për ndërtimin e kapaciteteve energjetike, por gjithashtu jemi të vetëdijshëm se çmimi i papërballeshëm i energjisë është po aq problem sa edhe mungesa e saj. E kjo do të evidentohet sapo të jetësohet projekti.

Strategjia gjithashtu nuk merr parasysh trendët afatgjatë të politikave të BE-së, ku ne aspirojmë, të cilat po përgatiten që në afat të gjatë ta dekarbonizojnë komplet këtë sektor dhe të fokusohen në burime të ripërtëritshme. Strategjia nuk e trajton fare mungesën e rezervave të naftës, e një strategji pa trajtim të kësaj çështje nuk mund të quhet strategji. Siç e dimë, ne kemi obligime, të cilat burojnë nga nënshkrimi i traktatit të energjisë në Vjenë, e cila e obligon Kosovën që deri në vitin 2022 të ketë rezerva të naftës për 90 ditë konsum, ose sasinë e 60 ditëve të importit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të ju informoj që në Qeverinë e kaluar e patëm sjellë Ligjin për naftën, i cili ligj në masë të madhe ka pasur për qëllim që të adresojë çështje të tilla, fillimisht me krijimin e deponive. Por, kjo është një çështje tjetër, sepse ligjin e kemi tërhequr pikërisht për shkak të ndikimit të grupeve të interesit ndërmje dy leximeve në Kuvend. Ajo çfarë po dua të them është se kjo strategji e ka lënë jashtë naftën komplet dhe si e tillë është tepër e mangët.

Gjithashtu, nuk është elaboruar sa duhet integrimi i tregut të energjisë dhe nuk flitet për impaktin e integritit të këtij tregu te aktorët në këtë sektor. Një gjë tjetër, e cila gjithashtu mund të konsiderohet si mangësi e strategjisë, është gjithashtu se është lënë jashtë çfarëdo mundësie e kyçjes së Kosovës në gazsjellësin “Trans-Adriatik TAP”. Unë jam e vetëdijshme që kostoja e kyçjes në “TAP” mund të duket edhe e papërballueshme për vendin sot, por jam gjithashtu e vetëdijshme se ne si vend nuk posedojmë as rrjet të shpërndarjes së gazit. Mirëpo, të paktën strategjia do të duhej ta parashihte një studim të fizibilitetit, i cili do të duhej të shqyrtonte mundësinë e Kosovës të kyçjes në “TAP” nën ndritën e krijimit të rrethanave të reja, siç janë: politikat e BE-së drejt dekarbonizimit të sektorit, siç janë indikatorët realë për ngritjen e çmimit të energjisë në 5-6 vjetët në vijim dhe me hapjen e projektit “Kosova e Re”, dhe gjithashtu para së gjithash duke marrë parasysh faktin se edhe me përfundimin e projektit “Kosova e Re”, ne të gjithë e dimë që Kosova nuk do të ketë energji të mjaftueshme për t’i mbuluar të gjitha nevojat e tregut të saj vendor.

Dhe, në fund, kësaj strategjie i mungojnë rezultatet e pritura, i mungon analiza e zbatueshmërisë, nuk ka fare analizë se çfarë do të prodhojnë politikat shtetërore në sektorin e energjisë, mungojnë indikatorët matës, gjë që duket të jetë bërë jo pa qëllim, sepse në këtë formë siç është shkruar është vështirë që dikush ta matë zbatimin e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Kabinet qeveritar,

Kosova i ka katër drejtime me potencial të zhvillimit ekonomik ku ligjërisht kontrollin e menaxhimin e ka ende sektori publik. Ato janë: Trepça, prodhimi i energjisë elektrike, ujësjellësi e kanalizimi, dhe Posta e Telekomit i Kosovës. Për të gjitha këto ka pasur dhe ka projekte në vijimësi për t’u hequr nga administrimi dhe pronësia publike drejt asaj private. Nëse me Ujësjellësin dhe Trepçën këto përpjekje janë ende në gjenezë dhe për PTK-në është ndaluar një proces privatizues për shkak të vështirësive të panumërta për privatizimin e saj, sektori i energjisë është ekspozuar më së shumti duke u cenuar po ashtu më së shumti.

Ne e dimë se Kosova është shumë e pasur me linjit. Ky linjit eksploatohet kollaj sepse ndodhet shumë pranë sipërfaqes së tokës dhe ai paraqet burimin kryesor të energjisë për neve.

Mirëpo, me kontratën e fundit midis Qeverisë dhe Fondit Investiv Contour Global neve do të na shtrenjtohet energjia, pra do të na rriten faturat me përqindje shumë më të lartë se sa edhe ajo shkalla e kthimit në kapital të garantuar për Contour Globalin prej 18,5%. Nëpërmjet kësaj kontrate, Qeveria ka marrë vendim edhe për qeveritë e ardhshme, edhe për brezat e ardhshëm.

Dhe tash na vjen kjo strategji në Kuvendin e Republikës pasi që vendimi kryesor tashmë është marrë. Nuk mund të merret vendimi për një strategji nëse tashmë është marrë vendimi brenda një strategjie. Pra, kjo i bie sikurse ta nxjerrësh qerren para kuajve. Dhe, nuk ka kurrfarë kuptimi që sot të diskutohet këtu për strategjinë e energjisë në Republikën e Kosovës deri në vitin 2026 kur nuk kemi pasur kurrfarë diskutimi, as që i ka paraprirë as që e ka pasuar kontratën e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Contour Globalin.

Çmimi final, i cili dikur propagandohej që nuk do t'i kalonte kurrsesi 80 euro për megavat orë, në kontratë është e qartë se i kanë vendosur edhe një bonus prej 20% në qoftë se prodhohet madje edhe vetëm një MWh më shumë. Si zakonisht, shteti i Kosovës, qytetarët si tatimpagues nëpërmjet kësaj Qeverie që bëri këtë kontratë të dëmshme, do të mbulojnë gjithë riskun, do ta paguajnë atë, të japin falas tokën, burimet të shiten me çmim më të ulët se sa prodhimi, të zhvendosen banorët, ne me buxhet të mbulojmë kostot, ta sigurojmë ujin, ta japim falas infrastrukturën e ujit dhe të negociojmë për çmimin e ujit jashtë rregullave dhe ta marrim përsipër si shtet – nëpërmjet kësaj qeverie që del të jetë kundër shtetit - mosshitjen aty për aty të energjisë së prodhuar duke ia paguar këtë bonus 20% të çmimit kur sistemi nuk ka nevojë më për të.

Natyrisht që këtë e bën edhe më të rëndë fakti që në kuadër të një procesi të këtyllë privatizues krijohet një ndërmarrje e re publike. Shihni çfarë ironie: ndërmarrjet publike duhet t'i shërbejnë interesit publik, ndërkaq në këtë rast parashihet krijimi i një kompanie të re, New Kosovo Electricity Company, e cila është aty për ta garantuar që do t'ia blejë çdo MWh të prodhuar Contour Globalit, pavarësisht se a kemi nevojë për të ose jo.

Në vend se kapacitetet e reja energjetike t'i ndërtojmë me para publike, ne ndodhemi në situatën ku falim pasuritë tona, investojmë ne në një fond investiv për hir të privatit pastaj garantojmë atë privat duke u zotuar që do të paguajmë pavarësisht se sa na nevojitet por veçse varësisht prej asaj se sa do të prodhojnë ata. Pra krijohen kompani të reja publike në shërbim të interesit privat!

Ne e dimë që situata energjetike në Kosovë është shumë e rëndë. U pat negociuar marrëveshja për energjinë me Serbinë dhe ende KOST-i, sot e kësaj dite, pengohet nga Serbia për anëtarësim në ENTSO-E dhe, si rrjedhojë, interkonjeksioni me Shqipërinë mbetet i bllokuar, kurse privatizimi i KEDS-it tash nuk ka qytetar i cili nuk e di se ishte kriminal e me dëme tejet të mëdha. Kur kësaj ia shtojmë edhe faktin që nuk u bë kurrfarë rindërtimi i Kosovës A, e kur ia shtojmë edhe këtë kontratën me Contour Globalin, unë nuk besoj se kjo Qeveri mund të ketë më kredibilitet që të propozojë strategji.

Së pari, është shumë e arsyeshme dhe po ashtu e domosdoshme besoj, referuar kalendarit që keni përpara sa i takon gjenerimit të energjisë në Kosovë, që të fillohet nga puna për rindërtimin e Kosovës A. Është shpërfillur projekti i Bilfinger, por është i domosdoshëm rindërtimi i Kosovës A. Duke rindërtuar Kosovën A, ne do të siguroheshim që së pari të kemi gjenerimin e nevojshëm të energjisë në një afat shumë më të shkurtër.

Së dyti, kjo do të na lejonte që të projektonim e vendosnim, jo në kushte të urgjencës për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, por në kushtet e planifikimit dhe të një vizioni

zhvillimor. Modelin financiar, volumin e kapacitetin, vendndodhjen, sigurimin e mjeteve për zhvendosjen eventuale të popullsisë, studimin e mirëfilltë ambiental, si dhe disa shqyrtime të rëndësishme sa i takon sektorëve të tjerë të industrisë, që lidhen direkt me kërkesën për energji elektrike siç janë modeli i zhvillimit dhe të prodhimit në Trepçë, industri të reja të prodhimit vendas, rrjeti dhe kapacitetet e reja të furnizimit me ujë, që të gjitha këto do të ishin pjesë përbërëse të një vizioni zhvillimor ekonomik nacional, i cili do t'i paraprinte strategjisë për energji në Republikën e Kosovës e që më tutje do t'i paraprinte çfarëdo ndërtimi të kapaciteteve të reja energjetike që do të duhej të bëheshin para së gjithash duke mobilizuar fondet publike që kemi ne, e kurrësi fondet investive private, në shërbim të së cilëve po e vëmë shtetin e Kosovës, përkatësisht interesin publik të qytetarëve. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ky vend dhe qytetarët e këtij vendi do të ishin shumë të lumtur sikur partitë politike të krijojnë shtabe, jo për të shikuar kush kë po e sha, ose të marrin fushata denigruese, fyese e poshtëruese ndaj kundërshtarëve politikë, por për të shikuar kush e ka shkatërruar Trepçën, që foli zoti Albin Kurti. Besoj që i merr nëpër portale Albin këto që do t'i them, se do të jap pak informacion. Kah janë shitur mineralet në Kinë dhe për mua është shumë brengosëse kur shefi i opozitës çdo fjalim të vetin e përdor veç për fushatë.

Domethënë, si t'ia nisë të flasë e deri ta mbarojë fjalimin mendon se qysh do ta votojnë qytetarët e Kosovës, se fjalimi i tij në mënyrë absolute nuk pati kurrfarë domethënie për një projekt, të cilin ne po e diskutojmë. Pse po e them këtë? Po e marr pak me radhë për të ardhur në atë që unë në mënyrë absolute dhe Grupi "Nisma" e përkrahim projektin e Qeverisë për ndërtimin e një termocentrali të ri me standarde evropiane dhe ekologjike, sepse as Albin Kurti, as kurrkush këtu në sallë që e kundërshton këtë projekt nuk na e jep një alternativë se cili do të ishte plani B.

A do ta bëjmë ne një termocentral atomik? A do ta bëjmë ne një hidrocentral si Shqipëria? A kemi ne kapacitete të ujit? Por, vetëm të kundërshtohet në qoftë se Qeveria vjen këtu dhe thotë që bora është e bardhë, këta duhet të thonë "jo është e zezë". Veç sa për të thënë, të këqyrin tani kush po thotë atje, duke pirë çaj me gjygyma, "këqyre këta qysh po e kundërshtojnë Qeverinë Haradinaj".

Së pari, që ta dinë qytetarët e Kosovës, KEK-un e kanë shkatërruar ndërkombëtarët së bashku me dy partitë që e kanë qeverisur këtë vend, Lidhja Demokratike e Kosovës me Partinë Demokratike të Kosovës. Ani, fishkëlleni ju, hiç të mos ua ndiej, po veç të flas unë, tani dilni ju në foltore e flisni edhe PDK-ja, edhe LDK-ja deri në mëngjes këtu, unë me argumente ju "fryj". Po, ju flisni me sms-a, qysh jua dërgojnë shefat e partive. Ju nuk flisni me argumente. Edhe unë dua të jua jap disa argumente qysh e keni shkatërruar ju KEK-un me "Ferronikelin" dhe qysh i keni

mbushur vagonët me naftë. Në Selanik janë mbushur vagonët me ujë, kanë ardhur në Doganë të Kosovës dhe janë shkruar me naftë, kanë shkruar në KEK e janë zbrazur natën, nuk ka pasur naftë, por ka pasur ujë, e para. Ju e keni duruar Xho Trashlerin që e keni pasur shef të KEK-ut, i cili i ka vjedhur 5 milionë të KEK-ut e i ka dërguar në konton e vet në bankë në Spanjë dhe është dënuar në Gjermani me 5 vjet burg.

Ju i keni duruar ndërkombëtarët kur i kanë kontrolluar dhe i kanë krijuar krejt mekanizmat e hajnisë dhe të faqeve të zeza me ju dy partitë. Bashkë i keni bërë këto. Ju veç i keni flladit ndërkombëtarët, pasi jeni zhegitur edhe ju, tani ia keni nisur t'i shani.

E dyta, po kalojmë te kontrata e “Ferronikelit”. Ju të dy partitë e keni ditur që “Ferronikeli” ka bërë kontratë fikse me KEK-un, ku 1 Mw rrymë është paguar vetëm 33 euro dhe blerjen e kemi bërë 120 euro, kur ka hyrë në KEK, ajo rrymë, shiko si qesh Ganimetja, se u zhegit, tash po del jashtë, edhe ai megavat prej KEK-ut, që i është shitur Ferronikelit... hajde Ganimete, fol edhe ti pak pas meje... ai megavat i është shitur “Ferronikelit” 33 euro. Kanë bërë kontratë fikse, mere me mend, për 5 vjet, kontratë fikse.

Tjetra? Te puna e PTK-së, më mirë ka qenë ta shesim ne PTK-në, se sa ta vjelin PTK-në, edhe Z-Mobile, edhe IPK-o, edhe krejt. Imagjinojeni, një lopë të japë 30 litra qumësht dhe qumështin e asaj lope, në vend se ta çojmë në familjet tona, qumështin e asaj lope e kanë pirë operatorët tjerë, Z-Mobile, IPKO, e plot të tjerë. Për këtë s'ua ka ndie hiç, se juve veç ju ka interesuar kush po na shan, çka po thotë, qysh t'i themi Qeverisë që nuk e ke mirë.

Hajde tash kalojmë te KEDS-i. Të gjithë e dimë se KEDS-i është shitur 23 milionë. Vetëm ndërtesa në qendër ka vlerë 70-80 milionë. Po pse bre nuk po e bëjmë ne komisionin për ta verifikuar qysh u shit, qysh shkoi procesi? Por, nuk doni ju të bëni komisione, ju doni të bëni llanga-llanga-llanga këtu për vota, sepse po të bëni komisione zbuloheni vetë ju që jeni në ato hajni, në ato procedura dhe tani qysh ta bëni? Qysh të bëni komision për ta zbuluar veten tënde. Hajt! Nuk shkon!

Të gjithë e dimë që aty është bërë krim. Është bërë krim në Postë, është bërë krim në Aeroport, është bërë krim në privatizim, është bërë në KEDS, e ne këtu veç flasim. Hajde t'i bëjmë, hajde i bëjmë grupet hetuese, hajde t'i hetojmë këto procese, e të këqyrim ku po del rezultati. Edhe “Trepça”, ne e dimë, po ju e dini e s'doni të flisni, se e dini më mirë se unë, mineralet e “Trepçës” janë shitur prej Mitrovicë në Kinë. Një kamion me kristale të “Trepçës” është shkruar 250 euro, e është shitur në Kinë 250 000 euro. Po, si ia kanë nisur hetimet, tak një shef atij policit hetues i ka thënë “rri trus, mos bëj hetime se ne t'i japim pak para”.

Prandaj, i dashur ministër, te ne në Drenicë thonë, “ishalla është ashtu qysh po thua ti”, ishalla e ndërton ti dhe Qeveria Haradinaj këtë termocentral. Ta dish se qytetarët qysh nuk e harrojnë Sali

Berishën që e ka bërë autostradën deri në Morinë e Fatmir Limajn deri në Prishtinë, edhe juve do të ju kujtojnë, pavarësisht a ju shajmë a s'ju shajmë juve.

Kështu që unë, në emër të Grupit “Nisma”, veç ju uroj suksese. Kaq! Nëse do dikush të polemizojë, këtu më keni rrafsh deri në mëngjes, nxjerr argumente të reja. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Musliu ka replikë, se ia ka përmendur emrin.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Përhëndetje për të gjithë kolegë deputetë!

Unë nuk dua të flas shumë, se mora mësim nga Milaimi, që tha nuk duhet bërë llaka-llaka, por duhet punuar. Milaim, merre iniciativën konkrete për t'i hetuar këto, unë e para do të të përkrah. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Milaim, urdhëro edhe ti!

MILAIM ZEKA: Faleminderit!

Jam shumë i bindur që ti nuk je e përzier në këto faqe të zeza kurrkund.

KRYESUESI: Zonja Nikoliq e ka fjalën.

MILJANA NIKOLIĆ: Poštovani,

Poslanička grupa Srpska lista je analizirala Energetsku strategiju Kosova za period od 2017. do 2026. godine i došla do sledećih zaključaka:

Sporazumom u najvećoj meri dominiraju stručne teme koje se odnose kao prvo na probleme u energetsom sektoru, kao drugo nemogućnosti za njihovo rešavanje, i kao treće, očekivani trendovi u energetsom sektoru. Međutim, analizom Poslanička grupa Srpska lista je uočila i velike nedostatke.

Prvo, u strategiji se ni na koji način ne uvažavaju obaveze Prištine preuzete sporazumom o energetici u okviru Briselskog sporazuma, koji je ratifikovan u Skupštini Kosova, i time uveden u pravni sistem. Pod dva, na strani 6 Energetske strategije se navodi: loše upravljanje preko granične razmene od operatora prenosnog sistema kao rezultat političke opstrukcije od strane operatora prenosnog sistema Srbije. Ova konstatacija nije tačna, jer Elektro-mreža Srbije u skladu sa dogovorima o energetici iz dijaloga tokom 2014. godine, potpisano sa KOST-om, kosovski operator prenosnog sistema potpisao je dva sporazuma. Prvi okvirni sporazum o saradnji februara meseca 2014. Godine, i drugi operativni sporazum o upravljanju mrežom i sistemom EMS-KOST, i to je bilo septembra meseca 2014. godine. A potom u okviru ENSO/e

oktobra meseca 2015. godine i SA, to jest sporazum o povezivanju KOST-a sa 36 operatora prenosnih sistema u okviru ENSO/e.

Stupanje na snagu SA ili sporazuma o povezivanju KOST-a sa 36 operatora uslovljeno je prethodnim licenciranjem kompanije elektro-sever od strane Prištine, član 16, i obaveza Prištine iz sporazuma o energetici. Dakle, KOST ne upravlja preko graničnom razmenom kao što još uvek nije postao zasebna kontrolna oblast, što po odredbama SA ili sporazuma o povezivanju KOST-a sa 36 operatora može da postane tek nakon licenciranja kompanije elektro-sever od strane Prištine. U strategiji se sve vreme brkaju pojmovi dobijanja statusa zasedne kontrolne oblasti sa članstvom u ENSO/e, koje je uslovljeno ispunjenjem standarda i kriterijuma ove organizacije. Licenciranje kompanije Eks-trgovina i Elektro-server kod Kosovske agencije za privredne registre nije rešeno od 2015. godine do danas. Četiri puta su podneti zahtevi. Kosovska agencija je četiri puta odbila da izvrši registraciju ova dva društva. U strategiji piše: nemogućnošću da se kontroliše sistem distribucije i snabdevanja u nekoliko opština na severu Kosova određena količina energije ostaje nefakturisana i to u meri od 5% od ukupne količine električne energije, kojom se tereti distributivni sistem. Ni ovo nije tačno.

Snabdevanje severa Kosova ne obavlja KOST, već se odvija iz proizvodnih kapaciteta javnog preduzeća Elektro-privrede Srbije, preko prenosnih kapaciteta Elektro-mreže Srbije. Strategija sadrži odredbu koja prejudicira pitanja vlasništva nad mrežom prenosnog sistema na severu Kosova. Treba uzeti u obzir da distributivne usluge koje bi trebalo da obavlja kompanija za snabdevanje električnom energijom Elektro-sever nije ni osnovana do dana današnjeg.

Zbog ovih primedbi i nedostataka, Poslanička grupa Srpska Lista ne podržava Energetsku strategiju Kosova za period od 2017-2026. godine. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Nuk e pata në plan të flas, por më stimuloi pak edhe Milaimi.

Tash i dëgjuam parafolësit që folën për këtë projekt dhe mendojmë se ky projekt fillimisht ka filluar në vitin 2007 dhe është stërzgjatur. Unë mendoj se shumë jemi vonuar dhe më lejoni ta përgëzoj së pari ministrin, të gjithë ata që kanë punuar në këtë projekt. Më çudit pak fakti qysh dikush qetësohet, kur e di shumë mirë se mbi 1 miliard e 300 milionë i kemi çuar në Serbi për të blerë rrymë. Po të kishim filluar në më 2007 ta ndërtojmë me investimet tona, sot ky projekt do të ishte i finalizuar, por meqenëse është një projekt investiv, unë veç ju përgëzoj dhe duhet ditur se mbi 11 mijë njerëz do të punësohen në këtë projekt.

Pra, është një projekt kapital, është në interes të Kosovës dhe mjaft më të dërgohen paratë tona jashtë Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Ju përshëndes të gjithëve, kolegët, ministrin, ministrat!

Me të vërtetë po më vjen mirë që po më vjen rendi edhe mua të flas dhe të ju përgëzoj për këtë projekt, pasi ky projekt ka filluar kaherë. Ky projekt është përgatitur kryesisht nga Qeveria apo qeveritë e kaluara dhe tani kjo ende po zgjat.

Mendoj se kjo duhet të ecën përpara. Duhet të ecën dhe ne duhet të bëjmë investime për ta zhvilluar vendin tonë, e për të mos blerë ditën a natën rrymë, por ta kemi rrymën tonë. Ajo që kisha dashur të them dhe t'i kërkoj ministrit që t'i kontrollojë investimet, që të bëhen këtu investimet, të mos na shkojnë me fryrje të pranimeve sikur kanë bërë në disa investime të mëhershme, e një prej tyre është edhe Aeroporti. Për KEDS-in u fol edhe më herët. Do të thotë se KEDS-i vetëm materialin që e ka pasur nëpër depo, kanë qenë afro 100 milionë, dhe është shitur për kurrjë hiç. Pse është shitur? Për arsye se hartimi i dokumentacionit është përgatitur që të mos ketë mundësi t'i afrohet konkurrencës vendore.

Prandaj, ky investim mendoj se është i mirëseardhur, e përkrahim fuqishëm dhe e përgëzoj ministrin dhe të gjithë të tjerët që ta shtojnë këtë projekt përpara. Kontrollojeni mirë, përcillen mirë, se ky projekt është për vendin tonë. Ne duhet t'i dalim zot vendit tonë. Kur bëhet investim i mirë, edhe ajo pjesë është patriotizëm, për arsye se po e zhvillon vendin tënd. Ne e përkrahim fuqishëm dhe ju përgëzojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka diskutues të tjerë. Qeveria nuk dëshiron ta marrë fjalën më.

Vazhdojmë me votimin e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës, 2017-2026.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë 73 deputetë.

Faleminderit! Kanë votuar 68 deputetë. 41 janë për, 18 kundër, 9 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës, 2017-2026.

Para se të kalojmë në pikën e radhës, dua t'i kaloj dy çështje që kanë të bëjnë me komisionet, në mënyrë që të mos vonohemi me këtë çështje, ose të mos shkoni pa u miratuar këto.

19. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare

Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Parlamentar, si në vijim:

Deputeti Nezir Çoçaj propozohet anëtar në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në vend të deputetit Agim Aliu.

Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar si në vijim:

Në Komisionin për Mbikëqyrjen Financiare Publike dhe në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës propozohet deputeti Muharrem Nitaj në vend të deputetit Blerim Kuçi.

Kërkoj nga ju që me ngritje dore të deklaroheni për propozimet e grupeve parlamentare të PDK-së dhe AAK-së. Besoj se jeni dakord të gjithë. Konstatoj se Kuvendi i miratoi propozimet e grupeve parlamentare të PDK-së dhe AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

20. Propozimi për emërimin e tre anëtarëve në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në mbështetje të Rregullores së Kuvendit dhe në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018, ka vendosur që seancës plenare t'ia procedojë propozim-vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e komisioneve parlamentare, datë 3 tetor 2017. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim plotësohet edhe me tre anëtarë.

Propozim-vendimi u është shpërndarë deputetëve.

Mendoj se s'ka nevojë për debat për këtë punë. Deputetët që do të jenë anëtarë të këtij komisioni janë: deputeti Haxhi Shala nga Grupi Parlamentar "Nisma për Kosovën"; deputeti Sllobodan Petroviq nga komuniteti serb dhe deputeti Veton Berisha nga komunitetet tjera. A jeni dakord edhe për këtë?

Konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës u krye. Kthehemi te pika e 17-të:

17. Përzgjedhja e një kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar listën e kandidatëve të propozuar, të përzgjedhur nga paneli përzgjedhës i Bankës Qendrore, për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nga kandidatët e propozuar.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Abdixhiku, që ta arsyetojë raportin e komisionit dhe ta sqarojë procedurën e votimit. Zoti Abdixhiku, e keni fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Në bazë të Ligjit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, paneli seleksionues i Bankës Qendrore për përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të BQK-së ka njoftuar se i ka zhvilluar të gjitha procedurat e konkursit dhe pas vlerësimit të integritetit të kualifikimeve profesionale dhe performansës së aplikantëve të ftuar për intervistë ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret formale dhe profesionale që kërkohen me Ligjin e BQK-së.

Kuvendi, në bazë të nenit 32.8 të Ligjit për BQK-në, përzgjedh kandidatin për pozitën e anëtarëve joekzekutivë të Bordit të BQK-së bazuar në rekomandimet e panelit seleksionues të BQK-së dhe pas konsultimit me Qeverinë, e cila brenda afatit të paraparë ligjor prej 15 ditësh ia ka dërguar Kuvendit mendimin, e cila është deklaruar se pajtohet me kandidatët e propozuar nga paneli seleksionues.

Me ligj nuk është e rregulluar mënyra e votimit në seancë plenare, pra nuk është saktësuar votimi i hapur apo i fshehtë. Gjithsesi, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka shqyrtuar propozimet e panelit seleksionues dhe ka vlerësuar se tre kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret formale-juridike të parapara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit, që me votim të fshehtë ta përzgjedhë njërin prej tre kandidatëve të propozuar. Kandidatët e propozuar janë:

1. Bedri Peci;
2. Flamur Mrasori dhe
3. Genc Rraci.

Kandidatët e përzgjedhur nga Kuvendi do t'i dërgohen Presidentit për miratim dhe emërim në pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, i ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin Votues.

“Vetëvendosje”, kë e propozoni?

GLAUK KONJUFCA: Saranda Bogujevcin.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i LDK-së? Avdullah!

AVDULLAH HOTI: Kryesues, Mirjeta Kalludra do të jetë përfaqësuese e LDK-së.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së?

ELMI REÇICA: Zëvendëskryetar, e kemi propozuar dje, është dikush... Ganimetja vjen pasi s'është kurrkush.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i AAK-së?

AHMET ISUFI: Ne e propozojmë Rasim Selmanajn.

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

Mi predlažemo eksperta iz redova Srpske liste za ove komisije, to jest Adem Hodža.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën”?

BILALL SHERIFI: E propozojmë Milaim Zekën.

KRYESUESI: Grupi “6+”?

FIKRIM DAMKA: Grupi Parlamentar “6+” e propozon deputetin Bahrim Shabani.

KRYESUESI: Faleminderit!

Ne kemi edhe pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës, që është votim i fshehtë, për ta kursye kohën unë kisha thënë që ta bëjmë votimin njëherazi për të dyja, po i marrin listën, njësojë është ajo punë, dy lista, i plotësoni një herë. Nëse jeni dakord ta kurseni kohën, nëse jo, unë nuk kam gjë.

A jeni dakord për t'i bërë të dyja përnjëherë, a jeni dakord edhe i njëjti komision të jetë për të dyja. Atëherë po e lexoj procedurën. Faleminderit!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar propozimin të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësuesve të Avokatit të Popullit dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit nga kandidaturat e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zonjën Duda Balje, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit. Nuk është. Zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2017 shqyrtoi propozim-vendimin e Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësve numër 102/217, datë 10 nëntor 2017 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto rekomandime.

Besoj i përcjell me kujdes, ngase shkohet në tri lista dhe ndoshta vëmendshëm do të shkojmë në mënyrë të saktë se si kërkohet votimi me ligj dhe rregullore.

Në një, rekomandohet Kuvendi që me votim të fshehtë të zgjedhë pesë zëvendësit e Avokatit të Popullit nga lista e propozuar nga Avokati i Popullit si në vijim.

Dy, për një pozitë të zëvendësit të Avokatit të Popullit nga radhët e gjinisë femërore propozohen:

1. Majlindë Sinani-Lulaj,
2. Afërdita Rexha,

Tre, për një pozitë të zëvendësit të Avokatit të Popullit nga radhët e komuniteteve joshumicë propozohen:

1. Aleksandra Dimitrijeviq,
2. Marija Radulloviq.

Pastaj nga pjesa katër, për tri pozita të zëvendësit të Avokatit të Popullit propozohen:

1. Albert Avdiu,
2. Murlan Prizreni,
3. Mehdi Geci,
4. Basri Berisha,
5. Baki Sfirca,

6. Naile Alaj dhe
7. Edona Hajrullahu.

Në bazë të paragrafit 2, të nenit 8 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, nëse asnjë kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, konsiderohet se asnjëri kandidat nuk është zgjedhur për zëvendës dhe Kuvendi e mbyll procesin e votimit, përveç nëse ka më shumë se dy kandidatë për një pozitë, përsëritet votimi.

Nëse në rundin e parë të votimit, sipas pikës 4 nuk plotësohen tri pozitat, atëherë votimi përsëritet vetëm për këta kandidatë.

Arsyetim: Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në bazë të nenit 10 të Ligjit për Avokatin e Popullit, neni 8 i Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit dhe zëvendësve të tij, ka shqyrtuar propozim-vendimin e Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësve që përbëhet prej 12 kandidatëve.

Në ndërkohë Institucioni i Avokatit të Popullit nga kandidati zoti Veton Vula ka pranuar njoftimin për tërheqjen nga lista e kandidatëve të propozuar dhe nisur nga ky fakt, Veton Vula nuk mund të konsiderohet pjesë e listës së kandidatëve, pra ju i keni këta kandidatë në lista dhe kjo konform ligjit dhe kërkesës që është parashtruar.

Zëvendësit e Avokatit të Popullit zgjidhen me mandat trevjeçar, me mundësi rizgjidhjeje.

Unë kisha lutur Kuvendin që vëmendshëm ta bëjë përzgjedhjen e duhur, nga se kjo çështje është zvarritur goxha kohë dhe zëvendësve u ka kaluar mandati që një kohë e gjatë.

Prandaj, ju ftoj në votim.

KRYESUESI: Faleminderit!

A pajtoheni me komisionin? A ka dikush kundër, nuk ka. Dakord.

Ju lus që komisioni ta zërë vendin dhe të fillojmë me procedurat paraprake dhe votimin.

Atëherë, po fillojmë, të nderuar deputetë, që t'ju ftoj me listën emërore, dy fletëvotimet i merrni njëherazi dhe i jepni dy nënshkrime për secilin fletëvotim:a

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albert Kinolli, Albin Kurti, Albulena Balaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Andin Hoti, Anton Çuni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta

Deliu, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekaliu, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Fitore Pacolli, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Abdyli, Haxhi Shala, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Milijana Nikoliq, Mimoza Kusari, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shëmsi Syla, Shkumbin Demalijaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Sllobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku, Valon Ramadani, Verica Çerçaniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsilović.

Unë i kam thirrur të gjithë, kush nuk ka votuar, ju lutem, ta merrni fletëvotimin.

GANIMETE MUSLIU: Të nderuar deputetë,

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 95 deputetë, ne do të fillojmë numërimin e fletëvotimit për zgjedhjen e një anëtarë joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Do t'i lexojmë emrat një nga një, kush jeni të interesuar, mund të jeni të vëmendshëm, gjithashtu edhe komisioni do ta kryejë punën e vet gjatë numërimit:

Genc Rraci
Bedri Peci
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Bedri Peci
Genc Rraci
Bedri Peci
E pavlefshme
Genc Rraci
Bedri Peci
E pavlefshme
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori

Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Bedri Peci
Bedri Peci
Genc Rraci
Bedri Peci
Bedri Peci
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Bedri Peci
Genc Rraci
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Genc Rraci
Genc Rraci
Renc Rraci
Genc Rraci
Genc Rraci
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Bedri Peci
Genc Rraci
Bedri Peci
Bedri Peci
Genc Rraci
Flamur Mrasori
Genc Rraci
Bedri Peci
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Bedri Peci
Bedri Peci
Flamur Mrasori

Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Genc Rraci
Genc Rraci
Genc Rraci
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Bedri Peci
Genc Rraci
Flamur Mrasori
Bedri Peci
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Genc Rraci
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Genc Rraci
Genc Rraci
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Genc Rraci
Bedri Peci
Bedri Peci
E pavlefshme
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Genc Rraci
Genc Rraci
Bedri Peci
Flamur Mrasori
Bedri Peci
Genc Rraci
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Flamur Mrasori
Genc Rraci

Flamur Mrasori
Flamur Mrasori.

Të nderuar deputetë,
Komisioni votues për përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës para seancës paraqet këtë:

R a p o r t

Rezultatet e votimit për përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38.2 të Ligjit numër 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar me vendim të Kuvendit më 25 janar 2018 në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar:

Saranda Bogujevci, “Vetëvendosje”,
Mirjeta Kalludra, LDK,
Ganimete Musliu, PDK,
Adem Hoxha, Lista serbe,
Rasim Selmanaj, AAK,
Milaim Zeka, “Nisma për Kosovën” dhe
Bahrim Shabani, Grupi “6+”.

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 25 janar 2018 konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë 95 deputetë, të pavlefshme janë 3 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuara janë si në vijim:

Bedri Peci, 31 vota,
Flamur Mrasori, 36 vota dhe
Genc Rraci, 25 vota.

Në bazë të konstatimit të komisionit, asnjëri nga kandidatët nuk është kualifikuar në këtë rund të votimit, prandaj dy kandidatët të cilët kanë marrë numër më të madh të votave, e që në këtë rast

janë Bedri Peci me 31 vota dhe Flamur Mrasori me 36 vota, shkojnë në rundin e dytë të votimit. Faleminderit!

SARANDA BOGUJEVCI: Përsëritet, tani do të bëjmë numërimin e votimit për përzgjedhjen e pesë anëtarëve të zëvendësve të Avokatit të Popullit. Vetëm për korrektësi, domethënë së pari do të bëjmë numërimin e pjesës së parë, pastaj pjesës së dytë, mandej vazhdojmë për pjesën e tretë:

E pavlefshme

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Afërdita Rexha

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Afërdita Rexha

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

E pavlefshme

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Afërdita Rexha

E pavlefshme

E pavlefshme

Afërdita Rexha

Afërdita Rexha

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj

Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
E pavlefshme
Majlindë Sinani-Lulaj
Afërdita Rexha
Afërdita Rexha
E pavlefshme
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Afërdita Rexha
Majlindë Sinani-Lulaj
Afërdita Rexha
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
E pavlefshme
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj

Afërdita Rexha
Afërdita Rexha
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Afërdita Rexha
Majlindë Sinani-Lulaj
E pavlefshme
Majlindë Sinani-Lulaj
E pavlefshme
Afërdita Rexha
Majlindë Sinani-Lulaj
Afërdita Rexha
Majlindë Sinani-Lulaj
Majlindë Sinani-Lulaj
Afërdita Rexha

Tani, vazhdojmë me pjesën e dytë:

Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq

Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
E pavlefshme
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq

Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
E pavlefshme
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Maria Raduloviq
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq
E pavlefshme
Maria Raduloviq
E pavlefshme
E pavlefshme
Aleksandra Dimitrijeviq
E pavlefshme
Maria Raduloviq
E pavlefshme
Aleksandra Dimitrijeviq
Aleksandra Dimitrijeviq

Vazhdojmë me pjesën e tretë:

Albert Avdiu

Mehdi Geci

Edona Hajrullahu

Albert Avdiu

Mehdi Geci

Edona Hajrullahu

Albert Avdiu

Basri Berisha

Naile Alaj

Albert Avdiu

Naile Alaj

Edona Hajrullahu

Albert Avdiu

Mehdi Geci

Edona Hajrullahu

Albert Avdiu

Mehdi Geci

Edona Hajrullahu

Murlan Prizreni

Mehdi Geci

Edona Hajrullahu

Mehdi Geci

Baki Svirca

Naile Alaj

Albert Avdiu

Mehdi Geci

Edona Hajrullahu

Albert Avdiu

Mehdi Geci

Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Naile Alaj

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Baki Svirca

Albert Avdiu
Murlan Prizreni
Mehdi Geci

Albert Avdiu
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Basri Berisha
Naile Alaj

Murlan Prizreni
Mehdi Geci
Basri Berisha

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Edona Hajrullahu
Mehdi Geci
Naile Alaj

Baki Svirca
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Naile Alaj
Albert Avdiu

Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Basri Berisha

Murlan Prizreni
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Baki Svirca

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Basri Berisha

Mehdi Geci
Basri Berisha
Naile Alaj

Mehdi Geci
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci

Mehdi Geci
Basri Berisha
Naile Alaj

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci

Baki Svirca

Edona Hajrullahu

Naile Alaj

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Murlan Prizreni
Mehdi Geci

Mehdi Geci

E pavlefshme

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

E pavlefshme

Mehdi Geci
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Basri Berisha

Albert Avdiu

Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci

Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Baki Svirca

Mehdi Geci
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Naile Alaj

Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu
Naile Alaj

Edona Hajrullahu

Naile Alaj

Mehdi Geci
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Naile Alaj

Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Baki Svirca
Edona Hajrullahu

Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Baki Svirca
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Baki Svirca
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Basri Berisha
Edona Hajrullahu

Albert Avdiu

Mehdi Geci
Naile Alaj

Edona Hajrullahu

Mehdi Geci
Basri Berisha
Naile Alaj

Albert Avdiu
Naile Alaj

Naile Alaj

Albert Avdiu
Mehdi Geci
Naile Alaj

Basri Berisha
Naile Alaj
Edona Hajrullahu

Naile Alaj

SARANDA BOGUJEVCI: Komisioni për zgjedhjen e pesë zëvendës-Avokatëve të Popullit
paraqet këtë:

R a p o r t

Në votim kanë marrë pjesë 95 deputetë. Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një pozitë të zëvendës-Avokatit të Popullit nga radhët e gjinisë femërore janë: Në konkurrencë kanë qenë Majlinda Sinani-Lulaj dhe Afërdita Rexhaj.

1. Majlindë Sinani-Lulaj, 72 vota dhe
2. Afërdita Rexhaj, 15 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një pozitë të zëvendës-Avokatit të popullit nga radhët e komuniteteve joshumicë janë:

1. Aleksandra Dimitrijeviq, 40 vota dhe
2. Marija Raduloviq, 48 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për tri pozita të zëvendës-Avokatit të Popullit janë:

1. Albert Avdiu, 38 vota,
2. Mulan Prizreni, 5 vota,
3. Mehdi Geci, 61 vota,
4. Basri Berisha, 20 vota,
5. Baki Svirca, 9 vota,
6. Naile Alaj, 34 vota dhe
7. Edona Hajrullahu, 58 vota.

Domethënë, kalojnë Mehdi Geci me 61 vota dhe Edona Hajrullahu me 58 vota.

Në rundin e dytë shkojnë Albert Avdiu dhe Naile Alaj, të tjerët janë të diskualifikuar.

KRYESUESI: Lus komisionin që të dalin për ta vazhduar procesin e votimit, të pozicionohen në tavolinën e tyre. Fletëvotimet i kemi të gatshme. Në qoftë se dëshironi, mund ta përshpejtoni procesin.

Regjia, fjalën...

GANIMETE MUSLIU: Lus anëtarët e Komisionit që të vijnë ta nënshkruajnë raportin dhe të vazhdojmë me rundin tjetër të votimit. Anëtarët e komisionit, ju lutem bashkëngjiteni!

KRYESUESI: A jeni gati?

Kadri Veseli, Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albert Kinolli, Albin Kurti, Albulena Balaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Andin Hoti, Anton Çuni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku, Drita Millaku, Driton Çaushti, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalio, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Fitore Pacolli, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Abdyl, Haxhi Shala, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Milijana Nikolij, Mimoza Kusari, Mirjeta Kalludra, Mufëra Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviç, Shëmsi Syla, Shkumbin Demalijaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Sllobodan Petroviç, Sërgjan Mitroviç, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku, Valon Ramadani, Verica Çerçaniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviç.

GANIMETE MUSLIU: Përshëndetje!

Vazhdon numërimi i votimit për përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ku në garë janë Flamur Mrasori dhe Bedri Peci në këtë rast.

Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,

Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
E pavlefshme,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
E pavlefshme,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
E pavlefshme,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,

Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
E pavlefshme,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
E pavlefshme,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Bedri Peci,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori,
Flamur Mrasori.

Të nderuar deputetë,

Komisioni votues për përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës paraqet këtë raport për rezultatet e votimit për përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38.2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit më 26 janar 2018, në përbërje nga një përfaqësues i secilit grup parlamentar: Saranda Bogujevci, “Vetëvendosje”; Mirjeta Kalludra, LDK; Ganimete Musliu, PDK; Adem Hoxha, Lista serbe; Rasim Selmanaj, AAK; Milaim Zeka, “Nisma për Kosovën”, dhe Bahrim Shabani, Grupi “6+”.

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në rundin e dytë, në seancën plenare, të mbajtur më 26 janar 2018, konstaton se në votim kanë marrë pjesë gjithsej 87 deputetë, të pavlefshme janë gjithsej 5 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Flamur Mrasori, 48 vota dhe
2. Bedri Peci, 34 vota.

Në bazë të rezultateve, komisioni konstaton se Flamur Mrasori e ka fituar garën për të qenë anëtar joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Vazhdojmë me leximin e rezultatin për zgjedhjen e një zëvendës-Avokatit të Popullit.

Për një pozitë të zëvendës-Avokatit të Popullit janë propozuar dhe kanë qenë në garë për votim Albert Avdiu dhe Naile Alaj. Shohim rezultatin, si në vijim:

Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Naile Alaj,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,

Naile Alaj,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Naile Alaj,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Naile Alaj,
Naile Alaj,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
E pavlefishme,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
E pavlefishme,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,
Naile Alaj,
Naile Alaj,
Albert Avdiu,
Albert Avdiu,

Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit, më 26 janar 2018, në përbërje të nga një përfaqësuesi të secilit grup parlamentar, si në vijim: Saranda Bogujevci, “Vetëvendosje”; Mirjeta Kalludra, LDK; Ganimete Musliu, PDK; Adem Hoxha, Lista serbe; Rasim Selmanaj, AAK; Milaim Zeka, “Nisma për Kosovën” dhe Brahim Shabani, Grupi “6+”.

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një zëvendës-Avokatit të Popullit në rundin e dytë, në seancën plenare, të mbajtur më 26 janar 2018, konstaton se në votim kanë marrë pjesë gjithsej 87 deputetë, të pavlefshme janë 5 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një pozitë të zëvendës-Avokatit të Popullit janë, si në vijim:

1. Albert Avdiu, 36 vota dhe
2. Naile Alaj, 46 vota.

Në bazë të rezultateve konstatojmë se këtë rund të votimit e ka fituar Naile Alaj për të qenë zëvendës-Avokate e Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Me kaq e mbyllim seancën e sotme. Mirupafshim në seancat e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*